BULETINI I BANKËS SË SHQIPËRISË

6-MUJORI 1, 2011

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Avni Rustemi", Nr.24, Tiranë.
Tel: 355-4-241 93 01/02/ 03; 355-4-241 94 01/2/3;
Faks: 355-4-241 94 08
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 650 kopje
Shtypur në shtypshkronjën AdelPrint

P Ë R M B A J T J A

Editorial
Projekti i binjakëzimit të Bankës së Shqipërisë me Bankën e Italisë dhe Bankën e Francës 5

Fjalime e prezantime të administratorëve të Bankës së Shqipërisë në aktivitete brenda e jashtë vendit 11

Analiza periodike
Informacion mbi disa tregues ekonomikë e monetar të rajonit të Evropës Qendrore-Lindore dhe Jug-Lindore 92
Doriana Lama, Priam Ramaj dhe Medvin Shehu

Analiza e ndërmjetësimit financiar 107
Erjona Suljoti, Sofika Note

Analizë e zhvillimeve në sektorin e jashtëm të ekonomisë Tremujori I-2011 118
Eglent Kika, Merita Boka

Artikuj
Tregtia aktuale dhe ajo potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë 125
Alban Pllaha

Vlerësimi i luhatshmërisë së rezervave valutore dhe shmangia nga niveli optimal: rasti i Shqipërisë 132
Gerti Shijaku

Ecuria e remitancave në Shqipëri për periudhën 1996-2010 dhe faktorët përcaktues të tyre 142
Esida Abazaj

Mikrokredia në Shqipëri 149
Alma Nako, Jonida Prifti

Banka e Shqipërisë në harkun kohor, janar-qershor 2011 156

Ngjarjet juridike, janar-qershor 2011 166

Drejtimi i Bankës së Shqipërisë, 30 qershor 2011 176

Bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë, deri në 30 qershor 2011 177

Publikime të botuara nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2011 181

EDITORIAL

PROJEKTI I BINJAKËZIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË ME BANKËN E ITALISË DHE BANKËN E FRANCËS

I. KONTEKSTI

Marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe BE-në u vendosën në vitin 1991 dhe u zhvilluan më tej me nënshkrimin e Marrëveshjes së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit në vitin 1992. Me mbajtjen e Këshillit Evropian të Selanikut, në qershor të vitit 2003 u nënvizua qartë perspektiva evropiane e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Shqipëria u konfirmua si vend kandidat potencial, për anëtarësim në BE.

Marrëdhëniet disavjeçare kaluan në një stad më të avancuar me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), në 12 qershor 2006. Procesi i ratifikimit u krye në më pak se tre vjet, me hyrjen në fuqi të MSA-së më datë 1 prill 2009, duke i hapur kështu rrugën Shqipërisë drejt aplikimit për anëtarësim në BE, për marrjen e statusit të vendit kandidat.

MSA-ja është një instrument i Strategjisë së Para-Aderimit të Bashkimit Evropian, drejtuar vendeve që aspirojnë anëtarësimin. Zbatimi i saj përbën një sfidë për vendin pasi i duhet të provojë se disponon kapacitetet e nevojshme për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga kjo marrëveshje. Vlen të theksohet se një rol të rëndësishëm në zbatimin e kësaj marrëveshje luajnë administrata qendrore dhe lokale, institucionet e pavarura e gjyqësori.

Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për zbatimin e dispozitave të MSA-së mbi të drejtën e vendosjes dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve/bankat; lirinë e lëvizjes së kapitalit dhe kryerjen e lirë të pagesave dhe transfertave korente; ruajtjen e stabilitetit makroekonomik (përmbushja e kriterit ekonomik të Kopenhagenit); si dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar, në fushat e sipërpërmendura.

Ndjekja e Strategjisë së BE-së për Para-Aderim përbën një pikënisje të mirë për institucionet shqiptare në drejtim të adoptimit të standardeve evropiane, në fushat e veprimtarisë së tyre si dhe në përafrimin e mëtejshëm të kuadrit legjislativ evropian. Për të përmbushur këtë detyrë me sukses, BE-ja mbështet institucionet shqiptare me ofrimin e asistencës së saj financiare, nëpërmjet Instrumenti të Para-Aderimit (IPA) dhe përkatësisht nëpërmjet Komponentit të Parë mbi Asistencën për Tranzicionin dhe Forcimin e Kapaciteteve Institucionale.

Ndër përfituesit e fondeve të IPA-s është dhe Banka e Shqipërisë, nëpërmjet Projektit të binjakëzimit 'Përforcimi i kapaciteteve institucionale të Bankës

së Shqipërisë në fushat e mbikëqyrjes bankare, statistikave, sistemeve të pagesave dhe implementimit të politikës monetare', i cili financohet nga Bashkimi Evropian me një shumë prej 1 milion euro. Vlen të theksohet se Banka e Shqipërisë përfiton për herë të parë asistencë financiare që Bashkimi Evropian ofron nëpërmjet Instrumentit të Para-Aderimit (IPA).

Projekti i binjakëzimit hyri në fazën e zbatimit pas përzgjedhjes së bankave binjakëzuese, të cilat qenë Banka e Italisë në partneritet me Bankën e Francës, si dhe zhvillimit të takimeve përgatitore të ekspertëve të huaj me ekspertët e Bankës së Shqipërisë, dhe me përfaqësuesit e sistemit bankar shqiptar.

II. PREZANTIMI I PROJEKTIT

Ceremonia e prezantimit të projektit të binjakëzimit u zhvillua në 23 mars 2011. Pjesëmarrës në ceremoni qenë përfaqësues të trupit diplomatik në Shqipëri, përfaqësues nga Banka e Italisë, Francës dhe Shqipërisë, si dhe përfaqësues të sistemit bankar në Shqipëri. Ndër të ftuarit e veçantë bënin pjesë Shefi i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri z.Ettore Sequi dhe Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së Italisë, z.Fabrizio Saccomanni.

III. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT TË BINJAKËZIMIT

Qëllimi kryesor i projektit është të asistojë Bankën e Shqipërisë në procesin e përafrimit të kuadrit ligjor dhe rregullator me *acquis*-në e Bashkimit Evropian si dhe përafrimin e praktikave të saj me standardet e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Ky projekt mbështetet gjerësisht në prioritetet që rrjedhin prej MSA-së, të cilat synojnë ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, përforcimin e kuadrit rregullativ dhe atij ligjor të sektorit bankar si dhe monitorimin e përgjithshëm të sektorit financiar, dhe përmirësimin e zhvillimin e mëtejshëm të statistikave të ndryshme ekonomike.

Aktivitetet e parashikuara në projekt do të realizohen nëpërmjet vizitave studimore periodike të ekspertëve të Bankës së Shqipërisë pranë Bankës së Italisë dhe të Francës, si dhe vizitave të ekspertëve të huaj në Bankën e Shqipërisë. Gjithashtu, përgjatë 18 muajve të zbatimit të projektit, z. Rocco Schiavone është atashuar pranë Bankës së Shqipërisë si Këshilltar i Përhershëm i Projektit.

Në vijim do të hedhim një vështrim mbi modulet përkatëse të projektit dhe aktiviteteve kryesore që ato mbulojnë.

IV. MODULET E PROJEKTIT TË BINJAKËZIMIT

1. Mbikëqyrja dhe stabiliteti financiar

Mbikëqyrja bankare, si një ndër veprimtaritë më të rëndësishme të Bankës së Shqipërisë, do të jetë një nga fushat që përfitojnë nga ky projekt. Tregu

bankar është një treg që zhvillohet gjithnjë e më shumë, për t'iu përgjigjur sa më mirë ndryshimeve të brendshme dhe hyrjes në treg të shërbimeve dhe produkteve të reja. Për këtë, nevojitet që në sektorin e mbikëqyrjes bankare të kryhen përmirësime të vazhdueshme, në përputhje me zhvillimet më të fundit globale. Përditësimi i kuadrit rregullativ dhe zhvillimi i kapaciteteve mbikëqyrëse do të jenë një ndër bazat themelore të këtij projekti. Krahas kësaj, synohet edhe përmirësimi i vazhdueshëm i parashikimeve analitike në fushën e stabilitetit financiar.

Aktivitetet e projektit për këtë modul do të përqendrohen si në trajnimin e punonjësve të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Stabilitetit Financiar, ashtu edhe në ofrimin e asistencës teknike, në drejtim të zhvillimit të instrumenteve ose manualeve të nevojshme të mbikëqyrjes bankare.

Aktivitetet trajnuese trajtojnë çështje në lidhje me mbikëqyrjen e rreziqeve bankare, si: administrimi i likuiditetit, rreziku operacional, modelet e brendshme të vlerësimit, çështjet kryesore të IFRS-së (si për shembull, vlerësimi IAS39 i instrumenteve financiarë) dhe sistemet e avancuara mbikëqyrëse të raportimit, kuadrin rregullator të Bazel-it dhe kritereve të Direktivës së Mjaftueshmërisë së Kapitalit (Shtylla I, II dhe III), udhëzimet më të reja në lidhje me stres-testet dhe treguesit e paralajmërimit të hershëm.

Programi i asistencës teknike dhe këshillimeve synon gjithashtu krijimin e tetë produkteve të nevojshme për përparimin e mbikëqyrjes bankare, në fushat e sistemeve të mbikëqyrjes së ekzaminimit bankar; rishikimit të rregulloreve dhe formateve të raportimit; mbikëqyrjes makro-prudenciale dhe mbështetjesme infrastrukturë teknologjike.

Zbatimi i suksesshëm i aktiviteteve të këtij moduli do të sjellë progres në përafrimin e mëtejshëm me standardet ndërkombëtare të mbikëqyrjes dhe në plotësimin e kritereve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke kontribuar kështu në evoluimin e sistemit të mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë në një model më cilësor, më të integruar, më informues për sistemin bankar. Ky përmirësim do të mbështet në përditësimin e kuadrit rregullator dhe ndjekjen e praktikave më të mira.

2. Edukimi financiar

Objektivi i modulit 'Edukimi Financiar' është zhvillimi i aktiviteteve të punës hulumtuese në këtë fushë, duke u mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe përvojën evropiane.

Në zbatim të këtij objektivi, do të zhvillohen anketime me qëllim matjen e kulturës së përgjithshme financiare në Shqipëri si dhe matjen e efektivitetit të aktiviteteve edukuese të Bankës së Shqipërisë, për arsimin e mesëm. Duke marrë shkas nga rëndësia në rritje e edukimit financiar në mbarë botën, pjesë e këtij moduli do të jetë edhe organizimi i një konference të nivelit të lartë, për të sjellë në Shqipëri eksperiencat më të mira ndërkombëtare dhe iniciativat e ndryshme në këtë drejtim.

3. Statistikat

Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore të sektorit të jashtëm dhe të statistikave monetare dhe financiare. Objektivi i modulit për statistikat është të mundësojë krijimin e një infrastrukture moderne për përpilimin e tyre të ndryshme makroekonomike në Bankën e Shqipërisë, sidomos në fushën e bilancit të pagesave.

Aktivitetet që i përkasin këtij moduli do të jenë trajnimet, asistenca teknike si dhe këshillimet në lidhje me statistikat BP/PIN, duke u përqendruar veçanërisht në Investimet Direkte dhe të Portofolit, si dhe në trajnimet më specifike *on-job* (në vendin e punës) mbi metodat e mbledhjes së të dhënave, pyetësorët, regjistrat e bizneseve, instrumentet e informatikës për mbledhjen e të dhënave, etj.. Kështu, do të zhvillohet një model për përmirësimin e cilësisë së sistemeve statistikore BP/PIN, në përputhje me standardet evropiane. Gjithashtu, ky modul do të trajtojë çështje në lidhje me statistikat financiare, me qëllim lehtësimin e procesit të raportimit, në mënyrë që të mbulohen edhe transaksionet e sistemit bankar.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i aktiviteteve të parashikuara, ndër të tjera, janë: rritja e kapaciteteve njerëzore në drejtim të adoptimit të formave të reja të mbledhjes së të dhënave, përpilimit të anketimeve dhe implementimit të masave shtrënguese në lidhje me respektimin e afatit të përgatitjes, dhe publikimit të të dhënave BP/PIN;rritja e bashkëpunimit me INSTAT-in; dhe përsa i përket statistikave financiare, rritja e fushës së mbulimit të tyre si dhe përdorimi i tyre gjatë procesit të vendimmarrjes në politikat ekonomike.

4. Sistemi i pagesave

Përsa i përket modulit të sistemit të pagesave, projekti parashikon një rishikim të kuadrit rregullativ, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e tij në përshtatje të plotë me direktivat dhe praktikat aktuale të Bashkimit Evropian në këtë fushë, si dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore në fushën e mbikëqyrjes së sistemit të pagesave.

Aktivitetet e modulit do të përqendrohen në zhvillimin e instrumenteve dhe metodologjisë së aktiviteteve të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave. Në fushat e sistemeve të pagesave dhe infrastrukturës do të synohet rritja e kapaciteteve njerëzore, në lidhje me administrimin e sistemeve të shlyerjeve të pagesave dhe përdorimin gradual të metodave dhe procedurave të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ).

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i aktiviteteve të parashikuara do të jenë përgatitja në lidhje me hartimin dhe përditësimin e kuadrit rregullativ, veçanërisht përsa i përket çështjeve të mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, manualeve operacionale përkatëse dhe adoptimit të Direktivës së Shërbimeve të Pagesave. Gjithashtu do të synohet përforcimi i procedurës së administrimit të kolateralit

dhe të shlyerjes së titujve, në përputhje me standardet e SEBQ-së; implementimi i një sistemi automatik të shlyerjeve të titujve dhe zbatimi i procedurave të reja.

5. Tregu ndërbankar

Zhvillimi i mëtejshëm i tregut ndërbankar përbën një objektiv të rëndësishëm për përmirësimin e mekanizimit të transmetimit të politikës monetare në ekonominë e vendit.

Për këtë arsye, aktivitetet e këtij moduli synojnë realizimin e tre objektivave kryesorë. Objektivi i parë ka të bëjë me promovimin e mëtejshëm të tregut ndërbankar të parasë, duke identifikuar strategjitë dhe iniciativat e mundshme për angazhimin e operatorëve të tregut të parasë, zhvillimin e tregut dytësor të bonove të qeverisë dhe përcaktimin e zgjedhjeve të programeve informatike, si platformë tregtuese në tregun ndërbankar. Objektivi i dytë lidhet me rritjen e kapaciteteve njerëzore në drejtim të zhvillimit të tregut të kolateralizuar të parasë, duke u përqendruar veçanërisht në detyrat operacionale të Bankës së Shqipërisë në këtë treg, mbikëqyrjen e tij, si dhe në metodologjitë vlerësuese të kolateralit. Objektivi i tretë lidhet me hartimin e parimeve themelore të manualeve të brendshme, që kanë të bëjnë me aktivitetin e mbikëqyrjes së tregut ndërbankar të parasë.

Zbatimi i këtij moduli do të hedhë bazat për krijimin e një tregu ndërbankar të parasë likuid dhe reagues ndaj vendimeve të politikës monetare, një objektiv madhor ky që kërkon bashkëpunimi të mëtejshëm me institucionet e tjera të vendit.

6. Koordinimi i procesit të integrimit evropian

Objektivi i modulit, 'Koordinimi i Procesit të Integrimit Evropian', do të zbatohet tërësisht nga Banka e Francës. Ai konsiston në zhvillimin dhe zotërimin e instrumenteve të nevojshëme koordinuese të procesit të integrimit evropian, me qëllim përgatitjen e takimeve në nivel evropian, si dhe koordinimin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Banka e Francës do të ofrojë eksperiencën e saj në organizimin e takimeve në nivel evropian dhe administrimin e procesit të përafrimit të legjislacionit bankar me acquis communauitare.

Zbatimi i aktiviteteve të këtij moduli do të përqendrohet në rritjen e nivelit të kualifikimit të stafit të Bankës së Shqipërisë, duke pasur në konsideratë edhe hapat e mëtejshëm të procesit të integrimit evropian që rrjedhin nga zbatimi i MSA-së, përafrimi me Sistemin Evropian të Bankave Qendrore, përfitimi i statusit të vendit kandidat për anëtarësim dhe hapja e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian. Gjithashtu, do të synohet rritja e efektivitetit të aktiviteteve koordinuese në drejtim të përfaqësimit të suksesshëm të institucionit tonë në SEBQ dhe BQE, dhe e zhvillimit të instrumenteve koordinues përkatës.

V. PËRFUNDIMI I PROJEKTIT

Kohëzgjatja e projektit është 18 muaj, i cili është parashikuar të përfundojë brenda gjysmës së parë të vitit 2012. Ashtu si është shprehur edhe z. Ettore Sequi, Banka e Shqipërisë do të ndihmohet nga bankat qendrore të Italisë dhe të Francës për tu përgatitur për integrimin ekonomik në Bashkimin Evropian, pasi ky projekt është pikërisht një hap drejt integrimit ekonomik me vendet anëtare të Bashkimi Evropian.

Pas realizimit të tij, Banka e Shqipërisë do të ketë përmirësuar kuadrin organizativ dhe atë operacional të departamenteve të saj kryesore, duke iu afruar kështu simotrave evropiane.

FJALIME E PREZANTIME TË ADMINISTRATORËVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË AKTIVITETE BRENDA E JASHTË VENDIT

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në takimin rajonal me përfaqësuesit e pushtetit vendor, të sektorit bankar, të komunitetit të biznesit të Qarkut të Shkodrës dhe me akademikë të Universitetit "Luigj Gurakuqi",
1 janar 2011

Zonja dhe zotërinj,

Banka e Shqipërisë gjykon se komunikimi me publikun përbën një hallkë të rëndësishme për transmetimin efektiv të vendimmarrjes së saj. Për këtë arsye, ajo shfrytëzon të gjitha format e komunikimit, por kontakti i drejtpërdrejtë me njerëzit na mundëson perceptimin dhe interpretimin real të qëndrimeve dhe të pritshmërive të tyre dhe mbështet një proces më efektiv të vendimmarrjes. Për këtë arsye, ndjehem mjaft mirë që gjendem sërish në qytetin tuaj, si qendra e një rajoni me vlera të mirënjohura intelektuale, kulturore e patriotike, që jep një kontribut të rëndësishëm në prodhimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Do të dëshiroja që në këtë komunikim me ju, të bëja fillimisht një analizë të përmbledhur të zhvillimeve ekonomike n ë vend dhe në vijim, të ndalesha në disa çështje më konkrete që ndikojnë në fortësinë e marrëdhënies mes familjeve e bizneseve, nga njëra anë, dhe sistemit financiar e sektorit bankar, nga ana tjetër. Gjatë vitit 2010, ekonomia shqiptare pritet të ketë regjistruar një rritje të kënaqshme. Në tremujorin e tretë të vitit të kaluar, rritja ekonomike vjetore vlerësohet në masën 4.9 %.

Ecuria e normës së rritjes ekonomike në dy vitet e fundit ka qenë e qëndrueshme, duke provuar kështu një nivel të mirë rezistence ndaj ndikimit të krizës ekonomike ndërkombëtare. Treguesit e tjerë makroekonomikë janë luhatur rreth vlerave të pranueshme dhe të pritshme. Vlen të theksohet se ky stabilitet makroekonomik pasqyron ndërthurjen e suksesshme të politikave bazë ekonomike, asaj monetare me atë fiskale, gjatë vitit të kaluar.

Më konkretisht, politika fiskale ka synuar dhe ka realizuar një proces të nevojshëm konsolidimi, pas një ekspansioni fiskal që ka shoqëruar zhvillimet ekonomike, në vitin 2009. Konsolidimi fiskal është realizuar nëpërmjet kontrollit më të mirë mbi shpenzimet publike dhe mbledhjes së të ardhurave pranë nivelit të parashikuar.

Kursi i këmbimit të monedhës kombëtare, me gjithë nënçmimin që ka pësuar në vitin 2009, e më pak, në vitin 2010, ka qenë shumë më i qëndrueshëm se monedhat e vendeve të tjera të Evropës Juglindore, të cilat zbatojnë politikën e një kursi këmbimi lirisht të luhatshëm. Nënçmimi gradual i lekut, vlerësohet se ka patur një ndikim pozitiv në pakësimin e deficitit tregtar dhe atë të llogarisë korente, nëpërmjet vendosjes së një dinamike më të favorshme për ecurinë e eksporteve dhe të importeve të ekonomisë sonë.

Tashmë, vërtetohet plotësisht se adoptimi i regjimit fleksibël të kursit të këmbimit ka qenë një nga zgjedhjet më të spikatura të politikave ekonomike financiare të dy dekadave të fundit.

Rritja vjetore e çmimeve të konsumit ka qenë pothuaj gjatë gjithë kohës brenda kufijve të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, prej 2-4 %. Në kushtet e presioneve të moderuara inflacioniste, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare lehtësuese, duke injektuar likuiditet në tregun ndërbankar dhe duke ulur normën bazë të interesit, në nivelin 5 %. Për vitin 2011, ecuria e treguesve makroekonomikë, pritet të jetë e ngjashme me atë të vitit 2010. Banka e Shqipërisë gjykon se harmonizimi i suksesshëm i vitit të kaluar, i politikës monetare me atë fiskale, duhet të vazhdojë më tej edhe në vitin 2011. Politika fiskale dhe ajo monetare, duhet të synojnë qëndrueshmërinë e këtyre treguesve, duke mbështetur gjithashtu, rritjen ekonomike. Ndikimi i faktorëve të kërkesës dhe të ofertës mbi kursin e këmbimit të monedhës kombëtare, pritet të jetë i ekuilibruar. Presionet inflacioniste parashikohen të jenë të moderuara gjatë këtij viti, ndonëse ecuria e çmimeve të mallrave të importuara paraqet një burim të qartë rreziku.

Banka e Shqipërisë, do të ruajë fleksibilitetin e politikës së saj monetare, për t'i paraprirë çdo zhvillimi të mundshëm në ecurinë e inflacionit.

Të nderuar pjesëmarrës,

Në vazhdim, dëshiroj të ndalem pak më hollësisht në ecurinë e sektorit bankar dhe në disa çështje që Banka e Shqipërisë i konsideron me rëndësi për rolin që ky sektor luan në ndërmjetësimin financiar dhe marrëdhënien me publikun, me një përfitim të dyanshëm. Vitet e fundit sektori bankar, si forca mbizotëruese e sistemit financiar, ka qenë mbështetës i fuqishëm i rritjes ekonomike të vendit, nëpërmjet një roli aktiv në ndërmjetësimin financiar. Sigurisht, veprimtaria bankare ka rreziqet e saj, por kriza financiare ndërkombëtare e tre viteve të fundit, provoi se sektori bankar në vendin tonë ishte i qëndrueshëm dhe nuk pati nevojë për ndihmë publike në përballimin e situatës. Në vitin e kaluar, situata financiare e sektorit bankar vlerësohet, përgjithësisht, më e mirë se ajo e vitit paraardhës. Me gjithë rritjen e vlerës së kredive me probleme, sektori bankar ka shënuar një rezultat financiar disa herë më të lartë se ai i vitit 2009.

Situata e likuiditetit është përmirësuar dukshëm, në kushtet e rritjes së qëndrueshme të depozitave. Për këtë arsye, nevojat e sektorit bankar për likuiditet nga Banka e Shqipërisë, janë pakësuar ndjeshëm.

Sektori bankar është i mirëkapitalizuar, në sajë të kujdesit për zgjerimin e veprimtarisë dhe rritjes së kapitalit nga ana e aksionerëve. Pavarësisht nga kjo ecuri e mirë e veprimtarisë së sektorit bankar, ka disa drejtime që kërkojnë përmirësim të shpejtë, për të cilat Banka e Shqipërisë ka përqendruar veprimtarinë e saj mbikëqyrëse.

Drejtimi i parë lidhet me nevojën për zgjerim të veprimtarisë së kreditimit

dhe përmirësim të cilësisë së saj. Të dy këto elementë mund të mbështesin njëri-tjetrin, nëse veprohet në mënyrë të kujdesshme.

Zgjerimi i ritmeve të kreditimit do të mbështetet më mirë gjatë vitit 2011, në sajë të dy zhvillimeve të rëndësishme, siç janë, përmirësimi i ndjeshëm i situatës së likuiditetit dhe prirja rënëse e normave të interesit edhe për kredinë në lek. Shenjat e para të një ecurie më pozitive, u dhanë në dy muajt e fundit të vitit 2010, kur ritmi vjetor i kredidhënies u përshpejtua dukshëm.

Nga ana tjetër, cilësia e kredisë mbetet problematike, por një përmirësim gradual pritet të shënohet gjatë këtij viti.

Përfitoj edhe një herë nga ky rast, për të ripërsëritur kërkesën tonë që bankat të jenë aktive në trajtimin e kredive me probleme për mbledhjen e tyre. Për kreditë që vlerësohen pa shpresë arkëtimi, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e rregullativ, bankat duhet të veprojnë për ekzekutimin e kolateralëve.

Në këtë proces ka nevojë për përmirësime të mëtejshme ligjore, për të pakësuar rrezikun e bankave në veprimtarinë e kreditimit dhe për të siguruar ulje të kostos së tij për klientët. Ky proces është i nevojshëm për të pastruar bilancet e bankave nga investime që rëndojnë ato dhe për të çliruar burime që do të përdoreshin për kredi të reja.

Në këtë kuadër, monitorimi i cilësisë së kreditimit dhe i sjelljes apo vështirësive që ndeshin bankat në këtë proces, është në qendër të veprimtarisë mbikëqyrëse.

Drejtimi i dytë lidhet me koston e shërbimeve bankare për klientët. Për këtë çështje, Banka e Shqipërisë ka kryer analizat e nevojshme, të cilat kanë arritur në përfundimin se kostot e disa produkteve dhe shërbimeve bankare, duke përfshirë pagesat dhe transfertat, kartat e debitit dhe të kreditit, si edhe disa forma të tjera të kreditimit, mund të jenë më të ulëta.

Lidhur me këtë çështje, ne jemi përqendruar në dy aspekte:

Së pari, në rritjen e transparencës së sektorit bankar në marrëdhënien me klientët, për këto shërbime. Për këtë çështje, kemi vendosur tashmë në zbatim kërkesat për ndërtimin e metodologjive të caktuara për përcaktimin e kostos efektive të kredisë dhe përcaktimin e saktë të detyrimeve kontraktuale në marrëdhënien me klientët. Bankave ju kërkohet të ofrojnë të gjithë informacionin dhe shpjegimet e nevojshme për klientët e interesuar. Gjithashtu, në të njëjtën logjikë, nga bankat do të kërkojmë ndërtimin e metodologjive për përcaktimin e kostos së shërbimeve bankare, që lidhen kryesisht me pagesat dhe transfertat e ndryshme.

Në këtë mënyrë, për klientët do të jetë më e thjeshtë të bëjnë krahasimin mes kushteve që ofrojnë institucione të ndryshme bankare e, kështu, të bëjnë zgjedhjen e tyre mbështetur në alternativën më të favorshme.

Në mënyrë që kjo të funksionojë sa më mirë, nevojitet që edhe vetë klientët të ushtrojnë kujdesin e duhur për njohjen sa më të saktë të kushteve të vendosura nga bankat për produktet dhe shërbimet që ato ofrojnë. Aty ku është e nevojshme, në këtë proces, mund të kërkohet edhe asistencë e jashtme më e specializuar.

Së dyti, Banka e Shqipërisë synon të ofrojë një stimul konkret në këtë proces për bankat tregtare, duke ulur më tej kostot me të cilat ato përballen për përdorimin e sistemeve të pagesave, AIPS dhe AECH, gjatë transaksioneve në lek, për llogari të tyre apo të klientëve të tyre.

Ne besojmë që nëpërmjet një politike më konkurruese në vendosjen e çmimit të këtyre produkteve nga ana e sektorit bankar, jo vetëm mund të përfitojnë më shumë klientët, por mund të realizohet një rritje e numrit të tyre dhe të gjenerohet një rritje e të ardhurave për vetë sektorin bankar.

Drejtimi i tretë, në të cilin jemi përqendruar, lidhet me forcimin e kërkesave për rritjen e përgjegjshmërisë në drejtimin e institucioneve bankare, duke kërkuar në mënyrë të përsëritur që profesionalizmi, dedikimi dhe përgjegjshmëria të shndërrohen në një kulturë pune për të gjithë personelin e institucioneve bankare.

Për këtë çështje, në mënyrë të vazhdueshme po rishikojmë proceset nëpërmjet të cilave bankat realizojnë vendimmarrjen, sigurojnë kontrollin e veprimtarive të caktuara e të raportimit të tyre brenda institucionit, si dhe ndërveprojnë me publikun.

Sistemet e kontrollit të brendshëm janë ato që përcaktojnë, në masën më të madhe, aftësinë e institucionit për të operuar në mënyrë të sigurt. Ato janë të domosdoshme për të shmangur çdo lloj hapësire që mund të shfrytëzohet për veprime abuzive në dëm të institucionit.

Për këtë arsye, në komunikimet e rregullta me bankat, Banka e Shqipërisë ka kërkuar që ato të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme; në para, njerëz dhe teknologji; për të garantuar sigurinë e çdo veprimi bankar.

Në përfundim, dua të theksoj se Banka e Shqipërisë do të jetë gjithmonë në lartësinë e kërkuar nga publiku, për të plotësuar, në çdo kohë, përgjegjësitë ligjore, në drejtim të realizimit të qëndrueshmërisë së nivelit të çmimeve dhe të sektorit bankar. Në këtë proces, nevojitet që autoritetet shtetërore dhe veçanërisht sistemi i drejtësisë, të ofrojnë bashkëpunimin e nevojshëm duke e vlerësuar çështjen e sistemit bankar si çështje me prioritet të lartë, nga ku varet zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë së vendit, në të ardhmen. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë i bën apel të gjithë faktorëve të lidhur që të përshpejtojnë reformat strukturore, të lidhura me titullin e pronësisë dhe ekzekutimin e kolateralit, si dhe të ndërmarrin një sërë rregullimesh të tjera të natyrës administrativo-burokratike që ndikojnë në rritjen e kostove të sistemit bankar.

Duke ju ftuar në një diskutim të hapur rreth këtyre çështjeve, ju falënderoj për vëmendjen!

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 26 janar 2011

Sot, në datën 26 janar 2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin e Politikës Monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2010.

Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e financiare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritshme të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5.00 për qind. Këshilli Mbikëqyrës i gjykon kushtet monetare aktuale të përshtatshme për përmbushjen e objektivit të inflacionit në afat të mesëm.

Në vijim, do të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike, si dhe të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme, të cilat motivuan vendimin e mësipërm.

***

Ekonomia shqiptare ka patur një ecuri pozitive gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2010. Aktiviteti ekonomik ka vijuar të shënojë rritje, ndërkohë që balancat kryesore makroekonomike janë përmirësuar dhe primet e rrezikut e normat e interesit në tregjet financiare kanë rënë. Rritja ekonomike gjatë vitit 2010 është mbështetur kryesisht nga kërkesa e huaj për mallrat e shërbimet shqiptare, ndërkohë që megjithë zhvillimet pozitive, ecuria e konsumit dhe e investimeve në vend mbetet e dobët. Presionet inflacioniste mbeten të kontrolluara, si pasojë e ekzistencës së kapaciteteve të lira në ekonomi dhe e pritjeve të ankoruara inflacioniste. Zgjerimi i shpejtë i eksporteve dhe rritja e moderuar e importeve kanë sjellë një përmirësim të deficitit tregtar dhe të atij të llogarisë korrente, duke ndihmuar në balancimin e kërkesës dhe të ofertës për valutë dhe në rritjen e qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit.

Politika monetare dhe fiskale kanë përcjellë një stimul të kujdesshëm makroekonomik. Tërheqja e stimulit fiskal gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit mundësoi ndjekjen e një politike monetare më stimuluese, nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit në muajin korrik dhe përcjelljes më të plotë të saj në tregjet financiare gjatë periudhës në vijim.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga përmirësimi i treguesve të likuiditetit dhe nga rënia e normave të interesit në pothuajse të gjithë harkun e instrumenteve financiarë. Nga ana tjetër, ndjekja e një politike të kujdesshme fiskale ka mundësuar respektimin e niveleve të parashikuara të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik gjatë vitit 2010.

Zhvillimet e mësipërme pritet të mbarten në vija të përgjithshme edhe gjatë vitit 2011. Rritja ekonomike pritet të mbetet në nivele të krahasueshme me rritjen ekonomike të vitit 2010, por ajo pritet të udhëhiqet në një masë më të madhe nga kërkesa e brendshme.

Sistemi bankar është në pozitë mjaft më të mirë se gjatë dy viteve të shkuara për të mbështetur me fonde financiare rritjen e konsumit e të investimeve në vend.

Nga ana tjetër, presionet inflacioniste parashikohet të jenë të kontrolluara, deficiti buxhetor e borxhi publik pritet të konsolidohet më tej, ndërsa pozicioni i jashtëm i ekonomisë pritet të jetë më i qëndrueshëm. Respektimi i kësaj tabloje ka implikime të rëndësishme për politikëbërësit e agjentët ekonomikë, të cilat do t'i trajtoj më në detaje në vazhdim.

Zhvillimet më të fundit në ekonominë botërore karakterizohen nga vijimi i rritjes ekonomike në pjesën më të madhe të vendeve të zhvilluara dhe të atyre në zhvillim. Në vendet e zhvilluara, rritja ekonomike ka rezultuar më e ulët si rrjedhojë e masave të marra për konsolidimin e financave publike dhe tërheqjen e stimulit fiskal. Ndërkohë, ekonomitë e vendeve në zhvillim kanë ruajtur ritme më të larta rritjeje, duke zgjeruar kërkesën e tyre për lëndë të para e për mallra konsumi dhe duke shtuar kështu presionet inflacioniste në nivel botëror.

Rritja ekonomike pritet të vazhdojë edhe në vitin 2011, por pasiguritë mbi të mbeten të larta. Zhbalancimet makroekonomike në nivel global, të shfaqura në nivele të larta të deficitit tregtar të disa vendeve të zhvilluara, mund të materializohen në goditje mbi kursin e këmbimit mes monedhave kryesore dhe mbi shkëmbimet e lira tregtare në botë.

Gjithashtu, shqetësimet mbi nivelin e borxhit publik dhe qëndrueshmërinë fiskale të disa prej vendeve të eurozonës vazhdojnë të ndikojnë ndjeshmërinë e tregjeve financiare dhe tolerancën e tyre ndaj rrezikut. Megjithë tendencat e fundit rritëse, balanca e presioneve inflacioniste vlerësohet se do të jetë e përmbajtur edhe në vitin në vazhdim, si pasojë e vijimit të ekzistencës së kapaciteteve të pashfrytëzuara.

Ruajtja e lëvizjes së lirë të mallrave e të kapitalit në nivel botëror, marrja në kohë e masave korrektuese ndaj ecurisë së borxhit publik, si dhe ndërtimi i mekanizmave efektivë për parandalimin dhe zbutjen e efekteve të krizave financiare në nivel lokal, do të jenë sfida të rëndësishme për politikëbërësit. Nga ana tjetër, politika monetare e bankave qendrore kryesore do të vijojë të jetë e kujdesshme, duke përcjellë në ekonomi stimulin e duhur monetar për nxitjen e aktivitetit ekonomik, por pa cënuar ecurinë aktuale dhe të pritur të inflacionit.

Ekonomia shqiptare regjistroi ritme pozitive rritjeje edhe në tremujorin e tretë të vitit. Sipas të dhënave të raportuara nga INSTAT-i, rritja reale vjetore e PBB-së shënoi nivelin 4.9%, duke qenë më e lartë se vlerat e regjistruara në dy tremujorët e parë të vitit. Përmirësimi i aktivitetit ekonomik është mbështetur më shumë nga sektori i tregtisë, i turizmit dhe i shërbimeve të tjera. Sektori

i industrisë ka ruajtur të njëjtin kontribut në rritjen ekonomike, ndërkohë që aktiviteti i sektorit të ndërtimit vazhdon të kontraktohet për të katërtin tremujor radhazi. Zhvillimet në komponentët e kërkesës ndjekin tendencat e shfaqura prej tyre që nga fillimi i vitit dhe janë në linjë me vlerësimet tona të mëparshme. Të dhënat e disponuara sugjerojnë se rritja e aktivitetit ekonomik ka vijuar të nxitet në një masë të madhe nga kërkesa e huaj, ndërkohë që konsolidimi fiskal gjatë gjashtëmujorit të dytë ka dhënë në mënyrë të parashikueshme një ndikim ngadalësues në aktivitetin ekonomik. Ecuria e konsumit dhe e investimeve private mbetet e ngadaltë edhe gjatë gjysmës së dytë të vitit, megjithë përmirësimin e kushteve të financimit të aktivitetit të tyre. Konsumi privat vazhdon të kushtëzohet nga një sjellje hezituese e konsumatorëve në kryerjen e shpenzimeve dhe nga një mbështetje e pakët e tyre me kredi bankare. Rritja e pagave, e punësimit dhe e remitancave në ekonomi, nuk janë faktorizuar plotësisht në optimizmin e individëve për të ardhmen, sikurse dështmohet nga nivelet e ulëta të indeksit të besimit konsumator edhe për tremujorin e tretë të vitit 2010.

Nga ana tjetër, kërkesa e ngadaltë konsumatore dhe prania e kapaciteteve të pashfrytëzuara në ekonomi nuk kanë nxitur bizneset për kryerjen e investimeve të reja. Megjithatë, me përmirësimin e kushteve të financimit dhe me rritjen e mëtejshme të kërkesës, investimet private, ndryshe nga dy tremujorët e parë të vitit, vlerësohet të kenë dhënë një kontribut pozitiv në tremujorin e tretë të tij.

Politika fiskale ka patur një sjellje të kujdesshme gjatë vitit 2010, duke synuar kontrollin e deficitit buxhetor dhe të nivelit të borxhit publik. Deficiti buxhetor i realizuar deri në fund të muajit nëntor të këtij viti ishte 23.1 miliardë lekë, duke shënuar një tkurrje prej 64%, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Reduktimi i deficitit buxhetor prej rreth 4 pikësh përqindjeje të PBB-së, i ndodhur gjatë vitit 2010, ka treguar një konsolidim fiskal të shfaqur si në fushën e të ardhurave publike, të cilat u rritën me 9.6% deri në muajin nëntor, ashtu edhe të shpenzimeve buxhetore, të cilat u ulën me 4.8% gjatë së njëjtës periudhë. Në veçanti, reduktimi i deficitit buxhetor dhe kontrolli i huamarrjes publike në tregjet e brendshme financiare ka ndikuar në përmirësimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe në rënien e normave të interesit në tregun financiar. Vijimi i kësaj tendence edhe gjatë vitit 2011 do të ishte një zhvillim i mirëpritur për ekonominë shqiptare. Banka e Shqipërisë gjykon se filozofia e kujdesit e ndjekur gjatë vitit 2010 në kryerjen e shpenzimeve buxhetore dhe në huamarrjen publike duhet të jetë e pranishme edhe gjatë vitit në vijim.

Kërkesa e huaj ka vijuar të mbështesë rritjen e aktivitetit ekonomik edhe gjatë tremujorëve të tretë e të katërt të vitit. Gjatë periudhës janar – nëntor 2010, u regjistrua një ngushtim i deficitit tregtar me rreth 9.2% në terma vjetorë, i cili erdhi si pasojë e rritjes me rreth 58% të eksporteve. Nga ana tjetër, importet shënuan një rritje më të moderuar – rreth 6.4 për qind – gjatë njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit. Përmirësimi i deficitit tregtar të vendit është favorizuar nga ecuria e nënçmuar e kursit të këmbimit, nga rritja e moderuar e kërkesës së brendshme, por edhe nga faktorë klimaterike dhe konjukuturale të tregjeve botërore të cilët kanë mbështetur eksportet shqiptare.

Megjithatë, kontributi i kërkesës së huaj neto në rritjen ekonomike të tremujorit të tretë vlerësohet të jetë më i pakët në krahasim me gjysmën e parë të vitit. Përmirësimi vjetor i deficitit tregtar me 10.7% në tremujorin e tretë rezultoi më i ulët se ai i regjistruar në dy tremujorët e parë të vitit 2010. Gjithashtu, ecuria e tregtisë së mallrave në dy muajt e parë të tremujorit të katërt të këtij viti dëshmon gjithashtu për një kontribut më të ulët të ekonomisë së jashtme edhe në tremujorin e katërt të vitit 2010. Tendenca rritëse e importeve dhe ngadalësimi i pritur i ritmit të rritjes së eksporteve mund të frenojnë procesin e korrektimit të bilancit të jashtëm tregtar të ekonomisë, dhe do të zvogëlojnë ndikimin e tij në rritjen ekonomike të vitit 2011. Në aspektin e politikave makroekonomike, këto zhvillime sugjerojnë se politikat e forta stimuluese të ekonomisë mund të amortizohen nga rritja e shpejtë e importeve që shoqëron rritjen e kërkesës së brendshme. Në aspektin strukturor, këto zhvillime ritheksojnë nevojën e vijimit të reformave strukturore, të cilat duhet të orientojnë ekonominë shqiptare drejt një modeli më të qëndrueshëm zhvillimi dhe një konkurrueshmërie më të lartë në tregjet botërore. Ndër të tjera, këto reforma duhet të synojnë edhe krijimin e një ambienti të përshtatshëm për tërheqjen e flukseve të qëndrueshme të kapitalit, në formën e investimeve të huaja direkte apo hyrjeve të tjera afatgjata të kapitalit.

Rritja e mëtejshme e kërkesës agregate ka bërë që ekonomia shqiptare të lëvizë më afër potencialit të saj prodhues, por duke mbetur gjithsesi dukshëm poshtë saj. Për rrjedhojë, presionet rënëse mbi inflacion kanë vijuar të jenë prezente edhe gjatë gjysmës së dytë të vitit. Inflacioni vjetor mesatar rezultoi 3.1% në tremujorin e katërt të viti, duke rënë me 0.4 pikë përqindjeje nga vlera mesatare e tij për tremujorin e tretë dhe duke iu afruar kështu objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ecuria e inflacionit gjatë vitit 2010 është ndikuar nga rritja e çmimeve të administruara, tendenca rritëse e çmimeve të mallrave bazë, të produkteve ushqimore dhe të naftës në tregjet ndërkombëtare, apo tendencat nënçmuese të kursit të këmbimit.

Rritja në 3.4% e inflacionit vjetor në muajin dhjetor u kushtëzua pikërisht nga rritja e çmimeve të produkteve bujqësore, në reflektim të lëvizjes së tyre rritëse në tregjet botërore. Megjithatë, pritjet e ankoruara për stabilitetin e çmimeve dhe presionet disinflacioniste nga ekonomia reale kanë balancuar veprimin e faktorëve të mësipërm të ofertës mbi inflacionin, duke frenuar përcjelljen e tyre në efekte të raundit të dytë dhe presione të qëndrueshme inflacioniste.

Banka e Shqipërisë gjykon se norma e inflacionit pritet të luhatet rreth objektivit tonë prej 3 për qind, gjatë gjithë vitit të ardhshëm. Efekti rritës mbi inflacion i faktorëve të ofertës do të balancohet nga rritja ekonomike nën potencial dhe ekzistenca e kapaciteteve të pashfrytëzuara në ekonomi.

Presionet e përmbajtura inflacioniste, si dhe ndjekja e një politike fiskale të kontrolluar, krijuan hapësira për rritjen graduale të stimulimit monetar në ekonomi gjatë vitit 2010. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi uljen e normës bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje në muajin korrik, duke e çuar atë në nivelet më të ulëta historike prej 5.0%. Paralelisht me këtë lëvizje, Banka e Shqipërisë ka furnizuar tregun ndërbankar me likuiditetin e nevojshëm për funksionimin normal të tregjeve financiare.

Në aspektin operacional, ndryshimi i formës së objektivit tonë në muajin qershor i ka shërbyer orientimit më të mirë të operacioneve të rifinancimit me likuiditet të sistemit bankar, duke sjellë uljen e primit të likuiditetit në sistem dhe një orientim më të mirë të normave të interesit të tregut ndërbankar. Tregjet financiare kanë qenë më të qeta dhe primet e rrezikut në to kanë ardhur në rënie. Normat e interesit në tregun primar ka vijuar prirjen rënëse të shfaqur që një vit më parë, në reflektim të kërkesës së moderuar të sektorit fiskal për financim dhe të situatës së mirë të likuiditetit të sistemit bankar. Ndërkohë, ulja e normës bazë është ndjekur në një masë të kënaqshme edhe nga normat e interesit të depozitave dhe kredive në lekë, duke mundësuar kështu përcjelljen e mirë të vendimmarrjes së politikës monetare në ekonomi.

Përtej një transmetimi më të mirë të vendimeve të politikës monetare në normat e interesit të tregjeve financiare gjatë gjashtëmujorit të dytë, Banka e Shqipërisë gjykon se përcjellja e tyre në ekonominë reale mbetet ende jo e plotë. Duke iu referuar zhvillimeve në kreditimin e ekonomisë gjatë pjesës së dytë të vitit, kredia për sektorin privat është rritur mesatarisht me të njëjtat ritme si edhe në pjesën e parë të tij. Rritja vjetore e kredisë në muajin nëntor shënoi 10.1%, duke qenë pothuajse në të njëjtin nivel si dhe në fund të gjashtëmujorit të parë. Rritja e kredisë për sektorin privat me norma të ngadalta ka dhënë një kontribut të ulët në zgjerimin monetar në ekonomi, duke rikonfirmuar presionet e përmbajtura inflacioniste nga ekonomia e brendshme. Rritja e parasë së gjerë M3 i është afruar mesatares së saj afatgjatë në tremujorin e katërt të vitit, duke shënuar 11.9% dhe duke marrë kryesisht formën e depozitave me afat në sistemin bankar.

Megjithëse bankat nuk kanë shtrënguar më tej kushtet e kredisë, madje gjatë gjysmës së dytë të vitit ka patur shenja të lehtësimit të tyre, kërkesa për kredi nga sektori privat ka qenë e ngadaltë. Kjo e fundit mbetet e ulët si pasojë e ekzistencës së kapaciteteve të pashfrytëzuara të prodhimit për bizneset, dhe rritjes së tendencës konsumatore për kursim nën perceptimin e një pasigurie të shtuar për të ardhmen dhe adoptimit të një sjelljeje më të kujdesshme ndaj konsumit aktual. Ulja e primeve të rrezikut në tregjet financiare, ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike, të punësimit dhe të pagave, si dhe qartësimi i perspektivës afatshkurtër e afatmesme të ekonomisë pritet të ndihmojnë në rritjen e kërkesës për kredi gjatë periudhës së ardhshme. Sistemi bankar i plotëson parakushtet e nevojshme, në terma të likuiditetit, kapitalizimit, dhe kushteve më të favorshme të financimit, për t'iu përgjigjur kësaj kërkese.

Projeksionet tona për të ardhmen mbështesin ruajtjen e ecurisë pozitive të ekonomisë sonë edhe në vitin 2011. Rritja e kërkesës pritet të jetë funksion i ecurisë krahasimisht më të mirë të kërkesës së brendshme gjatë këtij viti. Konsumi dhe investimet private pritet të rriten më tej, ndërkohë që pas ngadalësimit në vitin 2010, edhe sektori fiskal pritet të japë një kontribut pozitiv në rritjen ekonomike. Pavarësisht kësaj, rritja e kërkesës vlerësohet se do të jetë nën potencialin e ekonomisë sonë edhe për vitin 2011. Kjo do të kushtëzojë presione rënëse mbi inflacion nga ekonomia e brendshme, të cilat pritet të balancojnë efektin e rritjes së çmimeve të huaja dhe atyre të administruara.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 23 shkurt 2011

Sot, në datë 23 shkurt 2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritshme të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5.00 për qind. Në opinionin e Këshillit, kushtet monetare aktuale janë të përshtatshme për përmbushjen e objektivit të inflacionit në horizontin afatmesëm dhe për mbështetjen e aktivitetit ekonomik në vend.

Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike, si dhe të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.

* * *

Të dhënat më të fundit nga ekonomia botërore konfirmojnë momentin pozitiv të aktivitetit ekonomik në ekonomitë e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Megjithë tërheqjen graduale të stimujve fiskalë e monetarë, rritja ekonomike ka qenë e qëndrueshme, si pasojë e gjallërimit të kërkesës së sektorit privat në vendet në zhvillim.

Nga ana tjetër, kërkesa e shtuar ka nxitur rritjen e çmimeve të lëndëve të para, të mallrave bazë dhe të artikujve ushqimorë, duke ndikuar në zhvendosjen e presioneve inflacioniste në kahun rritës. Megjithatë, inflacioni i çmimeve të konsumit në nivel botëror mbetet ende i përmbajtur, për sa kohë që ekonomitë e mëdha vazhdojnë të karakterizohen nga rritje ekonomike nën potencial. Tregjet financiare botërore janë duke u përmirësuar, por ato janë ende mjaft të ndjeshme ndaj perspektivave fiskale të ekonomive të veçanta dhe ndaj tensioneve në eurozonë. Gjithashtu, këto tregje shfaqin një vëmendje krahasimisht të ulët për vendet e Evropës Juglindore, ku bën pjesë edhe Shqipëria.

Në tërësi, rritja ekonomike botërore pritet të mbetet në nivele të larta edhe për periudhën në vazhdim, duke kontribuar gjithashtu në nxitjen e presioneve inflacioniste dhe duke rritur vëmendjen e autoriteteve monetare ndaj ekuilibrave makroekonomikë.

Zhvillimet ekonomike e monetare në vend kanë vijuar të prodhojnë një ambient me presione të kontrolluara inflacioniste. Inflacioni vjetor në muajin janar 2011 rezultoi 3.3%, duke rënë me 0.1 pikë përqindjeje në krahasim me dhjetorin e vitit 2010. Rënia e inflacionit në muajin janar është diktuar

tërësisht nga efekti statistikor i shuarjes së ndikimit rritës në inflacion të disa çmimeve të administruara. Nga ana tjetër, mallrat ushqimorë dhe nafta kanë patur një rritje të ndjeshme çmimesh, si pasojë e rritjes së çmimeve në tregjet botërore. Këta faktorë kanë dhënë një kontribut prej rreth 80 për qind në formimin e shifrës së inflacionit. Rritja e çmimeve të produkteve bujqësore ka prekur më shumë shtresat me të ardhura të ulëta të shoqërisë shqiptare.

Ashtu siç e theksova edhe më parë, presionet inflacioniste në vend kanë natyrën e goditjeve afatshkurtra të ofertës, ndërsa inflacioni i gjeneruar nga kërkesa e brendshme është i ulët, siç reflektohet edhe në ecurinë relativisht të qëndrueshme të inflacionit bazë. Kjo ecuri kushtëzohet nga ekzistenca e kapaciteteve të pashfrytëzuara në ekonominë shqiptare si dhe ekspansioni i kontrolluar monetar dhe pritjet e ankoruara inflacioniste të konsumatorëve, të biznesit e të agjentëve të tregut financiar. Banka e Shqipërisë gjykon se, në vija të përgjithshme, këta faktorë do të vazhdojnë të jenë të pranishëm edhe gjatë vitit 2011.

Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë në parashikimin e inflacionit në të ardhmen ka faktorizuar edhe parashikimet e deritanishme të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatës Botërore të Ushqimit për ecurinë e naftës dhe mallrave ushqimorë. Në mungesë të goditjeve të shtuara dhe të paparashikueshme nga ana e ofertës apo të shfaqjes së fenomeneve zinxhir të raundit të dytë, ecuria e inflacionit pritet të jetë në linjë me objektivin e Bankës së Shqipërisë.

Në vijim të fjalës time do të paraqes një analizë më të detajuar të zhvillimeve aktuale e të pritshme në ekonominë shqiptare e në tregjet financiare, duke vlerësuar edhe implikimet e tyre për ecurinë e pritur të inflacionit të çmimeve të konsumit.

Aktiviteti ekonomik

Në mungesë të të dhënave direkte dhe duke gjykuar mbi një sërë treguesish të tërthortë, Banka e Shqipërisë vlerëson se ekonomia shqiptare ka vijuar të rritet edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2010. Rritja ekonomike është mbështetur kryesisht nga kërkesa e huaj për eksportet shqiptare.

Megjithatë, edhe kërkesa e brendshme ka shfaqur shenja gjallërimi së fundi, sikurse dëshmohet nga ecuria pozitive e kredisë bankare, nga tregues indirektë të konsumit, si dhe nga përmirësimi i treguesit të ndjesisë ekonomike të biznesit e konsumatorit shqiptar.

Konsumi dhe investimet private, dy përbërësit më të rëndësishëm të kërkesës agregate, kanë patur një ecuri të ngadaltë gjatë vitit 2010. Megjithëse të ardhurat e disponueshme të konsumatorit shqiptar vlerësohet të jenë rritur në terma realë, pasiguria e lartë dhe kushtet e shtrënguara të kreditimit të aplikuara nga sistemi bankar kanë frenuar konsumin në vend. Nga ana tjetër, biznesi shqiptar është përballur me një kërkesë të pamjaftueshme për shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve të tij, si dhe me një rritje të kostos së financimit. Kjo

ecuri është ndjerë më shumë në sektorë të caktuar të ekonomisë, si ndërtimi, i cili mbështetet tërësisht në kërkesën e brendshme, dhe më pak në sektorë të tjerë, si industria, e cila gjeneron një pjesë më të madhe të aktivitetit të saj nga kërkesa e huaj. Në këto rrethana, ritmi i investimeve ka qenë relativisht i ulët, krahasuar me vitet e mëparshme. Banka e Shqipërisë vlerëson se konsumi dhe investimet në vend do të kenë një ecuri më të mirë gjatë vitit në vazhdim.

Kushtet e financimit të kërkesës së sektorit privat paraqiten të përmirësuara, ndërkohë që primet e rrezikut në tregjet financiare paraqiten më të ulëta dhe pasiguria për të ardhmen duhet të vijë në rënie. Gjithashtu, ndikimi i pritur pozitiv i kërkesës së huaj dhe i politikës fiskale gjatë vitit 2011, pritet të stimulojnë kërkesën e brendshme.

Korrektimi i sjelljes fiskale është shoqëruar me një kontribut më të ulët në rritjen ekonomike përgjatë vitit 2010. Kështu, shpenzimet publike janë tkurrur me rreth 5% në terma vjetorë, ndërsa deficiti buxhetor është ulur me rreth 4 pikë përqindjeje të PBB-së. Banka e Shqipërisë e ka theksuar gjithnjë se qëndrueshmëria fiskale është një parakusht themelor për një rritje afatgjatë ekonomike. Në këtë kontekst, ne mendojmë se respektimi i objektivave të buxhetit për deficitin buxhetor dhe huamarrjen publike gjatë vitit 2011 do të japë një kontribut pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit. Ruajtja e niveleve relative të deficitit buxhetor do të eliminojë ndikimin negativ direkt në rritjen ekonomike, ndërsa nivelet relativisht të ulëta të huamarrjes publike do të ndikojnë në kontrollin e normave afatgjata të interesit dhe uljen e primeve të rrezikut në tregjet financiare.

Këto zhvillime u manifestuan gjatë gjysmës së dytë të vitit 2010 dhe pritet të nxitin kërkesën e brendshme edhe gjatë vitit të 2011.

S ektori i jashtëm i ekonomisë ka vijuar të karakterizohet nga një kontribut pozitiv, por në rënie, i kërkesës së huaj në rritjen ekonomike. Ritmi i korrektimit të deficitit tregtar është zbehur në këtë tremujor. Deficiti tregtar është ulur me 1.2% kundrejt normave dyshifrore të korrektimeve të regjistruara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010. Kjo ecuri e deficitit tregtar është përcaktuar kryesisht nga përshpejtimi i importeve, të cilët shënuan një rritje vjetore prej 10.8% në tremujorin e katërt të vitit 2010, duke regjistruar njëkohësisht rritje për të tretin tremujor radhazi. Nga ana tjetër, eksportet shqiptare u rritën me 48.8% në terma vjetorë, duke ruajtur ritme të larta rritjeje.

Banka e Shqipërisë gjykon se ekonomia shqiptare do ta ketë të vështirë të ruajë të njëjtat norma rritjeje të eksporteve edhe gjatë vitit 2011; ndër të tjera ky parashikim reflekton faktorët e përkohshëm që ndikuan në rritjen e vitit 2010 dhe është në linjë me ecurinë e ekonomisë botërore dhe me efektet bazë statistikorë. Megjithatë, kërkesa e huaj pritet të japë një kontribut pozitiv në rritjen ekonomike edhe gjatë vitit 2011.

Treguesit monetarë, tregjet financiare dhe inflacioni

Ecuria e treguesve monetarë vazhdon të prodhojë presione të kontrolluara

inflacioniste me natyrë monetare në ekonominë vendase. Oferta monetare u rrit me 12.5% në muajin dhjetor të vitit të kaluar, duke reflektuar ecurinë e mirë të depozitave të sistemit bankar gjatë gjithë gjysmës së dytë të këtij viti. Vlerësimet tona tregojnë se zgjerimi monetar është në përputhje me kërkesën e sektorit privat të ekonomisë për para reale. Ecuria e mirë e aktivitetit ekonomik dhe primet në rënie të rrezikut janë reflektuar edhe në rritjen e kërkesës për kredi të sektori privat. Parametrat e kënaqshëm të sistemit bankar në terma të likuiditetit dhe të kapitalizimit kanë mundësuar një mbështetje më të madhe të sektorit privat me kredi bankare. Në muajin dhjetor, rritja e kredisë për sektorin privat shënoi 10.6% në terma vjetorë. Përtej bizneseve private, të cilët kanë qenë përdoruesit kryesorë të financimit me kredi gjatë vitit 2010, sinjale pozitive vijnë edhe nga konsumatorët, kërkesa për kredi e të cilëve është rritur në tremujorin e fundit të vitit të kaluar.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga prime në rënie të rrezikut dhe të likuiditetit, reflektuar në rënien e mëtejshme të yield-eve në tregun primar dhe të normave interesit në tregun e depozitave e kredive në lekë. Në tregun ndërbankar, normat afatshkurtra të interesit kanë qëndruar pranë normës bazë të interesit dhe kanë shfaqur luhatshmëri të ulët. Tregtimi i valutës në tregun vendas ka qenë gjithashtu i qetë. Leku ka vijuar të nënçmohet në terma nominalë vjetorë kundrejt monedhave të huaja, por me ritme më të buta krahasuar me vitin 2010.

* * *

Duke vënë në balancë informacionin e përmbledhur më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se presionet inflacioniste në periudhën afatmesme mbeten të kontrolluara. Ecuria e çmimeve të konsumit në të ardhmen pritet të jetë nën presionin e rritjes së çmimeve në tregjet botërore, por, në mungesë të efekteve të raundit të dytë, ndikimi i tyre pritet të jetë kalimtar. Nga ana tjetër, kërkesa ende e pamjaftueshme do të vazhdojë të kushtëzojë nivele nën potencial të shfrytëzimit të kapaciteteve në vend, duke ushtruar presione në kahun rënës mbi inflacion.

Pritjet inflacioniste vazhdojnë të jenë të ankoruara rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë për inflacionin. Në mungesë të goditjeve të papritura, inflacioni pritet të jetë afër objektivit të Bankës së Shqipërisë në periudhën afatmesme. Banka e Shqipërisë, në vazhdim, do të monitorojë natyrën e këtyre goditjeve të jashtme dhe përcjelljen e tyre në çmimet në vend, për të reaguar në kohë me qëllim eliminimin e presioneve të qëndrueshme inflacioniste.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës konkludoi se kushtet monetare paraqiten të përshtatshme për respektimin e objektivit të inflacionit në periudhën afatmesme dhe vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5.00 %.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 23 mars 2011

Sot, në datë 23 mars 2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike dhe financiare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit. Pas kësaj rritjeje, norma bazë e interesit shkon në nivelin 5.25 %.

Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike, si dhe të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.

***

Ekonomia botërore karakterizohet nga shenja të qarta rritjeje gjatë tremujorit të parë të vitit 2011. Vendet në zhvillim mbeten udhëheqëset e rritjes ekonomike botërore, ndërkohë që ekspansioni ekonomik në vendet e zhvilluara është më i zbehtë. Ekonomia e Eurozonës, vendet anëtare të së cilës janë edhe partnerët tanë kryesorë tregtarë, ka vijuar të rritet gjatë kësaj periudhe. Kjo ekonomi vazhdon të përjetojë gjithashtu tensione të rritura financiare dhe rritje të ulët ekonomike në vendet periferike të saj. Projeksionet për të ardhmen flasin për forcimin e mëtejshëm të ekonomisë botërore, por kjo rritje do të kushtëzohet dukshëm nga procesi i korrektimit fiskal të ndërmarrë në shumë vende si dhe nga tendecat rritëse të inflacionit.

Nga ana tjetër, gjallërimi i kërkesës botërore, probleme strukturore me ofertën, si dhe faktorë klimaterikë apo zhvillime gjeopolitike në rajone të caktuara, kanë çuar në rritjen e çmimeve të lëndëve të para dhe të mallrave bazë. Kjo rritje çmimesh është bërë veçanërisht e ndjeshme për produktet bujqësore e agroindustriale, duke i risjellë indekset e tyre pranë rekordeve historike të shënuara në vitin 2008. Për rrjedhojë, presionet inflacioniste janë shtuar dhe çmimet e konsumit kanë pësuar tendenca të forta rritëse.

Këto zhvillime janë reflektuar edhe në ekonominë shqiptare. Nën ndikimin e fortë të rritjes së çmimeve në tregjet botërore, norma vjetore e inflacionit kërceu në nivelin 4.5 për qind në muajin shkurt, duke sinjalizuar për një përcjellje më të madhe të presioneve inflacioniste në tregun e brendshëm. Ndërsa kahu i lëvizjes së inflacionit ishte i pritur dhe i komunikuar nga Banka e Shqipërisë, shpejtësia e rritjes së tij nuk ishte. Në këndvështrimin e kompozimit të shportës, rritja e inflacionit në muajin shkurt u shkaktua nga rritja e çmimeve të ushqimeve dhe të produkteve energjetike. Në veçanti, inflacioni i ushqimeve të përpunuara dhe të papërpunuara është përgjegjës për rreth 70

për qind të inflacionit total, ndërsa rritja e çmimeve të administruara kontribuoi me 0.4 pikë përqindjeje në këtë inflacion. Ndikimi i rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore në inflacion është më i ndjeshëm në vendet në zhvillim, si Shqipëria, ku këto produkte kanë një peshë të konsiderueshme në shportë. Nga ana tjetër, pesha e konsiderueshme bën që rritja e këtyre çmimeve të transmetohet edhe në rritjen e inflacionit bazë, inflacion i cili u rrit në 3.2 për qind në muajin shkurt, dhe të zhvendosë në kahun rritës pritjet inflacioniste në ekonomi. Grupet e tjera të shportës kanë dhënë një ndikim më të vogël në inflacion, por kontributi i disa prej tyre ka ardhur në rritje.

Në kontekstin makroekonomik, rritja e inflacionit në muajin shkurt i detyrohet pothuajse tërësisht presioneve të shtuara inflacioniste me origjinë nga ekonomia e jashtme ndërkohë që presionet inflacioniste nga ekonomia e brendshme vijojnë të jenë të kontrolluara. Zhvillimet në ekonominë reale vazhdojnë të rezultojnë në kapacitete të lira prodhuese, si në tregun e punës ashtu edhe në atë të kapitalit, dhe në një hendek ende negativ prodhimi.

Duke kaluar në vlerësimin e ekonomisë së brendshme, duhet theksuar se gjykimi jonë mbi ecurinë e ekonomisë reale mbetet përgjithësisht i njëjtë me atë të muajve të mëparshëm. Mbulimi me shifra i ekonomisë reale në muajt e parë të vitit është i ulët, por të dhënat indirekte të disponuara sugjerojnë se ritmet pozitive të rritjes janë mbartur edhe në tremujorin e parë të këtij viti. Të dhënat më të fundit nga tregtia e jashtme dhe sektori fiskal, kanë konfirmuar pritjet tona për një kontribut të shtuar të kërkesës së brendshme në rritjen ekonomike. Ky kontribut i detyrohet në një masë të madhe rritjes së shpenzimeve publike dhe të deficitit buxhetor gjatë tre muajve të parë, duke reflektuar dhe duke i paraprirë një pozicioni më stimulues të politikës fiskale në kërkesën agregate të vitit 2011.

Në terma sasiorë, shpenzimet buxhetore u rritën me 14% në terma vjetorë në muajin janar, në sajë të rritjes me rreth 8 për qind të shpenzimeve korente dhe të rritjes me 40 për qind të shpenzimeve kapitale. Konsumi dhe investimet private vlerësohet të jenë rritur me ritme të përmbajtura, duke dhënë një kontribut të ulët në kërkesën e brendshme. Të dhënat më të fundit mbi sektorin e jashtëm të ekonomisë tregojnë për një kontribut në rënie të kërkesës së huaj në kërkesën agregate në tremujorin e fundit të vitit të kaluar. Deficiti i eksporteve neto u zgjerua me 2.3%, si rrjedhojë e rritjes më të lartë të importeve në këtë tremujor. Të dhënat e tregtisë së jashtme për muajin janar ecin gjithashtu në të njëjtën linjë. Eksportet e mallrave kanë ruajtur ritmet e larta të rritjes, duke u rritur me 53.8% në terma vjetorë ndërsa importet kanë shënuar një rritje vjetore prej 19.3%. Këto zhvillime kanë rezultuar në zgjerimin në terma vjetorë të deficitit tregtar me rreth 3.0%.

Analiza e zhvillimeve monetare konfirmon vlerësimet e deritanishme për presione të kontrolluara me natyrë monetare në afat të mesëm. Ritmet e rritjes nominale të ofertës monetare u zbutën në 11.5%, duke qenë rreth 1 pikë përqindje më të ulëta se ato të muajit dhjetor. Rritja e depozitave në sistemin bankar vijon të jetë e qëndrueshme dhe gjendja e likuiditetit në të është e përmirësuar.

Nga ana tjetër, me gjithë shenjat e gjallërimit të shfaqura së fundmi, kreditimi i ekonomisë po rritet me ritme të ngadalta. Rritja vjetore e kredisë në muajin janar shënoi 9.8%, në reflektim të njëkohshëm të kërkesës së moderuar për kredi dhe të sjelljes sezonale të saj në muajt e parë të vitit. Informacioni i marrë nga tregjet financiare dëshmon gjithashtu për prime të ulëta të rrezikut dhe të likuiditetit. Normat e interesit në tregun ndërbankar kanë marrë vlera pranë normës bazë të interesit dhe kanë shfaqur luhatshmëri të ulët. Në tregun primar, yield-et kanë shënuar një rritje të lehtë, duke reflektuar kërkesën më të lartë të sektorit fiskal për financim dhe duke korrektuar kështu një pjesë të rënies së fortë të shfaqur prej tyre gjatë dy muajve të fundit të viti të kaluar. Tregu valutor ka qenë gjithashtu i qetë dhe ecuria e kursit të këmbimit karakterizohet nga një nënçmim mjaft i ulët vjetor.

***

Në vijim të mbledhjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë diskutoi mbi ecurinë aktuale dhe të pritur të inflacionit. Në opinionin e Këshillit, rritja e shpejtë e inflacionit në muajin shkurt sugjeron se presionet nga inflacioni i importuar paraqiten më të larta sesa vlerësimet tona fillestare dhe efekti i tyre është duke u transmetuar më i plotë.

Presionet inflacioniste kanë përgjithësisht origjinë të huaj dhe natyrën e goditjeve të ofertës. Por, masa e importimit të presioneve të jashtme inflacioniste dhe materializimi i shpejtë i tyre në çmimet e konsumit në vend tregon se aftësia e tregtarëve dhe bizneseve për të diktuar çmimet finale në ekonomi është rritur. Ky zhvillim mund të jetë ndihmuar nga rigjallërimi i kërkesës në vend. Ai mund të tregojë gjithashtu zhvendosje në kahun lart të pritjeve inflacioniste në ekonomi apo edhe tendenca të shfaqjes së efekteve të raundit të dytë, duke gjykuar nga zgjerimi i bazës së artikujve që kontribuojnë në inflacion.

Duke vënë në balancë informacionin e përmbledhur më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se presionet inflacioniste në periudhën afatmesme paraqiten të rritura. Ecuria e çmimeve të konsumit në të ardhmen pritet të jetën nën presionin e rritjes së çmimeve në tregjet botërore. Duke faktorizuar edhe projeksionet për çmime të larta të produkteve bujqësore e të naftës në këto tregje, projeksioni bazë i inflacionit paraqitet në rritje në krahasim më muajt paraardhës. Gjithsesi, ecuria faktike e inflacionin do të varet në një masë të madhe nga ankorimi i pritjeve inflacioniste të publikut dhe nga prania e intensitetit të efekteve të raundit të dytë.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, duke e çuar atë në nivelin 5.25 për qind. Rritja e normës bazë së interesit synon të krijojë kushte monetare të përshtatshme për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në periudhën afatmesme. Kjo rritje e rivendos normën e faktuar reale të interesit në linjë me tendencat e saj historike, pas rënies së fortë që pësoi kjo normë nga rritja e inflacionit dhe e projeksioneve të tij. Ajo gjithashtu reflekton ndikimin e pritur të politikës fiskale në ekonomi, duke ruajtur pozicionin stimulues të politikave makroekonomike por duke i bërë ato më të kujdesshme në kushtet e realitetit të ri. Në linjë me

horizontin afatgjatë kohor të veprimit të politikës monetare, objektivi final i kësaj lëvizjeje mbetet ankorimi i pritjeve të publikut për inflacionin pranë objektivit 3 për qind të Bankës së Shqipërisë, duke synuar parandalimin e minimizimin e efekteve të raundit të dytë.

Banka e Shqipërisë gjykon se ky hap, i marrë në momentin e duhur, do të kontribuojë në frenimin e rritjeve të përgjithshme apo spekulative të çmimeve, duke mos cënuar në të njëjtën kohë qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në ceremoninë e lancimit të projektit të
binjakëzimit të Bankës së Shqipërisë,
23 mars 2011

Zonja e zotërinj, miq të nderuar,

Është kënaqësi të jem këtu me ju sot në ceremoninë e lancimit të këtij projekti të rëndësishëm.

Kjo ngjarje është emocionuese për mua e shumë kolege mes nesh, sepse sot shohim të marrë jetë një propozim, një ide e shkëlqyer e cila jam i bindur se brenda muajve në vijim do të shndërrohet në një produkt të dobishëm dhe shumë të suksesshëm.

Në fjalimin tim të parë ndaj publikut, rreth 7 vjet më parë, theksova se: "Banka e Shqipërisë sheh tek Banka Qendrore Evropiane institucionin i cili përfaqëson jo vetëm modelin e organizimit dhe të veprimit drejt të cilit ne synojmë të afrohemi me shpejtësi, por edhe mundësinë e një bashkëpunimi konkret në drejtime të veçanta të funksionimit të Bankës së Shqipërisë si edhe të objektivave strategjikë të ekonomisë së vendit".

Nga ky këndvështrim me kënaqësi konstatoj se kjo ceremoni e thjeshtë që po mbajmë sot është një dëshmi e: përmbushjes së kësaj ambicie në fillim të mandatit tim; maturimit të institucionit tonë; përafrimit të shpejtë me standardet e sistemit të bankave qendrore evropiane; rritjes së besimit të publikut ndaj saj dhe përmirësimit të imazhit në skenën ndërkombëtare.

Kam bindjen se projekti i binjakëzimit për të cilin jemi mbledhur këtu sot do të forcojë edhe më tej bashkëpunimin dhe komunikimin jo vetëm në sferën profesionale por edhe në atë personale mes institucioneve tona, element ky në të cilin besoj shumë. Jetojmë në një shoqëri globale në të cilën zhvillimet në botën bankare e financiare ecin me hapa alarmante e për këtë arsye bankat qendrore duhet të kenë mekanizma të brendshëm, të fortë dhe të besueshëm, të koordinimit dhe komunikimit të cilët mund të përgatisin institucionet tona të përballen me këto situata.

Pikërisht në këtë kuadër, edhe projekti i binjakëzimit është një element parësor i cili do të asistojë Bankën tonë në këtë rrugëtim, por jo vetëm. Duke analizuar me kujdes objektivin e përgjithshëm të këtij projekti vërejmë se ai fokusohet tek asistenca ndaj Bankës se Shqipërisë në përmbushjen e kritereve ekonomike në kuadër të integrimit të vendit tonë në BE, duke kontribuar kështu në përmirësimin e praktikave të punës në fushat e mbikëqyrjes bankare, statistikave, sistemeve të pagesave, tregut ndërbankar, bashkërendimit të procesit të integrimit në BE dhe edukimit financiar.

Theksoj gjithashtu se ky projekt binjakëzimi synon ndër të tjera edhe përafrim të standardeve të institucionit tonë me ato të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ) si dhe të sigurojë një përafrim të kuadrit ligjor dhe rregullator të Bankës sonë me acquis communautaire që prek fushën bankare dhe financiare.

Një proverb thotë: "Kur planifikon për një vit, mbill misër. Kur planifikon për një dekadë, mbill drurë. Kur planifikon për një jetë të tërë, trajno dhe arsimo njerëz."

Kjo është një filozofi e cila edhe sot po mishërohet përmes këtij projekti binjakëzimi i cili krahas ndihmës në zhvillimin e fushave të lartpërmendura gjithashtu do të ndihmojë në rritjen e vetëdijes për nevojën e përftimit të informacionit dhe trajnimit të mëtejshëm të stafit të institucionit tonë në fushat përkatëse. Harmonizimi i detyrave dhe standardeve të punës sonë me ato të Bashkimit Evropian është një nga prioritetet e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit, dhe gjithashtu edhe institucionit tonë si pjesë thelbësore e këtij procesi me rëndësi kombëtare.

Me këtë rast dua të shpreh mirënjohjen time për bashkëpunimin e shkëlqyer që kemi pasur me Banca d'Italia dhe Banque de France gjatë fazave të përgatitjes si dhe implementimit të fazës së parë projektit të binjakëzimit. Gjithashtu shpreh falënderimet e mia për Delegacionin e Bashkimit Evropian për asistencën e vazhdueshme dhe kujdesin e treguar gjatë gjithë ecurisë së projektit të binjakëzimit, dhe shpreh bindjen time të thellë që këto janë vetëm hapat e parë të një bashkëpunimi më të ngushtë mes institucioneve tona.

Përshëndes përpjekjet tuaja dhe shpresoj që realizimi i suksesshëm i këtij projekti do të shërbejë si shembull për të gjithë ne, që të përfshihemi më tepër në iniciativa të këtij lloji.

Po e mbyll fjalën duke qenë i bindur se ky projekt e ky bashkëpunim janë gurët e themelit për një të ardhme më të mirë, e një hap i rëndësishëm drejt integrimit evropian të institucionit tonë. Le të ndërtojmë mbi shpresat tona dhe mbi të gjitha t'i pranojmë përgjegjësitë tona. Le të jetë kjo e ardhmja jonë Evropiane.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në çeljen e ekspozitës me rastin e 85-vjetorit të monedhës kombëtare,
Muzeu Historik Kombëtar,
31 mars 2011

Kam kënaqësinë të çel siparin e aktiviteteve që Banka e Shqipërisë ka organizuar për të festuar 85-vjetorin e emetimit të monedhës kombëtare. Kur vendosëm të hapnim ekspozitën e sotme, mua personalisht me tërhoqi një tjetër dimension: historia e zhvillimit të sistemit monetar shqiptar. Monedhat e para të gjetura në vendin tonë datojnë që në shekullin e dytë para Krishtit. Këto monedha bronzi mbajnë të gjitha, në njërën anë, figurën e mbretit sundues, mbretit të fundit ilir Gent. Pra, në Iliri, si në të gjitha vendet e tjera të Mesdheut të lashtë, ky burrë i fuqishëm vendosi një lidhje të pazgjidhshme midis parasë dhe shtetit, jo vetëm për të promovuar veprimtarinë ekonomike të vendit, por edhe për të përfituar prej saj.

Aktiviteti i sotëm synon të japë dhe të transmetojë tek vizitori vlerat artistike, ato numizmatike dhe zhvillimin historik të monedhës tonë kombëtare. Nëpërmjet evolucionit të vlerave nominale ne jemi në gjendje të krijojmë një përfytyrim mbi:

- ecurinë në rrjedhën e viteve të ekonomisë kombëtare;
- fuqinë blerëse të parasë;
- historinë e popullit tonë nëpërmjet subjekteve të paraqitura dhe tematikave të trajtuara; ndjesitë kulturore dhe sociale të vendit nëpërmjet elementëve artistikë të dizenjimit.

Sistemi monetar e financiar i një vendi, jo vetëm që shpreh sovranitetin e politikave ekonomike të shtetit, por edhe mundëson zhvillimin e ekonomik e shoqëror të vendit.

Natyrisht që në gjithë këtë histori, emetimi i parasë kombëtare, në formën e monedhave e kartëmonedhave ka një rol unik. Historikisht, paraja ka lindur si përgjigje ndaj nevojave shoqërore për zhvillim e progres ekonomik. Të tre funksionet e saj: si mjet pagese, si ruajtës i vlerës dhe si mjet kontabël, mundësojnë një sofistikim më të madh ekonomik.

Njohja e këtyre roleve u kap shpejt nga sundimtarët e lashtësisë, të cilët ishin edhe emetuesit e parë të monedhave në format e tyre klasike. Duke njohur rolin dhe fuqinë që kishte paraja, këta princër, mbretër e perandorë, i vulosnin ato me portretet e tyre, si shprehje finale e autoritetit politik dhe ekonomik.

Kjo përshkruhet shumë bukur nga Mayer Rothschild, themeluesi i familjes së famshme Rothschild, kur thotë se: "... Më lejoni të emetoj dhe të kontrolloj

paranë e kombit dhe nuk më bëhet vonë se kush i harton ligjet...". Madje, edhe një botë sureale si ajo në librin e famshëm të Harri Poterit nuk mund të ekzistojë pa Bankën Gringots, të cilën shkrimtarja Rowling e përshkruan si një ndërtesë e bardhë shumëkatëshe, me kasaforta të nëndheshme, të cilat shtrihen në thellësi të panjohura të tokës.

Zhvillimi ekonomik e shoqëror ka sjellë vazhdimisht risi në lëmin e sistemeve monetare, por edhe të monedhave e të kartëmonedhave. Kështu, kartëmonedhat e para lindën si kundravlefta identike të sasive të metaleve të çmuara, kryesisht të arit, me një garanci eksplicite nga shtetet e sovranët për paritetin e tyre me arin. Kjo veçori reflektohet edhe në kartëmonedhat e periudhës së parë të shtetit shqiptar. Kartëmonedhat e emetuara gjatë kësaj periudhe emërtohen si "franga ari", duke nënkuptuar mbulimin e tyre me arin fizik, sipas një kursi të fiksuar e të pandryshueshëm.

Evolucioni i mëtejshëm i shoqërive njerëzore, sistemeve ekonomike e politike të tyre, solli novacione të mëdha në fushën monetare. Zhvillimi i bankave tregtare, sistemit të kreditit dhe bankave qendrore ishin momente vendimtare në zhvillimin ekonomik.

Bankat qendrore, si institucione publike të ngarkuara me emetimin dhe me qarkullimin e parasë, kanë një origjinë më të hershme. Shembujt e parë të bankave qendrore, në një kuptim të përafërt me atë të sotmin, datojnë në Anglinë apo Suedinë e shekullit të 17-të.

Këto institucione, fillimisht me një orientim të qartë tregtar, ishin të ngarkuara me emetimin e monedhave dhe shërbimin e nevojave të shtetit, me kredi apo huadhënie për qëllime të ndryshme. Banka qendrore moderne i ka origjinat e veta në shekullin e 20-të, dhe Rezerva Federale e SHBA shërbeu si një model për shumë banka qendrore të tjera.

Atribuimi i funksioneve mbikëqyrëse e rregullatore të sistemit bankar, si dhe orientimi i misionit të bankave qendrore në terma të objektivave ekonomikë, si inflacion i ulët apo rritje e qëndrueshme ekonomike, shënon edhe fillimin e bankave qendrore të ditëve të sotme. Këto të fundit, kanë ushtruar një rol primar në zhvillimet e mëtejshme të sistemeve monetare.

Konvertibiliteti me kurse fikse në metale fizike u paraqit problematik në administrimin ekonomik e monetar. Periudha e depresionit ekonomik të viteve 1929-1932 ilustroi qartë se politika monetare, e konceptuar si mundësi e autoriteteve publike për të ndikuar masën monetare në qarkullim si dhe çmimin e saj, ose normat e interesit, është një instrument i çmuar në zbutjen e luhatjeve ekonomike.

Duke filluar nga shekulli i 20-të, monedhat e kartëmonedhat e emetuara e humbën konvertibilitetin me arin sipas kurseve të fiksuara e të pandryshueshme. Paraja e emetuar, tashmë e tutje e quajtur edhe para e dekretuar, e mbështet vlerën e saj në forcën detyruese të shtetit.

Megjithatë, kjo është vetëm gjysma e pikturës. Aspekti më i rëndësishëm që përcakton vlerën e monedhës tashmë e tutje është besimi i publikut në të. Ruajtja e këtij besimi kërkon mbi të gjitha institucione të përgjegjshme dhe një qeverisje ekonomike transparente e të besueshme.

Në këtë premisë e ka zanafillën e vet edhe roli modern i bankave qendrore, si institucione të pavarura, të ngarkuara ekskluzivisht me emetimin e monedhës dhe të mandatuara ligjërisht për kontrollin e vlerës në kohë, ose me fjalë të tjera të fuqisë së saj blerëse apo, edhe më thjeshtë, të stabilitetit të çmimeve.

Zhvillimi i sistemeve monetare nuk e ka thënë ende fjalën e fundit; përkundrazi, dekadat e fundit kanë shënuar edhe periudhën më të vrullshme të tij. Lindja e parasë kontabile, në formën e depozitave të kursimit, të llogarive korente, të çeqeve e të kambialeve bankare, i kanë shtrirë më tej kornizat klasike të përkufizimit të parasë.

Paraja elektronike në formën e kartave të debitit e të kreditit, të urdhërpagesave të iniciuara nëpërmjet internetit apo telefonisë celulare, apo lëvizjet e fondeve nëpër platformat elektronike të tregjeve financiare ndërkombëtare, përbëjnë novacione të mëdha. Administrimi i tyre shtron sfida të rëndësishme për bankierët qendrorë dhe institucionet e tjera mbikëqyrëse.

Zhvillimet e mësipërme, me një devijim të dukshëm në periudhën e komunizmit, janë reflektuar edhe në historinë e sistemit monetar në Shqipëri. Pa dashur të zgjatem, dëshiroj të përmend stadet kryesore nëpër të cilat ka kaluar sistemi jonë monetar, duke u përpjekur të kap në disa rreshta thelbin e secilit prej tyre.

Kur Shqipëria fitoi pavarësinë nga Perandoria Osmane në 1912, monedhat të Francës, Italisë, Greqisë, Austro-Hungarisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene filluan të qarkullonin në vend të lirës osmane. Shqipëria nuk zotëronte një sistem kombëtar monetar.

Monedha më e përdorur në Shqipëri ishte ajo e Bashkimit Monetar Latin – frangu ar – i cili përbënte monedhën "de facto" të Shqipërisë. Duke mos zotëruar ndonjë monedhë ligjore Shqipëria kishte standardin e arit, nëpërmjet të cilit fiksoheshin vlerat e parasë argjend dhe letër.

Shqipëria ishte kështu një ndër vendet e pakta evropiane ku si mjet pagese dhe thesari ishte një monedhë e qëndrueshme. Detyra kryesore e shtruar përpara autoriteteve shqiptare ishte kodifikimi i sistemit monetar, duke shpallur frangun ar si njësinë monetare kombëtare. Kjo sillte nevojën e ngritjes së një banke emetimi, e cila do të ishte në gjendje të fiksonte normën ligjore të këmbimit për kartëmonedhat e emetuara, duke zhdukur gradualisht nga qarkullimi paranë letër të huaj.

Në vitin 1922, profesor Albert Calmes – anëtar i komisionit të hetimit të çështjeve shqiptare në Lidhjen e Kombeve – vërente se: "... megjithëse shqiptarët jetojnë shumë thjeshtë dhe në shumë raste, në kushtet e varfërisë

së madhe, ata janë në gjendje të kursejnë, pavarësisht produktit të vogël të prodhuar nga metodat e tij të punës, pasi janë shumë kursimtarë. Kapitali i kursyer grumbullohet në ar. Si rezultat, Shqipëria posedon një sasi të madhe metalesh të çmuara, të vlerësuara deri në 100 milionë franga ari. Por ky kapital, i cili, nëse vihet në përdorim do ta vërë jetën ekonomike në Shqipëri në rrugën e progresit, është i fshehur.

Kredia dhe organizatat e kredisë nuk ekzistojnë. Normat e interesit të kredisë prej 30% janë shumë të zakonshme. Arsyeja për këtë është mungesa e besimit. Besimi i shqiptarit në stabilitetin e qeverisë nuk është aq i fortë sa ta nxisë atë që të investojë paratë e tij në sipërmarrje financiare. Për të nxjerrë kapitalin nga vendet ku fshihet në mënyrë joproduktive, duhet krijuar besim...".

Mjeti më i mirë për këtë qëllim ishte krijimi i një banke kombëtare, një institucion për të cilin Shqipëria kishte shumë nevojë në atë periudhë. Krijimi i saj nevojitej urgjentisht, pasi vetëm ajo mund të zgjonte në Shqipëri kushtet e jetës ekonomike moderne. Misioni i saj kryesor ishte të nxiste besimin, kredinë dhe shpirtin e sipërmarrjes tek shqiptarët.

Banka Kombëtare Shqiptare u krijua më 1925, me kapital të përbashkët shqiptaro-italian. Kjo bankë fitonte të drejtën ekskluzive të emetimit të parasë – në prerje metalike (ar, argjend dhe bronz) dhe në kartëmonedhë – dhe caktimit të kursit të saj ligjor. Sasia e kartëmonedhave që banka vinte në qarkullim kishte mbulim në ar ose argjend.

Banka i dha Shqipërisë monedhën e parë kombëtare – frangun ar – duke u rikthyer në paritetin monetar ar-kartëmonedhë. Arritja më e madhe e Bankës ishte krijimi i një sistemi monetar të shëndoshë, i cili përballoi me sukses edhe vështirësitë e sistemit monetar botëror gjatë krizës ekonomike botërore të viteve '30. Monedha shqiptare i qëndroi besnike, deri në prill 1939, paritetit të kartëmonedhës me monedhën ar.

Duke qenë të bazuara në lingota ari, kartëmonedhat shqiptare pranoheshin në të parë në të gjitha sportelet e bankave kryesore të botës. Kështu, frangu shqiptar ishte një ndër valutat më të forta në Evropë në periudhën midis dy luftërave botërore.

Periudha midis viteve 1926-1939, përkon me krijimin e një sistemi të mirëfilltë bankar, sipas sistemit të ekonomisë së tregut dhe traditave bankare të periudhës. Në filozofinë e sistemit dhe të kohës, e cila paraqitet thelbësisht e njëjtë edhe me atë që ndjekim aktualisht, paraja luan rolet e rëndësishme të mjetit të këmbimit, të ruajtësit të vlerës dhe të njësisë kontabël.

Kjo dëshmohet qartë në shtypin e kohës. Në fjalimin e inaugurimit të tij si President i Bankës Kombëtare zoti Mosconi ka thënë se: "Dëshira jonë asht me sjellë këtu kushtimin e të hollave në të njëjtin nivel t'Italisë fqinje e mbi këtë rrugë janë realizue hapa fort të mdhaja, kështu që jemi tue j'a mbrrijt qëllimit qëkurse gjatë perjudhës së shkurtër t'ekzistencës s'onë, taksi zyrtar i

skontos, që formon masën themelore, ka zbritur prej 12 në 6 për qind" (Pjesë nga fjalimi i Presidentit të Bankës Kombëtare të Shqipnisë z. Mosconi, mbajtur me rastin e inaugurimit të godinës së Bankës, botuar në gazetën "Drita", 1 nëntor viti 1938).

Me përfundimin e luftës, Shqipëria u fut në orbitën e vendeve me ekonomi të centralizuar dhe Banka Kombëtare Shqiptare u transformua në Bankën e Shtetit Shqiptar.

Përpjekjet e para për disiplinimin e qarkullimit monetar ndikuan disi në stabilizimin e vlerës së monedhës shqiptare, emri i së cilës tanimë u kthye në lek.

Fillimisht e konceptuar si një bankë qendrore me organizim kapitalist, Banka shpejt u shndërrua në një institucion të rëndomtë të administratës shtetërore, e zhveshur nga çdo prerogativë e nevojshme për një bankë qendrore, duke e humbur të gjithë autonominë e saj. Banka humbi të drejtën tradicionale të ushtrimit të politikës monetare, duke u shndërruar në këtë mënyrë në një arkë të shtetit. Sistemi monetar e financiar komunist, i adoptuar në praktikë gjatë periudhës 1945-1991, ia njihte parasë të treja rolet e saj, por nuk e pranonte tërësisht rolin dhe rëndësinë e sistemit të kreditit. Për më tepër, analiza e monedhave dhe e kartëmonedhave të kohës tregon për një frymë artistike të orientuar dukshëm drejt realizimit socialist.

Vetëm pas vitit 1992, u bë i mundur transformimi i bankës së shtetit shqiptar në një bankë qendrore moderne, me mision themelor ruajtjen e fuqisë blerëse të lekut.

Në realizimin e këtij misioni, busulla jonë mbetet e orientuar drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, nëpërmjet një progresi të pandalshëm drejt konvergjencës ekonomike dhe ligjore me Bashkimin Evropian. Në këtë drejtim, në fokusin themelor të veprimtarisë sonë do të vazhdojë të jetë forcimi i pavarësisë funksionale, institucionale, personale dhe financiare të Bankës së Shqipërisë dhe, veçanërisht, garantimi i stabilitetit të çmimeve, si objektiv parësor i politikës monetare.

Paraja dhe sovraniteti janë të destinuara të qëndrojnë të ndërthurura. Sikurse monedhat ilire përdornin imazhin e sovranit si një mjet për të nxitur besimin e popullit, mënyra më e mirë që Banka e Shqipërisë të përmbushë misionin e saj ndaj publikut është njohja dhe besimi në monedhën vendase. Një monedhë e fortë dhe e shëndetshme do të jetë një shoqërues i pandarë i rrugëtimit tonë deri në portat e Brukselit dhe Frankfurtit.

Më lejoni ta mbyll këtë fjalë hyrëse me një parashikim personal.

Monedha dhe kartëmonedha, si simbole klasike të mjetit të pagesës, por edhe si një objekte të cilët përfaqësojnë në mënyrë të stilizuar vlerat historike e artistike të kohës, do të vijojnë të mbeten pjesë e realitetit ekonomik edhe për brezat që vijnë. Populli i ka kënduar me vargje parasë. Në "Autobiografinë

e popullit tim në vargje" Kadare shkruan: "Duke mbajtur frenë e kalit/duke i dhënë sisë djalit/derdhurë florinjtë e ballit. Duke mbajtur frenë e mushkës/duke i dhëne sisë çupës, derdhurë florinjtë e gushës." Muzeu i monedhës të cilin po e iniciojmë sot, jo vetëm që do të ruajë në kohë këtë kujtesë historike, por do të vazhdojë të pasurohet edhe në të ardhmen. Është fillimi i muzeut kombëtar të vlerave monetare dhe numizmatike, që Banka e Shqipërisë do t'i ofrojë së shpejti publikut në selinë e saj të rikonstruktuar, duke prezantuar vlerat të shtuara historike të kombit tonë.

Në përfundim, më lejoni të falënderoj koleksionistët shqiptarë dhe të huaj dhe Muzeun Historik Kombëtar për bashkëpunimin e treguar në organizimin e kësaj ekspozite.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën e njëzet e katërt të mbikëqyrësve bankarë të Evropës Qendrore e Lindore

Më lejoni t'ju uroj mirëseardhjen në konferencën e njëzet e katërt të mbikëqyrësve bankarë të Evropës Qendrore e Lindore, që këtë herë zhvillohet në Tiranë. Banka e Shqipërisë vlerëson rëndësinë e këtij forumi, si një platformë ku institucionet pjesëmarrëse shkëmbejnë përvojat me njëra-tjetrën. Ky forum është një autostradë moderne, që mundëson konvergimin e shpejtë të praktikave tona të mbikëqyrjes me standardet më të mira.

Më lejoni të vazhdoj me një analizë të përmbledhur të zhvillimeve ekonomike dhe financiare në Shqipëri gjatë dy viteve të fundit, duke u ndalur në disa çështje më konkrete që kërkojnë vëmendje më të madhe nga ana e industrisë bankare dhe e autoritetit mbikëqyrës në të ardhmen.

Ekonomia shqiptare është karakterizuar nga zhvillime pozitive në periudhën e parakrizës. Rritja vjetore ekonomike ka qenë mesatarisht 6 për qind, në kushtet e një stabiliteti të admirueshëm të treguesve kryesorë makroekonomikë. Rritja është mbështetur në forcimin e qëndrueshëm të përbërësve të kërkesës së brendshme, ndërkohë që është financuar nga burimet e brendshme, kryesisht përmes rritjes së shpejtë të kredisë për sektorin privat dhe asaj për investime.

Edhe sektori bankar, i cili dominon sistemin financiar në vend, ka pësuar një transformim të ndjeshëm vitet e fundit. Kjo është arritur si rezultat i hyrjes në treg të grupeve të mirënjohura bankare evropiane, zgjerimit të infrastrukturës bankare dhe përmirësimit të shërbimeve për klientelën. Performanca financiare ka qenë e mirë, duke regjistruar nivele mesatare të kthimit mbi kapitalin dhe mbi aktivet, përkatësisht mbi 20 për qind dhe 1.5 për qind. Ndër vite, sektori bankar ka zgjedhur të kapitalizojë pjesën dërrmuese të fitimeve për të mbështetur sa më mirë me likuiditet dhe kapital veprimtarinë e tij.

Gjatë kësaj periudhe të një zgjerimi të shpejtë dhe cilësisht më të mirë të veprimtarisë bankare, Banka e Shqipërisë, e gjykoi të domosdoshëm rishikimin e filozofisë mbikëqyrëse. Ambicia kryesore ishte orientimi i saj drejt burimeve të rrezikut, e thënë ndryshe forcimi i kontrollit mbi veprimtarinë bankare. Për këtë arsye, në fund të vitit 2006 u miratua ligji i ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Ky ligj i imponoi industrisë bankare, standarde më bashkëkohore në realizimin, drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë bankare.

Shqetësimi kryesor ishte ritmi i lartë i kreditimit, përqendrimi i theksuar i kreditimit në valutë dhe mungesa e diversifikimit sektorial. Si rrjedhim, në fund të vitit 2006, Banka e Shqipërisë prezantoi disa ndryshime rregullative me synim frenimin e ritmit të rritjes së kredisë, nëpërmjet vendosjes së kërkesave më të larta për kapital për bankat më agresive.

Këto masa u plotësuan më tej gjatë vitit 2008, duke synuar në mënyrë më të drejtpërdrejtë rastet kur huamarrësit nuk kishin të ardhura në valutë.

Një lëvizje tjetër strategjike gjatë kësaj periudhe, ishte integrimi i mbikëqyrjes bankare dhe stabilitetit financiar në procesin e vendimmarrjes së politikës monetare. Ky moment përbën një veprim, sa të guximshëm aq dhe inovativ në krijimin e ekuilibrave më optimalë midis funksionit tonë të hartimit dhe zbatimit të politikës monetare dhe asaj për ruajtjen e stabilitetit financiar të sistemit. Që nga ky moment, Raporti i Stabilitetit Financiar nuk do të ishte një libër shtesë në bibliotekën e Bankës së Shqipërisë, por një input i rëndësishëm për procesin e vendimmarrjes dhe koordinimin e politikave. Në këtë mënyrë, informacioni bëhet më i plotë, duke përfshirë dhe vlerësimin mbi ecurinë e rreziqeve të veprimtarisë bankare. Kjo do të thotë që filozofia jonë merr një natyrë më parandaluese dhe largpamëse, pasi informacionin e mbledhur e vë në shërbim të minimizimit të rreziqeve në të ardhmen.

Ne besojmë që këto veprime, ishin terapia e duhur për të zbutur ndikimin e krizës financiare dhe ekonomike ndërkombëtare, për sektorin bankar dhe ekonominë e vendit, të shfaqur në fund të vitit 2008. Tronditja e sistemit financiar botëror përcolli pasiguri tek publiku vendas dhe u reflektua në tërheqjen e një pjese të depozitave nga bankat.

Shtimi i nevojave për likuiditet si edhe tkurrja e kreditimit gjatë kësaj periudhe, ndikuan negativisht në gjendjen e burimeve financiare, të të ardhurave dhe të kapitalit të sektorit bankar.

Në këto kushte, autoritetet publike ndërmorën disa veprime për të mbështetur sektorin bankar, ku veçojmë:

- miratimin e ligjit për rritjen e vlerës së sigurimit të depozitave të publikut;
- vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për të kufizuar ekspozimin e bankave ndaj grupeve të huaja bankare zotëruese dhe për të pezulluar shpërndarjen e fitimit të bankave të realizuar në vitin 2008 dhe gjatë vitit 2009;
- zbatimin e një sërë vendimesh të tjera, të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në lidhje me krijimin e kushteve më lehtësuese për sigurimin e likuiditetit në tregun ndërbankar;
- si dhe përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës, duke synuar ruajtjen e qëndrueshmërisë së veprimtarisë bankare.

Në përgjithësi, gjatë kësaj faze Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol thelbësor në identifikimin e problemeve afatshkurtra të sektorit bankar dhe adresimin e shpejtë të tyre. Ky proces ishte i nevojshëm për të identifikuar më pas ndërlikimet më afatgjata në ecurinë e veprimtarisë bankare dhe përshtatjen e mëtejshme të kuadrit mbikëqyrës.

Ecuria e veprimtarisë bankare në dy vitet e fundit, ka provuar që këto masa rezultuan efektive dhe sektori bankar shqiptar përballoi me sukses efektet e kësaj krize. Rënia e depozitave të publikut në sektorin bankar u ndërpre

në fund të tremujorit të parë të vitit 2009, dhe rikthimi i tyre në banka vijon me ritme të qëndrueshme që nga ai moment. Situata financiare aktuale vlerësohet të jetë e stabilizuar në tërësi, krahasuar me periudhat e shkuara, me besim të qëndrueshëm të publikut dhe gjendje të kënaqshme të likuiditetit dhe kapitalizimit të veprimtarisë. Kryerja e provës së rezistencës, apo siç njihen ndryshe stress test-tet, së sektorit bankar ndaj zhvillimeve të pafavorshme të supozuara - ekonomike dhe financiare - tregon se sistemi bankar është i aftë t'i përballojë ato.

Ecuria e veprimtarisë bankare gjatë kësaj periudhe, ka reflektuar ecurinë e ekonomisë në përgjithësi. Në dy vitet e fundit, ndonëse hendeku i prodhimit është negativ, përsëri ekonomia e vendit ka vijuar rritjen pozitive në intervalin 3.5-4.5 për qind. Treguesit e tjerë makroekonomikë janë luhatur rreth vlerave të pranueshme dhe të pritshme.

Ne besojmë që ky stabilitet financiar dhe makroekonomik pasqyron angazhimin dhe koordinimin e politikave bazë ekonomike, asaj monetare me atë fiskale, përgjatë kohës. Ato do të vazhdojnë të mbështesin rritjen e qëndrueshme ekonomike në vijim, edhe në kushtet e rigjallërimit të ekonomisë botërore.

Të nderuar pjesëmarrës,

Kriza me të cilën u përball sistemi financiar botëror ishte e jashtëzakonshme. Të tilla ishin dhe masat që u ndërmorën. Është e natyrshme që efektet e saj do të vazhdojnë të ndjehen në ekonominë botërore, ndërkohë që vendimmarrësit, ekspertët dhe studiuesit, do të vazhdojnë me analiza të mëtejshme mbi shkaqet dhe mësimet që mund të nxirren prej saj. Duke përfituar nga prania në këtë panel mbikëqyrësish, dëshiroj të parashtroj disa prej përfundimeve tona:

Politikat makroprudenciale të mbikëqyrjes përbëjnë një argument thelbësor të diskutimeve të kohëve të fundit. Pjesë e tyre është dhe roli i bankës qendrore, veçanërisht për sa i takon rolit parandalues të saj. Randall Kroszner, në dokumentin e kohëve të fundit "Sfidat për Mbikëqyrjen Makroprudenciale", thotë: "... bankat qendrore, duhet të zhvendosen nga roli tradicional i atij të pompës së zjarrfikësit (që do të thotë se nëse diçka shkon keq, bankat qendrore ndërhyjnë dhe sigurojnë likuiditet për të shuar zjarrin ose për të ndaluar përhapjen e tij) në rolin e detektorit të tymit të zjarrit (që do të thotë të përpiqesh për të parandaluar shpërthimin e zjarrit)...". Në mënyrë më specifike, kjo nënkupton identifikimin dhe ndërtimin e një grupi treguesish të matshëm, të cilët së bashku formojnë sistemet paralajmëruese të problemeve makroprudenciale. Pjesë e domosdoshme janë dhe testet e rezistencës, të cilat duhet të jenë më të shpeshta, reale, transparente dhe të ndahen me entet mbikëqyrëse të vendeve të tjera. Elementë po kaq të domosdoshëm janë edhe integriteti, profesionalizmi dhe pavarësia që duhet të karakterizojë aktivitetin e çdo mbikëqyrësi bankar.

Politikat makroprudenciale të mbikëqyrjes post-krizë, megjithë progresin e bërë kohët e fundit, kanë nevojë për rregullime të mëtejshme. Për këtë qëllim,

institucionet e specializuara ndërkombëtare duhet të përqendrohen më shumë për një përkufizim dhe rakordim më të detajuar, për t'i përshtatur ato vazhdimisht me zhvillimet e tregjeve. Po kaq e rëndësishme është dhe marrja në konsideratë e specifikave të natyrës rajonale, demografike, historike dhe kulturore.

Sistemi bankar duhet medoemos të përqafojë një kulturë të mbështetur në vlerat më të mira të etikës, të shërbimit dhe të integritetit. Ky duhet të jetë objektivi parësor i të gjitha strukturave drejtuese të sistemit bankar, që do të çojë në rritjen e përgjegjshmërisë në drejtimin e institucioneve bankare. Strukturat drejtuese në banka janë përgjegjëse për drejtimin e ekuilibruar të institucionit, ku synimi i fitimeve vendoset në funksion të identifikimit, analizës dhe vlerësimit profesional të rreziqeve që shoqërojnë veprimet përkatëse. Gjithashtu, institucionet bankare dhe personeli i tyre duhet që në marrëdhëniet me klientët dhe publikun në përgjithësi, të reflektojnë standardet më të larta të sigurisë, të komunikimit e transparencës, të kujdesit e të mbështetjes, në mënyrë që kjo marrëdhënie besimi të shoqërojë zhvillimin e përbashkët. Kuadri rregullativ mbikëqyrës po plotësohet për të nxitur më tej këto zhvillime.

Mbikëqyrësit e bankave, nga ana e tyre duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje në kontrollet dhe raportet që përgatisin, kulturës, integritetit dhe sjelljes që karakterizon punën e çdo banke.

Një mësim tjetër i madh që vjen nga kriza është dhe shmangia me çdo kusht e përqendrimeve të mëdha si dhe e varësisë nga fondet financiare afatshkurtra. Prioritet mbi të gjithë prioritetet mbetet adoptimi i praktikave të kujdesshme të administrimit të rrezikut.

Kompozimi dhe cilësia e strukturave drejtuese të bankave përbën një tjetër sfidë për industrinë bankare në të ardhmen. Kriza e fundit tregoi se në shumë raste, anëtarë bordesh përfaqësonin vetëm interesat afatshkurtra të aksionerëve, në dëm të interesave të tjera të grupit, ashtu sikurse edhe njohuritë e tyre duhet të jenë të lidhura me aktivitetet e veçanta të bankës.

Tregu dhe inovacioni ecin më shpejt se mbikëqyrësi. Për këtë qëllim është e nevojshme që çdo inovacion apo produkt i ri bankar para hedhjes në treg të testohet me përgjegjshmëri, duke vlerësuar me kujdes të gjitha rreziqet që i shoqërojnë ato.

Në një kontekst më kombëtar, është e nevojshme dhe aktualisht tërësisht e mundshme që sektori bankar të përshpejtojë procesin e rigjallërimit të kreditimit, si një zhvillim që mbështet jo vetëm ekonominë dhe klientët, por edhe vetë bankat.

Veprimtaria e kreditimit duhet të mbështetet më mirë prej rritjes së qëndrueshme të burimeve të financimit, veçanërisht të depozitave. Në veprimtarinë e kreditimit, është e nevojshme të ketë një shpërndarje më të mirë sektoriale dhe një ekuilibër më të arsyeshëm midis projekteve të investimeve publike dhe private, midis formave të kredidhënies në lekë ose në monedhë të huaj, duke e orientuar kreditimin në mbështetje të ekonomisë vendase.

Në këtë kuadër, ekzistojnë hapësira të mjaftueshme për bankat, që të mbështesin më shumë kreditimin e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ofrojnë mundësi më të mëdha financimi në lekë. Në çdo rast, procesi i analizës, vlerësimit, ndjekjes dhe evidentimit të cilësisë së kredisë, duhet të jetë i një rëndësie parësore për strukturat përkatëse në banka dhe të kryhet me seriozitetin maksimal, në përputhje me kërkesat mbikëqyrëse.

Në këtë proces, është i nevojshëm bashkëpunimi me klientët që ndeshin në vështirësi të përkohshme, por në rastin e kredive pa shpresë arkëtimi është e domosdoshme kryerja e veprimeve të vendosura dhe në kohë për ekzekutimin e garancive dhe formave të tjera të kolateralit, për rikuperimin maksimal të vlerave.

Këto veprime janë të rëndësishme në kushtet kur Banka e Shqipërisë vlerëson se veprimtaria e kreditimit të sektorit bankar do të vazhdojë të ndeshet me një mjedis sfidues dhe përmirësimet e synuara në cilësinë e kredisë do të kërkojnë më tepër kohë për t'u realizuar.

Në përfundim më lejoni të theksoj se, lëvizja në drejtimet e mësipërme është një proces kompleks, që kërkon angazhim dhe bashkëpunim të dyanshëm. Me kënaqësi konstatoj se bashkëpunimi mes nesh dhe sektorit bankar po njeh progres, si në fushën e mbikëqyrjes ashtu edhe në atë të zbatimit të politikës monetare.

Besoj se bashkëpunimi do të rritet edhe mes mbikëqyrësve të rajonit të Evropës Juglindore. Në emër të Bankës së Shqipërisë dëshiroj t'ju garantoj se bashkëpunimi nga ana jonë do të jetë i plotë në këtë drejtim.

Duke përfituar nga ky rast, dua të theksoj se Banka e Shqipërisë do të jetë gjithmonë në lartësinë e kërkuar nga publiku, për të plotësuar në çdo kohë, përgjegjësitë ligjore, në drejtim të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit bankar dhe realizimit të qëndrueshmërisë së nivelit të çmimeve.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe ju uroj suksese!

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Sot, në datën 27 prill 2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike dhe financiare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritshme të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5.25%. Në opinionin e Këshillit, kushtet monetare aktuale janë të përshtatshme për përmbushjen e objektivit të inflacionit dhe për vazhdimin e stimulimit të aktivitetit ekonomik.

Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike, si dhe të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.

Ekonomia shqiptare vlerësohet të ketë patur një ecuri pozitive gjatë tremujorit të parë të vitit 2011. Aktiviteti ekonomik vlerësohet në rritje, ndërkohë që balancat kryesore makroekonomike janë përmirësuar dhe primet e rrezikut e normat e interesit në tregjet financiare kanë rënë. Rritja ekonomike gjatë vitit 2011 është mbështetur si nga kërkesa e huaj për mallrat shqiptare, ashtu edhe nga kërkesa e brendshme. Ecuria e konsumit dhe e investimeve në vend mbetet e ngadaltë, përtej efektit sezonal që karakterizon tremujorin e parë. Zgjerimi i shpejtë i eksporteve dhe rritja e moderuar e importeve kanë sjellë një përmirësim të deficitit tregtar, duke ndihmuar në balancimin e kërkesës dhe të ofertës për valutë dhe në ruajtjen e vlerës së monedhës vendase. Presionet inflacioniste të gjeneruara nga kërkesa mbeten të kontrolluara, si pasojë e ekzistencës së kapaciteteve të lira në ekonomi dhe përmbajtjes së konsumit, ndërkohë që rritja e çmimeve të importit ka qenë burimi kryesor i rritjes së çmimeve në vend.

Inflacioni në muajin mars 2011 arriti në 4.3%. Mesatarisht, gjatë tremujorit të parë të vitit 2011, inflacioni rezultoi 4.0%, duke qëndruar një pikë përqindjeje mbi objektivin afatmesëm për inflacionin. Ekonomia e vendit tonë ka vijuar të rritet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2010, dhe të dhënat e tërthorta të disponuara sugjerojnë se edhe tremujori i parë i vitit 2011 ka qenë pozitiv. Në terma mesatarë, kjo rritje vlerësohet të ketë qenë më e ulët se rritja potenciale e ekonomisë, duke sugjeruar se presionet inflacioniste nga ana e kërkesës së brendshme kanë qenë të dobëta. Rritja e shpejtë e çmimeve gjatë dy muajve të fundit i dedikohet kryesisht efektit të rritjes së çmimeve të mallrave ushqimore dhe çmimit të naftës në tregjet botërore, duke shkaktuar rritjen e lehtë të pritjeve inflacioniste dhe fillimin e shfaqjes së efekteve të raundit të dytë, në muajin shkurt. Në përgjigje të këtij fenomeni, Banka e Shqipërisë rriti normën e saj bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje në

fund të muajit mars. Pritjet inflacioniste mbeten të ankoruara pranë objektivit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë. Krahas kërkesës së brendshme, edhe qëndrueshmëria relative e kursit të këmbimit ka ndihmuar në frenimin e rritjes së mëtejshme të inflacionit.

Më konkretisht, gjatë tremujorit të parë të vitit 2011, inflacioni reflektoi rritjen e lartë të çmimeve të disa produkteve ushqimore, rritjen e mëtejshme të çmimeve të naftës, si dhe rritjen e çmimeve të barnave mjekësore. Me afrimin e stinës së ngrohtë, prodhimi vendas bujqësor pritet të kontribuojë në shtimin e ofertës në vend, duke zbutur presionet e larta të çmimeve të mallrave të importit.

Banka e Shqipërisë vlerëson se politikat në nxitje të prodhimit të brendshëm, që ulin ekspozimin e ekonomisë shqiptare ndaj goditjeve të jashtme përbëjnë një domosdoshmëri.

Inflacioni vjetor i sektorit të mallrave të tregtueshme në tremujorin e parë të vitit 2011, rezultoi 4.9% duke shpjeguar rreth 75% të shifrës së inflacionit total. Shkaqet kryesore për këtë sjellje kanë qenë konjuktura e rënduar aktuale dhe e pritshme për çmimet e lëndëve të para, situata e pazakontë gjeopolitike në ekonomitë e rëndësishme prodhuese të naftës dhe të produkteve agro-industriale, si dhe kushtet e pafavorshme të motit të cilat kanë dëmtuar produktet bujqësore. Inflacioni i produkteve të patregtueshme të shportës së IÇK-së, i cili pasqyron presionet e brendshme, në tremujorin e parë të vitit 2011 rezultoi 2%. Kjo vlerë është e përafërt me atë të një viti më parë dhe e krahasueshme me mesataren e tij historike.

Prirja e inflacionit e zhveshur nga efektet e përkohshme mbi të, ose inflacioni bazë iu afrua vlerës 3.0%, duke arritur vlera të larta historike. Ky përbërës afatgjatë i inflacionit, tregon se pritjet inflacioniste në ekonomi, megjithëse reflektojnë një vlerë relativisht më të lartë, mbeten mirë të ankoruara me objektivin e Bankës së Shqipërisë.

Në të ardhmen, presionet inflacioniste përgjatë horizontit kohor të veprimit të politikës monetare parashikohen të mbeten të larta, por intensiteti i tyre do të vijë në rënie gjatë vitit. Në vijim do të trajtoj në mënyrë të detajuar faktorët që përcaktojnë zhvillimet në inflacion së bashku me rreziqet përkatëse.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2011, aktiviteti ekonomik në botë ka shfaqur rritje, ndonëse papunësia mbetet e lartë. Rritja ekonomike pritet të intensifikohet në vazhdim, dhe i dedikohet kryesisht sektorit privat, duke krijuar kështu kushte për tërheqjen e sektorit publik.

Si rezultat i divergjencave të mëdha midis vendeve, sfidat me të cilat përballen autoritetet janë të ndryshme. Në ekonomitë e zhvilluara, fokusi është mbi zvogëlimin e borxhit publik dhe rregullimin e bilanceve financiare të agjentëve ekonomikë, ndërkohë që në vendet në zhvillim rreziku kryesor shfaqet në mbinxehjen e ekonomisë dhe në rritjen e lartë të kredisë. Presionet inflacioniste vlerësohen në rritje si rrjedhojë e goditjeve të ofertës në tregun

e naftës dhe mallrave të tjera. Nga ana tjetër, si arsye e rritjes së shpejtë të kërkesës në disa nga vendet në zhvillim, çmimet e faktorëve të prodhimit si ai i energjisë, i lëndëve të para dhe i kostove të punës, janë rritur. Parashikimet për të ardhmen përmbajnë një nivel të rritur pasigurie, si pasojë e turbullirave social-politike dhe katastrofave natyrore në disa vende të botës. Rritja e çmimeve në nivel botëror dhe shkalla e përcjelljes së tyre në ekonomi të ndryshme ka ndikuar vendimet për normat e interesit të aplikuara nga disa banka qendrore. Kështu, si rezultat i pritjeve për një inflacion mbi nivelin e synuar, Banka Qendrore Evropiane vendosi të rrisë normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje. Po ashtu, në tregjet financiare të huaja vihet re një rritje e lehtë e normave të interesit që faktorizon pritjet për një inflacion më të lartë.

Aktiviteti ekonomik në vend në tremujorin e katërt regjistroi një rritje prej 5.4% në terma vjetorë, duke ngushtuar ndjeshëm hendekun negativ të prodhimit. Rritja ekonomike u mbështet nga kërkesa e jashtme e nxitur pozitivisht nga rimëkëmbja e vazhduar e ekonomisë në nivel global. Përshpejtimi i normës vjetore rritëse të PBB-së reale në tremujorin e katërt, u nxit nga rritja e kontributit pozitiv të degës së industrisë. Ndërkohë, vlera e shtuar e sektorit të shërbimeve dhe e sektorit bujqësor kontribuan pozitivisht, por në një masë më të ulët, në rritjen vjetore të PBB-së reale.

Të dhënat më të fundit për tremujorin e parë të vitit 2011 nga vrojtimet e besimit të biznesit, nga ecuria e aktivitetit tregtar me jashtë, dhe nga treguesit monetarë e fiskalë, mbështesin vijimin e rikuperimit të aktivitetit ekonomik vendas, kryesisht prej kontributit pozitiv të sektorit prodhues.

Të dhënat e pjesshme që disponohen për konsumin privat, sugjerojnë një rritje të shpejtë të tij në terma vjetorë në tremujorin e katërt të vitit 2010. Ndërkohë, të dhëna të pjesshme për tremujorin e parë, sugjerojnë për një kontribut të moderuar të konsumit në kërkesën agregate. Vrojtimet e tremujorit të parë të vitit 2011 tregojnë se pasiguria për të ardhmen vlerësohet e lartë nga konsumatorët, duke ndikuar qëndrueshmërinë e rritjes së konsumit për periudhat në vazhdim. Banka e Shqipërisë gjykon se në terma afatshkurtër konsumatori shqiptar ka hapësirë për adoptimin e një sjelljeje më racionale në drejtim të zgjerimit të konsumit. Për sa i përket investimeve, vlerësohet se ecuria e tyre ka qenë më e qëndrueshme gjatë dy tremujorëve të fundit. Rritja e kërkesës së jashtme për bizneset prodhuese, pritjet pozitive për kërkesën në disa sektorë prodhues dhe lehtësimi i kushteve të financimit në tremujorin e fundit të vitit 2010 sinjalizojnë një vazhdimësi të kontributit pozitiv të investimeve private gjatë vitit në vazhdim. Megjithatë, shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese mbetet i ulët, dhe situata e konsumit të brendshëm mbetet e paqartë duke sugjeruar se ekonomia vazhdon të operojë nën potencialin e saj.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2011, vlerësohet se shpenzimet qeveritare kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në mbajtjen e kërkesës në nivele pozitive, ndryshe prej sjelljes së vënë re vitin e kaluar. Në fundin e tremujorit të parë të vitit 2011, deficiti buxhetor shënoi një vlerë prej 11.8 miliardë lekësh, kundrejt suficitit prej 0.7 miliardë lekësh të regjistruar në fundin e të njëjtit tremujor një vit më parë.

Gjatë kësaj periudhe, shpenzimet buxhetore janë rritur në terma nominalë me 16.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës, kryesisht si pasojë e rritjes së shpenzimeve korente. Ruajtja e ritmeve të rritjes të ngjashme edhe përgjatë tremujorëve të tjerë të vitit, pritet të përkthehet në kontribut më të lartë të përbërësit të shpenzimeve qeveritare në kërkesën agregate, krahasuar me vitin 2010. Zhvillimet e vërejtura si në kahun e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve, kanë shkaktuar rënien e balancës primare në vlera negative gjatë tremujorit të parë të vitit 2011, pas një përmirësimi të dukshëm të saj në tremujorin e fundit të vitit 2010.

Në tremujorin e katërt të vitit 2010, pozicioni neto i llogarisë korente u vlerësua në deficit prej 373.6 milionë eurosh ose në 16.4% ndaj PBB-së nominale. Në ndryshim me tre tremujorët e parë të vitit ku u regjistrua një ngushtim vjetor i deficitit të llogarisë korente, në tremujorin e katërt të vitit 2010, ky deficit u zgjerua me rreth 15.1% në terma vjetorë. Faktori kryesor në zgjerimin e deficitit të llogarisë korente ka qenë zgjerimi i deficitit tregtar, megjithë rritjen e lartë të eksportit të mallrave dhe shërbimeve prej 20.7% në terma vjetorë. Kërkesa e huaj ka vijuar të mbështesë rritjen ekonomike edhe gjatë dy muajve të parë të vitit 2011. Performanca e mirë e eksporteve ka ndikuar në ngushtimin e deficitit tregtar me 5.9% në nivel vjetor për këtë periudhë. Raporti mesatar i mbulimit të importeve prej eksporteve u vlerësua në 47.3% dhe regjistroi pikën e tij më të lartë historike. Shkëmbimet tregtare shënuan një rritje vjetore prej 30.4% gjatë dy muajve të parë të vitit. Eksportet në vlerë, vijuan prirjen e përshpejtuar rritëse të nisur gjatë tremujorit të parë të vitit 2010 dhe u zgjeruan me 66% në nivel vjetor.

Kontributin kryesor në këtë ecuri e dha rritja treshifrore vjetore e eksportit të energjisë elektrike, ndërkohë që vihet re se eksportet e metaleve të përpunuara dhe të produkteve tekstile me karakter rieksportues kanë vijuar të kontribuojnë pozitivisht në ecurinë vjetore të eksporteve në vlerë.

Në periudhën pas krizës globale, ekonomia e vendit po përshtatet me një model të ri rritjeje, i cili kërkon ndryshime strukturore të rëndësishme. Gjatë këtij procesi rishpërndarjeje burimesh në sektorët më eficientë të ekonomisë, si dhe të një sjelljeje më konservatore ndaj konsumit të familjeve shqiptare, prodhimi potencial i saj pritet të jetë më i ulët për një periudhë afatmesme. Nga analiza e përbërësve të kërkesës rezulton se përmirësimi i ritmeve të rritjes në dy tremujorët e fundit mund të ketë ngushtuar ndjeshëm hendekun negativ të prodhimit, por ekzistenca e kapaciteteve të lira në ekonomi edhe gjatë vitit 2011, sugjeron se ekonomia shqiptare do të vijojë të operojë nën potencial, duke gjeneruar presione të dobëta inflacioniste nga kërkesa e brendshme.

Nga ana e ofertës, produktiviteti në rritje gjatë tremujorit të katërt të vitit 2010 dhe rritja më e ngadaltë e kostove për njësi të punës, gjenerojnë presione më të ulëta inflacioniste nga ana e faktorit punë. Presionet inflacioniste mbi nivelin e çmimeve në vend, të cilat burojnë prej luhatjeve të çmimeve të naftës, dhe çmimeve të mallrave ushqimore në konjukturat ndërkombëtare, vlerësohen se do të jenë të pranishme gjatë vitit në vazhdim, por në rënie të vazhdueshme. Për shkak të situatës së rënduar gjeopolitike në botë, pasiguria që i rrethon

këto pritje mbetet e lartë. Aftësia absorbuese e ekonomisë së brendshme ndaj këtyre goditjeve si dhe shmangja e presioneve të qëndrueshme në inflacion, do të jenë funksion i ecurisë së ekonomisë shqiptare dhe i kontrollit të pritjeve inflacioniste të agjentëve.

Ecuria e treguesve monetarë ka pasqyruar ngadalësim të ofertës monetare në dy muajt e parë të këtij viti, duke konfirmuar presione të përmbajtura inflacioniste me natyrë monetare. Agregati M3 shënoi një rritje mesatare vjetore me 11.2%. Përbërësi valutor i ofertës monetare ka dhënë një kontribut në rënie në zgjerimin e parasë së gjerë, por përdorimi i valutës së huaj në nivele të larta në sistemin bankar dhe në ekonomi mbetet një ndër dobësitë e ekonomisë shqiptare. Duke shprehur interesin e tij për të adresuar këtë problem, në mbledhjen e sotme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori vendimin për heqjen e remunerimit të rezervës së detyruar në valutë. Kjo masë, efektivisht do t'i nxisë bankat tregtare të ulin kostot e mbledhjes së fondeve, duke favorizuar ndërmjetësimin në monedhën vendase. Ritmi i kërkesës për para nga agjentët ekonomikë privatë dhe publikë është rritur. Vlerësimet tona tregojnë se zgjerimi monetar është në përputhje me kërkesën e sektorit privat të ekonomisë për para reale. Ecuria e kredisë për sektorin privat ka qenë në linjë me sjelljen sezonale të saj në këtë periudhë të vitit, duke u rritur mesatarisht me 10.1% në terma vjetorë. Edhe pse deri tani zhvillimet në kredi kanë qenë të ngadalta, ka shenja inkurajuese për një ecuri më të mirë të kredisë në të ardhmen. Kërkesa e sektorit privat për kredi, niveli i ulët i së cilës ka qenë edhe pengesa kryesore në gjallërimin e kredisë, është rritur në tremujorin e parë të vitit dhe pritet të rritet edhe në tremujorin e ardhshëm. Sistemi bankar gëzon shëndet dhe likuiditet të mirë për të mbështetur rritjen e kërkesës për kredi, madje edhe me kushte më të mira kreditimi. Banka e Shqipërisë mbështet iniciativat e bankave për të pastruar bilancet, duke synuar rritjen e transparencës dhe krijimin e fondeve të lira për të mbështetur aktivitetin kreditues.

Ecuria e përgjithshme e tregjeve financiare gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 ka qenë pozitive.

Duke i qëndruar objektivit të saj kryesor të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, Banka e Shqipërisë mori vendimin për rritjen e normës bazë të interesit në fund të muajit mars. Ky vendim u reflektua në interesa më të larta në tregun ndërbankar, ndërkohë që ai pritet të përcillet edhe në tregjet e tjerë gjatë periudhës në vazhdim. Paralelisht me këtë lëvizje, Banka e Shqipërisë ka furnizuar tregun ndërbankar me likuiditetin e nevojshëm për funksionimin normal të tyre. Ndërkohë, në tregun e depozitave prirja rënëse e normave të interesit ka vazhduar. Për sa i përket ecurisë së normave të interesit në tregun e kredive ato janë luhatur, në rritje për lekun dhe në rënie për euron, ndonëse ky zhvillim gjykohet se përfaqëson politikat e veçanta të bankave për segmente të caktuara të ekonomisë. Së fundi, kursi nominal efektiv i këmbimit për të shtatin tremujor radhazi ka reduktuar prirjet e tij nënçmuese. Analizat tona tregojnë se në tërësi faktorët fondamentalë të ekonomisë po mbështesin një ekuilibër të ri të kursit të këmbimit, i cili dhe pse është më i lartë se tre vite më parë, është në përshtatje të ekuilibrave financiarë dhe ekonomikë në

vend, duke mbështetur rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Ecuria e qëndrueshme e kursit të këmbimit ka shërbyer për konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit financiar në vend, pa ushtruar presion mbi aktivitetin e bankave dhe sjelljen e agjentëve ekonomikë.

Projeksionet tona për të ardhmen mbështesin ruajtjen e ecurisë pozitive të ekonomisë shqiptare edhe në vazhdim të vitit 2011. Konsumi dhe investimet private pritet të rriten më tej, ndërkohë që pas ngadalësimit në vitin 2010, edhe sektori fiskal pritet të japë një kontribut pozitiv në rritjen ekonomike. Pavarësisht kësaj, rritja e kërkesës vlerësohet se do të jetë nën potencialin e ekonomisë sonë edhe për vitin 2011.

Kjo do të kushtëzojë presione rënëse mbi inflacion nga ekonomia e brendshme, të cilat pritet të balancojnë efektin e rritjes së çmimeve të huaja. Banka e Shqipërisë është e vendosur të marrë të gjitha masat e nevojshme në kohën e duhur për të respektuar objektivin e saj të inflacionit në periudhën afatmesme.

Duke vënë në balancë informacionin e përmbledhur më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se presionet inflacioniste në periudhën afatmesme janë të shtuara, por ato mbeten të kontrolluara. Ecuria e çmimeve të konsumit në të ardhmen pritet të jetë nën presionin e rritjes së çmimeve në tregjet botërore. Nga ana tjetër, kërkesa ende e pamjaftueshme do të vazhdojë të kushtëzojë nivele nën potencial të shfrytëzimit të kapaciteteve në vend, duke ushtruar presione në kahun rënës mbi inflacion. Pritjet inflacioniste vazhdojnë të jenë të ankoruara rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë për inflacionin.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës konkludoi se kushtet monetare paraqiten të përshtatshme për respektimin e objektivit të inflacionit në periudhën afatmesme dhe vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5.25%.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave për prezantimin e Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2010

I nderuar zoti Kryetar i Komisionit,

Të nderuar zonja dhe zotërinj anëtarë,

Është kënaqësi për mua të gjendem sot para jush, për të prezantuar konkluzionet kryesore të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë.

Në mbështetje të kërkesave ligjore, si dhe të angazhimeve tona institucionale për të forcuar pavarësinë, transparencën dhe përgjegjshmërinë e bankës qendrore, raporti vjetor përmban një analizë të plotë të zhvillimeve ekonomike e financiare në vend si dhe pasqyron me besnikëri aktivitetin e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2010. Ky aktivitet, në të gjithë spektrin e tij, është orientuar nga përmbushja e misionit dhe e detyrave tona ligjore, duke pasqyruar në të njëjtën kohë edhe rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 2010.

Më lejoni që, në fillim, të bëj një përmbledhje të shkurtër të çështjeve kryesore të trajtuara në raport.

Ekonomia shqiptare ka patur zhvillim përgjithësisht pozitiv gjatë vitit 2010. Nga ana tjetër, zhvillimet e këtij viti theksuan njëkohësisht nevojën për vazhdimin dhe thellimin e reformave strukturore, si parakusht për rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë ekonomike.

Aktiviteti ekonomik në vend shënoi rritje gjatë vitit të shkuar. Kjo rritje pasqyroi themelet e shëndosha të ekonomisë shqiptare; dinamizmin e sektorit privat; si dhe ruajtjen e konsolidimin e stabilitetit makroekonomik. Duke reflektuar zhvillimet në sektorin real e financiar të ekonomisë, si dhe politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, inflacioni i çmimeve të konsumit qëndroi në linjë me objektivin tonë gjatë vitit 2010. Gjatë këtij viti:

inflacioni ishte brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë;
deficiti buxhetor dhe borxhi publik shënuan rënie në terma relativë;
stabiliteti financiar u konsolidua;
ndërmjetësimi financiar u zgjerua më tej.

Gjithashtu, pozicioni i jashtëm i ekonomisë u përmirësua dhe normat e interesit e primet e rrezikut në tregjet financiare shënuan rënie.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare vlerësohet të jetë rritur me 3.9 % gjatë këtij viti. Në krahasim me vitin 2009, rritja ekonomike paraqitet

më e balancuar në shpërndarjen e saj sektoriale dhe në komponentët e kërkesës.

Gjatë vitit që lamë pas, rritja ekonomike është mbështetur më së shumti në kërkesën e huaj, e cila është reflektuar në rritjen e shpejtë të eksporteve shqiptare dhe në reduktimin e deficitit tregtar. Ajo ka gjetur gjithashtu, mbështetje në rritje në kërkesën e brendshme. Reduktimi i ndjeshëm i stimulit fiskal, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit, është kompensuar nga tendencat pozitive të shfaqura nga konsumi dhe investimet private gjatë kësaj periudhe.

Megjithëse në rritje, ekonomia shqiptare është karakterizuar në mënyrë të dukshme nga ekzistenca e kapaciteteve të lira, si në tregun e punës ashtu edhe në atë të kapitalit.

Kapacitetet e lira në ekonomi, pritjet e ankoruara inflacioniste të agjentëve ekonomikë, si dhe zgjerimi i kontrolluar monetar në përgjigje të politikës së kujdesshme të Bankës së Shqipërisë, kanë ushtruar ndikim rënës në inflacion.

Këta faktorë kanë kompensuar efektet inflacioniste të ardhura nga rritja e çmimeve të administruara, nga kursi i nënçmuar i këmbimit dhe nga ecuria e çmimeve në tregjet botërore. Për rrjedhojë, inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi një vlerë mesatare prej 3.6 % gjatë vitit 2010, duke qenë tërësisht në përputhje me përcaktimin e Bankës së Shqipërisë për stabilitetin e çmimeve.

Zhvillimet e përmendura më sipër janë mbështetur nga kombinimi i kujdesshëm i politikave monetare, makroprudenciale e fiskale. Në prani të presioneve të kontrolluara aktuale e të pritura inflacioniste, të prodhimit nën-potencial të ekonomisë shqiptare, por edhe të rivendosjes së besimit të publikut në sistemin financiar, politikat makroekonomike, gjatë vitit 2010, ruajtën kah stimulues. Zhvendosja e mirëpritur e vëmendjes së politikës fiskale drejt ruajtjes së qëndrueshmërisë afatgjatë të treguesve të borxhit, u shoqërua me reduktimin e deficitit buxhetor dhe të stimulit fiskal.

Ky zhvillim mundësoi ndjekjen e një politike monetare më stimuluese nga Banka e Shqipërisë dhe i hapi rrugë uljes me 0.25 pikë përqindjeje të normës bazë të interesit në muajin korrik 2010.

Në përgjigje edhe të injektimeve të vazhdueshme të likuiditetit nga autoriteti monetar, kahu lehtësues i politikës monetare u pasqyrua në reduktimin e normave të interesit të depozitave në lekë, të yield-eve të letrave me vlerë të qeverisë, dhe, në masë më të vogël, të normave të interesit të kredive në lekë. Tregjet financiare kanë patur një vit më të qetë, me likuiditet në rritje dhe norma interesi në rënie. Gjithashtu, treguesit e likuiditetit dhe të kapitalizimit të sistemit bankar janë përmirësuar.

Kushtet e kreditimit të zbatuara nga sistemi bankar shënuan lehtësim gradual gjatë vitit 2010. Ky lehtësim reflektoi jo vetëm politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, por edhe përmirësimin e treguesve të likuiditetit, rënien e primeve të rrezikut, dhe reduktimin e huamarrjes publike në tregjet e brendshme monetare. Lehtësimi i kushteve të kreditimit dhe rritja e kërkesës

për kredi u shoqëruan me rritje më të shpejtë të kredisë gjate vitit 2010.

Në kontekstin rajonal, rritja e ndërmjetësimit financiar gjatë vitit të shkuar përbën një zhvillim të spikatur, në ndryshim nga eksperienca e shumë vendeve të tjera të karakterizuara nga rënia e këtij treguesi. Kjo kredi ka mbështetur kryesisht rritjen e investimeve në sektorët e shërbimeve dhe të industrisë, ndërkohë që rritja e kredisë për konsum ka qenë e ulët.

Duke mbyllur konkluzionet e Raportit Vjetor, dëshiroj të tërheq vëmendjen tuaj në një ndër temat kryesore të tij. Zhvillimet ekonomike të vitit 2010 ilustruan sfidat ekonomike me të cilat përballet ekonomia shqiptare.

Së pari, modeli i zhvillimit ekonomik i ndjekur deri më tani ka vend për përmirësim. Axhenda e re e reformave strukturore duhet të synojë krijimin e kushteve për një rritje më të balancuar dhe më të qëndrueshme në periudhën afatgjatë.

Orientimi më i madh i ekonomisë shqiptare drejt eksportit, si dhe rritja në përgjithësi e konkurrueshmërisë së produkteve tona në tregjet e huaja e të brendshme, diktojnë nevojën për vazhdimin e reformave strukturore, në nivel makro dhe mikroekonomik.

Së dyti, konsolidimi i stabilitetit makroekonomik kërkon punë më të madhe në të ardhmen.

Ruajtja e ekuilibrave të brendshëm e të jashtëm të vendit kërkon zhvillimin e mëtejshëm të arkitekturës së vendimmarrjes e të koordinimit makroekonomik, si dhe të mekanizmave mbikëqyrëse e rregullatore të ekonomisë dhe të tregjeve. Aftësitë analizuese, parashikuese e vendimmarrëse të agjentëve publikë e privatë duhet gjithashtu të përmirësohen më tej. Mësimet e krizës së fundit globale duhet të analizohen e të zbatohen me vendosmëri nga të gjithë ne.

Së treti, garantimi i stabilitetit financiar të vendit kërkon koordinimin e veprimeve të të gjithë institucioneve mbikëqyrëse dhe rregullatore, si dhe të agjentëve privatë të tregut. Stabiliteti financiar i shërben kanalizimit të kursimeve në sektorët më konkurrues të ekonomisë gjatë periudhës afatgjatë.

***

Në vijim të fjalës time do të bëj një trajtim më të detajuar të çështjeve të mësipërme, duke u fokusuar në drejtimet kryesore të punës së Bankës së Shqipërisë.

1. ZHVILLIMET EKONOMIKE DHE FINANCIARE GJATË VITIT 2010

Ecuria e ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2010 është karakterizuar nga përmirësimi gradual i kërkesës agregate dhe nga konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik. Zhvillimi ekonomik është shoqëruar nga stabiliteti

i çmimeve, ndërkohë që borxhi publik, deficiti buxhetor dhe deficiti i llogarisë korente janë reduktuar.

Rritja ekonomike është mbështetur kryesisht nga kërkesa e huaj dhe rritja e eksporteve shqiptare, ndërsa kërkesa e brendshme ka patur ecuri më të ngadaltë. Kjo e fundit është frenuar nga konsolidimi i financave publike dhe ulja e deficitit buxhetor gjatë vitit 2010, ndërkohë që shpenzimet konsumatore dhe investimet private janë ndikuar nga pasiguria për të ardhmen dhe nga prania e kapaciteteve të pashfrytëzuara.

Konsumi privat ka patur ecuri të ngadaltë gjatë vitit 2010, si pasojë e pasigurisë mbi situatën ekonomike e financiare në tërësi, dhe pritjet për punësimin në të ardhmen. Kjo ecuri është pasqyruar në rritjen e preferencës së konsumatorëve për kursim, ndërkohë që të dhënat agregate flasin për rritje të të ardhurave të disponueshme.

Ashtu si dhe në shumë ekonomi të tjera, nxitja e konsumit privat do të jetë një nga përcaktuesit kryesorë të rritjes ekonomike dhe një ndër sfidat me të cilët do të përballemi gjatë periudhës në vijim.

Investimet private kanë patur gjithashtu ndikim të ulët në rritjen ekonomike të vitit 2010. Bizneset shqiptare kanë hezituar në kryerjen e investimeve të reja, të ndikuara nga nivele të ulëta të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese, por edhe nga kujdesi më i madh i bankave në procesin e kreditimit.

Politika fiskale u orientua drejt konsolidimit fiskal gjatë vitit 2010, pas natyrës kundërciklike të shfaqur në vitin 2009. Konsolidimi fiskal u përshpejtua, sidomos në gjashtëmujorin e dytë të vitit, me miratimin e buxhetit të rishikuar. Ky konsolidim ishte i pranishëm si në kahun e të ardhurave ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Të ardhurat buxhetore u rritën me 8.4 % në terma vjetorë, duke reflektuar rritjen ekonomike, zgjerimin e bazës së tatimpaguesve, dhe të ardhurat nga privatizimet. Nga ana tjetër, shpenzimet buxhetore u tkurrën me 4.5 %, duke pasqyruar tkurrjen e shpenzimeve kapitale të qeverisë.

Deficiti buxhetor për vitin 2010 zbriti rreth nivelit 3.0 % të PBB-së, duke u reduktuar me 52% krahasuar me një vit më parë. Ky deficit u financua kryesisht nëpërmjet emetimit të instrumenteve të zakonshme të borxhit të brendshëm. Megjithatë, financimi i deficitit solli një risi në vitin 2010, nëpërmjet emetimit të Eurobondit të parë shqiptar. Ky emetim, në vlerën prej 300 milionë eurosh, plotësoi një pjesë të nevojave në valutë të sektorit publik dhe u shoqërua me reduktimin e huamarrjes së brendshme. Ai zbehu presionet mbi monedhën vendase, rriti hapësirat për huamarrje të sektorit privat dhe ndikoi në përmirësimin e kushteve të financimit të tij.

Deficiti i llogarisë korente u ngushtua me rreth 21.5 % gjatë vitit 2010, duke qëndruar në nivelin 11.9 % të PBB-së. Ky reduktim reflektoi rritjen e kursimeve të sektorit privat dhe publik. Ai u ndihmua gjithashtu nga rritja e eksporteve si pasojë e gjallërimit të kërkesës së huaj, kursit të nënçmuar të këmbimit dhe përmirësimit të termave të tregtisë në këtë periudhë. Megjithë përmirësimin e shënuar gjatë vitit 2010, deficiti i llogarisë korente mbetet i

lartë. Siç e kemi theksuar në vazhdimësi, Banka e Shqipërisë gjykon se hartimi i politikave strukturore për zbutjen e zhbalancimeve të ekonomisë së jashtme duhet trajtuar me përparësi.

Tkurrja e ndjeshme e deficitit tregtar në mallra dhe shërbime, erdhi si pasojë e rritjes së përshpejtuar të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, me rreth 16.4 % në nivel vjetor. Nga ana tjetër, importet e mallrave dhe shërbimeve pasqyruan një ritëm të moderuar rritjeje prej 2.6 % në terma mesatarë, por me prirje rritëse në muajt e fundit të vitit. Situata e vështirë ekonomike në vendet fqinjë është reflektuar në rënien vjetore të dërgesave neto prej emigrantëve me 11.7 %, ndërkohë që raporti i tyre ndaj PBB-së u vlerësua në nivelin 7.8 %.

Flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare regjistruan një rënie me rreth 11.2 % gjatë vitit 2010, duke mundësuar financimin e deficitit të llogarisë korente në masën 87.5 %. Duke përjashtuar privatizimet, investimet e huaja direkte u vlerësuan në 9.3 % të PBB-së dhe ishin burimi kryesor i financimit të huaj të ekonomisë shqiptare. Rezerva valutore e vendit u rrit me rreth 178.8 milionë euro dhe stoku i saj prej 1.9 miliardë eurosh është i mjaftueshëm për mbulimin e 4.8 muajve importe mallrash dhe shërbimesh.

Zhvillimet pozitive në sektorin e jashtëm të ekonomisë, kryesisht si rrjedhojë e zgjerimit të eksporteve, si dhe të hyrat valutore nga Eurobondi, kanë ndihmuar në gjenerimin e presioneve të përmbajtura në tregun e shkëmbimeve valutore këtë vit. Në këndvështrimin makroekonomik, qëndrueshmëria relative e kursit të këmbimit gjatë vitit ka pasqyruar një ekuilibër të ri të arritur në kërkesën dhe ofertën për valutë të huaj.

Në terma sektorialë, zhvillimi i ekonomisë shqiptare është mbështetur kryesisht nga rritja e sektorit të industrisë dhe e atij të shërbimeve. Këta sektorë kanë përfituar në masë të madhe përkatësisht nga kërkesa e huaj dhe nga zhvendosja strukturore e kërkesës së brendshme drejt mallrave të konsumit afatshkurtër.

Në horizontin afatshkurtër dhe afatmesëm, sektori i industrisë dhe ai i shërbimeve pritet të mbeten mbështetësit kryesorë të ekonomisë shqiptare. Sektori i ndërtimit vijoi të kontraktohet gjatë vitit 2010, duke reflektuar tkurrjen e investimeve publike, kushtet më të shtrënguara të kredisë, një sjellje më të kujdesshme konsumatore drejt investimit në pasuri të paluajtshme, dhe problemet e shkaktuara nga stoku relativisht i lartë i inventarëve të trashëguar.

Tejkalimi i këtyre problemeve, si dhe tendencat korrektuese të çmimeve në disa segmente të tregjeve rezidenciale, do t'i hapin rrugë zhvillimit më të qëndrueshëm të këtij sektori. Nga ana tjetër, sektori bujqësor vlerësohet të ketë shënuar rritje, si pasojë e kushteve më të mira klimaterike dhe e konjukturës së favorshme të çmimeve që karakterizon, dhe do të karakterizojë këtë sektor.

Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare

Paraja e gjerë u rrit me mesatarisht 10.6 % gjatë vitit 2010. Rritja e saj pasqyron ecurinë e aktivitetit ekonomik dhe rikthimin e besimit të agjentëve ekonomikë në sistemin bankar. Zgjerimi i masës monetare ka qenë në përputhje me kërkesën e ekonomisë për para, duke mos nxitur tendenca inflacioniste në ekonomi. Raporti i depozitave ndaj PBB-së shënoi 64.2 % në fund të vitit, duke qëndruar më lart se niveli i regjistruar para tërheqjes së depozitave. Profili i strukturës kohore të depozitave ka reflektuar gjithashtu preferencën e rritur për kursim, duke u karakterizuar nga zhvendosja e depozitave në maturitete më afatgjata.

Lehtësimi i kushteve të kreditimit gjatë gjysmës së dytë të vitit, masat stimuluese të marra nga Banka e Shqipërisë, interesi në rritje i sistemit bankar për të mbështetur konsumin dhe investimet në vend, si dhe ulja e pasigurisë dhe e primeve të rrezikut, u shoqëruan me një rritje graduale të kredisë gjatë vitit. Portofoli i kredisë për sektorin privat u zgjerua me 10 % gjatë vitit 2010, i ndikuar kryesisht nga rritja e kreditimit në valutë. Megjithatë, aktiviteti kreditues vijon të vuajë nga mungesa e kërkesës dhe e planeve të biznesit realiste, cilësore e të vlefshme për kreditim.

Rikthimi i besimit në sistemin financiar, situata e stabilizuar makroekonomike dhe masat rregullative e mbikëqyrëse të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, ndikuan në stabilizimin dhe përmirësimin e treguesve të kapitalizimit, të likuiditetit dhe të përfitueshmërisë së sistemit bankar.

2. ECURIA E INFLACIONIT DHE POLITIKA MONETARE

Inflacioni vjetor i çmimeve të konsumit rezultoi mesatarisht 3.6 % gjatë vitit 2010, duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë për të. Presionet inflacioniste ishin më të përqendruara në gjysmën e parë të vitit, të shkaktuara më së shumti prej rritjes së disa çmimeve të administruara. Inflacioni mesatar vjetor në gjashtë muajt e parë të vitit rezultoi 3.9 %. Në dy tremujorët pasues, stabilizimi relativ i kursit të këmbimit dhe presionet e ulëta inflacioniste prej kërkesës së brendshme ndihmuan në konvergjimin e normës mesatare të inflacionit përreth objektivit të Bankës së Shqipërisë. Hendeku negativ i prodhimit ka prodhuar presione të përmbajtura inflacioniste gjatë gjithë vitit 2010, duke balancuar efektin e nënçmimit të monedhës vendase dhe të rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2010, politika monetare e Bankës së Shqipërisë u zhvillua në një mjedis makroekonomik të karakterizuar nga norma pozitive të rritjes ekonomike, nga pritje inflacioniste të ankoruara dhe nga presione të përmbajtura inflacioniste. Siç e theksova dhe më parë, ky mjedis mundësoi ruajtjen e natyrës ekspansioniste të politikës monetare, të shfaqur që gjatë vitit 2009.

Kjo politikë ka nxitur prirjen rënëse të normave të interesit, dhe ka plotësuar më tej efektet stimuluese të ardhura nga nënçmimi i kursit të këmbimit. Normat e ulëta të interesit kanë favorizuar rritjen e konsumit dhe të investimeve në vend, ndërsa kursi i nënçmuar i këmbimit ka mbështetur rritjen e eksporteve shqiptare gjatë vitit.

Reduktimi i stimulit fiskal zgjeroi më tej hapësirat për ndjekjen e një politike monetare stimuluese. N ë muajin korrik 2010, Banka e Shqipërisë uli me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, duke e zbritur atë në nivelin më të ulët historik prej 5.0%. Përmirësimi i kushteve të likuiditetit në sistemin bankar dhe kërkesa e dobët e sektorit shtetëror për mjete monetare kanë mbështetur përcjelljen e politikës lehtësuese në të gjitha segmentet e tregjeve financiare, në muajt e fundit të vitit 2010.

Paralelisht me këtë lëvizje, Banka e Shqipërisë ka furnizuar tregun financiar me likuiditetin e nevojshëm për mbështetjen e ndërmjetësimit financiar. Duke synuar gjithnjë adoptimin e modeleve më të përparuara të bankingut qendror, dhe në veçanti konvergjencën me praktikat e Eurosistemit, Banka e Shqipërisë ndryshoi edhe formën e objektivit të saj operacional.

Duke filluar nga muaji qershor 2010, operacionet tona të administrimit të likuiditetit orientohen nga shënjestrimi i normave afatshkurtra të interesit në tregun ndërbankar dhe nga minimizimi i luhatjeve të tyre. Ky ri-modelim i ndërhyrjeve tona në tregun e parasë rrit efektivitetin e politikës monetare dhe nxit zhvillimin e tregut ndërbankar. Paralelisht me të, ai shënon edhe një hap tjetër në përfundimin e përgatitjeve tona teknike për adoptimin e regjimit të inflacionit të shënjestruar.

***

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i detyrave të bankës qendrore është edhe funksioni mbikëqyrës i sistemit bankar.

3. MBIKËQYRJA BANKARE DHE STABILITETI FINANCIAR

Përmirësimi i aktivitetit ekonomik në vend është pasqyruar edhe në ecurinë e aktivitetit bankar. Viti 2010 u karakterizua nga rritja e aktiveve të bankave, përmirësimi i treguesve të shëndetit dhe të përfitueshmërisë bankare, si dhe nga - kapitalizimi i mirë i sistemit. Nga ana tjetër, sistemi bankar u karakterizua nga rritja e portofolit të kredive me probleme, duke reflektuar edhe politikën aktive të Bankës së Shqipërisë në drejtim të rritjes së transparencës së bilanceve të bankave. Ndryshimi organizativ i mbikëqyrjes bankare, në përshtatje me sfidat që parashtron koha, ka dhënë një ndihmesë në përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës dhe, për rrjedhojë, në forcimin e stabilitetit financiar në vend.

Ecuria e sistemit bankar

Sektori bankar vijon të mbetet aktori kryesor i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri. Aktualisht ky sektor përbehet nga 16 banka, ku dy prej tyre janë degë të bankave të huaja. Në fund të vitit 2010, aktivet e sistemit bankar janë rritur me ritme dy herë më të larta se një vit më parë, duke përfaqësuar rreth 81% të PBB-së. Në tërësi ky raport është zgjeruar me rreth 3.5 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë.

Struktura e aktivit të sistemit bankar vijon të financohet kryesisht nga depozitat e publikut dhe të jetë e përqendruar në aktivitetin e kredidhënies, i cili është i orientuar kryesisht drejt financimit të sektorit privat. Investimet e sistemit bankar, në aktivitetin kreditues janë rritur gjatë vitit 2010, por ritmet e rritjes vazhdojnë të jenë në nivele të moderuara. Kjo ecuri reflekton politikat e kujdesshme të bankave për cilësinë e portofolit të kredisë si dhe të kërkesës së moderuar për kredi që kanë shfaqur agjentët ekonomikë në vend. Rritja e ngadaltë e aktivitetit kreditues dhe ecuria nën potencial e ekonomisë kanë ndikuar në rritjen e treguesit të kredisë me probleme, në nivelin 14%. Megjithatë, ritmet e rritjes tij kanë ardhur në rënie përgjatë vitit 2010.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit mbetet në nivele të kënaqshme. Kapitali aksioner i sistemit është rritur me 10% në vitin 2010. Sektori bankar shqiptar vlerësohet i mirë-kapitalizuar, gjë që konfirmohet nga norma e lartë e mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin 15.4%, dukshëm më e lartë se niveli prej 12% i përcaktuar në kuadrin rregullator.

Treguesi i levës financiare në vitin 2010, rezultoi 10.6%, duke mbetur në nivel pothuaj të njëjtë me atë të vitit 2009. Kjo ecuri dëshmon për një mbështetje të qëndrueshme të aktivitetit ndërmjetësues të sistemit bankar, në nivele të njëjta borxhi për dy vitet e lartpërmendur. Rreziku i kreditit, mbetet rreziku kryesor për sektorin tonë bankar. Në përgjigje të këtij rreziku, sektori bankar ka krijuar fondet e veta rezervë për përballimin e humbjeve të mundshme. Në fund të vitit 2010, fondet rezervë për përballimin e rrezikut të kreditit (provigjonet) nga huadhënia për rezidentët, janë rreth 33% më shumë se niveli i tyre në fund të vitit 2009.

Analizat tona të stress test-it, ose provës së rezistencës, konfirmojnë se kapitali në sistemin bankar shqiptar është i mjaftueshëm për të përballuar goditje të mëdha, të cilat shkaktojnë uljen e aftësisë paguese të kredimarrësve apo prishjen e ekuilibrave të tregut. Banka e Shqipërisë ka përmirësuar dukshëm analizën e saj nëpërmjet analizave stres-test mbështetur edhe nga një bashkëpunim në rritje me FMN-në, Bankën Botërore, Bankën Qendrore Evropiane dhe bashkëpunimit me bankat qendrore të huaja. Në kuadër të forcimit të procesit të mbikëqyrjes së subjekteve bankare, Banka e Shqipërisë ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me bankat qendrore të rajonit dhe ato evropiane ku bankat mëma kanë selitë qendrore.

Procesi i shkëmbimit të informacionit si gjatë procesit të licencimit të institucioneve bankare, ashtu edhe në lidhje me rreziqe të mundshme ndaj stabilitetit financiar të institucioneve bankare që ato mbikëqyrin dhe bashkëpunimi në kryerjen e kontrolleve të subjekteve financiare që operojnë si brenda dhe jashtë vendit do të ndihmojë Bankën e Shqipërisë në ushtrimin e rolit të saj në garantimin e stabilitetit të sistemit bankar në vend.

Krahas sektorit bankar, viti 2010 ka qenë pozitiv edhe për institucionet financiare jobanka, duke dëshmuar për rritje të shumëllojshmërisë dhe plotësimit të infrastrukturës financiare në vend. Në fund të vitit, numri i institucioneve jobanka në sistemin financiar arriti në 17 nga 12 institucione

që ishin një vit më parë. Në tërësi aktiviteti i tyre financiar dhe ai kredidhënës kanë pasqyruar ecuri të mirë dhe kryesisht në përputhje me kuadrin rregullativ të vendosur nga Banka e Shqipërisë.

Mbikëqyrja e sistemit bankar

Sikurse e përmenda pak më parë, në fillim të vitit 2010, Banka e Shqipërisë ndryshoi kuadrin organizativ të mbikëqyrjes bankare, duke e orientuar dhe e lidhur drejtpërdrejt atë me rreziqet që shoqërojnë aktivitetin financiar.

Paralelisht me këtë, Banka e Shqipërisë bëri edhe një rikonceptim të fokusit dhe strategjisë së punës për qëllime mbikëqyrëse, sipas rreziqeve me të cilat përballet sistemi bankar dhe financiar në vend.

Në fokus të procesit mbikëqyrës përgjatë vitit 2010 kanë qenë dhe transparenca dhe publikimi i informacionit, për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare. Së pari, Banka e Shqipërisë nëpërmjet publikimit të analizave të detajuara të shëndetit financiar në nivel sistemi që prej vitit 2010, në çdo gjashtë muaj, ofron një kuadër orientues për ndërtimin e plan-bizneseve si për publikun ashtu dhe për agjentët financiarë. Nga ana tjetër nxitja për rritjen e transparencës së agjentëve financiarë privatë është pasqyruar dhe në ndryshimet e kuadrit rregullativ gjatë vitit. Një çështje sensitive e ndjekur gjatë vitit të kaluar dhe që do të ketë përparësi në periudhat në vijim është dhe niveli i lartë i komisioneve të aplikuara për produktet dhe shërbimet bankare. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet analizave të saj ka qenë pjesë e rëndësishme e diskutimeve mbi këtë fenomen, duke synuar adresimin në kohë dhe me eficencë të problematikës.

Pjesë e rëndësishme e procesit mbikëqyrës përgjatë vitit 2010, kanë qenë edhe çështjet që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave, me transparencën si dhe me ndjekjen e normave mbikëqyrëse. Për këto qëllime janë kryer inspektime të plota në vend në dy banka dhe katër subjekte financiare jobanka si dhe dy inspektime të targetuara. Në përgjigje të këtyre inspektimeve, këto subjekte kanë hartuar rregullore të brendshme dhe kanë zhvilluar më tej sistemet e pagesave, të cilat çdo ditë mundësojnë identifikimin e të gjitha transaksioneve në para fizike.

Forcimi i kuadrit rregullator e mbikëqyrës

Gjatë vitit 2010, Banka e Shqipërisë finalizoi hartimin e disa rregulloreve të reja dhe bëri ndryshime në disa rregullore të tjera të mbikëqyrjes bankare. Ky proces ka synuar që në vazhdimësi të përshtat me standardet e Komitetit të Bazelit dhe direktivat e Bashkimit Evropian, duke konsideruar praktikat më të mira në fushën e rregullimit dhe zhvillimet në sistemin bankar shqiptar.

Akte të reja rregullative dhe ndryshime me rëndësi në aktet në fuqi për mbikëqyrjen bankare të miratuara gjatë këtij viti janë:

Rregullorja "Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore" e cila specifikon rregullat dhe kriteret për llogaritjen, raportimin

dhe mbikëqyrjen e pozicioneve të hapura valutore të bankave, me qëllim administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit.

Rregullorja "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka", objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka duke dalluar në veçanti rregullat për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e institucioneve financiare të mikrokredisë dhe të atyre që zhvillojnë veprimtarinë e qirasë financiare në vend.

Manuali "Për kujdestarinë dhe likuidimin e bankave", i cili përcakton procedurat dhe veprimet për realizimin e procesit të kujdestarisë dhe likuidimit, duke plotësuar kuadrin e veprimit të autoritetit në rastet e vendosjes në kujdestari/likuidim të bankës ose degës së bankës së huaj.

****

Krahas drejtimeve kryesore të punës së Bankës së Shqipërisë, sikurse janë politika monetare dhe mbikëqyrja e rregullimi i sektorit bankar, në fjalën time do të doja të ndalesha edhe në disa aspekte të tjera të punës sonë. Këto aktivitete përmbushin detyrimet tona ligjore, dhe i shërbejnë zhvillimit të sistemit financiar dhe të ekonomisë së tregut në Shqipëri.

4. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në këtë kuadër, në mënyrë të përmbledhur do t' ju paraqes rolin e Bankës së Shqipërisë në zhvillimin e sistemit të pagesave; në mbështetjen e procesit të integrimit evropian; në edukimin dhe komunikimin me publikun; në zhvillimet e statistikave në vend; si dhe në përfundim do të doja të përmendja dhe rritjen e kapaciteteve studimore e kërkimore të stafit që unë drejtoj.

Sistemet e pagesave

Gjatë vitit 2010, infrastruktura e sistemeve të pagesave është përmirësuar më tej, siguria dhe eficienca e tyre është rritur, duke procesuar në të njëjtën kohë një numër dhe vëllim më të madh pagesash. Sistemi i pagesave për vlerat e mëdha në kohë reale (AIPS) ka shfaqur rritje të volumit të transaksioneve me 44 % krahasuar me vitin 2009.

Ky vit ka shënuar zgjerim të mëtejshëm të përdorimit të instrumenteve të pagesave, duke reflektuar ndër të tjera edhe rritjen e besimit të publikut në sistemin bankar.

Mirëfunksionimi i tregjeve financiare dhe forcimi i stabilitetit financiar në vend nuk mund të realizohen pa një sistem efektiv dhe të zhvilluar pagesash. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë po punon për të adoptuar praktikat më të mira të bankave të tjera qendrore. Projekti i binjakëzimit me Bankën e Italisë dhe me Bankën e Francës i realizuar këtë vit përbën një nga këto aktivitete, ku përveç të tjerave synohet ngritja e kapaciteteve dhe përafrimi i

kuadrit rregullativ dhe operacional të funksionimit të Sistemeve të Pagesave në Shqipëri me ato të vendeve të Bashkimit Evropian.

Puna gjatë vitit 2010 është fokusuar në dy aspekte kryesore: forcimi i kuadrit ligjor në funksion të rolit mbikëqyrës për sistemet e pagesave; dhe, përmirësimi e nxitja e ndryshimeve në sistemin kombëtar të pagesave në funksion të rolit reformator të Bankës së Shqipërisë. Në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor, në vitin që sapo mbyllëm u finalizua draftimi i projektligjit "Për sistemet e pagesave".

Ky projektligj përbën një hap të mëtejshëm, tepër të rëndësishëm në procesin për përafrimin e vazhdueshëm të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën bankare dhe financiare, parashikuar gjithashtu edhe në nenet 70 dhe 89 të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim (MSA).

Në përmbushje të rolit reformator, Banka e Shqipërisë në muajin Mars 2010 realizoi komunikimin live nëpërmjet ndërfaqes elektronike të Sistemit të Thesarit pranë Ministrisë së Financave dhe sistemeve të pagesave pranë Bankës së Shqipërisë. Kjo skemë e re i mundëson Ministrisë së Financave monitorimin në kohë reale të aktivitetit në llogaritë e saj pranë Bankës së Shqipërisë, duke i shërbyer kështu një administrimi sa më efecient të fondeve nga ana e saj. Gjithashtu, gjatë këtij viti puna është fokusuar edhe në përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturave të nevojshme për shlyerjen e instrumenteve elektronike të pagesave në lekë për kartat e ndryshme ndërkombëtare (MasterCard, Visa) si dhe në projekte të cilat synojnë reduktimin e përdorimit të cash-it në ekonomi.

Mbështetja e proceseve integruese

Në përputhje me procesin e zbatimit të MSA-së, Banka e Shqipërisë ka kontribuar në rishikimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) për vitet 2010 – 2014, duke identifikuar dhe përditësuar përparësitë dhe masat e marra në fushat e stabilitetit makroekonomik, të lëvizjes së lirë të kapitalit, lirisë së vendosjes, si dhe lirisë për të ofruar shërbime.

Banka e Shqipërisë u angazhua në procesin e plotësimit të përgjigjeve të pyetjeve të pyetësorit dërguar nga Komisioni Evropian, duke patur edhe rol koordinues për kapituj të veçantë të tij, si edhe ka marrë pjesë aktive në takimet e mëtejshme faktmbledhëse të organizuara nga ky organ.

Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2010 vazhdoi të mbajë kontakte të vazhdueshme dhe të frytshme me institucionet kryesore financiare ndërkombëtare si FMN, Banka Botërore, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) si dhe ka rritur marrëdhëniet dypalëshe me bankat e tjera qendrore.

Gjatë vitit 2010, Banka e Shqipërisë vijoi punën për rishikimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe në përshtatje me dinamikën më të fundit të zhvillimeve në vend, duke hartuar akte të rëndësishme ligjore, nënligjore dhe rregullative në fushën bankare.

Komunikimi me publikun dhe transparenca institucionale

Komunikimi me publikun e gjerë dhe me institucione të veçanta konsiderohet si një ndër elementet më të rëndësishëm të punës së Bankës së Shqipërisë, të cilës i dedikon edhe një pjesë të konsiderueshme të burimeve të saj. Gjatë vitit 2010, puna e Bankës së Shqipërisë në këtë kuadër është fokusuar kryesisht në ristrukturimin e mjeteve ekzistuese dhe ndërtimin e mënyrave të reja të komunikimit, të cilat ndihmojnë në krijimin e një mjedisi me aktorë të mirinformuar dhe të aftë për të kuptuar vendimmarrjen e bankës qendrore, dhe për të marrë vendime racionale mbi çështjet ekonomike e financiare. Nën këtë këndvështrim, gjatë vitit të kaluar janë shtuar kontaktet me shtresat e ndryshme të publikut, duke u drejtuar veçanërisht tek ato që kanë ndikim në proceset edukative të tij.

Aktivitetet e kryera kanë konsistuar në komunikime të drejtpërdrejta, botime periodike dhe joperiodike, prezantime dhe takime të cilat kanë vënë në dispozicion të publikut informacione mbi punën e Bankës dhe procesin vendimmarrës të saj. Në të njëjtën kohë, faqja zyrtare e internetit ofron në kohë reale dhe të thjeshtë çdo informacion mbi aktivitetin dhe vendimet e marra nga institucioni, si dhe mbi statistikat e prodhuara prej tij.

Përmirësimi i statistikave në Bankën e Shqipërisë

Në kryerjen e funksionit të prodhimit të statistikave, Banka e Shqipërisë ka synuar që, jo vetëm të realizojë me sukses hartimin dhe publikimin e treguesve statistikorë, por edhe të përmirësojë në vazhdimësi shërbimin ndaj publikut, duke zgjeruar gamën e treguesve, duke përafruar metodologjinë me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe duke ofruar informacion në mënyrë sa më të përshtatshme. Zhvillimi kryesor gjatë vitit 2010 në drejtim të prodhimit statistikor ishte publikimi për herë të parë i statistikave të borxhit të jashtëm bruto, statistikave të pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe statistikave të detajuara të kredisë për ekonominë, duke plotësuar kështu kategorinë e statistikave të sektorit të jashtëm.

Në fushën e statistikave monetare e financiare, është punuar në drejtim të përmirësimit metodologjik, të informatizimit të proceseve të kontrollit, si dhe të rritjes së numrit të treguesve të publikuar.

Forcimi i kapaciteteve studimore e kërkimore

Banka e Shqipërisë prej kohësh e ka konsideruar kërkimin shkencor në fushat ekonomike, financiare dhe sociale si një element të rëndësishëm në vlerësimin dhe analizën e kryer prej saj, në funksion të mbështetjes së procesit të vendimmarrjes.

Rritja e kapaciteteve kërkimore është zhvilluar nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore, modernizimit të infrastrukturës kërkimore dhe krijimit të urave për shkëmbimin e përvojës dhe njohurive me institucione në fushën kërkimore. Disa nga aspektet kryesore ku është përqendruar

kërkimi gjatë vitit 2010 kanë qenë: politika monetare dhe ajo fiskale, çështje të stabilitetit financiar, modeli i ri i rritjes ekonomike, si dhe sektori i jashtëm i ekonomisë. Mbështetja dhe aplikimi i modeleve ekonometrike në studimin e fenomeneve të ndryshme ekonomike ka mundësuar nxjerrjen e konkluzioneve dhe parashikimeve të besueshme.

Sfida jonë e brendshme për të ardhmen do të jetë përmirësimi i mëtejshëm i këtyre modeleve dhe rritja e përdorimit të tyre në vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë.

****

Në mbyllje të fjalës sime, më lejoni t'ju rikujtoj se, së bashku me Raportin Vjetor, pranë jush janë depozituar dhe pasqyrat financiare të Bankës Shqipërisë për vitin 2010, të certifikuara nga auditorët.

Duke iu falënderuar për vëmendjen, mbetem i hapur ndaj pyetjeve apo diskutimeve që mund të keni

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, në 25 maj 2011.

Sot, në datën 25 maj 2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike dhe financiare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e tyre të pritshme , Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5.25 %. Sipas opinionit të Këshillit, kushtet monetare aktuale janë të përshtatshme për përmbushjen e objektivit të inflacionit dhe për vazhdimin e stimulimit të aktivitetit ekonomik.

(Më lejoni që në vijim të parashtroj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike, si dhe të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

****

Ekonomia shqiptare vijon të ruajë një prirje pozitive zhvillimi. Gjallërimi i kërkesës së brendshme gjatë katër muajve të parë të vitit, si dhe kontributi pozitiv i kërkesës së huaj, kanë ndikuar në rritjen pozitive të ekonomisë shqiptare. Gjithashtu, balancat kryesorë makroekonomike mbeten të qëndrueshme dhe treguesit e sistemit financiar paraqiten përgjithësisht të përmirësuar.

Pas goditjes që pësoi në muajin shkurt, inflacioni i çmimeve të konsumit ka ndjekur një trajektore rënëse, në reflektim të presioneve të kontrolluara inflacioniste në ekonominë dhe në tregjet financiare shqiptare. Të dhënat e disponuara për tremujorin e parë të vitit 2011 tregojnë se aktiviteti ekonomik ka regjistruar rritje, por ekzistenca e kapaciteteve të lira sugjeron se kjo rritje mbetet nën potencial. Hendeku negativ i prodhimit nënkupton ekzistencën e presioneve të ulëta inflacioniste që gjenerohen nga kërkesa e brendshme, por goditjet e vazhdueshme të çmimeve të mallrave importit kanë sjellë një rritje të lehtë të pritjeve inflacioniste. Nga ana tjetër, qëndrueshmëria relative e kursit të këmbimit dhe rritja e ofertës së brendshme të mallrave ushqimorë, kanë qenë faktorë me ndikim pozitiv në frenimin e normës së inflacionit. Duke synuar stabilizimin e pritjeve inflacioniste në një periudhë afatmesme, Banka e Shqipërisë rriti me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në fund të muajit mars.

Pas goditjes që pësoi në muajin shkurt, inflacioni i çmimeve të konsumit ka ndjekur një trajektore rënëse, në reflektim të presioneve të kontrolluara inflacioniste në ekonominë dhe në tregjet financiare shqiptare. Të dhënat e disponuara për tremujorin e parë të vitit 2011 tregojnë se aktiviteti ekonomik ka regjistruar rritje, por ekzistenca e kapaciteteve të lira sugjeron se kjo rritje mbetet nën potencial. Hendeku negativ i prodhimit nënkupton ekzistencën

e presioneve të ulëta inflacioniste që gjenerohen nga kërkesa e brendshme, por goditjet e vazhdueshme të çmimeve të mallrave importit kanë sjellë një rritje të lehtë të pritjeve inflacioniste. Nga ana tjetër, qëndrueshmëria relative e kursit të këmbimit dhe rritja e ofertës së brendshme të mallrave ushqimorë, kanë qenë faktorë me ndikim pozitiv në frenimin e normës së inflacionit. Duke synuar stabilizimin e pritjeve inflacioniste në një periudhë afatmesme, Banka e Shqipërisë rriti me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në fund të muajit mars.

Kjo lëvizje është përcjellë në tregjet financiare, në përputhje me kohëvonesat e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare.

Inflacioni në muajin prill 2011 arriti në 4.1%, duke zbritur gradualisht drejt objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ecuria e inflacionit pasqyron rritjen e lartë të çmimeve të produkteve ushqimore, çmimet e rritura të disa mallrave të akcizës dhe në një masë më të vogël, inflacionin e çmimeve të administruara. Oferta më e lartë e mallrave bujqësore, ashtu si edhe në muajin mars, dha një kontribut pozitiv në reduktimin e normës vjetore të inflacionit. Në krahasim me muajin e kaluar, indeksi i çmimeve të konsumit ra me 0.6 %, duke shënuar vlerën më të ulët të inflacionit mujor të muajve prill në dhjetëvjeçarin e fundit.

Kategoritë "Ushqime të përpunuara" dhe "Mallra konsumi jo-ushqimorë", ku përfshihen edhe nafta e barnat, kanë dhënë kontributin kryesor në inflacion. Kategoria e parë, pas rritjes së çmimeve të produkteve bazë në tregjet botërore, është dhe do të vijojë të mbetet përcaktuese e vlerave të inflacionit vjetor përgjatë gjithë vitit 2011. Kategoria e dytë ka shënuar vlera pozitive në rritje si rezultat i konjukturës globale të çmimeve të mallrave të kësaj kategorie, në veçanti të çmimit të naftës.

Krahas rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore bazë, në inflacionin e muajit prill janë shfaqur edhe efektet e raundit të dytë, të materializuara në rritjen e çmimeve të disa shërbimeve. Banka e Shqipërisë vlerëson se ekonomia shqiptare duhet të gjejë hapësira për të përballuar goditjet e ofertës së jashtme apo luhatjet e çmimeve në tregjet botërore, nëpërmjet nxitjes së prodhimit të brendshëm në disa sektorë kyç.

Inflacioni vjetor i sektorit të mallrave të tregtueshme në muajin prill rezultoi 4.9%, duke shpjeguar rreth 73% të shifrës së inflacionit total. Niveli i lartë i inflacionit të këtij sektori të shportës së Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK), ka vijuar të ndikohet nga nivelet e larta të çmimeve të lëndëve të para në tregjet botërore, nga parashikimet jo optimiste për to në terma afatmesme, si dhe nga efektet e ardhura nga kursi i nënçmuar i këmbimit. Nga ana tjetër, rënia e peshës së këtij komponenti në përcaktimin e inflacionit total ishte rezultat i hyrjes në treg të ofertës bujqësore vendase. Inflacioni i produkteve të patregtueshme, i cili pasqyron më mirë presionet e brendshme inflacioniste, rezultoi 2.5% në muajin prill, duke konfirmuar një prirje të lehtë në rritje. Prirja e inflacionit e zhveshur nga ndikimet e përkohshme mbi të, ose inflacioni bazë në muajin prill iu afrua vlerës 3.3%, duke arritur vlera të larta historike.

Ritmet mujore të rritjes së tij, të cilët janë një sinjalizues më i mirë i tendencës

së pritjeve inflacioniste, shënuan megjithatë vlera më të ngadalësuara se në muajt paraardhës. Inflacioni bazë tregon se pritjet inflacioniste në ekonomi, megjithëse pasqyrojnë një vlerë relativisht më të lartë, mbeten të mirëankoruara me objektivin e Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë gjykon se, për periudhën në vazhdim, presionet inflacioniste përgjatë horizontit kohor të veprimit të politikës monetare do të mbeten relativisht të larta, por intensiteti i tyre do të vijë në rënie gjatë vitit. Në vijim do të trajtoj në mënyrë të detajuar faktorët që përcaktojnë zhvillimet në inflacion së bashku me rreziqet përkatëse.

Gjatë muajve të parë të vitit 2011, aktiviteti ekonomik botëror vazhdoi të rritet, ndonëse sinjalet që vijnë nga indekset e besimit sugjerojnë se rreziqet që shoqërojnë këto zhvillime pozitive mbeten të pranishme. Në nivel botëror, presionet inflacioniste janë rritur si rezultat i një kërkese më të lartë dhe i goditjeve të vazhdueshme të ofertës. Në ekonomitë e zhvilluara, shqetësimi kryesor mbetet konsolidimi fiskal dhe zvogëlimi i borxhit publik, ndërkohë që rritja e inflacionit ka zvogëluar hapësirën për stimul monetar.

Në vendet në zhvillim, momenti pozitiv i kërkesës botërore ka sjellë rritje të kërkesës agregate, ndërkohë që presionet inflacioniste në rritje kanë shkaktuar reagimin e bankave qendrore në drejtim të shtrëngimit të politikës monetare. Në tregjet financiare, shëndeti i bilanceve publike ka qenë përcaktues në ecurinë e yield-eve të disa shteteve, ndërkohë që tensionet politike në disa vende kanë rritur kërkesën për instrumentet e gjykuara si më të sigurta. Parashikimet për të ardhmen rrethohen nga një nivel i lartë pasigurie, si pasojë e rritjes së çmimeve në nivel botëror, konsolidimit fiskal në disa vende të zonës së euros dhe hapësirat më të ngushta për stimul fiskal e monetar.

Duke iu kthyer ekonomisë shqiptare, të dhënat më të fundit për tremujorin e parë të vitit 2011 nga vrojtimet e besimit të biznesit, nga ecuria e aktivitetit tregtar me jashtë, dhe nga treguesit monetarë e fiskalë, mbështesin vijimin e rikuperimit të aktivitetit ekonomik vendas, kryesisht prej kontributit pozitiv të sektorit prodhues Faktorët me ndikimin kryesor në këtë rritje kanë qenë kërkesa e jashtme dhe stimuli fiskal. Të dhënat e analizuara nga Këshilli Mbikëqyrës tregojnë se shpenzimet buxhetore të tremujorit të parë të vitit janë rritur me 16.8%, të mbështetura pjesërisht edhe nga rritja me 12.5 miliardë lekë e deficitit buxhetor, kundrejt së njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Ndërkohë, informacioni i muajit prill tregon një rritje më të ngadaltë të të ardhurave buxhetore në këtë periudhë, duke theksuar nevojën e marrjes së masave për respektimin e nivelit të planifikuar të deficitit buxhetor. Të dhënat e ekonomisë reale sugjerojnë një rritje të ngadaltë të konsumit, në vijim të pasigurive mbi situatën e ardhshme të punësimit. Nga ana tjetër, ecuria më pozitive e kredisë për bizneset dhe rritja e importeve të mallrave kapitalë sugjeron se investimet kanë qenë më pozitive duke forcuar premisat për një rritje ekonomike më të qëndrueshme në të ardhmen. Vijimësia e investimeve të bizneseve nga ana tjetër kërkon reagimin e kërkesës konsumatore, për të cilën Banka e Shqipërisë gjykon se ka hapësira rritjeje. Nga ana tjetër, rritja

afatgjatë e investimeve do të kushtëzohet nga aftësia e ekonomisë shqiptare për të tërhequr kapitalin e huaj. Në këtë kontekst, institucionet përgjegjëse, në nivel makro dhe mikroekonomik, duhet të forcojnë më tej punën për reformat strukturore të cilat zhvillojnë më tej avantazhet krahasuese të ekonomisë shqiptare dhe të rrisin konkurueshmërinë e ekonomisë sonë në tregjet e produkteve, të punës e të kapitalit. Banka e Shqipërisë gjykon se ruajtja e parametrave të stabilitetit makroekonomik është një parakusht i domosdoshëm në këtë drejtim, duke e orientuar gjithnjë punën e saj nga garantimi i stabilitetit të çmimeve dhe mbështetja e stabilitetit financiar të vendit.

Të dhënat mbi ecurinë e aktivitetit tregtar të vendit tonë, gjatë tremujorit të parë të vitit 2011, dëshmojnë për një ngushtim të lehtë të deficitit tregtar, i ndikuar prej rritjes së importeve dhe prej ngadalësimit të ritmeve rritëse të eksporteve gjatë muajit mars. Në nivel vjetor, deficiti i tregtisë në mallra u ngushtua me përafërsisht 0.3% dhe u vlerësua në nivelin 22.1% të PBB-së. Raporti i mbulimit të importeve prej eksporteve ishte mesatarisht 44.5%, ose rreth 9 pikë përqindjeje më i lartë krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit paraardhës. Gjatë periudhës në analizë, eksportet në vlerë vijuan prirjen rritëse të nisur gjatë tremujorit të parë të vitit 2010 dhe u zgjeruan me 45.4% në nivel vjetor. Megjithatë, pas një rritjeje të përshpejtuar gjatë dy muajve të parë të vitit, ritmet rritëse të eksporteve tona janë zbutur ndjeshëm gjatë muajit mars. Gjatë së njëjtës periudhë, importet shënuan një rritje vjetore prej 15.9%. Në ndarjen e importeve sipas përdorimit final të tyre, spikat rritja e përshpejtuar e importit të mallrave të ndërmjetëm dhe të mallrave kapitalë. Projektimi i këtyre tendencave në të ardhmen, mund të shoqërohet me zgjerim të deficitit tregtar e të atij të llogarisë korente të vendit. Banka e Shqipërisë është mjaft e vëmendshme ndaj këtij zhvillimi, duke qenë se ai kushtëzon ndjeshëm ekuilibrat e jashtëm të ekonomisë shqiptare dhe ato të tregut valutor.

Ekspansioni monetar gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 ka qenë në përputhje me kërkesën për para të agjentëve ekonomikë, duke shënuar një rritje vjetore të qëndrueshme rreth nivelit 11%. Rritja prej 6.2% e ofertës së parasë reale në terma vjetorë ka qëndruar pranë niveleve më të ulta historike. Ritmet e moderuara të rritjes së agregatit M3 dhe të treguesve të tjerë monetarë, janë në linjë me vlerësimet e deritanishme për ekzistencën e presioneve të përmbajtura inflacioniste me natyrë monetare. Kjo prirje mbështetet edhe nga zhvillimet në treguesin e parasë jashtë bankave. Ky tregues vijon të reduktohet në terma vjetorë dhe, së bashku me zhvendosjen e strukturës së depozitave drejt maturiteteve më të gjata, tregon për një preferencë më të ulët drejt likuiditetit të agjentëve ekonomikë.

Në muajin mars ekspansioni vjetor i parasë së gjerë është mbështetur nga rritja e kredisë për sektorin privat, e cila u shfaq më e gjallëruar gjatë këtij muaji, në linjë me sjelljen sezonale të saj. Kontributi në rritje i kërkesës për para nga sektori privat i ekonomisë ka kompensuar rënien graduale të mjeteve valutore neto. Kërkesa për para e sektorit publik ka qenë në rritje, në mbështetje të sjelljes më aktive të qeverisë në tremujorin e parë të vitit. Në terma vjetorë, portofoli i kredisë për sektorin privat shënoi rritje me 11.5%, nga 10.3% në muajin shkurt.

Kredia për biznese mbetet kontribuuesi kryesor në zgjerimin e kredisë për sektorin privat. Ndërkohë, gjatë muajit mars, shenja pozitive ka shfaqur edhe kredia për individë.

Ecuria e përgjithshme e tregjeve financiare gjatë katër muajve të parë të vitit 2011 ka qenë pozitive. Informacioni i përcjellë nga tregjet financiare tregon për pritje të ankoruara inflacioniste të agjentëve. Rritja e normës bazë në fund të muajit mars është përcjellë tek normat afatshkurtra të interesit në tregun e parasë, duke sjellë një sheshim të lehtë të pjerrësisë së yield-eve të bonove të thesarit. Në tregun e depozitave ka vazhduar rënia e normave të interesit, duke reflektuar edhe korrektimin e niveleve të larta që shënuan ato pas vitit 2008. Tregu i shkëmbimeve valutore ka operuar i qetë dhe kursi i këmbimit ka vijuar të nënçmohet me ritme të ulëta vjetore. Banka e Shqipërisë ka furnizuar tregun ndërbankar me likuiditetin e nevojshëm për funksionimin normal të tyre.

Në mënyrë të përmbledhur, Banka e Shqipërisë gjykon se presionet relativisht të larta inflacioniste të tremujorit të parë të vitit kanë përgjithësisht natyrën e goditjeve kalimtare. Faktorët e tjerë që ndikojnë në inflacion, si ecuria aktuale dhe e pritur ekonomike përkundrejt ritmit potencial të zhvillimit, ekspansioni i mjeteve monetare në ekonomi, dhe pritjet e publikut e të tregjeve financiare, ushtrojnë ndikim frenues në inflacion.

Projeksionet tona për të ardhmen mbështesin ruajtjen e ecurisë pozitive të ekonomisë shqiptare edhe në vazhdim të këtij viti. Konsumi dhe investimet private pritet të rriten më tej, ndërkohë që pas ngadalësimit në vitin 2010 edhe sektori fiskal pritet të japë një kontribut pozitiv në rritjen ekonomike. Pavarësisht kësaj, rritja e kërkesës vlerësohet se do të jetë nën potencialin e ekonomisë sonë edhe për vitin 2011. Kjo do të kushtëzojë presionet rënëse mbi inflacion nga ekonomia e brendshme, të cilat pritet të balancojnë efektin e rritjes së çmimeve të huaja. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë është e vendosur të marrë të gjitha masat e nevojshme në kohën e duhur për të respektuar objektivin e saj të inflacionit në periudhën afatmesme.

***

Duke vënë në balancë informacionin e përmbledhur më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se presionet inflacioniste në periudhën afatmesme janë të kontrolluara. Pritjet inflacioniste vazhdojnë të jenë të ankoruara rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë për inflacionin. Në mungesë të goditjeve të papritura, në periudhën afatmesme inflacioni pritet të jetë brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Faktorët e rrezikut që rrethojnë këtë skenar bazë paraqiten gjithashtu të balancuar.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës konkludoi se kushtet monetare paraqiten të përshtatshme për respektimin e objektivit të inflacionit në periudhën afatmesme dhe vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5.25 %.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në mbledhjen vjetore të EFSE– Fondi Evropian
për Evropën Juglindore,
në 7 qershor 2011

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar Guvernatorë,

Të nderuar pjesëtarë të Bordit të EFSE,

Të nderuar zonja dhe zotërinj

Është privilegj dhe kënaqësi e madhe që ndodhem sot në këtë panel të nderuar për të përshëndetur fillimin e mbledhjes vjetore për vitin 2011 të Fondit Evropian për Evropën Juglindore ose siç jemi mësuar ta quajmë ndryshe EFSE. Pak më shumë se katër vjet më parë, isha i ftuar në lançimin e kësaj iniciative të mrekullueshme këtu në qytetin e Tiranës. Dy vjet më parë, në mbledhjen vjetore që u zhvillua në qytetin Novi Sad qeveria e Shqipërisë u bë aksioner i këtij Fondi. Ndërkohë që sot jemi mbledhur përsëri në kryeqytetin shqiptar për të bërë bilancin e punës të këtij institucioni.

Përfitoj nga rasti që të falënderoj Fondin Evropian për Evropën Juglindore, për kontributin e dhënë anekënd rajonit tonë, për mbështetjen financiare që i ka dhënë atij, për ekspertizën e ofruar, për zhvillimin e tregut financiar, pa harruar të përmend në mënyrë më specifike ndihmesën që EFSE ka dhënë në Shqipëri nëpërmjet financimit me terma konkurruese të projekteve të biznesit, në një kohë kur kredia e sektorit bankar ka regjistruar ritme të ngadalta gjallërimi.

Kriza e rëndë financiare e kohëve moderne ka shkaktuar shumë paqëndrueshmëri në ekonominë botërore. Sot, vlerësohet se po përjetojmë një situatë më të përmirësuar. Në tavolinat e debatit teorik dhe shkencor përpjekjet janë përqendruar në identifikimin e shkaqeve dhe marrjen e masave për të mos lejuar përsëritjen e ngjarjeve të tilla në të ardhmen. Një infrastrukturë e re financiare po projektohet. Ky është konteksti i këtij takimi vjetor, në qendër të të cilit do të jetë identifikimi i sfidave me të cilat ndeshet rajoni ynë në periudhën e paskrizës financiare.

Më lejoni të trajtoj shkurtimisht dy-tre mendimet e mia personale në lidhje me këtë situatë. Përpara ndikimit të krizës financiare ndërkombëtare, të gjitha vendet e rajonit qenë përfshirë në reforma të rëndësishme që synonin rritjen e qëndrueshme ekonomike. Ne këtë fazë, nëpërmjet përmirësimeve të nevojshme ligjore dhe politikave të kujdesshme të zhvillimit, u realizua hapja e ekonomive dhe zhvillimi i tregtisë, rritja e investimeve të brendshme

dhe të huaja, liberalizimi në përgjithësi i tregjeve, si dhe u nxit zhvillimi i tregut financiar për të ofruar shërbime financiare më cilësore dhe më të përballueshme për familjet e bizneset.

Në këndvështrimin makroekonomik, politikat fiskale në rajon kane synuar të shkojnë drejt konsolidimit fiskal nëpërmjet rritjes së të ardhurave dhe orientimit më të madh të shpenzimeve publike në investime. Politikat monetare, të ndikuara prej regjimeve të ndryshme të kursit të këmbimit, kanë mbajtur përgjithësisht nën kontroll rritjen e çmimeve të konsumit dhe normat e interesit kanë ndjekur një prirje rënëse. Megjithatë, ndikimi i krizës financiare ndërkombëtare në vendet e rajonit tonë ishte i pranishëm, për shkak të disa dobësive që ishin krijuar gjatë fazës së rritjes ekonomike.

Së pari, afërsia e vendeve tona dhe përqendrimi i tregtisë me zonën e Bashkimit Evropian, si edhe lëvizjet migratore, kanë sjellë përdorimin e euros në një masë të konsiderueshme brenda ekonomive të rajonit. Rritja ekonomike është financuar në masë të rëndësishme me burime të huaja, në formën e huamarrjes në valutë nga sektori publik, sektori financiar, bizneset dhe familjet. Bankat e kanë një pjesë të konsiderueshme të detyrimeve në valutë, e gjithashtu edhe një pjesë të mirë të portofolit të kredive. Kreditimi në valutë ka qenë mbizotërues dhe i parapëlqyeri nga palët.

Shkak për këtë ishte një kombinim faktorësh që lidheshin me një prirje pozitive të kursit të këmbimit, norma më të ulëta të interesit dhe mundësi të mira të sektorit bankar për të financuar këto kredi në tregjet e shumicës. Financimet në valutë për sektorin privat dhe familjet, janë përdorur në një masë të konsiderueshme për konsum.

Investimet e huaja në sektorët e mallrave të tregtueshëm, që mund të kontribuojnë pozitivisht në gjendjen e bilancit tregtar, kanë qenë më të pakta në krahasim me ato në sektorët e mallrave të patregtueshëm. Ky është rasti i Shqipërisë, i Bosnje-Hercegovinës apo edhe i Serbisë, ku vlerësohet që në fund të vitit 2008, në stokun e investimeve të huaja, pesha e investimeve në sektorin e mallrave të tregtueshëm varionte nga 15 % në Shqipëri në 35% në Serbi. Për këto arsye, përpara krizës, disa nga vendet e rajonit kanë shënuar deficite të bilancit tregtar, të cilat kanë qenë të qëndrueshme madje edhe kane ardhur në rritje.

Së dyti, megjithë përpjekjet për zhvillimin e tregut financiar, sektori bankar vijoi të dominojë në sistemin financiar të vendeve të rajonit tonë. Kjo është një dukuri e vendeve me ekonomi në zhvillim, e cila dëshmon varësinë e madhe që ka zhvillimi ekonomik nga gjendja e sektorit bankar.

Sektori bankar në disa vende të rajonit zotërohet kryesisht prej grupeve bankare evropiane. Kriza financiare tregoi se krahas përparësive që sjell hyrja e grupeve të huaja bankare në një treg vendas, ajo shoqërohet edhe me elemente të përcjelljes së rrezikut që duhet të vlerësohen me kujdes dhe në kohën e duhur.

Së treti, vendet e rajonit tonë kanë nevoja të ndryshme për investime, duke veçuar ato në infrastrukturën rrugore, energjetike dhe të kujdesit shëndetësor. Gjithashtu, zhvillimet demografike, duke përfshirë migracionin si edhe vendosjen e një prirjeje ngadalësuese të rritjes së popullsisë, kanë sjellë rritjen e kostove të skemave publike të pensionit dhe të elementeve të tjerë të mbrojtjes sociale. Për këtë arsye, megjithë përpjekjet për konsolidim fiskal, deficitet buxhetore kanë qene të pranishme dhe të qëndrueshme gjatë gjithë kohës.

Gjatë viteve të ndikimit të krizës financiare, pati një angazhim të autoriteteve publike për të kapërcyer situatën. Pothuaj në të gjitha vendet e rajonit, qeveritë u angazhuan në ndjekjen e politikave fiskale stimuluese që synonin rritjen e mbështetjes për ekonominë reale si edhe për sistemin financiar.

Politika monetare ndoqi një prirje lehtësuese, duke ulur normat e interesit dhe duke plotësuar nevojat e tregut ndërbankar për likuiditete. Duke ju kthyer rastit të Shqipërisë, do të doja të theksoja se eksperienca jonë në absorbimin e efekteve të krizës qe e suksesshme.

Shqipëria u vlerësua si një nga vendet që:

- Nuk përjetoi falimentim bankash apo injektime të kapitalit nga ana e shtetit;
- Përballoi me shumë kurajo krizën e besimit ndaj sistemit bankar dhe ku ndërmjetësimi financiar nuk u ndal për asnjë moment.
- Ekonomia vazhdoi të rritej në terma pozitivë, pavarësisht një ritmi më të ngadaltë;

Pritshmëritë inflacioniste mbetën të ankoruara gjatë gjithë kohës.

Sektorit bankar në Shqipëri, gjatë kësaj periudhe, vijoi zgjerimin e veprimtarisë dhe të kreditimit të ekonomisë por me ritme më të ulëta. Vështirësitë e shtuara të sektorit real të ekonomisë dhe nënçmimi i kursit të këmbimit në vitin 2009 me rreth 12%, u shoqëruan me një rënie të cilësisë së kredisë dhe rritje të fondeve rezervë në banka për përballimin e rrezikut të kredititit.

Të nderuar pjesëmarrës,

Dukuritë e periudhës së parakrizës, si edhe ato të shfaqura në vitet 2008-2010, ofrojnë një përvojë të çmuar për aktorët ekonomikë dhe autoritetet publike në çdo vend të rajonit tonë. Pa dashur t'i përmend të gjitha do të ndalesha në disa prej tyre që unë i konsideroj të rëndësishme për të rritur qëndrueshmërinë e ekonomisë dhe të sistemit tonë financiar në të ardhmen.

Së pari, rajoni ka nevojë për një balancë më të mirë të faktorëve që mbështesin rritjen e qëndrueshme ekonomike. Mendoj qe autoritetet publike duhet të vendosin si përparësi rritjen e investimeve dhe zbatimin e politikave stimuluese për zhvillimin e sektorëve konkurrues. Në këtë mënyrë, kapacitetet

eksportuese të vendit do të rriteshin, duke krijuar kushte më të mira për përmirësimin e qëndrueshëm të bilancit të jashtëm të ekonomisë sonë.

Së dyti, lidhur ngushtësisht me çështjen e parë do të evidentoja domosdoshmërinë për ndërmarrjen dhe thellimin e mëtejshëm të reformave strukturore. Ky objektiv strategjik mbetet një përparësi konstante për secilën prej ekonomive tona.

Fokusi i tyre duhet të jetë sa më i gjerë, duke nënkuptuar përshtatjen e mëtejshme të legjislacionit, përmirësimin e infrastrukturës, privatizimin e plotë të aseteve publike, përmirësimin e klimës së biznesit, thellimin dhe zgjerimin e tregut financiar, reformën e plotë në pensione si dhe një sërë aksionesh të tjera, të cilat për arsye objektive nuk mund t'i përmend të gjitha. Mendoj se objektivi ynë madhor mbetet hyrja e investimeve të huaja direkte. Pa to rajoni do të vazhdojë të mbetet i vogël, i fragmentuar, me potencial të ulët zhvillimi social dhe ekonomik, me eksporte sporadike, me tregje prematurë dhe me kosto të larta ose e thënë ndryshe me një produktivitet të ulët. Për mua personalisht çdo investim i huaj do të thotë konvergim i shpejtë me Evropën .

Së treti, tregu financiar ka nevoje të zhvillohet për të krijuar alternativa të tjera për kursimin, për financimin dhe për administrimin e rrezikut për subjektet ekonomike, si edhe për të përmirësuar kushtet e këtyre veprimtarive. Është e nevojshme që krahas sektorit bankar, të zhvillohet më shpejtë pjesa e sistemit financiar jobankar për të mundësuar një përfshirje dhe akses më të madh në shërbimet financiare, të subjekteve që nuk mund të përfitojnë sa duhet prej shërbimeve bankare.

Gjithashtu, gjykoj se është e rëndësishme t'iu kushtohet vëmendje më e madhe zhvillimit të tregjeve të kapitalit, veçanërisht ato të emetimit dhe të tregtimit të letrave me vlerë të kapitalit dhe të borxhit, nga subjektet private.

Së katërti, kuadri rregullativ dhe praktikat mbikëqyrëse duhet të plotësohen me disa elementë të rëndësishëm që lidhen me kuadrin e masave prudenciale dhe me ato të administrimit të situatave të jashtëzakonshme financiare. Kuadri i masave prudenciale, duhet të trajtojë me kujdes kërkesat për kapital dhe për likuiditet të bankave, veçanërisht në rastin e valutës. Njëherazi është e nevojshme të vlerësohet rreziku sistemik në sistemin financiar dhe në sektorin bankar, nëpërmjet ndërtimit të indekseve të posaçme si edhe zbatimit të praktikave më të mira të stress-testit. Për sa i përket plotësimit të kuadrit të administrimit të situatave të jashtëzakonshme financiare, merr rëndësi procesi i rishikimeve dhe përmirësimeve të nevojshme ligjore dhe rregullative, i bashkëpunimit mes autoriteteve publike dhe i identifikimit në kohë të problemeve të ndryshme veçanërisht në institucionet me rëndësi sistemike. Banka e Shqipërisë, prej disa kohësh ka hyrë në këtë proces rishikimi dhe përmirësimi të kuadrit rregullativ, mbi bazën e disa objektivave të paracaktuar.

Duke përfunduar, dëshiroj të theksoj se vendet e rajonit tonë, kanë kapërcyer me sukses një periudhë të vështirë si rezultat i ndikimit të krizës financiare ndërkombëtare. Megjithatë sfidat që gjenden përpara nesh janë të shumta.

Ato na imponojnë për një angazhim të vazhdueshëm të gjithë faktorëve të jetës ekonomike dhe politike të vendit. Nevoja për bashkërendim të veprimeve si në nivel lokal ashtu dhe në nivel rajonal, është një përparësi absolute.

Mendoj se ekzistojnë të gjithë prerogativat që ky bashkëpunim të jetë efektiv, i sinqertë dhe me përfitime reciproke për secilin prej vendeve të rajonit. Për këtë qëllim, mendoj se një rol të rëndësishëm, do të vazhdojë të luajë edhe Fondi Evropian për Evropën Juglindore, të cilin përfitoj edhe njëherë nga rasti ta përgëzoj për punën e bërë dhe për angazhimet e marra për të ardhmen.

Ju faleminderit!

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

gjatë prezantimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë
për vitin 2010 në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë,
në 9 qershor 2011.

E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Është kënaqësi për mua të gjendem sot para jush, për të prezantuar opinionin e Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare të vitit të shkuar.

Në mbështetje të kërkesave ligjore, si dhe të angazhimeve tona institucionale për të forcuar pavarësinë, transparencën dhe përgjegjshmërinë e bankës qendrore, gjatë këtij komunikimi do të ndaj me ju edhe linjat kryesore të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2010. Në të gjithë spektrin e tij, ky aktivitet është orientuar nga përmbushja e misionit dhe e detyrave tona ligjore, duke reflektuar njëkohësisht edhe rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për vitin 2010.

Më lejoni që, fillimisht, të bëj një përmbledhje të shkurtër të konkluzioneve tona.

Ekonomia shqiptare ka patur një zhvillim përgjithësisht pozitiv gjatë vitit 2010. Aktiviteti ekonomik në vend shënoi rritje gjatë vitit të shkuar, ndërkohë që stabiliteti makroekonomik dhe treguesit e shëndetit financiar u përmirësuan.

Rritja ekonomike reflektoi kryesisht kërkesën e huaj për produktet e shërbimet shqiptare, duke konfirmuar para së gjithash dinamizmin e sektorit tonë privat. Ajo u mbështet gjithashtu nga një ambient i qëndrueshëm makroekonomik, me prime rreziku në ulje dhe tregues likuiditeti të përmirësuar.

Në veçanti, duke reflektuar zhvillimet në sektorin real e financiar të ekonomisë, si dhe politikën tonë monetare, inflacioni i çmimeve të konsumit qëndroi në linjë me objektivin e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2010.

Gjithashtu, gjatë këtij viti:

pozicioni i jashtëm i ekonomisë u përmirësua;
raportet e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik ndaj PBB-së shënuan rënie;
stabiliteti financiar u konsolidua;
ndërmjetësimi financiar u zgjerua më tej; dhe,
normat e interesit e primet e rrezikut në tregjet financiare shënuan rënie.

Nga ana tjetër, zhvillimet e vitit 2010 nënvizuan edhe një herë nevojën për vazhdimin dhe thellimin e reformave strukturore, si parakusht për një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë ekonomike.

Së pari, axhenda e re e reformave strukturore duhet të synojë krijimin e kushteve për një rritje më të balancuar dhe më të qëndrueshme në periudhën afatgjatë.

Orientimi më i madh i ekonomisë shqiptare drejt eksportit, si dhe rritja në përgjithësi e konkurrueshmërisë së produkteve tona në tregjet e huaja e të brendshme, diktojnë nevojën për vazhdimin e reformave strukturore, në nivel makro dhe mikroekonomik.

Së dyti, konsolidimi i stabilitetit makroekonomik kërkon një punë më të madhe në të ardhmen. Mësimi më i madh i krizës së fundit botërore, është se mënyra më e mirë për përballimin e krizave është në radhë të parë parandalimi i tyre.

Ruajtja e ekuilibrave të brendshëm e të jashtëm të vendit kërkon zhvillimin e mëtejshëm të arkitekturës së vendimmarrjes e të koordinimit makroekonomik, si dhe të mekanizmave mbikëqyrës e rregullatorë të ekonomisë dhe të tregjeve. Aftësitë analizuese, parashikuese e vendimmarrëse të agjentëve ekonomikë, publikë e privatë, duhet gjithashtu të përmirësohen më tej.

Së treti, garantimi i stabilitetit financiar të vendit kërkon një koordinim të veprimeve të të gjitha institucioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe të një vëmendje më të madhe të agjentëve privatë të tregut.

Një sistem financiar i qëndrueshëm, i orientuar drejt horizontit afatgjatë dhe i kujdesshëm ndaj rreziqeve, i shërben kanalizimit të kursimeve në sektorët më konkurrues të ekonomisë.

***

Në vijim të fjalës time do të bëj një trajtim më të detajuar të çështjeve të mësipërme, duke u fokusuar në drejtimet kryesore të punës së Bankës së Shqipërisë.

1. Zhvillimet ekonomike dhe financiare gjatë vitit 2010

Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare vlerësohet të jetë rritur me 3.9% gjatë këtij viti. Në krahasim me vitin 2009, rritja ekonomike paraqitet më e balancuar në shpërndarjen e saj sektoriale dhe në komponentët e kërkesës.

Ecuria e ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2010 është karakterizuar nga përmirësimi gradual i kërkesës agregate dhe nga konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik. Zhvillimi ekonomik është shoqëruar nga stabiliteti i çmimeve, ndërkohë që borxhi publik, deficiti buxhetor dhe deficiti i llogarisë korrente janë reduktuar.

Rritja ekonomike është mbështetur kryesisht nga kërkesa e huaj dhe rritja

e eksporteve shqiptare, ndërsa kërkesa e brendshme ka patur një ecuri më të ngadaltë. Kjo e fundit është frenuar nga konsolidimi i financave publike dhe ulja e deficitit buxhetor gjatë vitit 2010, ndërkohë që shpenzimet konsumatore dhe investimet private janë ndikuar nga pasiguria për të ardhmen dhe nga prania e kapaciteteve të pashfrytëzuara.

Politika fiskale u orientua drejt konsolidimit fiskal gjatë vitit 2010, pas natyrës stimuluese të shfaqur në vitin 2009. Konsolidimi fiskal u përshpejtua sidomos në gjashtëmujorin e dytë të vitit, me miratimin e buxhetit të rishikuar. Ky konsolidim ishte i pranishëm si në kahun e të ardhurave ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Të ardhurat buxhetore u rritën me 8.4% në terma vjetorë, duke reflektuar rritjen ekonomike, zgjerimin e bazës së tatimpaguesve, dhe të ardhurat nga privatizimet. Nga ana tjetër, shpenzimet buxhetore u tkurrën me 4.5%, duke reflektuar tkurrjen e shpenzimeve kapitale të qeverisë.

Deficiti buxhetor për vitin 2010 zbriti rreth nivelit 3.0% të PBB-së, duke u reduktuar me 52% krahasuar me një vit më parë. Deficiti u financua kryesisht nëpërmjet emetimit të instrumenteve të zakonshme të borxhit të brendshëm. Megjithatë, financimi i deficitit solli një risi në vitin 2010, nëpërmjet emetimit të Eurobondit të parë shqiptar. Ky emetim, në vlerën prej 300 milionë eurosh, plotësoi një pjesë të nevojave në valutë të sektorit publik dhe u shoqërua me reduktimin e huamarrjes së brendshme.

Deficiti i llogarisë korrente u ngushtua me rreth 21.5% gjatë vitit 2010, duke qëndruar në nivelin 11.9% të PBB-së. Ky reduktim reflektoi rritjen e kursimeve të sektorit privat dhe publik. Ai u ndihmua gjithashtu nga rritja e eksporteve si pasojë e gjallërimit të kërkesës së huaj, kursit të nënçmuar të këmbimit dhe përmirësimit të termave të tregtisë në këtë periudhë. Megjithë përmirësimin e shënuar gjatë vitit 2010, deficiti i llogarisë korente mbetet i lartë. Siç e kemi theksuar në vazhdimësi, Banka e Shqipërisë gjykon se hartimi i politikave strukturore për zbutjen e zhbalancimeve të ekonomisë së jashtme duhet trajtuar me prioritet.

Flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare regjistruan një rënie me rreth 11.2% gjatë vitit 2010, duke mundësuar financimin e deficitit të llogarisë korrente në masën 87.5%. Duke përjashtuar privatizimet, investimet e huaja direkte u vlerësuan në 9.3% të PBB-së dhe ishin burimi kryesor i financimit të huaj të ekonomisë shqiptare. Rezerva valutore e vendit u rrit me rreth 178.8 milionë euro dhe stoku i saj prej 1.9 miliardë eurosh është i mjaftueshëm për mbulimin e 4.8 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Zhvillimet pozitive në sektorin e jashtëm të ekonomisë, kryesisht si rrjedhojë e zgjerimit të eksporteve, si dhe të hyrat valutore nga Eurobondi, kanë ndihmuar në gjenerimin e presioneve të përmbajtura në tregun e shkëmbimeve valutore këtë vit. Në këndvështrimin makroekonomik, qëndrueshmëria relative e kursit të këmbimit gjatë vitit ka reflektuar një ekuilibër të ri të arritur në kërkesën dhe ofertën për valutë të huaj.

Në terma sektorialë, zhvillimi i ekonomisë shqiptare është mbështetur

kryesisht nga rritja e sektorit të industrisë dhe e atij të shërbimeve, ndërkohë që sektori i ndërtimit ka vijuar të kontraktohet gjatë vitit 2010. Sektorët e industrisë dhe të shërbimeve kanë përfituar në një masë të madhe respektivisht nga kërkesa e huaj dhe nga zhvendosja strukturore e kërkesës së brendshme drejt mallrave të konsumit afatshkurtër. Në horizontin afatshkurtër dhe afatmesëm, këta dy sektorë pritet të mbeten mbështetësit kryesorë të ekonomisë shqiptare. Sektori tjetër i rëndësishëm i ekonomisë shqiptare, ai bujqësor, ka regjistruar një ecuri pozitive gjatë vitit 2010. Megjithatë, bazuar në përqendrimin e madh të popullsisë së vendit dhe në potencialin e madh të zhvillimit, prioritet afatgjatë mbetet rritja e produktivitetit të këtij sektori.

Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare

Zhvillimet monetare të vitit të shkuar kanë qenë në linjë me ecurinë e sektorit real të ekonomisë, duke reflektuar njëkohësisht rivendosjen e plotë të besimit në sistemin financiar, përmirësimin e raporteve të kërkesës e ofertës në tregjet financiare dhe politikën e kujdesshme të administrimit të likuiditetit nga Banka e Shqipërisë. Rritja me mesatarisht 10.6% e masës monetare ka qenë në përputhje me kërkesën e ekonomisë për para, duke mos nxitur tendenca inflacioniste në ekonomi. Raporti i depozitave ndaj PBB-së shënoi 64.2% në fund të vitit, duke qëndruar më lart se niveli i regjistruar para fenomenit të tërheqjes së depozitave. Profili i strukturës kohore të depozitave ka reflektuar gjithashtu preferencën e rritur për kursim, duke u karakterizuar nga zhvendosja e depozitave drejt maturiteteve më afatgjata.

Lehtësimi i kushteve të kreditimit gjatë gjysmës së dytë të vitit, masat stimuluese të marra nga Banka e Shqipërisë, si dhe ulja e pasigurisë dhe e primeve të rrezikut, u shoqëruan me një rritje graduale të kredisë. Portofoli i kredisë për sektorin privat u zgjerua me 10% gjatë vitit 2010, i ndikuar kryesisht nga rritja e kreditimit në valutë. Kjo ecuri reflekton politikat e kujdesshme të bankave për cilësinë e portofolit të kredisë, si dhe kërkesën e moderuar për kredi të agjentëve ekonomikë.

Në përgjithësi, aktiviteti kreditues vijon të vuajë nga mungesa e kërkesës dhe e planeve të biznesit realiste, cilësore e të vlefshme për kreditim.

Rikthimi i besimit në sistemin financiar, konsolidimi makroekonomik, si dhe masat rregullative e mbikëqyrëse të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, ndikuan në stabilizimin dhe përmirësimin e treguesve të kapitalizimit, të likuiditetit dhe të përfitueshmërisë së sistemit bankar.

2. Ecuria e inflacionit dhe politika monetare

Inflacioni vjetor i çmimeve të konsumit rezultoi mesatarisht 3.6% gjatë vitit 2010, duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Presionet inflacioniste u përqendruan në gjysmën e parë të vitit, të nxitura më së shumti prej rritjes së disa çmimeve të administruara. Inflacioni mesatar vjetor në gjashtë muajt e parë të vitit rezultoi 3.9%. Në dy tremujorët pasues, stabilizimi

relativ i kursit të këmbimit dhe presionet e ulëta inflacioniste prej kërkesës së brendshme ndihmuan në konvergimin e normës mesatare të inflacionit përreth objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Hendeku negativ i prodhimit ka prodhuar presione të përmbajtura inflacioniste gjatë gjithë vitit 2010, duke balancuar efektin e nënçmimit të monedhës vendase dhe të rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Nëse hedhim vështrimin përpara, ekonomia shqiptare pritet të operojë nën potencialin e saj edhe për një periudhë afatmesme, duke ushtruar presione rënëse në inflacion.

Siç e theksova dhe më parë, gjatë vitit 2010, politika monetare e Bankës së Shqipërisë u zhvillua në një mjedis makroekonomik të karakterizuar nga presione të përmbajtura inflacioniste dhe nga pritje të ankoruara për inflacionin e ardhshëm. Ky mjedis mundësoi ruajtjen e një natyre stimuluese të politikës monetare, të shfaqur që gjatë vitit 2009. Kjo politikë ka nxitur tendencën rënëse të normave të interesit dhe ka plotësuar më tej efektet stimuluese të ardhura nga nënçmimi i kursit të këmbimit. Normat e ulëta të interesit kanë favorizuar rritjen e konsumit dhe të investimeve në vend, ndërsa kursi i nënçmuar i këmbimit ka mbështetur rritjen e eksporteve shqiptare gjatë vitit.

Reduktimi i stimulit fiskal gjatë gjashtëmujorit të dytë zgjeroi hapësirat për veprimin e politikës monetare. Në muajin korrik 2010, Banka e Shqipërisë uli me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interesit, duke e zbritur atë në nivelin më të ulët historik prej 5.0%. Përmirësimi i kushteve të likuiditetit në sistemin bankar dhe kërkesa e dobët e sektorit shtetëror për mjete monetare kanë mbështetur përcjelljen e politikës lehtësuese në të gjitha segmentet e tregjeve financiare në muajt e fundit të vitit 2010.

Paralelisht me këtë lëvizje, Banka e Shqipërisë ka furnizuar tregun financiar me likuiditetin e nevojshëm për mbështetjen e ndërmjetësimit financiar. Duke synuar gjithnjë adoptimin e modeleve më të përparuara të bankingut qendror, dhe në veçanti konvergjencën me praktikat e Eurosistemit, Banka e Shqipërisë ndryshoi edhe formën e objektivit të saj operacional.

Duke filluar nga muaji qershor 2010, operacionet tona të administrimit të likuiditetit orientohen nga shënjestrimi i normave afatshkurtra të interesit në tregun ndërbankar dhe nga minimizimi i luhatjeve të tyre.

***

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i detyrave të bankës qendrore është edhe funksioni mbikëqyrës i sistemit bankar.

3. Mbikëqyrja bankare dhe stabiliteti financiar

Viti 2010 u karakterizua nga rritja e mëtejshme e aktivitetit bankar,

përmirësimi i treguesve të shëndetit dhe të fitimit, si dhe nga një kapitalizim i mirë i sistemit. Nga ana tjetër, problemi kryesor i sistemit bankar ka qenë rritja e portofolit të kredive me probleme, e cila ka reflektuar edhe politikën aktive të Bankës së Shqipërisë në drejtim të rritjes së transparencës së bilanceve të bankave.

Ecuria e sistemit bankar

Sektori bankar vijon të mbetet aktori kryesor i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri. Në fund të vitit 2010, aktivet e sistemit bankar janë rritur me ritme dy herë më të larta se një vit më parë, duke përfaqësuar rreth 81% të PBB-së. Financimi i sistemit bankar vijon të mbështetet kryesisht nga depozitat e publikut dhe të jetë e përqendruar në kreditimin e sektorit privat.

Nga ana tjetër, rritja nën potencial e ekonomisë dhe kursi i nënçmuar i këmbimit kanë ndikuar në rritjen e raportit të kredisë me probleme, në 14% të totalit të kredisë. Megjithatë, ritmet e rritjes së këtij treguesi kanë ardhur në rënie përgjatë vitit 2010.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit mbetet i kënaqshëm, në nivelin 15.4%, dukshëm më i lartë se limiti prej 12% i përcaktuar në kuadrin rregullator. Kapitali aksioner i sistemit është rritur me 10% në vitin 2010.

Rreziku i kreditit mbetet rreziku kryesor për sektorin tonë bankar. Në përgjigje të këtij rreziku, sektori bankar ka krijuar fonde rezervë të mjaftueshme për përballimin e goditjeve të mëdha mbi aftësinë paguese të kredimarrësve dhe ekuilibrat e tregut.

Mbikëqyrja e sistemit bankar

Në fillim të vitit 2010, Banka e Shqipërisë ndryshoi kuadrin organizativ të mbikëqyrjes bankare, duke e orientuar dhe e lidhur drejtpërdrejt atë me rreziqet që shoqërojnë aktivitetin financiar. Paralelisht me këtë, Banka e Shqipërisë bëri edhe një rikonceptim të fokusit dhe strategjisë së punës për qëllime mbikëqyrëse sipas rreziqeve me të cilat përballet sistemi bankar dhe financiar në vend.

Në fokus të procesit mbikëqyrës përgjatë vitit 2010 kanë qenë dhe transparenca dhe publikimi i informacionit, për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare. Nxitja për rritjen e transparencës së agjentëve financiarë privatë është pasqyruar dhe në ndryshimet e kuadrit rregullativ gjatë vitit. Një çështje sensitive e ndjekur gjatë vitit të kaluar dhe që do të ketë prioritet në periudhat në vijim është dhe niveli i lartë i komisioneve të aplikuara për produktet dhe shërbimet bankare. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet analizave të saj, ka qenë pjesë e rëndësishme e diskutimeve mbi këtë fenomen, duke synuar adresimin në kohë dhe me eficiencë të kësaj problematike.

Pjesë e rëndësishme e procesit mbikëqyrës përgjatë vitit 2010, kanë qenë edhe çështjet që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave si dhe me

ndjekjen e normave mbikëqyrëse.

Në kuadër të forcimit të procesit të mbikëqyrjes së subjekteve bankare, Banka e Shqipërisë ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me bankat qendrore të rajonit dhe ato evropiane ku bankat mëma kanë selitë e tyre qendrore.

Forcimi i kuadrit rregullator e mbikëqyrës

Gjatë vitit 2010, Banka e Shqipërisë finalizoi hartimin e disa rregulloreve të reja dhe bëri ndryshime në disa rregullore të tjera të mbikëqyrjes bankare. Ky proces ka synuar në vazhdimësi përshtatjen me standardet e Komitetit të Bazelit dhe direktivat e Bashkimit Evropian, duke konsideruar praktikat më të mira në fushën e rregullimit dhe zhvillimet në sistemin bankar shqiptar.

Akte të reja rregullative dhe ndryshime me rëndësi në aktet në fuqi për mbikëqyrjen bankare të miratuara gjatë këtij viti janë:

Rregullorja "Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore";
Rregullorja "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jo-banka"; dhe
Manuali "Për kujdestarinë dhe likuidimin e bankave".

***

Krahas drejtimeve kryesore të punës së Bankës së Shqipërisë, sikurse janë politika monetare dhe mbikëqyrja e rregullimi i sektorit bankar, aktiviteti i Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2010 është përqendruar edhe në përmbushjen e detyrave të tjera ligjore dhe angazhimeve tona institucionale.

Pa u ndalur në veçanti, dëshiroj të theksoj se Banka e Shqipërisë ka bërë një punë të madhe gjatë vitit 2010 për:

- Zhvillimin dhe sofistikimin e sistemit të pagesave;
- Mbështetjen e proceseve integruese të vendit, në përputhje me sferën tonë të veprimtarisë;
- Rritjen sasiore dhe cilësore të komunikimit tonë me publikun, si një instrument esencial për forcimin e transparencës dhe pavarësisë së bankës qendrore;
- Zhvillimin e mëtejshëm të statistikave monetare dhe të sektorit të jashtëm të ekonomisë;
- Forcimin e kapaciteteve studimore dhe kërkimore, në mbështetje të analizës e vendimmarrjes.

Të gjitha këto aktivitete i shërbejnë zhvillimit të sistemit financiar dhe mbështesin ekonominë e tregut të lirë në Shqipëri. Një trajtim të detajuar të tyre mund ta gjeni në Raportin tonë Vjetor.

****

E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Duke iu rikthyer edhe një herë analizës së zhvillimeve ekonomike e financiare të vendit para, gjatë dhe pas krizës botërore, do të doja të theksoja një dobësi strukturore të ekonomisë shqiptare që e ka shoqëruar atë përgjatë gjithë tranzicionit: deficitin e lartë të llogarisë korente dhe shkallën ende të ulët të konkurrueshmërisë së ekonomisë tonë në tregjet botërore.

Sot jetojmë në një botë globale, me tregje të integruara kapitali, produktesh e pune. Si një vend në zhvillim, Shqipëria po përballet e do të përballet me konkurrencë në rritje, jo vetëm në kontekstin rajonal por dhe më gjerë.

Në opinionin tonë, zhvillimi i qëndrueshëm dhe afatgjatë i vendit, si dhe ulja e dobësive tona strukturore, nënkupton detyrimisht rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare. Vazhdimi i reformës strukturore duhet të orientohet nga objektiva ambiciozë dhe një horizont kohor realist.

Reformat strukturore duhet të synojnë krijimin e një klime akoma më tërheqëse për investimet e huaja dhe ato vendase, nxitjen e punësimit dhe rritjen e mëtejshme të mirëqenies, duke ofruar:

- një ambient të qëndrueshëm makroekonomik;
- një sistem financiar eficient e të besueshëm;
- një kuadër ligjor funksional, të plotë e transparent;
- një infrastrukturë moderne;
- një forcë punëtore të kualifikuar dhe konkurruese në terma të kostos; dhe
- një perspektivë të qartë për një integrim sa më të shpejtë në Bashkimin Evropian e cila do t'i hapë rrugë fondeve të konvergjencës.

Plotësimi i këtyre kritereve kërkon angazhimin e përbashkët të të gjithëve, ku Banka e Shqipërisë do të luajë rolin e saj. Personalisht, mbetem i bindur se rritja e efektivitetit të reformave në këto linja do t'i mundësojë Shqipërisë të hedhë një hap cilësor drejt rrugës së saj të integrimit.

Duke përfunduar, më lejoni t'ju rikujtoj se, së bashku me Raportin Vjetor, pranë jush janë depozituar dhe pasqyrat financiare të Bankës Shqipërisë për vitin 2010, të certifikuara nga auditorët.

Ju falënderoj për vëmendjen.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në takimin e organizuar nga Banka Raiffeisen
me përfaqësues biznesi dhe klientë të rëndësishëm të saj,
14 qershor 2011.

I nderuar zoti Ministër i Financave,

I nderuar z. Lennkh dhe z. Hodell,

I nderuar z. Canacaris,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Takimi i sotëm i organizuar nga Banka Raiffaisen me përfaqësues të komunitetit të biznesit në Shqipëri është domethënës. Para së gjithash ai dëshmon një strategji të mirëpërcaktuar nga grupi Raiffasien për të rritur peshën e tij në Shqipëri nëpërmjet një dialogu me partnerët e drejtpërdrejtë në biznes. Së dyti, forume të tilla shërbejnë edhe si një platformë nga ku marrin jetë ide zhvillimore, projekte interesante me rëndësi kombëtare dhe pse jo, ndoshta edhe rajonale. Së treti, mendoj se takimi i sotëm është tregues i një maturie dhe ndërgjegjësimi në rritje i të dy komuniteteve: sistemit bankar dhe komunitetit të biznesit. Personalisht, do të uroja që takime të tilla të shtohen në të ardhmen dhe jo vetëm kaq: ato duhet të jenë më të strukturuara, të orientuara drejt një debati konstruktiv ndërmjet palëve, të përfshijnë të gjithë sistemin dhe gjithë sektorët e ndryshëm të ekonomisë. Shkurt, bankat dhe biznesi duhet të ulen këmbëkryq me njëri – tjetrin.

Të nderuar pjesëmarrës,

Jemi pothuajse në mes të vitit 2011, i cili për arsye objektive, që lidhen me zhvillimet financiare ndërkombëtare të 3 – 4 viteve të fundit, është kompleks për nga sfidat që mbart. Ekonomia jonë edhe pse ka regjistruar rritje pozitive vazhdon të operojë poshtë potencialit të saj.

Ambienti ndërkombëtar është i mbushur me pasiguri të lartë për një grup ekonomish të zhvilluara, ndërkohë që çmimet e prodhimeve bujqësore dhe të lëndëve të para vazhdojnë të jenë të larta. Pozicioni i jashtëm i vendit megjithë ngushtimin e deficitit korrent në vitin e kaluar vazhdon të mbetet një dobësi e qëndrueshme strukturore.

Sistemi bankar shqiptar vlerësohet të jetë përshtatur në mënyrë të admirueshme ndaj kësaj situate komplekse. Duhet të theksoj se puna që kemi bërë deri më tash ka qenë e pamasë. Për këtë arsye, përfitoj nga rasti të përgëzoj të gjithë strukturat drejtuese të bankave që operojnë në Shqipëri, si ato të selive qendrore ashtu dhe drejtuesit lokalë. Sektori bankar në Shqipëri gjate kësaj periudhe, ka vijuar zgjerimin e veprimtarisë dhe të kreditimit të

ekonomisë. Treguesit e shëndetit financiar dhe të fitimit janë përmirësuar, ndërkohë që vihet re një gjendje e mirë e kapitalizimit të veprimtarisë së sistemit. Sektori bankar vijon të mbetet aktori kryesor i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, financimi i të cilit vijon të mbështetet kryesisht nga depozitat e publikut.

Problemi kryesor i sistemit bankar ka qenë rritja e portofolit të kredive me probleme, e cila ka reflektuar edhe politikën aktive të Bankës së Shqipërisë në drejtim të rritjes së transparencës së bilanceve të bankave. Rreziku i kreditit mbetet rreziku kryesor për sektorin tonë bankar. Në përgjigje të këtij rreziku, sektori bankar ka krijuar fonde rezervë të mjaftueshme për përballimin e goditjeve të mëdha mbi aftësinë paguese të kredimarrësve dhe ekuilibrat e tregut. Provat e rezistencës mbështesin konkluzionin tonë për qëndrueshmërinë e sistemit bankar.

Prania në këtë pallat e dy komuniteteve: atij të biznesit dhe atij të sistemit bankar më detyron t'i kthehem edhe njëherë domosdoshmërisë për një bashkëpunim të sinqertë dhe me përfitim reciprok për secilin prej tyre. Me përjashtime të pakta mendoj se këto vitet e fundit, ky bashkëpunim ka qenë i pranishëm, ka qenë funksional dhe sigurisht ka mbështetur në mënyrë të veçantë aktivitetin e ekonomik të vendit. Kriza ndërkombëtare që shpërtheu në fund të vitit 2008, pati influencat e saj edhe në ekonominë tonë duke krijuar një tkurrje të këtij bashkëpunimi. Nga njëra anë, sistemi u gjend në një situatë të vështirë likuiditeti, ndërkohë që nga ana tjetër bizneset e patën të vështirë aksesin në tregje. Po t'i shtojmë edhe disa arsye subjektive, rezultati i gjithë kësaj ishte një përkeqësim i portofolit të kredive të sistemit dhe një paaftësi likuiduese në rritje nga ana e kompanive. Për rrjedhim, periudha 2009 – 2010 shënoi një ngadalësim në rritjen e kredisë për ekonominë duke pasqyruar një kujdes të rritur, plotësisht të justifikuar nga ana e sistemit, dhe një paaftësi të biznesit për të merituar kredi të re. E gjithë kjo periudhë ka përkuar me një rishikim të bilanceve, ristrukturim të portofolit aty ku ka qenë e mundur me provigjonime, duke ndikuar drejtpërdrejtë rezultatin financiar të sistemit.

Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol të madh duke qëndruar si gardian jo vetëm për stabilitetin makroekonomik, por edhe për stabilitetin financiar të vendit. Makroprudenca ka qenë fjala që ka mbizotëruar komunikimin tonë me tregun, autoritetet dhe me publikun e gjerë. Makroprudencën e kemi përkthyer si një domosdoshmëri për më shumë kapital, më shumë likuiditet, më shumë aftësi paguese të sistemit bankar. Për rrjedhojë, sektori bankar shqiptar për asnjë çast nuk ka përjetuar ngërç. Banka e Shqipërisë i dha dhe vazhdon t'i japë likuiditetin e nevojshëm sistemit bankar duke i sjellë frymëmarrjen e nevojshme jo vetëm tregut, por gjithë ekonomisë. Politikat e kujdesshme të ndërmarra, rregullimet ligjore të kryera në kohë, nga njëra anë garantuan një mbikëqyrje bankare efektive dhe nga ana tjetër mundësuan një shkallë të kënaqshme aksesi të biznesit ne kredinë bankare. Aktualisht, dëshiroj të vë në dukje se sistemi bankar shqiptar doli i shëndetshëm nga kriza dhe garanton stabilitet në rritje.

Vetë sistemi bankar gjatë kësaj periudhe ka kryer një volum pune të konsiderueshëm. Ajo ka shërbyer për të kolauduar saktë pozicionin e secilës bankë para, gjatë dhe pas krizës. Për rrjedhim, bankat sot janë në gjendje të rivënë në punë me kapacitet të plotë, potencialin e tyre kreditues. Për hir të vërtetës duhet theksuar se shifrat e fundit flasin për një rritje të rangut 10 për qind në terma vjetore, një shifër kjo që nuk duhet neglizhuar apo konsideruar si e pamjaftueshme. Të njëjtën filozofi, në formë këshille do t'ja sugjeroja dhe komunitetit të biznesit. Për arsye të natyrës objektive, koha e parave të lira duket se i përket të kaluarës. Me këtë dua të them se kredia bankare duhet të jetë e merituar, që do të thotë bashkëpunim pa kushte, i sinqertë dhe brenda kornizave ligjore dhe rregulluese të miratuara nga autoritetet e vendit. Sigurisht që bankat janë krijuar për të dhënë kredi por para së gjithash duhet të mbajmë parasysh se rëndësi më të madhe: se kreditimi i një biznesi të veçantë apo se portofoli i një banke të veçantë përbën stabiliteti i depozitave të popullatës, të individëve të thjeshtë. Për më tepër biznesi duhet të rikalibrojë pozicionin e tij në raport me zhvillimet e fundit si në ekonominë e brendshme ashtu edhe në atë të jashtme. Ai duhet të synojë produktivitet më të lartë, kryesisht nëpërmjet evidentimit të të gjithë avantazheve krahasuese në raport me spektrin e ndryshimeve globale.

Për këtë qëllim është e domosdoshme adoptimi i filozofive të reja në administrimin e kompanive duke rritur kapacitetet dhe investimet në burime njerëzore, në qeverisje, kontrollin e brendshëm, në konsulencë financiare dhe juridike, dhe administrimin e rreziqeve. Marrëdhënia bankë klient përveçse një marrëdhënie juridike është një marrëdhënie njerëzore, besimi. Në momentin kur një biznes vonon të paguajë kredinë e radhës në banka duhet t'i vijë në mendje si do ta gjykonte bankën në qoftë se ajo do të vononte të paguante në kohë interesin e maturuar të depozitës.

Të nderuar pjesëmarrës,

Në emër të institucionit të Bankës së Shqipërisë dëshiroj të ftoj të dy komunitet e përfaqësuara në këtë takim, që t'i forcojnë urat e komunikimit në të mirë të njeri- tjetrit, të të gjithë ekonomisë në tërësi.

FJALA E ZËVENDËSGUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. FATOS IBRAHIMI

Në Forumin e Biznesit me guvernatorët dhe
Bordin e Drejtorëve të Bankës së Detit të Zi,
19 qershor 2011.

Të nderuar pjesëmarrës,

Është një kënaqësi e veçantë të marr fjalën në këtë forum të organizuar nga Banka e Detit të Zi, Tregtisë dhe Zhvillimit, që këtë herë ka në qendër të tij nxitjen e mundësive të zhvillimit në Shqipëri. Më lejoni të them se koha e mbajtjes së këtij forumi përkon me nevojën për sigurimin e një rigjallërimi të ekonomisë së vendit, pas kapërcimit të efekteve të drejtpërdrejta të krizës financiare dhe ekonomike ndërkombëtare. Ky rigjallërim i ekonomisë, ka nevojë të bëhet më i qëndrueshëm duke nxitur zhvillimin e sektorëve që ofrojnë një avantazh konkurrues nëpërmjet zhvillimit të politikave të posaçme publike dhe ngritjes në një nivel të ri të partneritetit mes investimeve publike dhe atyre private.

Më lejoni që në vijim të ndalem më hollësisht në kontributin që sistemi financiar dhe sektori bankar mund të japin në mbështetjen e projekteve të vlefshme të biznesit.

Parakusht për kryerjen e një veprimtarie të suksesshme të ndërmjetësimit financiar, është zhvillimi dhe gjendja e mirë financiare e vetë sistemit financiar dhe posaçërisht e sektorit bankar. Në fakt, në dekadën e fundit, sektori bankar ka njohur një zhvillim të shpejt. Në treg kanë hyrë grupe të mirënjohura bankare evropiane, të cilat kanë sjellë njohuritë dhe teknologjitë më të mira dhe kanë forcuar tiparet e konkurrencës së tregut ndërbankar. Gjithashtu edhe bankat me kapital shqiptar kanë zgjeruar rrjetin e tyre dhe kanë shfrytëzuar siç duhet përparësitë e njohjes më të mirë të tregut vendas. Si rezultat i politikave aktive të zhvillimit të veprimtarisë,sektori bankar ka patur rritje të qëndrueshme të depozitave dhe zgjerim të kreditimit. Mjafton të përmendim faktin që në fund të vitit 2004, kredia zinte vetëm 7% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të vendit ,ndërsa sot ky nivel vlerësohet rreth 40%. Rreth 2/3 e kredisë është shfrytëzuar nga sektori privat, ndërsa pjesa tjetër nga familjet dhe individët. Në sektorin e biznesit, kredi kanë përfituar sektorët më të rëndësishëm dhe ata me zhvillimin më të shpejtë, siç janë tregtia, shërbimet e tjera, transporti dhe ndërtimi. Pothuaj të gjithë kredinë për biznese e kanë përfituar ato private, ndonëse së fundi konstatohet një rritje e kredisë për projekte/investime të sektorit publik. Nga ana tjetër, zgjerimi i rrjetit bankar dhe shfrytëzimi më i mirë i teknologjive të reja, kanë mundësuar ndjekjen e politikave më konkurruese, duke tërhequr një numër të madh depozituesish dhe duke ofruar shërbime të vlefshme për qytetarët. Depozitat vijojnë të përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të sektorit bankar duke qenë një element që tregon për qëndrueshmërinë e tij. Normat e interesit për

kreditë dhe depozitat, kanë pasqyruar objektivat për treguesit financiarë të bankave, politikën monetare në vend dhe në vendet e valutave kryesore, si edhe marzhin e rrezikut të vendit. Vlerësojmë se gjatë kësaj periudhe, këto norma interesi kanë qenë të përshtatshme për zhvillimin e qëndrueshëm të veprimtarisë së ndërmjetësimit financiar nga ana e sektorit bankar.

Gjatë 2-3 viteve të fundit, ekonomia e vendit ndjeu ndikimin e krizës financiare dhe ekonomike ndërkombëtare. Autoritetet publike u angazhuan për të mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit nëpërmjet politikave stimuluese, fiskale dhe monetare. Në sektorin bankar, kriza financiare ndërkombëtare u shfaq kryesisht me tkurrjen e ritmit të kreditimit për ekonominë vendase. Gjatë kësaj periudhe, Banka e Shqipërisë ka synuar të mos lejoj thellimin e ndikimit të kësaj krize, duke ofruar një politikë monetare lehtësuese, si edhe duke siguruar likuiditetin e nevojshëm në tregun ndërbankar. Gjatë vitit 2009 dhe në vitin 2010, Banka e Shqipërisë uli me 1.25 pikë përqindje normën bazë të interesit, në nivelin 5%. Po ashtu, në pjesën më të madhe të vitit 2009, bankat përfituan likuiditet pa kufi, me normën e interesit të njëjtë me atë të politikës monetare. Ndërkohë, përpara ndikimit të krizës, nëpërmjet akteve të posaçme rregullative të nisura prej vitit 2006, Banka e Shqipërisë synoi të kufizonte disa nga rreziqet e veprimtarisë bankare, si kreditimi i shpejtë dhe në valutë, nëpërmjet vendosjes së kërkesave më të larta për kapital për bankat më të ekspozuara. Gjatë gjithë kësaj periudhe kemi komunikuar rregullisht me publikun e gjerë, me biznesin dhe me vetë industrinë bankare, për të shpjeguar veprimet tona dhe për të diskutuar rreth sfidave me të cilat ndeshen aktorët ekonomikë. Ne besojmë që si rezultat i këtyre veprimeve të autoriteteve publike dhe të bashkëpunimit me industrinë financiare, sektori bankar e përballoi me sukses ndikimin e krizës financiare ndërkombëtare, duke mbetur i qëndrueshëm dhe duke ruajtur tregues pozitivë të ndërmjetësimit financiar. Kështu, gjatë vitit 2010 rritja e kreditimit nga ana e sektorit bankarë, ndonëse në nivele më të ulëta se ato të viteve të parakrizës, mbeti e konsiderueshme duke qenë rreth 9%. Në disa vende të Evropës Qendrore dhe Juglindore, ky tregues është negativ. Rënia e ritmit të kreditimit, e cila fillimisht u ndikua edhe nga faktorë të ofertës, është më tepër një fenomen që i atribuohet rënies së kërkesës për kredi. Si rezultat i pritjeve më të dobëta për zhvillimin e veprimtarisë, bizneset kanë ulur përdorimin e kapaciteteve të tyre prodhuese, duke ulur objektivat për investime dhe kërkesën për kredi.

Megjithë përballimin e situatës së ndikimit të drejtpërdrejtë të krizës, sektori bankar dhe Banka e Shqipërisë duhet të përballen edhe me disa sfida të rëndësishme. Së pari, duhet ndjekur me kujdes ecuria e cilësia e kredisë, duke synuar që të evidentohen në kohë kreditë me probleme, të vlerësohen drejtë sipas mundësive të tyre për t'u arkëtuar dhe të ndiqen politikat e nevojshme për rikuperimin e vlerës së kredisë brenda një kohe të përshtatshme. Së dyti, gjatë kësaj faze është e domosdoshme të forcohen sistemet e kontrollit të brendshëm në banka, jo vetëm ato që lidhen me rrezikun e kreditit por edhe ato që sigurojnë një standard më të lartë të drejtimit të tyre. Së treti, është e nevojshme që bankat të vlerësojnë pritshmëritë e tyre për ecurinë e veprimtarisë dhe të veprojnë për të forcuar paraprakisht pozicionin e tyre të kapitalit në rast nevoje. Banka e Shqipërisë vlerëson që sektori bankar dhe

ekonomia shqiptare kanë nevojë që gjatë kësaj kohe të përcaktojnë dhe të ndjekin disa politika më të përshtatshme të zhvillimit, që për sektorin bankar duhet të përfshijnë vendosjen e objektivave më realiste të zhvillimit, vendosjen e çmimeve me konkurruese për produktet dhe shërbimet bankare dhe rritjen e kreditimit në monedhën vendase. Për ekonominë në përgjithësi, është e nevojshme të sigurohet një zhvillim më i qëndrueshëm që lidhet kryesisht me kontrollin më të mirë të ecurisë së deficitit tregtar, nëpërmjet mbështetjes së sektorëve që aktualisht kontribuojnë ose mund të kontribuojnë në rritjen e eksporteve të vendit. Autoritet publike duhet të përforcojnë angazhimin e tyre për zhvillimin e tregut financiar jobankar si një zhvillim i cili do të çoj gradualisht në uljen e varësisë së ekonomisë nga gjendja e sektorit bankar, dhe do të përmirësojë aksesin në financim të një numri më të madh subjektesh private. Në këtë mënyrë do të sigurohej edhe një mundësi më e madhe e financimit nga ana e sistemit financiar të projekteve në sektorin e bujqësisë, si një prej sektorëve që ka potencial të lartë për sigurimin e avantazheve konkurruese të ekonomisë shqiptare.

Më lejoni që në përfundim të ritheksoj gatishmërinë e Bankës së Shqipërisë që nëpërmjet politikave të saj në sferën monetare, dhe në atë të stabilitetit financiar, të kontribuojë për ruajtjen e një klime sa më të mirë të zhvillimit të shëndetshëm të veprimtarisë financiare, dhe të asaj bankare ne vend, si kusht për një mbështetje më të madhe financiare, për zhvillimin e biznesit në vend. Mendoj se ky forum do të jap një kontribut të çmuar në përcaktimin e disa politikave dhe projekteve konkrete të zhvillimit, për të cilat besoj se Banka e Detit të Zi, Tregtisë dhe Zhvillimit do të ofrojë mbështetjen dhe ekspertizën e saj.

Duke ju uruar sukses në zhvillimin e këtij forumi, ju falënderoj për vëmendjen!

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën e përbashkët për shtyp me Ministrin e Financave dhe Shefin e Misionit te FMN në Shqipëri,
22 qershor 2011.

Të nderuar përfaqësues të medias,

Sikurse jeni vënë në dijeni, gjatë dy javëve të fundit ka qenë i pranishëm në Shqipëri një ekip i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), i kryesuar nga zoti Bell. Gjatë kësaj periudhe kemi patur diskutime intensive në lidhje me zhvillimet aktuale ekonomike, ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, dhe natyrisht mbi orientimin e duhur të politikave makroekonomike. Më lejoni të theksoj se kjo vizitë, duke qenë në kuadrin e Diskutimeve të Artikullit 4, u përqendrua gjithashtu në çështje strukturore të ekonomisë shqiptare, duke vënë theksin në hapat që duhen ndjekur për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e afatgjatë të vendit.

Cilat kanë qenë shkurtimisht çështjet kryesore të diskutuara?

Së pari, të para në tërësinë e tyre, zhvillimet ekonomike e financiare të vitit 2010 dhe ato të muajve të parë të vitit 2011, treguan se ekonomia shqiptare përballoi me sukses efektet e krizës botërore dhe gëzon parakushtet e nevojshme për të prodhuar rritje ekonomike edhe në të ardhmen. Kërkesa e huaj ka qenë kontribuuesi kryesor në rritjen ekonomike të vitit 2010, ndërkohë që viti në vazhdim pritet të karakterizohet nga një gjallërim i kërkesës së brendshme, por edhe një rritje më e ngadaltë e eksporteve shqiptare. Në aspektin makroekonomik, situata paraqitet përgjithësisht e balancuar, e karakterizuar nga inflacion i ulët dhe nën kontroll, nga një sistem financiar i sigurt, likuid e i mirëkapitalizuar, nga tregje financiare në përmirësim dhe nga një pozicion i përmirësuar i llogarisë korente. Këto zhvillime pasqyrojnë ndër të tjera edhe politikat e ndjekura për këtë qëllim, të cilat kanë rezultuar efektive në amortizimin e goditjes së madhe që morëm nga kriza botërore. Gjej me vend të theksoj se puna e Bankës së Shqipërisë për të kontrolluar inflacionin dhe për të ankoruar pritjet inflacioniste, si dhe masat tona rregullatore e mbikëqyrëse për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit financiar, ulën kostot e përballimit të goditjes dhe shmangën pasojat më të padëshiruara të saj.

Së dyti, në lidhje me ecurinë e pritur të ekonomisë në horizontin afatmesëm e afatgjatë, përfundimi i arritur pas konsultimeve të dy javëve të fundit ishte se ekonomia shqiptare pritet të mbetet në territore pozitive të rritjes ekonomike. Megjithatë, ritmi i rritjes ekonomike do të varet dukshëm nga rigjallërimi i kërkesës së brendshme, e cila vuan ende nga pasiguria që lidhet me zhvillimet e brendshme dhe të huaja. Konsumi dhe investimet vijojnë të vuajnë nga një dozë e shtuar kujdesi e agjentëve ekonomikë, ndërkohë që kushtet financiare dhe aftësia e sistemit bankar për të mbështetur ekonominë me kredi paraqiten në përmirësim. Nga ana tjetër, inflacioni i rritur i muajve të parë të vitit 2011 pritet të vijë duke rënë në periudhën e ardhme. Kjo pasqyron si origjinën e tregut të huaj të goditjeve që sollën rritjen e çmimeve, ashtu edhe kushtet e

brendshme ekonomike e financiare, si dhe politikën tonë monetare.

Diagnostikimi i përbashkët i ekonomisë shqiptare, identifikoi sektorin fiskal dhe atë jashtëm të ekonomisë si dy fusha të cilat do të kërkojnë vëmendjen dhe punën tonë në të ardhmen.

Për sa i përket financave publike, Banka e Shqipërisë e ka theksuar me kohë se qëndrueshmëria afatgjatë e tyre përbën një parakusht për rritjen e qëndrueshme ekonomike. Kanalet nëpërmjet të cilave tregues si deficiti buxhetor dhe borxhi publik ndikojnë tregjet financiare dhe më tej ekonominë reale, i kemi përditë të ilustruara në shtypin botëror. Duke mbetur të bindur se ekonomia shqiptare do të përfitonte në terma afatmesëm dhe afatgjatë nga reduktimi i borxhit publik, ne kemi inkurajuar dhe mbështetur të gjitha masat e marra për këtë qëllim. Gjykojmë se kjo filozofi duhet të qëndrojë në bazë të rishikimit të pritur të buxhetit për vitin 2011, por edhe të projekteve afatmesme e afatgjata të financave publike.

Sektori i jashtëm i ekonomisë është një tjetër fushë e cila përbën një dobësi strukturore të ekonomisë shqiptare. Pjesërisht edhe në përgjigje të këtij shqetësimi, Banka e Shqipërisë ka theksuar vazhdimisht nevojën për thellimin e reformës strukturore, në mbështetje të një modeli të ri të rritjes e të zhvillimit të ekonomisë shqiptare. Ky model duhet të kalojë detyrimisht nga një rritje e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së produkteve e shërbimeve tona në të tregjet e brendshme dhe të huaja.

Nga ana tjetër, ai kërkon edhe një qëndrim më racional të sektorit privat të ekonomisë ndaj kontekstit ekonomik në të cilin ndodhemi, si dhe një administrim më të kujdesshëm të rreziqeve financiare që e shoqërojnë atë. Përtej kësaj, ekonomia shqiptare duhet të bëhet sa më atraktive për investitorët e huaj, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të klimës së biznesit, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe të zbatimit të tij, si dhe të ofrimit të një fuqie punëtore të edukuar dhe me kosto atraktive.

Së treti, dhe të para në kontekstin e ekspozuar më sipër, politikat tona duhet të mbeten të kujdesshme për të garantuar ekuilibrat makroekonomikë të vendit. Siç e theksova dhe më parë, një nga mësimet e periudhës së krizës është se parandalimi është mënyra më e mirë e kurimit. Në këtë kontekst, të gjitha masat politike e strukturore që i shërbejnë stabilitetit, kanë një ndikim pozitiv në afatin e gjatë.

***

Gjatë këtyre diskutimeve kam konstatuar me kënaqësi se ndajmë vlerësime të njëjta me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Ministrinë e Financave mbi nevojën për ruajtjen dhe forcimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik. Po kështu, gjykoj se ekziston një konsensus modern e funksional në ndarjen e detyrave midis dy institucioneve qendrore të administrimit makroekonomik (bankës qendrore dhe Ministrisë së Financave), si dhe një angazhim konkret për vazhdimin e këtij bashkërendimi edhe në të ardhmen. Duke mbyllur këtë komunikim, dëshiroj të theksoj edhe një herë se Banka e Shqipërisë mbetet tërësisht e angazhuar në respektimin e objektivit të saj të inflacionit prej 3 %, duke vazhduar të orientojë politikën e saj monetare ekskluzivisht në funksion të tij.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 29 qershor 2011.

Sot, në datën 29 qershor 2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike dhe financiare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5.25 për qind. Në opinionin e Këshillit, kushtet monetare aktuale janë të përshtatshme për përmbushjen e objektivit të inflacionit dhe për vazhdimin e stimulimit të aktivitetit ekonomik.

Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike, si dhe të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.

***

Inflacioni vjetor rezultoi 4.2% në muajin maj, duke qëndruar pranë vlerave të shënuara në muajt e mëparshëm të vitit. Nën presionin e rritjes së çmimeve të huaja, çmimet e mallrave të grupeve 'ushqime të përpunuara' dhe 'mallra të konsumit jo-ushqimor', në të cilin bën pjesë edhe nafta, kanë qenë kontribuuesit kryesor në vlerën e inflacionit. Ndërkohë, efekti sezonal i rritjes së ofertës vendase të frutave dhe perimeve është reflektuar në një kontribut më të ulët të grupit 'ushqime të papërpunuara' në inflacion. Rritja e disa prej çmimeve të administruara dhe efekti i rritjes së akcizës për disa mallra vazhdojnë të japin një kontribut konstant, por pozitiv, në inflacionin vjetor.

Ecuria e inflacionit në muajt e fundit është rezultat i balancës së veprimeve me kah të kundërt të dy faktorëve kryesorë. Në kahun rritës, çmimeve e larta të mallrave bazë dhe të lëndëve të para në tregjet botërore janë përcjellë në inflacionin në vend në formën e rritjes së inflacionit të importuar. Në afat të shkurtër, ky fenomen ka ushqyer edhe inflacionin bazë, i cili është rritur në krahasim me vitin e kaluar. Sikurse tregohet edhe nga norma më e lartë e inflacionit neto të mallrave të patregtueshëm, një pjesë e rritjes së çmimeve të mallrave bazë është materializuar në efekte të raundit të dytë në inflacion.

Zhvillimet e fundit në inflacion kanë prekur edhe pritjet e agjentëve ekonomikë për inflacionin, por megjithatë, këto të fundit vazhdojnë të qëndrojnë brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Në kahun rënës, zhvillimet në ekonominë vendase vijojnë të prodhojnë një ambient me presione të përmbajtura inflacioniste. Vlerësimet tona mbi aktivitetin ekonomik sugjerojnë për një normë pozitive rritjeje gjatë

tremujorit të parë të vitit, por duke mbetur nën nivelin potencial të saj. Në këto kushte, ekonomia shqiptare vazhdon të karakterizohet nga kapacitete të pashfrytëzuara të faktorëve të prodhimit – të punës e të kapitalit – dhe një hendek ende negativ prodhimi, i cili vijon të ushtrojë presione në rënëse mbi inflacion. Gjithashtu, analiza e zhvillimeve monetare konfirmon prezencën e presioneve të përmbajtura me natyrë monetare në ekonominë vendase.

Në vijim, do të ndalem në trajtimin e faktorëve ekonomikë që kanë përcaktuar zhvillimet në inflacion, së bashku me diskutimin mbi ecurinë e pritur të tyre.

Aktiviteti ekonomik në vend në muajt e parë të vitit është zhvilluar në kontekstin e një ekonomie botërore në rritje, por me presione inflacioniste në rritje dhe pasiguri të shtuara në tregjet financiare.

Aktiviteti ekonomik botëror ka vijuar të rritet në pjesën e parë të vitit 2011, i udhëhequr nga ekspansioni i shpejtë i kërkesës në vendet në zhvillim. Nga ana tjetër, kërkesa e lartë dhe tensioni gjeopolitik janë reflektuar në rritjen e çmimeve të lëndëve të para dhe të mallrave bazë, duke rritur presionet inflacioniste në nivel botëror. Zhvillimet në tregjet financiare kanë reflektuar shqetësimin për qëndrueshmërinë e pozicionit fiskal të vendeve periferike të Eurozonës, duke rritur primet e rrezikut në shkallë të gjerë. Në balancë, rreziqet mbi ecurinë e ardhshme të ekonomisë botërore janë shtuar, ndërkohë që hapësirat për reagim të politikave fiskale dhe monetare janë ngushtuar.

Nën këtë sfond të zhvillimeve ekonomike ndërkombëtare, ekonomia vendase vlerësohet të jetë rritur në muajt e parë të vitit. Kërkesa e huaj ka dhënë një kontribut pozitiv në kërkesën agregate, por, sikurse pritej, kontributi i eksporteve shqiptare në rritjen ekonomike ka qenë më i vogël në krahasim me vitin 2010. Gjithashtu, kërkesa e sektorit publik ka mbështetur rritjen e aktivitetit ekonomik gjatë kësaj periudhe. Nga ana tjetër, ecuria e konsumit dhe investimeve private vlerësohet të ketë qenë e ngadaltë.

Tregues indirektë të këtyre komponentëve të kërkesës së brendshme japin sinjale për një ecuri të dobët të tyre, pavarësisht përmirësimit të kushteve të financimit dhe një ambienti më të përshtatshëm për zhvillimin e sektorit privat të ekonomisë. Pasiguritë për të ardhmen, sikurse shprehen në nivelin e ulët të besimit konsumator, kanë diktuar një sjellje konservatore të individëve në konsum dhe rritje të preferencës së tyre për kursim. Në kushtet e shfrytëzimit jo të plotë të kapaciteteve të prodhimit, edhe nevojat e biznesit për investime të reja ka qenë e ulët.

Momenti pozitiv i ekonomisë botërore ka vijuar të nxisë eksportet tona, por në një masë më të vogël në krahasim me vitin e kaluar. Në muajin prill, rritja vjetore e eksporteve shënoi 10.8% ndërkohë që importet janë zgjeruar më tej, duke shënuar një rritje vjetore prej 16.7% në këtë muaj. Këto zhvillime në tregtinë e jashtme janë materializuar në thellimin e deficitit tregtar gjatë kësaj periudhe, i cili rezultoi 19.5% në terma vjetorë. Në përgjithësi, zhvillimet në bilancin e pagesave konfirmojnë brishtësinë e pozicionit të jashtëm të ekonomisë sonë.

Deficiti i llogarisë korente, i vlerësuar në 11.8% të PBB-së në tremujorin e parë të vitit, mbetet i lartë. Banka e Shqipërisë e ka theksuar në vazhdimësi nevojën për marrjen e masave për uljen e tij, si dhe sigurimin e burimeve të qëndrueshme të financimit të nëpërmjet nxitjes së flukseve hyrëse investimeve të huaja direkte.

Zhvillimet në bilancin e pagesave janë reflektuar në një ecuri relativisht të qetë të kursit të këmbimit. Në kushtet e një balancimi mes kërkesës dhe ofertës, monedha vendase ka shfaqur qëndrueshmëri, duke u nënçmuar lehtë në terma nominale efektivë në muajin maj. Ecuria e kursit të këmbimit në të ardhmen, do kushtëzohet ndjeshëm nga balancat e ekonomisë së jashtme dhe nga preferencat e individëve për strukturën e portofolit të mjeteve financiare.

Shpenzimet e sektorit publik kanë qenë një nxitës i rëndësishëm i aktivitetit ekonomik në muajt e parë të këtij viti. Gjatë periudhës janar – maj, këto shpenzime janë rritur me 10.3% në terma vjetorë, ndërkohë që të ardhurat fiskale janë rritur me ritme të ulëta, në reflektim të kërkesës së ngadaltë të sektorit privat të ekonomisë. Këto zhvillime janë pasqyruar në një deficit buxhetor rreth 1.7 herë më të lartë në krahasim me një vit më parë. Ritmet e rritjes së shpenzimeve kanë ardhur në rënie në tremujorin e dytë.

Një sjellje e tillë pritet të ruhet edhe në pjesën e mbetur të vitit, e kushtëzuar nga angazhimi për të respektuar objektivin e deficitit dhe të borxhit publik për vitin 2011. Kjo përqasje e politikës fiskale pritet të formalizohet edhe me rishikimin e buxhetit në muajin korrik, i cili duhet të tregohet i vëmendshëm ndaj qëndrueshmërisë afatgjatë të borxhit publik.

Përballë zhvillimeve të trajtuara më sipër, analiza e treguesve monetarë konfirmon gjithashtu për presione të kontrolluara inflacioniste me origjinë nga ekonomia e brendshme. Rritja vjetore e ofertës së parasë shënoi 12.2% në muajin prill, duke qëndruar pranë trendit të saj historik. Zgjerimi monetar ka reflektuar akumulimin e likuiditetit në sistemin bankar, në reflektim të një sjelljeje të individëve të orientuar drejt kursimit. Vlerësimet tona tregojnë se masa e zgjerimit monetar është në përputhje me kërkesën e sektorit privat të ekonomisë për para reale, duke dëshmuar kështu për presione të kontrolluara inflacioniste me natyrë monetare.

Sjellja e përmbajtur e sektorit privat të ekonomisë në ndërmarrjen e shpenzimeve dhe investimeve është reflektuar edhe në kërkesë të ulët të tij për financim bankar.

Ritmet e rritjes vjetore të kredisë për sektorin privat janë luhatur në intervalin 10%-12% në katër muajt e parë të vitit, duke qëndruar mesatarisht vetëm 2 pikë përqindje më lart në krahasim me vitin e kaluar. Kërkesa e bizneseve për mbulimin e nevojave për likuiditet ka qenë burimi kryesor i kërkesës për kredi, ndërkohë që kredia për individë është rritur me ritme të ulëta.

Zhvillimet në tregjet financiare flasin për prime të ulëta të rrezikut dhe të likuiditetit. Normat afatshkurtra të interesit në tregun ndërbankar kanë

qëndruar pranë normës bazë të interesit dhe kanë shfaqur luhatshmëri të përmbajtur. Në tregun primar, yield-et e letrave me vlerë të qeverisë janë rritur në 3 muajt e fundit, në përgjigje të një kërkese më të lartë të sektorit publik për financim. Megjithatë, kurba e tyre qëndron më poshtë në krahasim me një vit më parë, duke treguar për kushte më të favorshme financiare në ekonomi.

Duke zhvendosur vëmendjen drejt së ardhmes, vlerësimet dhe projeksionet e Bankës së Shqipërisë sugjerojnë për mbartjen e rritjes pozitive ekonomike edhe në periudhën në vazhdim. Në një afat më të gjatë, në kushtet e zbehjes së impulsit të huaj në kërkesën agregate dhe të një sjelljeje më të përmbajtur fiskale, përshpejtimi i ritmeve të rritjes ekonomike do të kushtëzohet nga gjallërimi i sektorit privat të ekonomisë.

Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë gjykon se ambienti ekonomik ofron kushtet dhe hapësirat për një rritje më të madhe të konsumit dhe të investimeve private në vend.

Pavarësisht ritmeve pozitive të rritjes, ekonomia shqiptare pritet të mbetet nën nivelin potencial të saj, duke kushtëzuar vazhdimësinë e hendekut negativ të prodhimit dhe presione të përmbajtura inflacioniste nga kahu i kërkesës. Nga ana tjetër, ecuria e inflacionit do të vazhdojë të jetë nën presionin e çmimeve të huaja edhe në periudhën në vazhdim. Por, në mungesë të zhvillimeve të papritura, efekti i goditjeve të çmimeve të huaja pritet të zbehet ndërsa efekti i rritjes së çmimeve të administruara pritet të shuhet në tremujorin e tretë të vitit. Për rrjedhojë, inflacioni parashikohet të rikthehet brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë në fund të vitit. Edhe pse rreziqet rreth këtij skenari bazë janë shtuar si rrjedhojë e pasigurive që rrethojnë zhvillimet ekonomike në botë, ato mbeten të balancuara.

***

Duke vënë në balancë informacionin e përmbledhur më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se presionet inflacioniste janë të larta në afat të shkurtër, por me trajektore rënëse, dhe në periudhën afatmesme ato mbeten të kontrolluara.

Në mungesë të goditjeve të papritura, inflacioni pritet të jetë brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë përgjatë horizontit kohor të politikës monetare. Pritjet inflacioniste të agjentëve ekonomikë vazhdojnë të jenë brenda objektivit, çka është thelbësore në kushtet e prezencës së njëkohshme të hendekut negativ të prodhimit dhe të çmimeve të larta të huaja. Banka e Shqipërisë është plotësisht e angazhuar në ankorimin e pritjeve inflacioniste në përputhje me objektivin e saj për inflacionin, dhe e gatshme të përmbushë mandatin e saj, duke evituar materializimin e presioneve të qëndrueshme në inflacion.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës konkludoi se kushtet monetare paraqiten të përshtatshme për respektimin e objektivit të inflacionit në periudhën afatmesme dhe vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5.25 %.

ANALIZA PERIODIKE*

** Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

INFORMACION MBI DISA TREGUES EKONOMIKË E MONETAR TË RAJONIT TË EVROPËS QENDRORE-LINDORE DHE JUG-LINDORE

DORIANA LAMA, PRIAM RAMAJ DHE MEDVIN SHEHU
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETRAE, KORRIK 2011

Aktiviteti ekonomik në nivel botëror ka vijuar të regjistrojë vlera pozitive rritjeje edhe në T1- 2011, duke treguar në të njëjtën kohë aftësi vetëfinancuese dhe zhvendosje nga mbështetja e politikave fiskale. Megjithatë, të dhënat indirekte dhe tregues koniukturorë të publikuar gjatë këtyre muajve të fundit sinjalizojnë një tendencë uljeje të ritmit të rritjes ekonomike për tremujorin e dytë të këtij viti. Panorama e përgjithshme ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe, vijon të konfirmojë ecuri të ndryshme për shtete dhe rajone të veçanta megjithëse dallohet se ecuria pozitive ekonomike dalëngadalë po shkëputet nga elementi publik dhe po shpërndahet në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Ecuria e inflacionit ka qenë në kahun rritës duke reflektuar rritjen e çmimeve në sektorin e energjisë por edhe të lëndëve të para. Ecuria ekonomike në Zonën Euro ka regjistruar vlera pozitive dhe në rritje si gjatë gjithë vitit të kaluar edhe në T1-2011. Vlerësimet paraprake tregojnë për një rritje të PBB-së në Zonën Euro edhe në T2-2011, e mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së jashtme dhe përmirësimi i asaj të brendshme në kushtet rritjes së treguesve të besimit nga bizneset. Situata delikate financiare dhe shqetësimi mbi përballueshmërinë e bilancit publik në disa shtete brenda Zonës Euro (Greqi, Irlandë,Portugali dhe Spanjë) ka kontribuar në rritjen e pasigurisë në tregjet ndërkombëtare financiare, gjë që është shprehur në ridimensionimin e klimës së përgjithshme ekonomike si edhe në ecurinë rritëse të normave të interesit në tregun e parasë dhe të yield-eve të obligacioneve përkatëse.

Normat bazë të interesit dhe përdorimi i instrumenteve në ekonomitë e zhvilluara:

	Eurozona (BQE)	SHBA (Fed)	MB	Japoni
Objektivi i Inflacionit	2%	n.a.	2%	1% [1 2]
Ndryshimet e normës bazë të interesit	05.05.11 (+0.25) 09.06.11 (0.00) 07.07.11 (+0.25)	15.03.11 (0.00) 27.04 11 (0,00) 22.06.10 (0.00)	05.05.11 (0,00) 09.06.11 (0,00) 07.07.11 (0,00)	28.04.11 (0.00) 20.05.11 (0,00) 14.06.11 (0,00)
Norma aktuale e interesit	1.50%	0-0.25 %	0.50%	0-0.1 %
Inflacioni i fundit[3]	2.7%	3.6%	4.2%	0,30%
Mbledhjet e ardhshme të KMPM-së	21.07.11 04.08.11 08.09.11	09.08.11 20.09.11 02.11.11	04 Gusht 08 Shtator 06 Tetor	5 Gusht 7 Shtator 7 Tetor
Ngjarje të ardhshme	11 Gusht 15 Shtator Buletini mujor	27 Gusht 07 Shtator Beige book	10 Gusht Inflation Report	14 Korrik Raporti mujor

[1] *Banka e Japonisë nuk ka adoptuar inflacionin e shënjestruar dhe niveli i kuptuar si stabilitet çmimesh nga kjo bankë është intervali 0-2% ose me saktë pika e mesit 1.00%.*
[2] *Burimi: "Understanding of Medium- to Long-Term Price Stability",Banka e Japonisë.*
[3] *Qershor 2011.*
Burimi: Bankat qendrore përkatëse.

1. DISA TREGUES TË EKONOMISË, INFLACIONI DHE ORIENTIMI I POLITIKËS MONETARE NË EKONOMITË E ZHVILLUARA

EUROZONË

Zona Euro gjatë T1- 2011 regjistroi një rritje ekonomike pozitive me 0.8% krahasuar me tremujorin paraardhës dhe 2.5% v.m.v, duke shfaqur ecuri jo të njëtrajtshme të shteteve brenda kësaj zone. Zërat kryesorë që kontribuuan ishin rritja e konsumit privat dhe e investimeve. Tregues paraprakë si ai i shitjeve me pakicë apo i shfrytëzimit të kapaciteteve, tregojnë vazhdimin e rritjes ekonomike edhe në tremujorin e dytë të këtij viti. Kriza e borxhit në Evropë ka hyrë në një fazë të re. Banka Qendrore Evropiane (BQE), Bashkimi Evropian (BE) dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) kanë zhvilluar një seri takimesh ku janë diskutuar mundësitë për financimin të mëtejshëm të borxhit grek si edhe për ecurinë e planit korrigjues fiskal, të ndërmarrë nga ana e Qeverisë Greke ku janë ritheksuar kërkesat për masa më të thella konsoliduese. Problemet e lidhura me bilancet publike të shteteve brenda kësaj zone, janë reflektuar edhe tek ecuria e yield-eve të instrumenteve të borxhit. Në muajt e fundit, vlerat e tyre kanë arritur nivele të larta. Presionet inflacioniste gjatë këtyre muajve janë shtuar, të ndikuara nga rritja e çmimeve të naftës dhe rritja e çmimeve të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare. Në mbledhjet e muajve prill dhe korrik, BQE vendosi për rritjen e normës bazë me nga 0.25 pikë përqindje duke e çuar atë në 1.50%. Gjithashtu, në mbledhjen e fundit të zhvilluar në muajin qershor, BQE ka konfirmuar vazhdimin e kryerjes së operacioneve injektuese të likuiditetit me normë fikse dhe shumë të hapur, si dhe të atyre me maturitet 1- dhe 3-mujor së paku deri në muajin tetor. Tregjet financiare në Zonën Euro kanë përcjellë pasigurinë në rritje që ka karakterizuar këta muaj. Kjo panoramë është pasqyruar edhe në tregjet e parasë, të cilat kanë regjistruar rritje të vazhdueshme.

Eurozonë	Parashikimi PBB[1]		Parashikimi Inflacion[1]	
	2011	2012	2011	2012
FMN	1.6	1.8	2.3	1.7
OECD	2.0	2.0	2.6	1.6
Komisioni Evropian	1.6	1.8	2.6	1.8
BQE	1.5-2.3	0.6-2.8	2.5-2.7	1.1-2.3

[1] *Marrë nga institucionet përkatëse.*

Perspektiva ekonomike për zonën mbart shumë pasiguri, që lidhen kryesisht me efektet ngjitëse që mund të ketë kriza e borxhit grek dhe ecuria e çmimeve të lëndëve të para. Pritet që të dyja këto, në kushtet e politikave shtrënguese fiskale, të ulin konsumin dhe investimet.

SHBA

Të dhënat e fundit për SHBA, flasin për një situatë ekonomike në përmirësim, ku ritmi i rritjes ekonomike rezultoi i afërt me pritjet e agjentëve të tregut për T1- 2011. Departamenti i shtetit për tregtinë publikoi shifrën prej 1.9% rritje

ekonomike në terma tremujorë dhe 2.3% në terma vjetorë. Ndonëse pozitive, vlerat e këtij tremujori janë më të ulëta se ato të periudhës paraardhëse duke treguar një frenim të lehtë në performancën pozitive të shfaqur nga ekonomia amerikane që prej vitit të kaluar. Krahasuar me T4- 2010 faktorët që ndikuan ishin ulja e shpenzimeve konsumatore, rritja e importeve, ulja e shpenzimeve publike si dhe tkurrja e investimeve. Të dhënat paraprake mbështesin idenë se ndonëse me vlera më të ulëta, rritja ekonomike do të jetë pozitive edhe gjatë tremujorit të dytë dhe vitit 2011. Përmirësimi i treguesve të punësimit, kushte më të favorshme financimi si edhe politika monetare akomoduese gjykohen se do të jenë disa nga faktorët që do të kenë ndikim pozitiv në performancën e ekonomisë amerikane. Deficiti i llogarisë korente vijoi të rritej në T1-2011 duke reflektuar kryesisht rritjen e deficitit tregtar. Presionet inflacioniste në SHBA ndonëse kanë shfaqur shenja rritjeje nën ndikimin e çmimeve të produkteve energjetike dhe mallrave ushqimorë kanë qenë përgjithësisht në nivele të përmbajtura, e treguar kjo edhe nga ecuria e inflacionit bazë. Politika monetare e SHBA ka vazhduar të jetë me karakter lehtësues dhe norma referencë nuk ka ndryshuar gjatë këtyre muajve. Në të njëjtën kohë ka vijuar edhe aktiviteti i FED në tregun e letrave me vlerë të Qeverisë Amerikane, duke zbatuar të ashtuquajturin "lehtësim sasior" sipas vendimit të marrë në muajin nëntor të vitit të kaluar. Gjatë këtyre muajve tregjet financiare në SHBA kanë reflektuar ridimensionimin e pritjeve për një rritje ekonomike të shpejtë gjë që ka sjellë edhe ecuri të moderuar rritjeje të yield-eve në këto tregje.

2. DISA TREGUES TË EKONOMISË, INFLACIONI DHE ORIENTIMI I POLITIKËS MONETARE NË DISA VENDE TË EVROPËS QENDRORE- LINDORE[1]

Ecuria ekonomike në Republikën Çeke, Hungari dhe Poloni ka qenë relativisht e kënaqshme. Rritja ekonomike e këtyre vendeve në T1-2011 ka qenë mbi mesataren e Eurozonës dhe mbi pritshmëritë. Në të njëjtën linjë, parashikimet për rritjen ekonomike për 2011-2012 janë në nivele të larta. Rritja ekonomike është gjeneruar nga kërkesa e jashtme, ndërkohë që gjallërimi i kërkesës së brendshme ka qenë shume i ngadaltë. Të gjitha vendet operojnë me kapacitete të pashfrytëzuara dhe nën potencialin ekonomik. Kjo pamje është më pak uniforme në termat e ecurisë së inflacionit. Në Çeki, norma e inflacionit ka qenë në nivele të ulëta dhe në përputhje me objektivin e inflacionit, duke e detyruar bankën qendrore të ruajë nivelet më të ulëta historike të normës së interesit. Në Poloni dhe Hungari, norma e inflacionit ka lëvizur dhe qëndruar mbi objektiv. Reagim të politikës monetare ka patur nga banka qendrore e Polonisë, e cila rriti normën bazë tre herë brenda tremujorit të dytë me nga 25 pikë bazë (nga 3.75% në mars

Grafik 1. Rritja ekonomike në Evropën Qendrore Lindore ka qenë e larte në 2011



Burimi: Komisioni Evropian dhe raportet e Konvergjencës.

[1] *Ky rajon përfshin Republikën Çeke, Hungarinë dhe Poloninë.*

në 4.50% në qershor). Ndryshimet e politikës monetare janë bërë në kushtet kur monedhat e këtyre vendeve kanë qenë veçanërisht të qëndrueshme në tremujorin e dytë. Presionet inflacioniste në tremujorin e dytë vlerësohen në ulje, në kontekstin e frenimit të rritjes së çmimeve të lëndëve të para.

Zhvillimet në tregues të borxhit publik në vendet e Eurozonës kanë bërë që këto vende të rishikojnë politikat fiskale në drejtim të shtrëngimit të tyre. Më agresive në këtë aspekt ka qenë Hungaria. Në përgjithësi, rreziqet me të cilat përballen këto vende janë të njëjta me ato të Eurozonës për vetë ndërlidhjen e ngushtë ekonomike e financiarë që kanë ato me këtë zonë.

2.1 AKTIVITETI EKONOMIK

Niveli i borxhit është më i ulët se në shume vende të Eurozonës (përjashtim Hungaria)
Borxhi publik ne % PBB



Burimi: Komisioni Evropian dhe raportet e Konvergjencës.

Republika Çeke shfaq treguesit më të shëndoshë makroekonomikë në rajon. Në T1- 2011, rritja ekonomike (v/v e zhveshur nga sezonaliteti) është 2.8%, rreth 0.5 pikë përqindjeje më lart sesa parashikimet e bankës qendrore. Ndërkohë, dhe tregues të tjerë si punësimi dhe pagat janë rritur mbi parashikimet. Punësimi u rrit me 0.7% në tremujorin e parë, ndërsa pagat u rritën me 2.1%. Burimi kryesor i kësaj rritjeje janë eksportet, ndërkohë që kërkesa e brendshme vlerësohet ende e dobët. Ky profil zhvillimi gjeneron dhe presione më të ulëta inflacioniste. Nisur nga shifrat, për tremujorin e dytë pritet një ritëm rritjeje më i ulët për prodhimin industrial. Balancat fiskale janë të shëndosha, në pikën që i mundësojnë qeverisë reforma në sistemin e taksave dhe atë të pensioneve, të cilat nënkuptojnë më pak të ardhura në buxhet.

Klasifikimi ÇEKI		
A1 (stabël) (Moody's)	A (pozitive) (S&P)	A+ (pozitive) (Fich)

Monedha çeke është më e qëndrueshmja në rajonin e vendeve të Evropës Qendrore Lindore. Që nga fillimi i vitit, kursi i këmbimit ka qenë i qëndrueshëm, pak më lart se 24 koruna për euro. Prirja afatgjatë mbiçmuese e koronës çeke duket se është e palëkundur, megjithëse mund të cënohet nga zgjerimi i diferencave në normat bazë të interesit. Banka qendrore pret që kursi mesatar i këmbimit të jetë 24,1 CZK / EUR në 2011 dhe 23,4 CZK/ EUR në vitin në vijim. Ky vlerësim është bazuar në përqasjen e bilancit të pagesave - eksporteve neto, të parashikuara të rriten në të ardhmen duke nënkuptuar një vlerësim të monedhës çeke.

Grafik 3. Defiçiti buxhetor (ne % ndaj PBB) pritet që të ngushtohet



Burimi: Komisioni Evropian dhe raportet e Konvergjencës.

Në tremujorin e parë, rritja ekonomike në Hungari rezultoi 2.5% (v/v) e gjeneruar kryesisht nga kërkesa e huaj. Prodhimi industrial ka treguar rritje të vazhdueshme, ndërkohë që ecuria e sektorit të shërbimeve mbetet e ngadaltë. Rritja ekonomike nuk është reflektuar në rritje të punësimit. Konsumi i brendshëm mbetet i dobët pavarësisht vlerësimeve për rritje të të ardhurave të disponueshme (si pasojë e reduktimit të disa taksave). Sjellja e individëve është e prirur drejt kursimeve dhe niveli i kredive të reja është i ulët. Ekonomia vazhdon të karakterizohet nga rregullimi i bilanceve të sektorit privat pas periudhës së krizës, reflektuar kjo dhe në investimet e ulëta. Sipas bankës qendrore, ekonomia rritet nën potencial me një marzh të llogaritur 3 pikë përqindjeje. Nga ana tjetër, Hungaria ndoshta është i vetmi vend në Evropë që parashikon të dalë me suficit buxhetor. Kjo, si pasojë e reformave në sistemin e pensionit që do të kenë efekt vetëm për vitin fiskal 2011. Ndërkohë, masat e rrepta fiskale të parashtruara në Programin e Reformave Fiskale të qeverisë parashikojnë që deficiti buxhetor të ulet në rreth 3% në vitin 2012, ndërsa borxhi publik në rreth 70%.

Klasifikimi HUNGARI		
Baa3 (negative) (Moody's)	BBB- (negativ) (S&P)	BBB- (stabël) (Fich)

Kursi i këmbimit HUF/EUR ka ndjekur prije mbiçmuese në muajt e fundit. Hungaria gjykohet të jetë një vend me ekuilibra të brishtë. Megjithatë, duke pasur parasysh pozitën e qëndrueshme fiskale të vendit, rreziku i përhapjes së krizës së borxhit është i moderuar. Vlerësimet për monedhën hungareze në fund të vitit janë rreth 270 HUF/EUR, që do të thotë një kurs këmbimi i qëndrueshëm kundrejt euros. Aftësitë paguese të Qeverisë Hungareze si dhe përmbushja e masave për konsolidimin fiskal do të luajnë një rol parësor në zhvillimet e kësaj monedhe.

Të dhënat ekonomike për tremujorin e parë në Poloni ishin mjaft pozitive (më të lartat në këtë rajon) dhe reflektonin rritjen e konsumit e të investimeve. Shifra për rritjen e PBB-së rezultoi 4.4% nga 4.5% në T4- 2010. Shtytja kryesore e ekonomisë polake ka qenë rritja e kërkesës së brendshme. Konsumi privat vlerësohet të jetë rritur me 3.9% (v/v) ndërsa investimet me 6.0%, duke reflektuar dhe përgatitjet për zhvillimin e Kampionatit Evropian të futbollit. Rritja ekonomike pritet të rezultojë relativisht e lartë dhe në vazhdim sikurse tregojnë treguesit e përmirësuar të tregut të punës, të rritjes së kredive për investim dhe atyre hipotekore, si dhe rritja e hyrjeve të investimeve të huaja. Nga ana tjetër, parashikimi për një ngadalësim të ekonomisë së Eurozonës dhe shtrëngimi i politikës monetare në tremujorin e dytë, mund të ndikojnë në rishikimin për poshtë të rritjes ekonomike për 2011.

Klasifikimi POLONI		
A2 (stabël) (Moody's)	A (stabël) (S&P)	A- (stabël) (Fich)

Kursi i këmbimit të zlotit me monedhën evropiane ka qenë i qëndrueshëm kohët e fundit, afër 4 PLN/EUR për të gjithë tremujorin e dytë. Parashikimet për monedhën polake mbështeten në rritjen e eksporteve, me një mbiçmim të mundshëm në afatin e gjatë, por me pak hapësira ndryshimi në muajt në vijim. Ecuria pozitive e zlotit është ndihmuar nga zhvillimet pozitive makroekonomike, një fakt ky që duket se ka nxitur kanalizimin e fondeve për investim drejt kësaj ekonomie.

2.2 ECURIA E INFLACIONIT DHE POLITIKA MONETARE

Krahasuar me vendet e tjera në këtë rajon, inflacioni në Çeki është në nivele të ulëta, nën 2% që është objektivi i bankës qendrore dhe i Eurozonës.

Grafik 4/a. Presionet inflacioniste janë në rënie



Burimi: Bankat qendrore përkatëse.

Grafik 4/b. Presionet inflacioniste janë në rënie



Burimi: Bankat qendrore përkatëse.

Grafik 4/c. Presionet inflacioniste janë në rënie



Burimi: Bankat qendrore përkatëse.

Në muajin qershor ai zbriti në 1.8% nga 2% në maj. Sipas bankës qendrore, presionet inflacioniste mbeten të ekuilibruara gjë që e ka shtyrë atë të mos ndërmarrë ndryshime të kahut të politikës monetare. Norma bazë është në nivelin më të ulët historik 0.75% që prej muajit maj 2010. Faktorë që rrezikojnë ecurinë pozitive të inflacionit janë pritjet relativisht të larta inflacioniste, dhe një përshpejtim i papritur i kërkesës së brendshme. Pritjet inflacioniste janë në nivelin 2.5%, mbi objektiv por brenda intervalit të tolerancës (+/- 1%). Ndërkohë, zhvillimet në Eurozonë (një përshkallëzim i problemit të borxhit publik të disa vendeve) përcjellin presione të ulëta inflacioniste.

Në Hungari, norma e inflacionit ka rezultuar mbi objektivin e bankës qendrore por kjo nuk ka reaguar duke vlerësuar se presionet inflacioniste janë kalimtare. Ato vijnë nga rritja e çmimeve të administruara (energjisë) dhe atyre të lëndës së parë në tregun ndërkombëtar dhe nuk mendohet të kenë efekt zinxhir përsa kohë nuk ka presione nga tregu i punës. Inflacioni rezultoi 3.5% në qershor nga 3.9% në maj. Megjithatë, projeksionet e bankës qendrore tregojnë se në mungesë të ndryshimeve të normës bazë, inflacioni do të rikthehet në objektivin 3% në vitin 2012. Ky parashikim supozon se çmimet në tregun ndërkombëtar do të bien dhe në prezencën e një kërkese të brendshme të dobët, do të shuhen dhe efekte të mundshme të veprimit të dytë.

Grafik 5. Politika monetare ka mbetur e pandryshuar/shtrenguar



Burimi: Bankat qendrore përkatëse.

Rritja e vazhdueshme e inflacionit në Poloni, deri në 5% në maj – 2.5 pikë përqindjeje mbi objektivin – ka bërë që norma bazë e interesit të rritet tre herë në tremujorin e dytë. Inflacioni ka reflektuar kryesisht rritjen e çmimeve të ushqimeve dhe të energjisë. Shqetësuese ka qenë rritja e inflacionit bazë dhe e pritjeve inflacioniste të publikut. Në këtë kontekst, duke qenë se burimi i rritjes ekonomike ka qenë kërkesa e brendshme, banka qendrore ka adresuar rritjen e inflacionit duke ndryshuar normën bazë tre herë gjatë T2- 2011, me nga +25 pikë bazë, nga 3.75% në 4.50%. Në mbledhjen e fundit të muajit korrik, ajo vendosi të ruajë të pandryshuar normën bazë duke sinjalizuar vazhdimësinë e kësaj politike. Shtrëngimi i kushteve monetare në kombinim me shtrëngimin e dëshiruar të politikës fiskale, do të bëjë që inflacioni të zbresë pranë objektivit në periudhën afatmesme.

3. DISA TREGUES TË EKONOMISË, INFLACIONI DHE ORIENTIMI I POLITIKËS MONETARE NË DISA VENDE TË EVROPËS JUGLINDORE (+TURQI)[2]

Pas stabilizimit të ekonomive përkatëse vitin e kaluar, këto vende kanë njohur ritme të shpejta të rritjes ekonomike në 2011, në veçanti, Turqia, e cila është rritur me ritmin më të lartë (11%) në tremujorin e parë. Në të njëjtën kohë, normat e inflacionit kanë rezultuar relativisht të larta, si pasojë e rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Zhvillimet pozitive ekonomike nuk janë përkthyer në përmirësime të dukshme të tregut të punës apo në rënien e kredive të këqija duke treguar për brishtësinë e ekonomive. Rrezik tjetër për këto vende vjen nga efekti që mund të ketë zgjatja dhe ngërçi për zgjidhjen e krizës së borxhit publik në vende me të cilat janë të lidhura financiarisht (Greqi, Itali).

	Pritet rritje ekonomike[1]				
	2009	2010	T1 2011	2011p	2012p
Serbi	(3.5)	1.8	3.4	3.0	5.0
Rumani	(7.1)	(1.3)	1.7	1.5	3.7
Kroaci	(6.0)	(1.2)		1.1	2.0
Bullgari	(5.5)	0.2	1.5	2.8	3.7
Turqi	(4.8)	8.9	11.0	8.7[2]	2.5[3]
Maqedoni	(0.9)	0.7	5.1	2.5	3.3
Shqipëri[4]	3.3	3.9	3.4	3.5	6.1

[1] *Të dhënat për PBB-në në T1-2011 janë paraprake. Parashikimet për 2011-2012 janë të Komisionit Evropian.*
[2] *Parashikim i FMN-së i riparë pas publikimit të PBB-së për tremujorin e parë.*
[3] *Parashikimet për Shqipërinë janë të BSH dhe MF.*

Për të adresuar rritjen e inflacionit, në Serbi është rritur norma bazë, ndërsa në Turqi është rritur niveli i rezervës së detyruar. Banka të tjera nuk kanë ndryshuar normën e interesit pavarësisht se ajo ka qenë mbi objektivin, duke gjykuar se kjo prirje është e përkohshme dhe se në periudhën afatmesme, presionet inflacioniste janë të zbutura. Ajo çka u monitorua ngushtë këtë periudhë qenë pritjet inflacioniste, të cilat kishin filluar të rriteshin (sipas vrojtimeve të besimit dhe të ekspertëve). Me rënien e presioneve inflacioniste, norma bazë në Serbi ka pësuar ulje. Pritet që rënia e inflacionit të jetë trend i zgjatur duke e sjellë këtë tregues brenda objektivave të bankave përkatëse në periudhën afatmesme.

3.1 AKTIVITETI EKONOMIK

Rritja vjetore e PBB-së në Bullgari në T1- 2011 rezultoi 1.5%, nga 3.1% në T4- 2010 (në terma realë v/v). Përveç bujqësisë, pothuajse të gjithë sektorët ekonomikë kanë njohur rritje. Kontribut kryesor në rritjen ekonomike kanë

[2] *Ky rajon përfshin Bullgarinë, Maqedoninë, Rumaninë dhe Serbinë e, për efekt studimi, edhe Turqinë.*

dhënë eksportet. Rritja e eksporteve (22%) dhe rënia relative e importeve (+4%) kanë sjellë përmirësimin e dukshëm të bilancit të jashtëm të vendit. Llogaria korente është ngushtuar nga -23% e PBB-së në 2008, në -1% në 2010 dhe rezulton në suficit në T1- 2011. Konsumi i brendshëm vazhdon të rritet në terma negativë (por më të zbutur) në kontekstin e një norme papunësie të lartë, rënies së indekseve të besimit dhe prirjes për kursim. Në periudhën pas krizës me qëllim ristrukturimin e treguesve fiskalë, u miratua vendimi për ngrirjen e pagave dhe pensioneve (kontributet për këto të fundit janë rritur). Suficitet buxhetore të akumuluara në të shkuarën ndihmuan në kalimin e krizës, ndërkohë që masa të shtrënguara fiskale vazhdojnë të jenë në fuqi, me qëllim prurjen e deficitit buxhetor në 3% të PBB dhe ruajtjen e borxhit publik në nivele shumë të ulëta. Në kuadrin e treguesve të shëndoshë fiskalë dhe perspektivës së tyre, agjencia "Fitch" rishikoi vlerësimin për Bullgarinë nga negativ në pozitiv.

Deficiti korent në % PBB Bullgari



Burimi: Komisioni Evropian dhe raportet e Konvergjencës.

Deficiti fiskal % PBB Bullgari



Burimi: Komisioni Evropian dhe raportet e Konvergjencës.

Borxhi publik % PBB Bullgari



Burimi: Komisioni Evropian dhe raportet e Konvergjencës.

Deficiti buxhetor % PBB Rumani



Burimi: Komisioni Evropian dhe raportet e Konvergjencës.

Maqedonia po ecën me ritme rritjeje të ngadalta, por pozitive. PBB-ja shënoi një rritje prej 5.1% në T1- 2011, vlera më e lartë që prej 2008 (por kjo kryesisht e ndikuar nga efekti i bazës). Udhëheqësit e rritjes janë eksportet dhe investimet në sektorin e industrisë, tregtisë dhe ndërtimit. Nga ana e kërkesës janë vërejtur përmirësime në kreditimin e sektorit privat, në kushtet e tregut të punës (punësimi është rritur me 5% në terma vjetorë në tremujorin e parë) dhe përmirësimi i besimit të konsumatorit. Gjithashtu investimet e huaja direkte (IHD) u rritën me 2.7% në tremujorin e parë nga 1.2% në tremujorin e kaluar. Deficiti buxhetor ka qëndruar në të njëjtat nivele me vitin 2010, duke shënuar 2.5% ndaj PBB-së edhe gjatë këtij viti.

Deficiti korent % PBB Rumani



Burimi: Komisioni Evropian dhe raportet e Konvergjencës.

Rritja ekonomike në Rumani shënoi vlera pozitive për herë të parë që prej vitit 2008, duke regjistruar zyrtarisht daljen e vendit nga recesioni. PBB-ja u rrit 1.7% në T1-2011 nga -0.6% në T4-2010. Rimëkëmbja e vonuar pasqyroi ndikimin e politikës fiskale shtrënguese që filloi në muajin korrik 2010. Ndërkohë, kërkesa e brendshme mbetet e ndrydhur, si pasojë e kushteve ende të shtrënguara të kredive dhe rënies në flukset hyrëse të kapitaleve. Vlen për t'u përmendur se eksportet u rritën 24.4% këtë tremujor, nga 18.0% që ishin në tremujorin e shkuar. Deficti i llogarisë korente është përmirësuar në 3.1% të PBB-së në pjesën e parë të këtij viti, nga 4.1% që shënoi në fund të vitit 2010.

Që në T1- 2011, lei rumun u pozicionua në një trend të lehtë mbiçmimi, si rrjedhojë e përmirësimit në perceptimin e investitorëve mbi Rumaninë dhe vendimin e autoriteteve për të përfunduar një Stand-By Arrangement parandaluese (SBA). Në tremujorin e dytë, monedha vendase arriti të hyjë dhe të qëndrojë në intervalin mbi 4.1 ron/eur dhe vazhdoi kështu deri në mes të muajit qershor, kur ndërroi kah drejt nënçmimit.

Klasifikimi RUMANI		
Baa3 (stabël) (Moody's)	BB+ (stabël) (S&P)	BBB-(stabël) (Fich)

Rritja ekonomike në Serbi në tremujorin e parë u ndikua nga zhvillimi i shpejtë pozitiv i sektorit të industrisë. Prodhimi industrial u rrit me ritme të konsiderueshme (6.0% v/v) si pasojë e rritjes së kërkesës së jashtme dhe e përmirësimit të termave të konkurrencës së vendit. Kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike dhanë investimet private. Këto të fundit u mbështetën nga hyrjet valutore në formën e IHD-ve, rritjes së kredisë për bizneset, përmirësimit të parametrave në sektorin e ndërtimit dhe uljes së kapaciteteve të lira. Pritet që ekonomia e Serbisë të vazhdojë të rritet rreth nivelit 3% në 2011, në kushtet e rritjes së kërkesës së brendshme. Rënia e inflacionit dhe përmirësimi i treguesve në tregun e punës do të ndihmojnë në këtë drejtim.

Deficiti korent në % PBB Serbi



Burimi: Komisioni Evropian dhe raportet e Konvergjencës.

Deficiti buxhetor % PBB Serbi



Burimi: Komisioni Evropian dhe raportet e Konvergjencës.

Klasifikimi SERBI		
E pa vlerësuar (Moody's)	BB (stabël) (S&P)	BB- (stabël) (Fich)

Për shkak të diferencës së lartë të normës së interesit me Eurozonën, kursi i këmbimit të dinarit kundrejt euros ka vazhduar tendencën rritëse, e pranishme që nga tremujori i fundit të vitit të kaluar. Dinari është mbiçmuar më shumë se 5% në terma nominalë dhe duke pasur parasysh diferencën e madhe të inflacionit me atë të zonës euro, vlerësimi në terma realë është edhe më i rëndësishëm. Është e qartë se një dinar i fortë është i dobishëm në luftën kundër inflacionit, por një vlerësim i vazhdueshëm do të rrezikonte eksportet e Serbisë. Zhvillimet e fundit (korrik) në kursin e këmbimit kanë pasqyruar pasiguritë e përcjella nga Eurozona, duke sjellë nënçmim të dinarit serb.

Deficiti korent në % PBB Turqi



Burimi: Komisioni Evropian dhe banka qendrore.

Rritja reale e PBB arriti 11% v/v, në T1- 2011 në Turqi. Rritja ekonomike në Turqi është ndikuar nga një rigjallërim i shpejtë i kërkesës së brendshme, rritje e konsumit privat dhe e shpenzimeve publike. Në anën e shpenzimeve, konsumi privat u rrit me 12.1% në terma vjetorë. Rritja e investimeve private mbetet shumë e lartë, në terma vjetorë 38.3% edhe pse në rënie nga T4-2010. Kërkesa e brendshme u rrit me 15.9% në terma vjetorë ndërsa eksportet neto kanë dhënë ndikim negativ. Rritja e importeve ka qenë e shpejtë, duke ndikuar në zgjerimin e konsiderueshëm të llogarisë korente dhe duke rritur presionet në tregun valutor.

Klasifikimi TURQI		
Ba2 (Moody's)	BB (pozitive) (S&P)	BB+ (pozitive) (Fich)

Lira turke ka treguar ecuri nënçmuese ndikuar nga rritja e konsiderueshme e importeve dhe ruajtja e normës së interesit në të njëjtin nivel. Ajo është zhvlerësuar 10.9% kundrejt dollarit amerikan dhe 16.4% kundrejt euros, gjatë 9 muajve të fundit. Banka qendrore ka theksuar vazhdimësinë e flukseve të dobëta të kapitalit në drejtim të tregjeve në zhvillim, kjo për shkak të shqetësimeve në lidhje me problemet e qëndrueshmërisë së borxhit në disa vende të Zonës Euro. Në varësi të rrethanave, ajo mund rishikojë shumën e blerjeve të valutës së huaj nëpërmjet ankandeve të përditshme.

3.2 ECURIA E INFLACIONIT DHE POLITIKA MONETARE

Norma e inflacionit në Bullgari shënoi 4.3% në muajin qershor, nga 4.8% në muajin maj. Banka qendrore vlerëson se presionet e brendshme inflacioniste kanë qenë të ulëta dhe të kontrolluara. Rritja e inflacionit në fillim të 2011 iu atribua rritjes së çmimeve në nivel ndërkombëtar, ndërkohë që inflacioni bazë pati një rritje të lehtë.

Presionet inflacioniste



Burimi: Bankat Qendrore përkatëse.

Presionet inflacioniste



Burimi: Bankat Qendrore përkatëse.

Gjatë vitit 2011 inflacioni vjetor është rritur vazhdimisht në Maqedoni, duke shënuar 5.2% në muajin maj dhe një mesatare 4.5% në pjesën e parë të këtij viti. Kontribuesit kryesorë në rritje kanë qenë çmimet e ushqimeve dhe të energjisë (kryesisht karburantet). Inflacioni bazë ka qenë i qëndrueshëm. Kjo ka mbështetur edhe supozimet që inflacioni do të jetë i qëndrueshëm në intervalin e parashikuar 5-5.5% në muajt në vazhdim, duke supozuar qëndrimin neutral të politikës fiskale. Banka Qendrore e Maqedonisë ka të ngjarë të fillojë një cikël shtrëngimi të politikës monetare, për të përmbajtur presionet inflacioniste në rritje dhe të kufizojë zgjerimin e deficitit të llogarisë korente. Norma bazë është në nivelet më të ulta historike (4%).

Inflacioni vjetor në Rumani u rrit në 7.9% në muajin qershor nga 8.4% në maj 2011, por kjo vlerë mbetet e lartë krahasuar me objektivin 3%±1%. Rritja e çmimeve në muajt e fundit është ndikuar kryesisht nga rritja e TVSH-së[3] nga ana e qeverisë si dhe nga rritja e çmimeve të ushqimeve bujqësore. Edhe pse norma më e lartë në gjithë Bashkimin Evropian, rritja e inflacionit ishte faktorizuar në parashikimet e bankës qendrore, duke bërë që kjo e fundit të mos ndërmarrë masa të politikës monetare për sa kohë inflacioni nuk ka natyrë monetare. Banka Qendrore e Rumanisë e ka ruajtur normën bazë në 6.25% (ndryshimi i fundit në 4 maj 2010). Ajo ka sinjalizuar për mosndryshim të normës për sa kohë hendeku i prodhimit është negativ. Ecuria e inflacionit do të varet nga implementimi i reformave fiskale-strukturore, si rritja e TVSH-së dhe absorbimi i fondeve të marra nga BE dhe FMN. Pritet që efekti i rritjes së TVSH-së të shuhet në gjysmën e dytë të vitit 2011 dhe norma vjetore e inflacionit të zbresë në 4.9%, në fundvit.

Politika monetare ka mbetur e pandryshuar/shtrenguar



Burimi: Bankat Qendrore përkatëse.

Inflacioni në Serbi arriti kulmin në muajin prill (14.7%) si pasojë e rritjes së cmimeve të ushqimeve. Për të ruajtur pritjet inflacioniste të ankoruara, Banka e Serbisë rriti normën e interesit dy herë me nga 25 pikë bazë, në 12.50%. Në qershor, inflacioni zbriti në 12.7% nga 13.4% në maj. Mendohet që ky tregues ka nisur pririjen rënëse mbështetur nga rënia sezonale e çmimeve bujqësore, nga efekti i shtrëngimit të politikës monetare, kontrolli i treguesve fiskalë si dhe pririja për mbiçmimin e dinarit serb. Këto vlerësime kanë bërë që banka qendrore të nisë një cikël lehtësues të politikës monetare, duke e ulur normën bazë në qershor (-50 pikë bazë) dhe në korrik (-25 pikë bazë) në 11.75%.

Interesat e kredive në monedhën e vendit



Burimi: Bankat Qendrore përkatëse.

Në Turqi inflacioni shënoi 6.24% në qershor, nga 7.17% në muajin maj. Ulja e çmimeve të ushqimeve me 6.4% ishte arsyeja kryesore prapa kësaj rënieje. Ndërkohë, çmimet e prodhimit kanë mbetur pothuajse të pandryshuara në terma mujorë. Inflacioni bazë ka shfaqur shenja rritëse i ndikuar nga presionet e kërkesës dhe kursi i këmbimit në rënie. Banka Qendrore e Turqisë ka mbajtur të pandryshuar normën e interesit për repon javore në 6.25%, që prej muajit janar 2011. Në fillim të vitit, ajo përdori instrumentin e rezervës së detyruar si mjet për shtrëngimin e kushteve monetare në ekonomi. Ndërkohë, zgjerimi i llogarisë korente së bashku me rritjen e aktivitetit kreditues mund të shkaktojnë rrezik për stabilitetin financiar, duke përbërë argument për rritje të normës së interesit.

[3] *TVSH ndryshoi me 5 pikë bazë (në 24%) në vitin 2010, me qëllim arritjen e objektivave buxhetorë sipas marrëveshjes me FMN-në, në kuadër të ndihmës që ka marrë Rumania prej këtij institucioni për kalimin e krizës ($25 mld euro).*

4. ECURIA E KURSIT TË KËMBIMIT NË EVROPËN QENDRORE DHE JUGLINDORE

Monedhat e vendeve të Evropës Qendrore –Çeki, Poloni, Hungari, kanë qenë veçanërisht të qëndrueshme në këtë periudhë. Ekonomia e këtyre vendeve është e orientuar nga eksportet. Rritja e eksporteve neto (Çeki) mund të jetë faktor për mbiçmimin e tyre në terma aftagjatë. Gjithashtu, rritja e diferencës së normave të interesit me Eurozonën (Poloni) mund të sjellë një mbiçmim të lehtë të saj. Monedha hungareze, pavarësisht historikut negativ, konsiderohet e qëndrueshme përsa kohë realizohen angazhimet e qeverisë për respektimin e reformave fiskale.

Monedhat e vendeve juglindore, vazhdojnë të jenë në pozita të brishta. Disa prej tyre (Serbi, Rumani) janë mbiçmuar lehtë në fillim të tremujorit nisur nga perpektivat pozitive makroekonomike. Në fund të muajit qershor e në muajin korrik, kursi i këmbimit të këtyre monedhave ndaj euros është rritur, i diktuar nga lajmet jopozitive në Eurozonë. Pasiguria që shoqëron zgjidhjen e krizës së borxhit në Eurozonë mund të sjellë një krizë besimi dhe frike për investime në monedhat vendase.

Në Turqi, rritja e importeve dhe zgjerimi i llogarisë korente kanë vënë nën presion monedhën vendase. Nga ana tjetër, autoritetet qeveritare janë shprehur se e përkrahin monedhën e dobët si mënyrë për të nxitur eksportet dhe për të ngushtuar deficitin korent.

Ecuria ditore e kursit euro/monedhë vendase për vendet e Evropës Qendrore- Lindore (indeks me bazë shator 2008)



Burimi: Bankat qendrore përkatëse dhe llogaritje të DPM.

Mesataret mujore të kursit të këmbimit dhe ndryshimet mujore në përqindje.

Euro/monedhë vendase	Serbi	Turqi	Rumani	Poloni	Hungari	Çeki
Mars - 11	103.42	2.21	4.16	4.02	271.00	24.41
Prill - 11	101.15	2.20	4.10	3.97	265.34	24.28
Maj -11	98.26	2.26	4.11	3.94	267.06	24.38
Qershor - 11	99.98	2.31	4.19	3.97	266.61	24.28
Ndryshim mujor prill – 11	-2.19%	-0.45%	-1.44%	-1.24%	-2.09%	-0.53%
Ndryshim mujor maj – 11	-2.86%	2.73%	0.24%	-0.76%	0.65%	0.41%
Ndryshim mujor qershor – 11	1.75%	2.21%	1.95%	0.76%	-0.17%	-0.41%

Burimi: Bankat qendrore përkatëse dhe llogaritje të DPM.

5. TË TJERA SHKURT

- Në muajin maj u arrit një marrëveshje midis Portugalisë, BQE, KE dhe FMN. Në të u qartësuan kushtet që duhet të plotësojë Qeveria e Portugalisë në drejtim të konsolidimit të sektorit fiskal, rikapitalizimit të sektorit bankar si edhe reformave strukturore me qëllim marrjen e ndihmës financiare nga këto institucione.

- Në korrik, agjencia e renditjeve Moody's uli vlerësimin për Portugalinë nga Baa1 në Ba2, në kushtet e rritjes së borxhit publik të këtij vendi.

- Në 29 qershor Këshilli Drejtues i BQE në koordinim me atë të Bankës Qendrore të Kanadasë, të Anglisë dhe të Zvicrës vendosën zgjatjen e procedurës lehtësuese "swap" në dollarë amerikanë me Bankën Qendrore të SHBA (FED), deri në muajin gusht të vitit 2012.

- Në muajin mars, Guvernatori i BQA (FED) Ben S. Bernanke lajmëroi se që prej atij muaji FED do të kryente katër konferenca shtypi të rregullta në vit, për të prezantuar dhe shpjeguar risitë, projeksionet dhe analizat kryesore ekonomike të zhvilluara në mbledhjet e bordit të kësaj banke. Ky ndryshim, u bë në kuadër të forcimit të transparencës dhe qartësimit të implementimit të politikës monetare.

- Banka Qendrore e Rumanisë për herë të parë ka nisur funksionimin e sistemit të pagesave në euro (TARGET 2) me 23 pjesëmarrës. TARGET2-Romania është komponenti kombëtar i sistemit evropian të pagesave TARGET2. Prezantimi i TARGET2-Romania është një hap përpara drejt integrimit evropian dhe adoptimit të euros. Banka Qendrore e Rumanisë është banka e 24 kombëtare që lidhet me TARGET2, nga 28 bankat qendrore anëtare të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

- Agjencia e renditjeve Fitch, ka rritur renditjen e Bullgarisë nga negative në pozitive (BBB-). Ky vendim reflekton treguesit solid makroekonomik të vendit dhe prospektet për përmirësimin e tyre. Agjencia është shprehur se mund të konsiderojë një renditje tjetër të vendit në rast se sektori bankar tregon shenja stabilizimi dhe deficiti buxhetor e borxhi publik janë reduktuar më tej.

- Renditja e Rumanisë u rrit me një shkallë në BBB- me vlerësim pozitiv nga agjencia Fitch. Rivlerësimi shpreh progresin që ka bërë vendi në drejtim të ngushtimit të deficitit korent dhe reduktimit të deficitit buxhetor.

ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR

ERJONA SULJOTI, SOFIKA NOTE
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, KORRIK 2011.

1. HYRJE

Sistemi bankar shqiptar në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, përbëhet nga 16 banka, me pronësi private dhe me dominim të ndjeshëm të kapitalit të huaj. Aktualisht, kapitali i huaj përbën rreth 94% të totalit të sistemit bankar. Ndërkohë, sistemi bankar, ashtu sikurse edhe në vendet e tjera të rajonit, përbën segmentin kryesor të sektorit financiar që ofron ndërmjetësim për sektorin privat. Bankat zotërojnë rreth 95% të aseteve të sistemit financiar dhe kredia e akorduar prej tyre zë rreth 90% të portofolit total të kredisë për ekonominë. Gjithsesi, që prej vitit 2010, segmenti i institucioneve financiare jobanka në vend ka shfaqur rritje, si në numër ashtu edhe në portofolin e kredisë. Numri i institucioneve financiare jobanka në qershor të vitit 2011 ishte i njëjtë me fundin e vitit 2010, në 17 institucione ose 5 institucione më shumë krahasuar me vitin 2009. Këto zhvillime dëshmojnë për plotësimin e gamës së produkteve të tregut financiar, në përshtatje me nevojat e ekonomisë dhe veçanërisht të biznesit të vogël dhe atij të mesëm.

Ndërmjetësit financiarë gjatë pjesës së parë të vitit 2011, kanë shfaqur një pjesëmarrje të kujdesshme në rritjen e ndërmjetësimit financiar. Raporti i kredisë ndaj depozitave totale qëndroi në nivel të njëjtë me fundin e tremujorit të parë, në 61.1%. Gjatë kësaj periudhe sistemi bankar ka qenë aktiv dhe ka rritur fondet e grumbulluara nga kursimet e publikut, i përkrahur dhe nga sjellja e individëve për të kursyer. Ndërkohë, financimi i sektorit privat ka ruajtur ritme të moderuara të zgjerimit vjetor. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit, në muajt prill dhe maj flukset neto të kreditimit kanë ardhur duke u dobësuar, të ndikuara nga mungesa e rritjes sezonale për këta dy muaj në kreditimin e bizneseve. Kjo ecuri reflekton një kërkesë më të dobët të bizneseve

Në fund të muajit maj, rreth 47.6% e aktiveve të sistemit bankar janë të investuara në portofolin e kredisë. Ndërkohë që depozitat, si burimi kryesor i fondeve të bankave, përfaqësojnë rreth 76.2% të pasivit krahasuar me 73.9% një vit më parë. Në pesë muajt e parë të vitit, raporti i kredisë ndaj PBB-së është rritur lehtësisht nga niveli i fundvitit 2010, në 39.2%. Ndërkohë, ecuria e mirë e grumbullimit të fondeve ka ndikuar në rritjen e monetizimit të ekonomisë, e shprehur në rritjen e raportit të depozitave ndaj M3, në 81.2%. Në raport me PBB-në, depozitat totale shënuan 64.1% në fund të muajit maj 2011.

Ecuria e ndërmjetësimit sipas grupbankave ka treguar për performancën më të mirë të bankave të vogla në tregun e kredidhënies, të cilat kanë rritur më tej portofolin e tyre të kredisë duke balancuar kontraktimin e portofolit

të bankave greke. Pjesa e tregut të kredisë së bankave të vogla arriti në 20.1% krahasuar me 18.7% që shënonte në fund të vitit 2010. Në të njëjtin kohë, portofoli i bankave greke, i ndikuar nga ndryshimi i strategjisë së këtyre bankave, është tkurrur dukshëm. Pesha e bankave greke në sistem arriti në 28% krahasuar me 30%, pesë muaj më parë. Ndërkohë, rritja e qëndrueshme e portofolit të kredisë së bankave të mëdha ka ndihmuar në konsolidimin e mëtejshëm të pozicionit të tyre dominues në tregun e kredisë, në 41%.

Grafiku 15. Ecuria e depozitave dhe e kredive në raport me PBB-në, (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të muajit maj, tregu i depozitave nuk ka shfaqur ndryshime të ndjeshme në krahasim me një vit më parë. Grupi i bankave të mëdha zë rreth 58.6% të këtij tregu, krahasuar me 58% në fund të vitit 2010 dhe rreth 59% një vit më parë. Bankat greke, duke ofruar produkte tërheqëse për depozitat, kanë mundur të mbajnë të pandryshuar pjesën e tregut në më shumë se 2 vjet. Ndërkohë, grupi i bankave të vogla ka shfaqur një rritje të moderuar të depozitave krahasuar me fundvitin 2010.

Grafiku 16. Pesha e grup-bankave* në totalin e depozitave dhe kredisë së sistemit bankar.



Analiza e grup-bankave bazohet mbi aktivitetin ndërmjetësues të 9 bankave më aktive në tregun e kredidhënies, të cilat përbëjnë rreth 91% të aktiveve të sistemit bankar. Ndarja e bankave në grupe është bazuar në madhësinë e bilancit të bankave si dhe karakteristikat e financimit të veprimtarisë së tyre. Më konkretisht ato përfaqësojnë: B1- 3 bankat më të mëdha të sistemit; B2- 3 bankat greke; B3- 3 bankat e vogla të sistemit bankar aktive në kredidhënie.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

2. NDËRMJETËSIMI I SISTEMIT BANKAR

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 është vërejtur një rimëkëmbje e ngadaltë e aktivitetit ekonomik në vend. Impulsi pozitiv që ka dhënë politika fiskale stimuluese ka ndikuar në zgjerimin e aktivitetit ekonomik, veçanërisht në lekë, dhe në kontributin më të lartë të komponentit fiskal në rritjen e kërkesës. Ndërkohë, sektori privat, i ndikuar nga pasiguritë për të ardhmen, ka shfaqur një rimëkëmbje të ngadaltë të kërkesës për para, sikurse vihet re në ecurinë e moderuar të kërkesës për kredi. Gjithashtu, ecuria e çmimeve në ekonomi ka shfaqur rritje të inflacionit vjetor, duke përcjellë presionet e shtuara inflacioniste të çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare në inflacionin e mallrave të konsumit në vend.

Në këtë kuadër, në fund të muajit mars, autoriteti monetar ndërmori rritjen me 0.25 pikë përqindje të normës bazë të interesit, me qëllim menaxhimin dhe ankorimin e pritjeve inflacioniste rreth objektivit të tij, si dhe dekurajimin e materializimit të mëtejshëm të efekteve të raundit të dytë në inflacion. Mbas këtij vendimi, norma bazë e interesit në ekonomi shënoi 5.25% dhe mbetet pranë niveleve të ulta historike. Në tremujorin e dytë të vitit, tregjet financiare kanë përcjellë sinjalet e politikës monetare, duke shprehur tendenca rritëse të normave të interesit pothuajse në të gjitha segmentet e këtij tregu. Për të njëjtën periudhë, ecuria e kursit të këmbimit ndaj monedhave kryesore ka shfaqur nënçmim të moderuar vjetor, duke ndikuar që në tërësi kushtet monetare të mbeten akomoduese në ekonomi dhe të përkrahin rigjallërimin e aktivitetit ekonomik. Ndërkohë, norma reale e interesit vijon të jetë në nivele të ulta historike, duke mbështetur kërkesën agregate në vend.

Ecuria e treguesve monetarë gjatë periudhës janar - maj 2011 është ndikuar nga një kontribut i qëndrueshëm i kërkesës së sektorit privat dhe një rritje e kërkesës për financim të sektorit publik, kryesisht në monedhën vendase. Kjo kërkesë ka ushqyer rritjen e qëndrueshme të depozitave në lekë gjatë kësaj periudhe dhe për rrjedhojë, edhe rigjallërimin e ritmeve të rritjes

Grafiku 17. Oferta e parasë dhe komponentët kryesorë ndaj M3*.



*Të dhënat në grafik janë të pastruara nga efekti i kursit të këmbimit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

së agregatit M2, i cili u rrit mesatarisht rreth 6% në terma vjetorë. Një vit më parë, ky agregat shfaqi për gjatë gjithë vitit ritme të moderuara të rritjes vjetore, në përgjigje të një kërkese të ulët për monedhën vendase nga sektori privat dhe ai publik.

Agregati M3 ka shfaqur një ekspansion më të lartë në terma vjetorë në tremujorin e dytë, krahasuar me tremujorin e parë të vitit, i ndikuar nga performanca më e mirë e depozitave në valutë. Në muajt prill-maj ai u rrit mesatarisht me rreth 11.7% krahasuar me 11.0% në tremujorin e parë. Komponenti valutor edhe në tremujorin e dytë ka vijuar të japë kontributin kryesor në ekspansionin monetar, por në nivele më të ulëta se fundi i vitit 2010.

Grafiku 18. Ecuria vjetore dhe tremujore e kredititi të brendshëm.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ritmet e kreditimit të ekonomisë vijojnë të jenë të moderuara dhe nën mesataren e tyre historike, duke reflektuar jo vetëm kërkesën e moderuar për para por edhe rritjen e pasigurisë për të ardhmen. Ndërkohë, përkeqësimi i mëtejshëm i cilësisë së portofolit të kredisë i ka penguar bankat në lehtësimin e mëtejshëm të standardeve. Norma vjetore e rritjes së kredisë për ekonominë shënon mesatarisht rreth 10.8 % gjatë muajve prill- maj, kundrejt mesatares prej rreth 9.6% që shënoi në tremujorin e parë të vitit. Ndërsa kredia për sektorin privat pësoi një rritje relativisht më të shpejtë me rreth 11.4 % mesatarisht në dy muaj. Në terma absolutë, stoku i kredisë për sektorin privat u zgjerua me rreth 7.6 miliardë lekë, i mbështetur si në financimin e individëve ashtu dhe atë të bizneseve. Gjithsesi, duke e pastruar nga lëvizjet në kursin e këmbimit, fluksi neto mujor i vërejtur në muajt prill-maj ka qenë rreth 40% më pak se fluksi mujor i regjistruar në fund të tremujorit të parë. Ndërkohë, ecuria e kërkesës për kredi nga bizneset ishte ndjeshëm më e ulët se flukset e larta sezonale të kësaj periudhe. Huadhënia për bizneset ka qenë kryesisht në valutë dhe e orientuar për qëllime likuiditeti. Njëkohësisht, të dhënat e tremujorit të dytë konfirmuan ecurinë pozitive të kredisë për individë, e cila në terma vjetorë u rrit me 2.5%, ndërsa si fluks në këta dy muaj ishte 1.7 mld

lekë ose rreth 3 herë më shumë se në tremujorin e parë të vitit. Përmirësimi i ecurisë së portofolit të kredisë për individ, pasqyron lehtësimin e kushteve të kredidhënies si dhe një ecuri më pozitive të kërkesës për këtë kredi.

Grafiku 19. Ecuria vjetore e kreditit të brendshëm dhe e kostos të tij.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pjesa e parë e vitit, është karakterizuar nga një rritje e dobët e të ardhurave buxhetore dhe rritje e ndjeshme e shpenzimeve buxhetore, në veçanti atyre kapitale. Ekspansioni fiskal në pjesën e parë të vitit 2011, ndikoi në zgjerimin e ritmeve rritëse të huamarrjes së sektorit publik nga sistemi bankar. Gjatë kësaj periudhe, pretendimet neto të qeverisë u rritën mesatarisht 4.5% në terma vjetorë, krahasuar me 3.4% mesatarisht për tremujorin e parë. Kjo huamarrje u krye me instrumente afatshkurtra të borxhit, kryesisht 12- mujore si dhe me obligacione afatgjata 2 dhe 5 vjeçare. Kërkesa në rritje e qeverisë për financim ka ushtruar presion në përcaktimin e çmimeve në tregun primar, të cilat kanë qenë në një trend rritës përgjatë gjithë vitit 2011. Krahas kërkesës më të lartë, ecuria e yielde-ve në këtë treg, ka reflektuar edhe rritjen e normës bazë të interesit në fund të tremujorit të parë.

Ndërmjetësimi i sistemit bankar për ekonominë, përfaqësuar nga raporti i stokut total të kredisë ndaj depozitave, vijon të mbetet relativisht i ulët. Në fund të muajit maj, raporti i kredisë ndaj depozitave në total rezultoi në 61.1%, duke qëndruar në të njëjtat nivele me tremujorin e parë tw vitit 2011. Ndwrkohw, ky raport shfaqet më i ulët, kundrejt nivelit maksimal prej rreth 69% qw shwnoi në muajin maj 2009. Rënia e ndërmjetësimit në terma afatmesëm reflekton, përveç rritjen e shpejtë të depozitave në sajë të rikthimit të plotë të tyre nw sistem që në gjysmën e parë të vitit 2010, edhe ritmin e moderuar të zgjerimit të kredisë për ekonominë nw vitet e fundit.

3. ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT BANKAR[4]

Ecuria e ndërmjetësimit bankar në muajt prill-maj ka qenë në linjë me zhvillimet e vërejtura në tremujorin e parë të vitit. Treguesit e ndërmjetësimit kanë mbetur pothuajse të pandryshueshëm në nivelin e T1- 2011, pa devijuar shumë nga mesatarja e 6-7 muajve paraardhës. Kostot e ndërmjetësimit, përtej luhatshmërisë mujore, kanë qenë të qëndrueshme për monedhën euro dhe në rënie për monedhën vendase. Nga ana tjetër, një pjesë e rëndësishme e elementeve jo-kosto të kushteve të kreditimit, mbetet në kahun shtrëngues.

3.1 Ecuria e ndërmjetësimit në lekë

Ndërmjetësimi në monedhën vendase në periudhën prill-maj ka ruajtur nivelet e vërejtura në dy tremujorët e mëparshëm. Raporti kredi/depozita është rritur lehtë në mesatarisht 38.6%, nga 38.2% që qëndronte në dy tremujorët e mëparshëm. Qëndrueshmëria në treguesin e ndërmjetësimit prej më shumë se një viti ka ardhur si pasojë e zhvillimeve relativisht të balancuara në kredinë dhe depozitat në lekë.

Grafiku 20. Ecuria e ndërmjetësimit në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në muajt prill-maj, kredia në lekë ka mbartur ritmet mesatare të rritjes vjetore të tremujorit të mëparshëm, prej 12.9%. Burimi kryesor i rritjes së kredisë në lekë mbetet kërkesa e bizneseve për financimin e kapitalit qarkullues. Por, në muajt e fundit, me gjallërimin e kërkesës për kredi të individëve, edhe këta të fundit kanë rritur përdorimin e financimit në lekë. Në periudhën prill-maj, kredia në lekë për individë zuri rreth 50% të fluksit neto të kredisë totale në lekë. Përveç kredisë konsumatore, e cila përgjithësisht akordohet në lekë, monedha vendase po gjen përdorim më të madh edhe në kredinë hipotekare, duke reflektuar një faktorizim më të madh të rrezikut të kursit të këmbimit në aftësinë për të shlyer kredinë.

[4] *Veprimtaria e bankave në valutë është e dominuar nga aktiviteti i tyre ne euro, i cili zë më shumë se 80% të aktivitetit në valutë.*

Depozitat në lekë janë rritur mesatarisht me 11.9% në periudhën prill-maj, një ritëm ky i krahasueshëm me atë të vërejtur në tremujorin e parë të vitit. Fluksi neto mujor i tyre, gjatë kësaj periudhe rezultoi 3.7 miliardë lekë, nga 4.7 miliardë lekë që rezultoi në tremujorin e parë të vitit. Megjithatë, në një horizont më të gjatë kohor, zgjerimi mesatar mujor i depozitave mbetet i qëndrueshëm, i krahasueshëm me fluksin mesatar të vërejtur që nga fillimi i vitit 2010.

Grafiku 21. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostoja e ndërmjetësimit në lekë ka shënuar rënie në muajt prill dhe maj. Në terma mesatarë, ajo ka rezultuar 7.4%, nga 8.1% që shënonte mesatarisht në tremujorin e parë të vitit. Ndërkohë që norma mesatare e interesit të depozitave ka shënuar vetëm një rënie të lehtë në krahasim me tremujorin e kaluar, duke rezultuar 4.6%. Reduktimi i kostos së ndërmjetësimit ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies së normës mesatare të interesit të kredisë. Ajo ka shënuar mesatarisht 12.0%, ose rreth 0.9 pikë përqindje më pak se në tremujorin e parë të vitit. Si edhe në muajt e mëparshëm, ecuria e saj është ndikuar kryesisht nga normat e interesit të kredisë për qëllime likuiditeti dhënë bizneseve. Reduktimi i normave të interesit të kredisë ka ndodhur në kushtet e rritjes së normës së interesit të bonos së thesarit 12-mujore, që në shumicën e rasteve shërben si normë referencë në përcaktimin e kostos së kredisë. *Spread*-i mesatar rezultoi 4.6% në këtë periudhë, duke rënë me rreth 1.3 pikë përqindje në krahasim me tremujorin e parë të vitit.

3.2 Ecuria e ndërmjetësimit në Valutë (Euro)

Ndërmjetësimi në valutë në muajt prill-maj ka shfaqur një ecuri në linjë me zhvillimet në muajt e mëparshëm. Raporti kredi/depozita ka shënuar një rritje të lehtë, duke qëndruar mesatarisht në 85.9%, nga 85.1% që shënonte në tremujorin e parë të vitit. Një ecuri e tillë ka ardhur kryesisht si pasojë e ngadalësimit të depozitave, ndërkohë që kredia ka mbajtur një ritëm të qëndrueshëm rritjeje.

Rritja vjetore e kredisë në valutë shënoi mesatarisht 7.8% në periudhën prill-maj, 0.4 pp më shumë se në tremujorin e parë të vitit. Rritja e kreditimit në valutë të ekonomisë në këtë periudhë u nxit kryesisht nga kërkesa e bizneseve për financimin e kapitalit qarkullues. Në të njëjtën kohë, në këtë periudhë, ka patur një kërkesë të shtuar për financim në valutë edhe nga ndërmarrjet publike.

Në muajt prill-maj, fluksi mesatar mujor i depozitave në valutë, ndryshe nga tremujori i parë i vitit, ishte pozitiv. Pavarësisht kësaj, ai ishte sa rreth 50% e fluksit mujor të regjistruar në gjysmën e dytë të vitit të kaluar. Ky ngadalësim i rritjes së depozitave në valutë është në linjë edhe me reduktimin e remitancave dhe flukseve të huaja hyrëse gjatë kësaj periudhe në ekonominë tonë. Në terma vjetorë, ritmet e rritjes në këta dy muaj shënuan 19.3%, nga 20.7% që shënuan në tremujorin e parë të vitit.

Kostoja e ndërmjetësimit në euro është shfaqur e qëndrueshme në periudhën prill-maj, duke ruajtur nivelin prej 5.1% të vërejtur në tremujorin e parë të vitit. Ajo ka mbetur e pandryshuar si rrjedhojë e rritjes së lehtë dhe të njëkohshme të normës mesatare të kredisë dhe të asaj të depozitave.

Grafiku 22. Ecuria e ndërmjetësimit në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostoja e kredisë në euro vijon të jetë ndjeshëm më e lartë se normat referencë të kësaj monedhe në tregjet e huaja ndërbankare, duke reflektuar koston e lartë të depozitave në euro në vend. Megjithatë, diferenca mes këtyre të fundit dhe normave Euribor ka rënë ndjeshëm nën 1 pikë përqindje, me përmirësimin e situatës së likuiditetit në vend dhe rritjen e normave të interesit për euron në tregjet ndërkombëtare. Kjo është reflektuar edhe në rënien e normës së interesit të kredive në euro në vend dhe të diferencës mes tyre dhe normave Euribor. Aktualisht, kjo diferencë qëndron në 5.2 pp, nga 5.5 pp dhe 6.3 pp që qëndronte përkatësisht tremujorin e kaluar dhe një vit më parë.

Grafiku 23. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.3 Ecuria e elementeve jo-kosto në ndërmjetësim

Ecuria e ndërmjetësimit bankar, përveç normës së interesit, ndikohet edhe nga elemente jo-kosto të kreditimit, të cilat përcaktojnë ofertën për kredi. Në përgjithësi, vërehet se edhe pse normat e interesit të kredive kanë shënuar rënie, elemente të rëndësishme në përcaktimin e aftësisë së kredimarrësve potencialë për të marrë kredi mbeten ende të shtrënguara.

Grafiku 24. Ecuria e kushteve të kreditimit për bizneset*.



*Balanca neto e përgjigjeve në këtë vrojtim.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kushtet e kreditimit për bizneset janë shtrënguar në tremujorin e dytë të vitit. Elementet çmim të kredidhënies - marzhi për kreditë me rrezik normal dhe komisionet - janë lehtësuar për herë të parë që prej mëse dy vjetësh. Në kahun lehtësues kanë vepruar edhe madhësia dhe maturiteti i kredisë. Nga ana tjetër, rritja e mëtejshme e kërkesave për kolateral vazhdon të kufizojë ndjeshëm aftësinë kredimarrëse të bizneseve.

Grafiku 25. Ecuria e kushteve të kreditimit për individët*.



*Balanca neto e përgjigjeve në këtë vrojtim.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kushtet e financimit për individët kanë vijuar të lehtësohen edhe në tremujorin e dytë të vitit. Përveç lehtësimit në marzhin e aplikuar për kreditë me rrezik normal, politika më lehtësuese është zbatuar edhe nëpërmjet uljes së komisioneve bankare. Ndonëse ulja e kostos kryesore të kredisë – normës së interesit – është faktor i rëndësishëm në kredidhënie, kjo e fundit ndikohet në një masë të madhe edhe nga faktorë të tjerë jo-çmim. Kështu, mbajtja e shtrënguar e elementeve të tjera si madhësia e kredisë, kërkesat për kolateral dhe raporti kësht/të ardhura për kredinë për individë balancon një pjesë të mirë të efektit lehtësues të dhënë nga ulja e normës së interesit.

ANEKS

ECURIA E DEPOZITAVE



ECURIA E PORTOFOLIT TË KREDISË



ANALIZË E ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË TREMUJORI I- 2011

EGLENT KIKA, MERITA BOKA
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, BANKA E SHQIPËRISË, KORRIK 2011

ZHVILLIMET NË BILANCIN E PAGESAVE, TREMUJORI I- 2011

Gjatë T1- 2011, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me zvogëlim të mjeteve valutore me rreth 77.1 milionë euro. Deficiti i llogarisë korente gjatë këtij tremujori u zgjerua me rreth 4.7 % në terma vjetorë. Deficiti korent u vlerësua në rreth 11.7 % ndaj PBB-së nominale. Prurjet valutore neto në llogarinë kapitale dhe financiare rezultuan rreth 186.6 milionë euro, në rritje me rreth 59.2 % në terma vjetorë. Në raport ndaj PBB-së nominale, flukset kapitale dhe financiare neto vlerësohen në rreth 8.9 % ose rreth 2.8 pikë përqindjeje më të larta se raporti i regjistruar në të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Tabelë 1. Tregues të bilancit të pagesave.

Milionë Euro	T4:09	T1:10	T2:10	T3:10	T4:10	T1:11
Mallra	-601.34	-419.01	-482.93	-595.92	-584.85	-408.50
Eksport	205.51	254.91	340.47	270.29	305.86	370.59
Import	-806.85	-673.92	-823.40	-866.20	-890.71	-779.09
Shërbime	34.47	-13.07	9.51	180.00	5.22	-46.04
Eksport	389.84	259.31	369.55	661.04	412.47	289.21
Import	-355.37	-272.38	-360.04	-481.04	-407.24	-335.25
Të ardhurat	-30.53	-14.10	-11.21	-19.93	-31.61	11.74
Të ardhurat nga investimet e huaja direkte	-70.64	-65.88	-56.08	-25.02	-73.71	-26.78
Transferta korente	272.76	210.86	282.46	190.62	237.69	196.43
Remitanca (neto)	226.84	170.05	219.47	135.15	165.10	153.14
Llogaria korente	-324.63	-235.32	-202.18	-245.22	-373.55	-246.37
Llogaria kapitale e financiare	109.6	117.3	180.6	193.7	433.1	186.6
Llogaria kapitale	17.0	10.0	22.7	22.6	30.2	19.1
Llogaria financiare	92.6	107.3	157.9	171.1	402.8	167.5
Investimet e huaja direkte (hyrëse)	108.5	165.8	171.6	241.1	249.0	57.5
(a) aksione dhe riinvestim fitimesh	155.1	161.0	171.8	256.2	245.4	172.6
(b) kapitale të tjera	-46.6	4.8	-0.2	-15.1	3.6	-115.1
Investime portofoli (neto)	4.1	-25.9	-25.0	-1.5	272.4	-20.9
Investime të tjera (neto)	-14.9	-32.4	13.0	-78.9	-119.6	134.6
Gabime dhe harresa	128.3	100.6	31.9	111.7	66.2	-17.4
Bilanci i përgjithshëm	-86.7	-17.4	10.3	60.2	125.7	-77.1

Burimi: Bilanci i Pagesave, Banka e Shqipërisë.

LLOGARIA KORENTE

Pozicioni neto i llogarisë korente regjistroi një deficit prej 246.4 milionë

eurosh ose rreth 11.7 % ndaj PBB-së nominale. Ky deficit, në vlerë, vijoi të zgjerohet për të dytin tremujor radhazi në nivel vjetor dhe, gjatë tremujorit në analizë, u paraqit 4.7 % më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Megjithatë, raporti i tij ndaj PBB-së gjatë tremujorit të parë të vitit vlerësohet rreth 0.3 pikë përqindjeje më i ulët kundrejt raportit të regjistruar një vit më parë. Thellimi i deficitit të llogarisë korente gjatë këtij tremujori u ndikua gjerësisht prej ecurisë së llogarisë së shërbimeve dhe të transfertave korente. Përkeqësimi i kombinuar i pozicionit të tyre neto krahasuar me të njëjtit tremujor të vitit paraardhës ka kontribuar në thellimin e deficitit korent. Në të njëjtën kohë edhe deficiti tregtar në mallra u zgjerua me rreth 2.5% në bazë vjetore. Kontributi i eksporteve neto në ecurinë vjetore të kërkesës agregate vlerësohet të jetë negativ, gjatë T1- 2011.

Shërbimet, të ardhurat dhe transfertat korente

Në analizën e llogarisë korente sipas zërave të saj kryesorë evidentohet zgjerimi i deficitit të eksporteve neto, si faktor i rëndësishëm në përkeqësimin e pozicionit të kësaj llogarie. Ndonëse, deficiti tregtar në mallra regjistroi ngushtim të lehtë në nivel vjetor, thellimi i pozicionit neto negativ të llogarisë së shërbimeve kushtëzoi zgjerimin e deficitit të eksporteve neto me 5.2% në nivel vjetor. Pozicioni neto i llogarisë së shërbimeve ishte negativ këtë tremujor me rreth 46 milionë euro, si pasojë e rritjes së shpenzimeve për udhëtime personale për qëllime turizmi e biznesi të rezidentëve. Efekt të qenësishëm vlerësohet të ketë dhënë heqja e regjimit të vizave për rezidentët, i cili ka ndihmuar në rritjen e daljeve financiare prej shërbimeve të udhëtimit me rreth 29% në nivel vjetor. Megjithëse të ardhurat hyrëse prej jorezidentëve ishin më të larta këtë tremujor krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ato nuk arritën të eklipsonin rritjen e shpenzimeve të udhëtarëve rezidentë jashtë vendit.

Grafiku 26. Komponentët e llogarisë korente ndaj PBB-së sipas tremujorëve (grafiku majtas) dhe hyrjet dhe daljet financiare prej udhëtimeve personale në bazë vjetore (grafiku djathtas).



Burimi: Bilanci i Pagesave, Banka e Shqipërisë.

Balanca neto e llogarisë së të ardhurave gjatë tremujorit të parë të vitit rezultoi në suficit prej 11.7 milionë eurosh. Ky rezultat përbën një ndryshim në prirjen e kësaj llogarie, e cila ka regjistruar deficit neto për tetë tremujorë

me radhë. Kontributin kryesor në këtë ecuri e dha rënia e flukseve dalëse të të ardhurave prej investimeve të huaja direkte (IHD) me rreth 55.9% në bazë vjetore. Ndonëse kjo rënie e riatdhesimit të fitimeve prej investitorëve të huaj mund të nënkuptojë implikime në përfitueshmërinë e aktivitetit të tyre në vend, vërtetësia e saj do të jetë e mundur të konfirmohet me ecurinë e këtij nënzëri gjatë tremujorëve në vazhdim. Megjithatë, duke vlerësuar prirjen e këtij nënzëri gjatë tre viteve të fundit ecuria e sipërpërmendur mund të shihet si ri-investim i fitimeve të tyre me qëllim rritjen e kapaciteteve prodhuese. Të ardhurat neto prej investimeve të portofolit janë rritur me 2.7 milionë euro ndërsa ato prej pagesave neto të interesit të borxhit janë rritur me rreth 10.9 milionë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafiku 27. Të ardhurat prej IHD-ve në vlerë (grafiku majtas) dhe ndaj PBB-së (grafiku djathtas).



Burimi: Bilanci i Pagesave, Banka e Shqipërisë.

Suficiti i transfertave korente këtë tremujor regjistroi një rënie prej 6.8% krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Nënzëri kryesor i kësaj llogarie, transfertat prej emigrantëve, vijoi prirjen rënëse vjetore për të dytin tremujor me radhe. Në terma vjetorë, remitancat ishin rreth 10% më të ulëta këtë tremujor.

Analizat statistikore paraqesin një prirje afatgjatë rënëse të tyre ndërsa lëvizjet afatshkurtra të këtij nënzëri janë ndikuar prej faktorëve të jashtëm ekonomikë. Kështu, niveli i lartë i papunësisë në Greqi[5] vlerësohet të ketë ndikuar drejtpërsëdrejti dërgesat e emigrantëve drejt vendit tonë. Ndërsa prej Italisë[6], sipas të dhënave më të fundit për T1- 2011, remitancat vlerësohet të kenë mbetur të pandryshuara në bazë vjetore. Raporti i tyre kundrejt deficitit tregtar vlerësohet në nivelin 37.5% ose rreth 3.1 pikë përqindje më i ulët se raporti i financimit, i regjistruar gjatë T1- 2010. Në të njëjtën kohë, raporti i financimit të deficitit tregtar ka shfaqur prirje rënëse që prej vitit 2007.

[5] *Greqia është vendi më i madh i origjinës së remitancave drejt vendit tonë. Të dhënat më të fundit për transfertat e emigrantëve prej Greqisë janë të vitit 2009, dhe rënia e tyre shpjegon plotësisht rënien e remitancave hyrëse në vendin tonë. Italia është vendi i dytë më i madh i origjinës së remitancave.*

[6] *Të dhëna nga Banka e Italisë për Italinë dhe Eurostat për Greqinë.*

Grafiku 28. Raporti i financimit të deficitit tregtar prej remitancave (grafiku majtas) dhe prirja afatgjatë dhe cikli i ecurisë vjetore të remitancave.



Burimi: Bilanci i Pagesave, Banka e Shqipërisë.

Llogaria kapitale dhe financiare

Gjatë T1- 2011, prurjet valutore neto në llogarinë kapitale dhe financiare rezultuan rreth 186.6 milionë euro, në rritje me rreth 59.2 % në terma vjetorë. Në raport ndaj PBB-së nominale, flukset kapitale dhe financiare neto vlerësohen në rreth 8.9 % ose rreth 2.8 pikë përqindjeje më të larta se raporti i regjistruar në të njëjtin tremujor të një viti më parë. Ndër to, rreth 19.1 milionë euro kanë hyrë në vend në formën e granteve për investime kapitale, ndërsa rreth 167.5 milionë euro kanë hyrë në formën e flukseve financiare. Ndonëse në terma vjetorë kjo llogari shënoi zhvillime pozitive, suficiti i regjistruar në T1- 2011 rezultoi i pamjaftueshëm për të financuar tërësisht deficitin e llogarisë korente. Raporti i financimit të këtij të fundit ishte 75.7 për qind; raport ky, megjithatë, rreth 25.9 pikë përqindjeje më i lartë krahasuar me tremujorin korrespondues të një viti më parë.

Grafiku 29. Llogaria kapitale dhe financiare, në milionë euro (bm) dhe raporti i financimit të deficitit të llogarisë korente nga llogaria kapitale dhe financiare, në përqindje (bd).



Burimi: Bilanci i Pagesave, Banka e Shqipërisë.

Fluksi neto i transaksioneve financiare gjatë T1- 2011, regjistroi një vlerë prej 167.5 milionë eurosh, në rritje me rreth 56.2 % në terma vjetorë. Detyrimet financiare të rezidendëve ndaj jorezidentëve, gjatë kësaj periudhe, ishin rreth 119.6 milionë euro, në rënie me rreth 31.8 % në terma vjetorë. Mjetet tona financiare të investuara jashtë shënuan rënie me rreth 47.9 milionë euro në T1- 2011. Në të njëjtën periudhë të një viti më parë, mjetet financiare të rezidentëve të investuara jashtë u rritën me rreth 68.1 milionë euro. Si pasojë e lëvizjes së flukseve valutore në zërat e mjeteve dhe të detyrimeve, treguesi i shkallës së hapjes financiare[7] në vend për T1- 2011 rezultoi rreth 8.0 për qind. Ky tregues është rreth 4.5 pikë përqindjeje më i ulët krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 30. Përbërja e llogarisë financiare në detyrime dhe mjete (flukse në milionë euro, bm) dhe treguesi i shkallës së hapjes financiare (në përqindje, bm).



Burimi: Bilanci i Pagesave, Banka e Shqipërisë.

Gjatë T1- 2011, flukset neto (hyrëse – dalëse) të investimeve të huaja direkte rezultuan në rreth 53.8 milionë euro, në rënie me rreth 67.5 % në terma vjetorë. Sipas drejtimit të investimit, zhvillimet në IHD gjatë këtij tremujori u përcaktuan nga flukset hyrëse të tyre. Sipas instrumentit të përdorur për investime, gjatë T1- 2011, IHD-të hyrëse në trajtën e letrave me vlerë të pasurisë (aksione) dhe ri-investim të fitimeve ishin rreth 172.6 milionë euro, në rritje me rreth 7.2 % në terma vjetorë. Instrumenti kapitale të tjera[8] luajti një rol të rëndësishëm në përcaktimin e fluksit hyrës të IHD-ve gjatë T1- 2011. Gjatë kësaj periudhe, në zërin kapitale të tjera u regjistrua një dalje kapitalesh në formën e huave midis ndërmarrjeve të lidhura prej 115.1 milionë eurosh. Zhvillimet në flukset dalëse të IHD-ve (IHD-të e rezidentëve në ekonomitë e huaja) ishin të papërfillshme gjatë periudhës nw analizw.

Flukset neto të investimeve të portofolit (hyrëse – dalëse) në T1- 2011 shënuan një vlerë prej 20.9 milionë eurosh. Sipas drejtimit të investimit, rritja e

[7] *Treguesi i shkallës së hapjes financiare llogaritet si shuma e detyrimeve dhe vlerës absolute të mjeteve financiare ndaj PBB-së nominale.*

[8] *Instrumenti kapitale të tjera të investimit direkt,mbulon huamarrjen dhe huadhënien e fondeve, duke përfshirë letrat e borxhit dhe kreditë tregtare ndërmjet investitorit direkt dhe sipërmarrjes së investimit direkt si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve të investimit direkt që ndajnë të njëjtin investitor direkt.*

investimeve të portofolit u përcaktua në pjesën më të madhe nga flukset dalëse të tyre. Kështu, në këtë tremujor, investimet e portofolit jashtë kontribuan me rreth 18.8 milionë euro në rritjen e mjeteve tona të investuara në ekonomitë e huaja. Ndër to, rreth 8 milionë euro u investuan në letra me vlerë të pasurisë (aksione) dhe rreth 10.8 milionë euro në letra me vlerë të borxhit.

Grafiku 31. Llogaria financiare dhe zërat kryesorë (flukse neto në milionë euro).



Burimi: Bilanci i Pagesave, Banka e Shqipërisë.

Llogaria e investimeve të tjera neto u mbyll me një bilanc pozitiv, duke kontribuar me rreth 134.6 milionë euro në rritjen e detyrimeve të rezidentëve ndaj botës. Kahu i flukseve financiare në këtë llogari u përcaktua nga rritja e detyrimeve ndaj botës dhe rënia e mjeteve tona të investuara jashtë. Si pasojë e rritjes, në masë pothuajse të barabartë, të depozitave të jorezidentëve në vend dhe e huamarrjes nga jashtë, detyrimet tona u rritën me rreth 64.1 milionë euro. Fluksi neto i huamarrjes në tremujorin e parë të vitit ishte rreth 36.7 milionë euro, në rënie me rreth 20.2 % në terma vjetorë. Kjo rënie erdhi si pasojë e tkurrjes me rreth 41.5 % e huamarrjes shtetërore. Huamarrja private ishte rreth 13.0 milionë euro ose rreth 10 milionë euro më e lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Depozitat e jorezidentëve në institucionet vendase u rritën me rreth 37.3 milionë euro, kundrejt rënies me rreth 9 milionë euro të regjistruar një vit më parë. Në kahun e mjeteve financiare të investuara jashtë ekonomisë shqiptare, llogaria është mbyllur me rënie prej 47.9 milionë eurosh. Rënia e mjeteve tona jashtë ka reflektuar uljen e depozitave të sistemit tonë bankar në institucionet financiare jorezidente, me rreth 86.3 milionë euro.

Gjatë T1- 2011, mjetet e rezervës shënuan rënie me rreth 77.0 milionë euro. Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës shënoi nivelin 1,787.0 milionë euro. Ky nivel vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 4.3 muajve importesh të mallrave dhe të shërbimeve.

ARTIKUJ*

** Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

TREGTIA AKTUALE DHE AJO POTENCIALE NDËRMJET SHQIPËRISË DHE PARTNERËVE TË SAJ KRYESORË:

ALBAN PLLAHA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

1. HYRJE

Fraza të tilla si: integrim rajonal, integrim ekonomik, zonë e tregtisë të lirë dhe integrim Evropian janë "fjala e ditës" që karakterizon marrëdhëniet ndërmjet vendeve të Evropës Jug Lindore (midis tyre) dhe Bashkimit Evropian (BE). Vetë BE-ja e ka zanafillën nga një inisiativë e bashkëpunimit politiko – tregtar- ekonomik, e vitit 1950, ndërmjet gjashtë themelueseve të saj (Belgjika, Franca, Gjermania, Italia, Luksemburgu dhe Holanda). Teoria tradicionale e integrimit rajonal sugjeron se marrëveshjet e tregtisë së lirë gjenerojnë kryesisht krijimin e tregtisë ndërmjet vendeve pjesëmarrëse në to. Në arenën akademike ekziston një konsensus i përgjithshëm se krijimi i zonave të tregtisë së lirë gjeneron produktivitet, rritje të mirëqenies dhe përfitime ekonomike për vendet pjesëmarrëse në to[9]. Në këtë artikull analizohen flukset tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë në rajon dhe BE, duke përdorur modelin e gravitetit. Kështu, flukset tregtare reale krahasohen me ato potenciale, duke ofruar mundësinë e analizimit të potencialeve për intensifikimin e tregtisë me vendet partnere, me të cilat flukset tregtare janë nën nivelet optimale.

2. VËSHTRIM MBI LITERATURËN

Modelet e gravitetit për tregtinë janë shndërruar në modelet më të përdorura për vlerësimin e tregtisë dypalëshe ndërmjet shteteve. Linder (1961) dhe Linnemann (1966) njihen si themeluesit/krijuesit e modeleve të gravitetit për tregtinë. Ashtu si teoria origjinale e gravitetit[10], edhe modelet e gravitetit për tregtinë shprehin flukset e tregtisë dypalëshe ndërmjet dy shteteve si funksion të dy variablave kryesorë: sipozitivisht të lidhura (në përpjesëtim të drejte/të tërhequra) me masën ekonomike (madhësinë/ përmasat e ekonomisë) të dy vendeve që tregtojnë ndërmjet tyre dhe negativisht të lidhura (në përpjesëtim të zhdrejtë) me distancën ndërmjet kryeqyteteve (kryeqëndrës ekonomike) të këtyre dy shteteve. Studime të kohëve të fundit i shtojnë modelit të gravitetit katër variabla të tjerë (Cheng and Wall 2004). Arsyetimi/supozimi i parë është : shtetet që flasin të njëjtën gjuhë janë të predispozuara të tregtojnë më shumë ndërmjet tyre sesa në rastin e kundërt. Së dyti, nëse vendet ndahen nga kufiri i përbashkët (shtete fqinje) ato tregtojnë më shumë ndërmjet tyre, kryesisht kostot e shitblerjeve midis tyre mund të reduktohen për shkak të

[9] *Pllaha, A "Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE-në. Integrimi tregtar dhe implikimet ekonomike", prezantuar në Workshop-in e IV të Kërkimeve, viti 2010*

[10] *Ligji i Isaac Newton për gravitetin. Ky ligj fizik e shpjegon forcën e gravitetit ndërmjet dy trupave si pozitivisht në proporcion direkt të masave të tyre dhe negativisht në proporcion të distancës ndërmjet këtyre trupave.*

afërsisë fizike. Së treti, nëse shtetet kanë qënë pjesë e të njëjtit territor politiko-administrativ (si për shembull ish-Çekosllovakia apo ish-Jugosllavia) ka gjasa që përgjatë historisë së tyre të përbashkët këto vende të kenë ndërtuar lidhje tregtare, të cilat stimulojnë flukse të larta tregtare ndërmjet tyre. Së fundi, modelet e gravitetit marrin parasysh gjithashtu edhe mundësinë e stimulimit të flukseve tregtare ndërmjet një shteti që bëhet pjesë e një zone të tregtisë së lirë dhe shteteve të tjera përbërëse të kësaj zone.. Kështu, Spanja, në gjysmën e dytë të viteve 80, intensifikoi tregtinë e saj me vendet e Bashkimit Evropian (Bussiere at al., 2005).

Analiza e këtij materiali bazohet në një model më të thjeshtuar të gravitetit, të propozuar nga Kaminski dhe de la Rocha (2003), dhe Frankel, Stein dhe Wei (1997)[11], për të matur flukset tregtare potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë. Ekuacioni përdor vlera standarde të koeficientëve si më poshtë:

log Tij = 0.7 log (PBBi * PBBj) + 0.3 log (PBBPFi * PBBPFj) – 0.7 log (Distancaij) (1)

ku: T_{ij} përfaqëson flukset tregtare ndërmjet shtetit i dhe shtetit j; PBB-ja përfaqëson totalin e Prodhimit të Brendshëm Bruto; PBBPF-ja përfaqëson Prodhimin e Brendshëm Bruto Për Frymë; $Distanca_{ij}$ tregon distancën ndërmjet kryeqyteteve të partnerëve tregtarë.

Me anë të ekuacionit të mësipërm ne llogarisim sesa do të ishin flukset tregtare potenciale dhe më pas këto rezultate krahasohen me vlerat aktuale të tregtisë për secilin nga vendet.

Rezultatet e marra duhet të interpretohen me kujdes, pasi flukset aktuale të raportuara mund të jenë më të vogla se ato reale, duke bërë që hendeku midis flukseve tregtare potenciale dhe atyre reale të jetë më i vogël. Kjo vjen si rezultat i cilësisë së ulët të të dhënave dhe mungesës së raportimeve prej secilit vend.

Së dyti, ekuacioni i mësipërm tenton të zmadhojë flukset tregtare potenciale, pasi si variabël shpjegues përdoret edhe distanca ndërmjet kryeqyteteve të partnerëve tregtarë. Vendet e Evropës Jug Lindore karakterizohen nga një infrastrukturë e dobët, e cila sjell rritje të kostove tregtare. Në studimin e tyre Kaminski dhe de la Rocha (2003), nënvizojnë faktin se Shqipërisë i mungon një rrjet i mirë transporti me pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit, përveç Greqisë. Për më tepër, variabli i distancës midis dy vendeve nuk merr parasysh kosto të tjera të lidhura me transportin, si për shembull: kostot e kohëvonesave të shkaktuara nga kontrollet doganore, kostot e adaptimit të dokumentacioneve me ato të shtetit ku importohen/eksportohen mallrat, etj..

[11] *Ky model graviteti i thjeshtësuar merr parasysh dy probleme kryesore që karakterizojnë rajonin e Evropës Jug Lindore; cilësinë e dobët të të dhënave dhe flukset tregtare të paraportuara ndërmjet shteteve të Ballkanit (Shih Kaminski dhe de la Rocha, 2003).*

3. TË DHËNAT DHE REZULTATET: RASTI I SHQIPËRISË

Të dhënat e përdorura për aplikimin e modelti të gravitetit për rastin e Shqipërisë janw marrë nga Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore. Kështu janë përdorur raportimet e volumeve tregtare aktuale vjetore të shprehura në terma të flukseve të importeve dhe eksporteve për periudhën 2004-2008, statistika të Bankës së Shqipërisë për Shqipërinë dhe secilin prej partnerëve tregtarë. Të dhënat mbi Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) dhe Prodhimin e Brendshëm Bruto Për Frymë (PBBPF), për secilin vend specifik janë marrë nga Banka Botërore (World Development Indicators). Vlerat vjetore të PBB-së dhe PBBPF-së, janë të shprehura fillimisht në dollarë amerikanë. Për qëllim përputhshmërie të dhënat vjetore të PBB-së dhe PBBPF-së janë shprehur në euro, duke përdorur kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë. Të dhënat e variablit të distancës janë marrë nga faqja zyrtare e Michelin[12].

Zbatimi i modelit të mësipërm na lejon gjenerimin e të dhënave për flukset tregtare potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe shtatë prej partnerëve të saj kryesorë, ndër të cilët edhe BE-ja si partneri tregtar kryesor i Shqipërisë, me tre nga vendet anëtare të tij, Gjermaninë, Greqinë dhe Italinë. Ndërkohë pjesë e rëndësishme e shkëmbimeve tregtare janë edhe vendet e rajonit, ku përmendim Bosnje – Hercegovinën, Kroacinë, Maqedoninë dhe Serbinë. Kosova, edhe pse një partner tregtar rajonal i rëndësishëm, nuk është përfshirë në projeksionet e tregtisë potenciale për faktin se të dhënat për të janë të pamjaftueshme

Grafik 1 a). Raporti i tregtisë aktuale dhe tregtisë potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë në BE. (në milionë Euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Banka Botërore dhe përllogaritjet e autorit.

Shënim: Shkalla ndërmjet grafikeve mund të jetë e ndryshme për të mundësuar lexueshmërinë në përputhje me ndryshimet në numrin e shkëmbimeve tregtare ndërmjet shteteve.

[12] *www.viamichelin.com*

Grafik 1 b) Raporti midis tregtisë aktuale dhe tregtisë potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë në BE. (në milionë Euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Banka Botërore dhe përllogaritjet e autorit.

4. REZULTATE

Ashtu siç e përmendëm më sipër, bazuar në karakteristikat dhe veçoritë që ka ky lloj modeli, duhe të themi se rezultatet e gjeneruara prej tij duhen interpretuar me kujdes. Ky fakt, më së tepërmi sugjeron se këto projeksione duhen konsideruar si tregues të mirë që rekomandojnë ndryshimet potenciale të tendencave.

Bazuar në rezultatet e marra nga ky model mund të themi se: paraqitja grafike e flukseve tregtare reale drejt atyre potenciale me Gjermaninë, (shih Grafikun 1. a) nxjerr në pah disa fakte interesante. Siç mund të vërehet në mënyrë të qartë, flukset tregtare aktuale (reale) me Gjermaninë janë shumë poshtë atyre potenciale. Shkëmbimet tregtare reale me Gjermaninë në vitin 2008 janë rreth 1/10 e atyre potenciale. Edhe pse Gjermania është eksportuesi kryesor i BE-së, flukset tregtare me të mbeten nën nivelet potenciale. Projeksionet e modelit të gravitetit sugjerojnë se Shqipëria dhe Gjermania mund të intensifikojnë volumet e flukseve tregtare me rreth 90% më shumë se ato aktuale.(Grafik-u 1. a)

Projeksionet e modelit të gravitetit për potencialet e flukseve tregtare me Greqinë ofrojnë një tjetër tablo. Kështu, flukset tregtare me Greqinë për vitin 2008 përbëjnë rreth 40% të potencialit. Duke pasur parasysh këtu problemin e sipërpërmendur, se flukset tregtare raportohen në nivele më të ulta nga ato realet, mund të arrijmë në përfundimin se flukset reale mund të jenë mjaft më të larta se 40% (nga potenciali). Afërsia fizike (si dy vende fqinjë) ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë mund të jetë njëra nga arsyet shpjeguese se pse shkëmbimet tregtare me të janë më intensive se ato me Gjermaninë. Siç u nënvizua dhe më sipër, teoria e modeleve të gravitetit sugjeron se vendet fqinje janë të predispozuara të tregtojnë më shumë ndërmjet tyre. Kostot tregtare ndërmjet shteteve fqinjë tentojnë të ulen si pasojë e afërsisë fizike, ngjashmërive kulturore dhe rrjeteve tregtare të ndërtuara përgjatë

historisë. Modeli i gravitetit prodhon disa të dhëna interesante mbi flukset tregtare potenciale me Italinë. Në dallim nga dy vendet e tjera të BE-së, të trajtuara më sipër (Gjermania dhe Greqia), flukset tregtare me Italinë janë mjaft më intensive. Për Shqipërinë, Italia përfaqëson partnerin tregtar kryesor. Kështu, gjatë 2009-s eksportet Shqiptare drejt Italisë arritën vlerën e 62.60% ndaj totalit të eksporteve Shqiptare, dhe 27.90% të totalit të importeve të vendit . Megjithatë, gjetjet e modelit të gravitetit sugjerojnë se tregtia aktuale me Italinë është nën nivelet optimale. Në 2008, flukset tregtare reale me Italinë përbënë vetëm 54% ndaj atyre potenciale. Duke marrë në konsideratë mundësinë që raportimet statistikore të të dhënave për shkëmbimet tregtare mund të jenë më të ulta se ato aktualet, mund të thuhet se flukset tregtare me Italinë janë shumë pranë potencialeve të tyre. Përveç faktorit të afërsisë fizike ndërmjet dy vendeve, duket se numri i lartë i emigrantëve Shqiptarë në Itali dhe Greqi, është faktori tjetër kryesor që shpjegon pse niveli i shkëmbimeve tregtare me këto dy vende është shumë pranë niveleve të ekuilibrit, ndryshe nga rasti i Gjermanisë. Edhe pse nivelet e flukseve aktuale tregtare me Gjermaninë, Greqinë dhe Italinë janë poshtë atyre potenciale, pritet që shkëmbimet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe këtyre tre partnerëve tregtarë të përshkallëzohen mbas implementimit të plotë të Marrëveshjes të Stabilizim Asocimit (MSA) (Marrëveshja e Stabilizim Asocimit u ratifikua në pranverë të 2009- ës).

Grafik-u 1. b) ofron paraqitjen grafike të projeksioneve të modelit të gravitetit për flukset tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe katër prej partnerëve të saj rajonalë (Bosnje – Hercegovina, Kroacia, Maqedonisë dhe Serbia)[13]. Projeksionet e modelit të gravitetit sugjerojnë se shkëmbimet tregtare me Bosnje – Hercegovinën janë thuajse inekzistente të peshuara ndaj potencialit të flukseve tregtare. Në mënyrë të ngjashme flukset tregtare me Kroacinë janë shumë më poshtë potencialeve të gjeneruara nga modeli i gravitetit. Flukset tregtare me Kroacinë në vitin 2008, përbëjnë vetëm 4% të potencialit. Modeli i gravitetit sugjeron ekzistencën e një potenciali prej rreth 90% për intensifikimin e shkëmbimeve tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Kroacisë. Edhe pse shkëmbimet tregtare me Serbinë janë rritur ndjeshëm gjatë pesë viteve të fundit, flukset tregtare aktuale me këtë vend mbeten nën potencialet e tyre. Gjatë 2007-ës flukset tregtare reale me Serbinë arritën vlerën rreth 10% ndaj peshës së potencialeve të tyre. Përsëri mund të arrijmë në përfundimin se ekziston një mundësi e pashfrytëzuar për përshkallëzimin e shkëmbimeve tregtare ndërmjet këtyre dy partnerëve tregtarë rajonalë. Duke patur parasysh se Shqipëria dhe Maqedonia janë vende fqinje, pritet që të kenë shkëmbime tregtare të konsiderueshme ndërmjet tyre. Megjithatë, vërehet se projeksionet e modelit të gravitetit në praktikë ofrojnë rezultate kontradiktore me sugjerimet e teorisë. Kështu, gjatë 2008-ës flukset tregtare aktuale me Maqedoninë përbënin vetëm 7.5% ndaj atyre potenciale. Projeksionet e modelit të gravitetit sugjerojnë se flukset e shkëmbimeve tregtare gjatë viteve paraardhës kanë qenë në raport akoma më të zhdrejtë ndaj potencialit tregtar.

[13] *Kosova dhe Mali i Zi janë dy nga partnerët tregtarë rajonalë më të rëndësishëm për Shqipërinë, megjithatë, këto dy vende nuk mundën të bëhen pjesë e projeksioneve të modelit të gravitetit për shkak të pamjaftueshmërisë të të dhënave.*

Në përmbledhje mund të theksohet se flukset tregtare me vendet e rajonit janë shumë më poshtë potencialeve të tyre. Supozohet se flukset tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të rajonit janë mjaft më të ulta se potencialet e tyre, për arsyet e radhitura më poshtë: E para, gjatë regjimit komunist Shqipëria u shndërrua në një nga vendet më të izoluara, si e tillë nuk mund të kishte një rrjet tregtie (lidhje tregtare) me vendet e rajonit. Së dyti, disa studime empirike argumentojnë se të dhënat statistikore mbi flukset tregtare në rajonin e Evropës Jug Lindore raportohen më të ulta nga flukset aktuale. Kaminski dhe de la Rocha (2003), sugjerojnë se shërbimet doganore të korruptuara dhe taksat e larta doganore të disa produkteve, favorizojnë aktivitetin e kontrabandës midis vendeve të Ballkanit. Ata sugjerojnë se flukset tregtare reale ndërmjet vendeve të rajonit janë mjaft më të larta se të dhënat statistikore të raportuara zyrtarisht. Së fundi, Shqipëria trashëgoi një infrastrukturë transporti të dobët me vendet e rajonit. Një rrjet kaq i dobët transporti përbën një pengesë shumë të madhe për intensifikimin e tregtisë midis Shqipërisë dhe vendeve të rajonit.

5. PËRMBLEDHJE

Gjetjet e modelit të gravitetit për tregtinë sugjerojnë se flukset e shkëmbimeve tregtare me Italinë dhe Greqinë janë pranë niveleve të tyre optimale. Vërehet ekzistenca e potencialit për intensifikimin e shkëmbimeve tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë me të paktën 80% më shumë se nivelet aktuale. Flukset tregtare reale ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të rajonit janë shumë më poshtë niveleve potenciale. Projeksionet e të dhënave të modelit sugjerojnë se Shqipëria mund të intensifikojë flukset tregtare me secilin nga vendet e rajonit (Bosnje – Hercegovinën, Kroacinë, Maqedoninë dhe Serbinë) me të paktën 90% më shumë se flukset ekzistuese.

LITERATURA:

1. Bussiere at al., (2005) Trade Integration of Central and Eastern European Countries: Lessons from a Gravity Model

2. Cheng, I-H. and H. J. Wall (2005). "Controlling for heterogeneity in gravity models of trade and integration. " Federal Reserve Bank of St. Louis Review, 87, 1, 49-63.

3. Frankel, J., Stein E. and Wei S., (1997), Regional Trading Blocs in the World Economy, Institute of International Economics, Washington D.C., October

4. Kaminski, B. and de la Rocha, M. (2003) 'Stabilization and Association Process in the Balkans: Integration Options and their Assessment': Washington

5. Linder, S. (1961). "An essay on trade and transformation." Uppsala: Almqvist and Wiksells.

VLERËSIMI I LUHATSHMËRISË SË REZERVAVE VALUTORE DHE SHMANGIA NGA NIVELI OPTIMAL: RASTI I SHQIPËRISË

GERTI SHIJAKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

I. HYRJE

Rezerva valutore e një vendi është bashkësia e të gjithë mjeteve likuide në monedhë të huaj që mbahen dhe administrohen nga banka qendrore ose qeveria, si garanci për të mundësuar pagesat e detyrimet që mund të lindin nga transaksionet tregtare dhe ato financiare. Ajo përfaqëson një aset publik që mund dhe duhet të përdoret për të garantuar vazhdimin e aktivitetit ekonomik dhe stabilitetin financiar të ekonomisë, në rastet e krizave. Përgjithësisht këto rezerva, të mbajtura në formën e valutave të forta ose metaleve në formë të monetarizuar apo monetare, kanë aftësinë për të gjeneruar fitime kur përdoren në tregjet e parasë dhe të kapitalit. Nga vetë përkufizimi i rezervës kuptohet se motivi i sigurisë predominon motivin e të ardhurave. Rrjedhimisht mjetet e rezervës investohen në investime të sigurta, me normë të ulët kthimi dhe për pasojë rritja e nivelit të tyre ka kosto oportune të lartë.

Gjithsesi, përkufizimi i përgjithshëm përshtatet dhe ndryshon në varësi të zgjedhjeve që ekonomitë bëjnë në raport me hapjen, veçoritë e sektorit të jashtëm, modelin ekonomik dhe regjimin e kursit të këmbimit. Në përgjithësi mund të thuhet se rezervat luajnë një rol më aktiv në vendet me kurs të fiksuar këmbimi ose në ekonomitë që përdorin kursin si një vegël që mund të ruajë avantazhet krahasuese të industrive eksportuese, ose mund të balancojë efektet negative të prurjeve të paqëndrueshme valutore, si në rastin e remitancave dhe investimeve të portofolit. Në këto raste rezerva mund të shërbejë:

- së pari, për të mbështetur politikat e tregtisë së jashtme dhe për të shmangur vështirësitë për kryerjen e pagesave ndërkombëtare të qeverisë, si pasojë e mungesës së likuiditetit në valutë të huaj;

- së dyti, për t'u vetë-siguruar kundrejt paqëndrueshmërisë së flukseve monetare të huaja, kryesisht remitancave dhe të ardhurave nga investimet e huaja direkte (IHD), si dhe për të zbutur efektet negative si pasojë e sezonalitetit, goditjeve spekulative dhe efekteve të deficitit të llogarisë korente të shkaktuar nga sektori publik dhe privat.

Përgjithësisht globalizimi ka sjellë disa prirje të reja në lidhje me ecurinë e rezervave. Fillimisht ky fenomen u shfaq në zhvendosjen e prodhimit drejt vendeve në zhvillim dhe atyre në tranzicion, duke nxitur flukse të konsiderueshme investimesh të huaja dhe rritje të flukseve tregtare ndërmjet vendeve në zhvillim dhe atyre të zhvilluara. Këto fenomene sollën rritje të suficiteve tregtare dhe rritje të konsiderueshme të rezervave valutore të vendeve në zhvillim. Stoku i

rezervave është rritur gjithashtu edhe në ekonomitë në tranzicion, të cilat kanë regjistruar deficite të larta korente, të nxitura nga flukse të larta të IHD-ve. Këto tendenca janë vërejtur edhe në ekonomitë e vogla të Evropës Juglindore, të cilat kanë akumuluar rezerva të mëdha, krahasuar me përmasat e ekonomive të tyre. Në dallim nga këto vende, Shqipëria ka akumuluar rezerva valutore me një shpejtësi më të ulët, në kushtet e një kursi këmbimi fleksibël dhe të një llogarie kapitale të liberalizuar, e shoqëruar kjo edhe me deficite korente të vazhdueshëm.

Në kushtet e rritjes së lëvizjes së lirë të kapitalit, integrimi financiar rrit ekspozimin ndaj luhatshmërisë të flukseve të kapitalit (Aizenman dhe Marion, (2002) dhe Calvo, (1998)), ndërsa rezerva mund të shërbejë për të përkrahur eksportet dhe për të kanalizuar investimet direkte vendase e të huaja në industritë eksportuese [Aizenman dhe Lee, (2005)]. Një tjetër shpjegim i mbajtjes së rezervës është ai nga Frenkel dhe Jovanovic, (1981), që e sheh mbajtjen e rezervave si garanci për balancimin e goditjeve të sektorit të jashtëm, dhe nga flukset hyrëse dhe dalëse të bilancit të pagesa. Në këtë material synohet të vlerësohet ecuria e rezervës valutore dhe e kursit nominal dhe real të këmbimit, në funksion të luhatshmërisë së pagesave dhe të ardhurave në bilancin e pagesave[14].

II. METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT

Luhatshmëria e pagesave dhe të ardhurave në bilancin e pagesave matet me devijimin standard nga tendenca, në afatin e gjatë, e ndryshimeve në stokun e rezervave, për një periudhë të dhënë kohore[15]. Disavantazhi i kësaj metode është se prodhon një vlerësim të njëanshëm më të madh (rritës) për shkak të riakumulimit të rezervave dhe më të vogël (rënës) për shkak të rënies së shpejtë të tyre përgjatë krizave financiare [Flood dhe Marion, (2002)]. Për të shmangur këtë, luhatshmëria e pagesave dhe të ardhurave në bilancin e pagesave është marrë si ndryshimi i stokut të rezervave (IR)[16] dhe si ndryshimi mesatar i normës së kursit real dhe/ose nominal efektiv të këmbimit (REER dhe NEER)[17].

Modelimi i dinamikës së luhatshmërisë së IR, REER dhe NEER u vlerësua me metodën *Autoregressive Conditional Heteroskedasticity* (ARCH) për shkak se testi diagnostikues ARCH-LM sugjeron se seritë kohore vuajnë nga efektet ARCH. Në këtë mënyrë, me qëllim vlerësimin e një variabli për matjen e volatilitetit të pagesave dhe të ardhurave në bilancin e pagesave u testuan specifikime të ndryshme ARCH, GARCH, EGARCH, TGARCH, PARCH dhe C-ARCH, duke përshtatur specifikimin e përdorur nga Ramachandran (2006) dhe Silva dhe Silva (2004), i shprehur matematikisht:

$$\Delta IR_t = \delta_0 + \sqrt{h_t} * \upsilon \qquad (1)$$

[14] Shijaku, G., (2011), "Optimal Level of rezerve holdings: an empirical investigation in the case of Albania", published in Economic Policies in SEE: Design, Performance and Challenges, Fullani, A., (2011), 4th South-Eastern European Economic Research Workshop, Bank of Albania.

[15] [shih: Prabheesha, et. al., (2009), Ramachandran, (2006), Ford dhe Huang, (1994), Landell-Mills, (1989), Frenkel dhe Jovanovic, (1981)].

[16] Shih: Silva dhe Silva, (2004).

[17] Shih: Ramachandran, (2006).

$$\Delta REER_t = \delta_0 + \sqrt{h_t} * \upsilon \quad (2)$$

$$\Delta NEER_t = \delta_0 + \sqrt{h_t} * \upsilon \quad (3)$$

Ku, δ_0 është elementi specifik i ndryshëm për vende të ndryshme dhe është funksion i kostove fikse të përshtatjes së shpenzimeve ndaj të ardhurave në bilancin e pagesave; h_t është varianca e kushtëzuar e secilit prej variablave të mësipërm dhe v_t është variabël i rastit (*random variable*). Përdorimi i alternativave të metodologjisë *ARCH* synon shpjegimin e luhatshmërisë që shfaqin këto tregues, veçanërisht përgjatë periudhës së krizës ekonomike që përfshiu Shqipërinë në fund të vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009.

Të dhënat kohore mbi (IR_t) përfaqësojnë stokun e rezervave valutore në monedhë të huaj dhe paraqiten si shumë e vlerës së arit, vlerës së transheve të monedhave në valutë të huaj dhe të drejtave të veçanta të tërheqjes (SDR). Të dhënat janë në milion euro dhe janë marrë nga Departamenti i Operacioneve Monetare, pranë Bankës së Shqipërisë. Të dhënat kohore mbi ($REER_t$) dhe ($NEER_t$) janë marrë nga Departamenti i Kërkimeve. Norma e kursit të këmbimit shprehet si njësia e monedhës vendase ndaj njësisë së monedhës së huaj. Rritja e kursit të këmbimit shpreh mbiçmim dhe një rënie tregon nënçmim e monedhës vendase (ALL). Luhatshmëria e variablave të mësipërm u vlerësua për periudhën 1996 M1–2010 M12.

III. REZULTATET EMPIRIKE DHE DISKUTIMI

Përzgjedhja e modelit më të mirë, u bazua mbi kriterin statistikor të *Akaike Info Criterion* (AIC) dhe testeve diagnostikuese *Q-statistic* dhe *ARCH LM-test*. Përkatësisht, *EGARCH(1,1)-AR(1)-in-mean* u përzgjodh si modeli më i mirë për gjetjen e volatilitetit të ndryshimit së stokut të rezervave, ndërsa *EGARCH(1,1)-in-mean* dhe *EGARCH(1,2)-AR(12)-in-mean* mbi ndryshimin e REER dhe NEER. Testet diagnostikuese mbi modelet e vlerësuara nuk paraqesin probleme në lidhje me korrelacionin serial dhe efektet ARCH mbi mbetjen e gabimit.

Rezultatet e vlerësuara (Tabela 1a) tregojnë se devijimi standard i kushtëzuar është statistikisht i rëndësishëm, duke nënkuptuar ndikimin e tij në paluhatshmërinë e rezervave të mbajtura. Termi *AR(1)* është i rëndësishëm dhe përmirëson testin statistikor *Q-square*. Koeficienti i goditjes së kushtëzuar, koeficienti c(5) është statistikisht i rëndësishëm dhe ka vlerë pozitive. Kjo nënkupton që goditja e kushtëzuar rrit luhatshmërinë e kushtëzuar të rezervave të mbajtura. Koeficienti c(6) ka shenjë negative, por ka rezultuar statistikisht i parëndësishëm dhe nënkupton që goditjet kanë efekte asimetrike në paqëndrueshmërinë e rezervave të mbajtura. Madhësia e koeficientit, ndonëse statistikisht i parëndëisishëm, konfirmon se goditjet pozitive reagojnë pozitivisht duke ulur luhatshmërinë. Kjo diktohet më tepër në përgjigje të një goditje negative. Ky rezultat (Grafiku 2) përforcohet edhe nëpërmjet kurbës së ndikimit të lajmit (KNL)[18]. Madhësia dhe rëndësia e koeficienti c(7) sugjeron se shkalla e ndikimit të goditjeve është e lartë. Kjo tendencë vërehet përgjatë të gjithë

[18] *Angl: News Impact Curve (NIC)*

formave të specifikimit të përqasjes ARCH që konfirmon se ndikimi i goditjeve në rezervat e mbajtura janë të vazhdueshme dhe me efekt afatgjatë (Grafiku 1).

Grafiku 1. Luhatshmëria e rezerva valutore të mbajtura bazuar në modelin EGARCH(1,1)-AR(1)-in-mean



Burimi: Përllogaritjet e autorit.

Rezultatet e vlerësuara (Grafiku 2) tregojnë gjithashtu se luhatshmëria në ndryshimet e rezervave është më e lartë në periudhën 2008 M01-2010 M02 dhe në fund të vitit 2010. Kjo ecuri ka ardhur si rezultat i disa arsyeve. Së pari, gjatë periudhës 2008 M01-2010 M02, shkalla e lartë e luhatshmërisë pasqyron krizën ekonomike, në të cilën Shqipëria u përfshi për shkak të krizës globale financiare. Nga kjo pikëpamje, luhatshmëria diktohet nga rënia e kërkesës së brendshme përgjatë kësaj periudhe dhe administrimit të rezervave për të siguruar mbulimin e një numri të caktuar të importeve. Së dyti, niveli i rezervave dhe për pasojë luhatshmëria e tyre, u diktua nga stabilizimi i çmimit të monedhës vendase 'ALL' në afatin e shkurtër, dhe vendimet për pagesat e borxhit publik. Ndërsa rritja e luhatshmërisë në fund të periudhës 2010 lidhet me disbursimin e huamarrjes së jatshme nga Ministria e Financave.

Rezultatet në tabelat 2b dhe 2c dëshmojnë se devijimi standard i kushtëzuar është i rëndësishëm statistikisht në rastin e REER-it. Koeficienti i goditjes së kushtëzuar c(5) është statistikisht i rëndësishëm dhe për REER (NEER) ka shenjë negative (pozitive). Kjo nënkupton se goditja e kushtëzuar e zvogëlon (rrit) luhatshëmrinë e kushtëzuar mbi REER (NEER). Koeficienti c(5) (Tabela 4b) ka shenjë pozitive, ndërsa koeficienti c(7) (Tabela 4c) ka shenjë negative. Kjo sugjeron se goditjet kanë efekte asimetrike mbi luhatshmërinë e NEER dhe jo mbi REER, ndonëse të parëndësishëm statistikisht. Pra, madhësia dhe shenja e koeficientit diktojnë se luhatshmëria e REER (NEER) rritet më tepër si pasojë e goditjeve pozitive (negative). Modelet paraqesin se shkalla e ndikimit të goditjeve është e lartë dhe e vazhdueshme, ndonëse e pa rëndësishme në rastin e NEER. Më tej, rezultatet e vlerësuar (Grafiku 2) tregojnë se luhatshmëria në ndryshimet e NEER-it është më e lartë gjatë periudhës 1997-1998, duke u normalizuar në vijimësi. Ndërkohë, luhatshmëria në ndryshimet e REER është më e lartë gjatë periudhës 1997-1998 dhe pëson rritje që nga viti 2001, duke i reflektuar më tepër ndryshimet në çmimet relative.

Grafiku 2. Luhatshmëria e REER-it dhe NEER-it, bazuar në modelin EGARCH-in-mean



Burimi: Përllogaritjet e autorit.

IV. KONTRUBUTI I VARIABLAVE TË TJERË

Vlerësimi empirik në lidhje me nivelin optimal të rezervave të mbajtur [Shijaku, (2011)], evidentoi që niveli aktual i rezervave të mbajtura është më i lartë krahasuar me nivelin optimal të vlerësuar [Grafiku 4]. Ky mbivlerësim shpjegohet me strategjinë e përqasjes monetare ndaj Bilancit të Pagesave të ndjekur nga Banka e Shqipërisë për t'u vetë-siguruar ndaj luhatjeve të flukseve të kapitaleve hyrëse. Megjithatë, në studimet empirike niveli optimal i rezervave të mbajtura paraqitet si funksion i qëndrueshëm i disa treguesve makroekonomik, ndër të cilët bën pjesë luhatshmëria e rezervave si pasojë e flukseve të kapitalit, kostos oportune dhe importeve të mallrave dhe shërbimeve.

Prandaj, analizimi më i hollësishëm i shmangies në rritje midis nivelit aktual dhe atij optimal u vlerësua duke analizuar kontributin e peshuar të ndikimit specifik të treguesve makroekonomik të përfshirë nga Shijaku, (2011) në vlerësimin e nivelit optimal. Peshat e kontributit të secilit tregues u bazuan në koeficientët afatgjatë të vlerësuar19. Rezultatet tregojnë se diferenca në rritje midis nivelit aktual dhe atij optimal është shkaktuar kryesisht nga rënia e kostos oportune të mbajtjes së rezervave valutore, duke ndikuar në rritjen e nivelit të akumuluar nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu ndikimi i luhatshmërisë së rezervave, ndonëse relativisht i vogël, ka qenë më i lartë dhe i ndryshueshëm kryesisht përgjatë periudhës së krizës financiare dhe ekonomike. Ndërsa, kontributi i zhvillimeve dinamike në rezervat e mbajtura dhe importet e mallrave dhe shërbimeve kanë qenë kostante përgjatë periudhës kohore të vlerësuar. Kjo dëshmon se ndikimi i tyre, megjithëse i madh krahasuar me treguesit e tjerë, ka qenë në tërësi i pandryshuar.

[19] *Analiza u bazua në koeficientët afatgjatë të vlerësuar [shih: Shijaku, (2011), Tabela 7, f: 169] dhe në dinamikën kohore të secilit tregues.*

Grafiku 3. Rezerva valutore e mbajtur dhe vartiablat shpjegues



Burimi: Përllogaritjet e autorit.

Grafiku 4. Kontributi i variablave shpjegues në diferencën e rezervave aktual ndaj niveli optimal të vlerësuar



Burimi: Përllogaritjet e autorit.

V. PËRFUNDIME

Qëllimi i kësaj analize ishte vlerësimi i luhatshmërisë së ndryshimit të rezervave valutore të mbajtura dhe kursit nominal dhe real të këmbimit gjatë periudhës 1996-2010. Rezultatet e vlerësuara sugjerojnë se kriza ekonomike financiare ka patur një ndikim më të dukshëm në dinamikën e rezervave valutore, e ndikuar kjo nga strategjia e administrimit të rezervave nga Banka e Shqipërisë dhe luhatshmëria e kërkesës së brendshme. Përgjithësisht, ecuria e kursit të këmbimit ka qenë e qëndrueshme, ndonëse luhatshmëria në rritje e kursit real pasqyron prirjen në rritje të çmimeve relative. Analiza e kontributit të peshuar të secilit prej treguesve makroekonomik sugjeron se diferenca në rritje midis nivelit aktual dhe atij optimal është shkaktuar kryesisht nga rënia e kostos oportune e mbajtjes së rezervave valutore dhe rritja e luhatshmërisë së nivelit të akumuluara, si pasojë e krizës financiare dhe ekonomike.

LITERATURA:

1. Aizenman, J., and Lee, J., (2005), "International Reserves: Precautionary vs. Mercantilist Views, Theory and Evidence", IMF Working Paper, WP/05/198;

2. Aizenman, J., and Nancy, M., (2004), "International Reserve Holdings with Sovereign Risk and Costly Tax Collection The Economic Journal", Blackwell Publishing, Vol. 114, No. 497 (Jul., 2004), pp. 569-591;

3. Aizenman, J., and Nancy, M., (2003), "The High Demand for International Reserves in the Far East: what is Going on?", Journal of the Japanese and International Economies 17(3), pp: 370-400;

4. Aizenman, and Sun, J., (2009), "The Financial Crisis and Sizable International Reserves Depletion: From 'Fear of Floating' to the 'Fear of Losing International Reserves'?", NBER Paper, working Paper 15308, Cambridge;

5. Brookes, C., et. al., (2003), "Multivariete Garch Models: Software Choice and Estimation Issues", ISMA Centre Discussion Papers in Finance 2003–07;

6. Calvo, G. A., (1998), "Capital Flows and Capital – Market Crisis: The Simple Economics of Sudden Stops", Journal of Applied Economics, Vol : 1 no. 1, pp: 35-54;

7. Enders, W., (2010), "Modelling Volatility", in Applied Econometric Time Series, Wiley, USA, 3rd Edition, Chapter 3, pp: 121-176;

8. Frenkel, J., and Jovanovic, B., (1981), "Optimal International Reserves: A Stochastic Framework", Economic Journal, Vol: 91 (June), pp: 507-514;

9. Flood, R., and Nancy, M., (2002), "Holding International Reserves In an Era of high Capital Mobility", IMF Working Paper, WP/02/62;

10. Ford, J. L., dhe Huang, G., (1994), "Demand for internacional reserves in China", Economica, Vol. 67, pp: 379-97

11. Shijaku, G., (2011), "Optimal Level of rezerve holdings: an empirical investigation in the case of Albania", published in Economic Policies in SEE: Design Performance and Challenges, Fullani, A., (2011), 4th South-Eastern European Economic Research Workshop, Bank of Albania

12. Heynen, R. C., and Kat, H. M., (1994), "Volatility prediction: a comparison of stochastic volatility, GARCH(1,1) and EGARCH(1,1) models", Journal of Derivates, Vol. 2, No. 2, pp: 50-65;

13. Landell-Mills, J. M., (1989), "The Demand for International Reserves and Their Opportunity Cost", Staff Papers-International Monetary Fund, Vol. 36, No. 3, Sep 1989), pp: 708-732;

14. Prabheesha, K. P., et. al., (2009). "Precautionary and mercantilist approaches to demand for international reserves: an empirical investigation in the Indian context", Macroeconomics and Finance in Emerging Market Economies, Vol. 2, No. 2, September 2009, pp: 279-291;

15. Ramachandran, M. (2006), "On the upsurge of foreign exchange reserves in India", Journal of Policy Modeling, Vol. 28, pp: 797-809;

16. Rummel, O., (2010), "Modelling pound sterling Exchange rate volatility", Centre for Central Banking Studies, Bank of England, 8 December 2010

17. Silva, A. F. J., and Silva, da, E. D., (2004), "Optimal International reserves holdings in emerging markets economies: The Brazilian case", Banco Central do Brazil;

18. Vika, I., (2008), "Assessing Motives Behind the Bank of Albania's Purchase Interventions in the Foreign Exchange Market", Research Department, Bank of Albania, November 2008;

SHTOJCË

Tabela 1. Kriteret informues të modeleve të vlerësuar (me shpërndarje normale)

Model	AIC	SIC	HQ	Serial Corelation Effects	Negative Coeffience in the Variance Equation	ARCH Effects
ARCH (11)	9.275463	9.346690	9.304345	No	No	[0.5625]
GARCH (11)	8.860027	8.949061	8.896130	Yes	No	[0.0112]
GARCH (11) - AR(1)	8.944731	9.054564	9.054564	No	No	[0.7190]
TGARCH (11)	8.869650	8.976490	8.912973	Yes	Yes	[0.0203]
TGARCH (11) - AR(1)	8.935122	9.060248	8.985864	No	No	[0.4375]
EGARCH (11)	9.092575	9.199414	9.135897	No	No	[0.6058]
EGARCH (11) - AR(1)	8.987551	9.112877	9.038495	No	Yes	[0.9179]

Tabela 2a: EGARCH (11) – AR(1)-in-mean model for dIR (me shpërndarje normale)

Dependent Variable: *dIR*				
Method: ML - ARCH (Marquardt) - Normal distribucion				
Sample (adjusted): 1996M03 2010M12				
Included observations: 178 after adjustments				
Convergence achieved after 112 iterations				
Presample variance: backcast (parameter = 0.7)				
LOG(GARCH) = C(4) + C(5)*ABS(RESID(-1)/@SQRT(GARCH(-1))) + C(6) *RESID(-1)/@SQRT(GARCH(-1)) + C(7)*LOG(GARCH(-1))				
	Coefficient	Std. Error	z-Statistic	Prob.
@SQRT(GARCH)	0.179143	0.087136	2.055907	0.0398
C	7.751772	1.630941	4.752943	0.0000
AR(1)	0.452236	0.057105	7.919381	0.0000
Variance Equation				
C(4)	-0.101686	0.411550	-0.247082	0.8048
C(5)	1.554286	0.435741	3.566996	0.0004
C(6)	-0.312856	0.209856	-1.490815	0.1360
C(7)	0.849841	0.090535	9.386923	0.0000
R-squared	-0.469417	Mean dependent var		9.599526
Adjusted R-squared	-0.520976	S.D. dependent var		31.72249
S.E. of regression	39.12266	Akaike info criterion		8.987751
Sum squared resid	261729.6	Schwarz criterion		9.112877
Log likelihood	-792.9098	Hannan-Quinn criter.		9.038493
Durbin-Watson stat	2.370426			
Inverted AR Roots .45				

Tabela 2b. EGARCH (11)-in-mean model for dlog(REER) (me shpërndarje normale)

Dependent Variable: DLOG(REER)				
Method: ML - ARCH				
Sample (adjusted): 1996M02 2010M12				
Included observations: 179 after adjustments				
Convergence achieved after 22 iterations				
Presample variance: backcast (parameter = 0.7)				
LOG(GARCH) = C(3) + C(4)*ABS(RESID(-1)/@SQRT(GARCH(-1))) + C(5) *RESID(-1)/@SQRT(GARCH(-1)) + C(6)*LOG(GARCH(-1))				
	Coefficient	Std. Error	z-Statistic	Prob.
@SQRT(GARCH)	-0.743097	0.090018	-8.254986	0.0000
C	0.011058	0.001447	7.641938	0.0000
	Variance Equation			
C(3)	-0.095318	8.44E-05	-1129.304	0.0000
C(4)	-0.029071	2.64E-09	-11014674	0.0000
C(5)	0.083754	0.021803	3.841314	0.0001
C(6)	0.987315	1.03E-07	9627658.	0.0000
R-squared	0.008603	Mean dependent var		-0.001798
Adjusted R-squared	-0.020050	S.D. dependent var		0.022531
S.E. of regression	0.022756	Akaike info criterion		-5.171984
Sum squared resid	0.089586	Schwarz criterion		-5.065144
Log likelihood	468.8925	Hannan-Quinn criter.		-5.128661
F-statistic	0.300237	Durbin-Watson stat		1.240005
Prob(F-statistic)	0.912189			

Tabela 2c: EGARCH (1,2)-AR(12)-in-mean model for dlog(NEER) (me shpërndarje normale)

Dependent Variable: DLOG(NEER)				
Method: ML - ARCH				
Sample (adjusted): 1997M02 2010M12				
Included observations: 167 after adjustments				
Convergence achieved after 24 iterations				
Presample variance: backcast (parameter = 0.7)				
LOG(GARCH) = C(5) + C(6)*ABS(RESID(-1)/@SQRT(GARCH(-1))) + C(7) *RESID(-1)/@SQRT(GARCH(-1)) + C(8)*LOG(GARCH(-1)) + C(9)*LOG(GARCH(-2))				
	Coefficient	Std. Error	z-Statistic	Prob.
@SQRT(GARCH)	-0.258491	0.249465	-1.036183	0.3001
C	0.000675	0.001777	0.379808	0.7041
AR(1)	0.236256	0.069688	3.390192	0.0007
AR(12)	0.183470	0.062415	2.939497	0.0033
	Variance Equation			
C(5)	-0.737533	0.376449	-1.959183	0.0501
C(6)	0.318137	0.154865	2.054278	0.0399
C(7)	-0.094910	0.090280	-1.051290	0.2931
C(8)	0.569088	0.637559	0.892603	0.3721
C(9)	0.380631	0.615127	0.618784	0.5361
R-squared	0.157560	Mean dependent var		-0.000822
Adjusted R-squared	0.114905	S.D. dependent var		0.022439
S.E. of regression	0.021110	Akaike info criterion		-5.813511
Sum squared resid	0.070412	Schwarz criterion		-5.645475
Log likelihood	494.4282	Hannan-Quinn criter.		-5.745309
F-statistic	3.693799	Durbin-Watson stat		1.374214
Prob(F-statistic)	0.000558			
Inverted AR Roots	.89	.77+.43i	.77-.43i	.45-.75i
	.45+.75i	.02+.87i	.02-.87i	-.42-.75i
	-.42+.75i	-.73+.43i	-.73-.43i	-.85

ECURIA E REMITANCAVE NË SHQIPËRI PËR PERIUDHËN 1996-2010 DHE FAKTORËT PËRCAKTUES TË TYRE

ESIDA ABAZAJ, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE[20]

1. HYRJE

Dërgesat nga të çatdhesuarit (remitancat) përbëjnë një burim të rëndësishëm të financimit të huaj në Shqipëri, të cilat gjatë 15 viteve të fundit vlerësohen të përbëjnë rreth 12.5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe 14.43% të konsumit. Këto transferta janë një komponent thelbësor i Bilancit të Pagesave të Bankës së Shqipërisë, duke përbërë rreth 80% të transfertave korrente. Gjithashtu, ndryshe nga burimet e tjera të financimit të huaj (eksportet apo investimet e huaja direkte), remitancat kanë një "profil privat", çka do të thotë që nuk kanë gjasa të përfundojnë në duart e zyrtarëve \të qeverisë.

Gjatë tre viteve të fundit, dërgesat e emigrantëve shqiptarë tërhoqën vëmendjen e politikëbërësve, medias dhe organizatave ndërkombëtare në Shqipëri. Kjo vëmendje buroi nga ngadalësimi i tyre progresiv dhe i konsiderueshëm këto tre vitet e fundit, nga rëndësia e tyre për ekonominë shqiptare si dhe nga përfitimet e mëdha që sjellin për familjet e emigrantëve. Për këtë arsye lind nevoja që të studiohen dhe të analizohen empirikisht përcaktuesit apo forcat lëvizëse të sjelljes së remitancave, dhe këto forca, nëse është e mundur, të përdoren për të tërhequr më shumë flukse remitancash.

Grafik 1. Shpërndarja e emigrantëve Shqiptarë



Burimi: DEVINPRO Consortium Members Fact Sheet

2. FAKTE TË STILIZUARA – RËNDËSIA E REMITANCAVE NË EKONOMINË SHQIPTARE

Pavarësisht numrit të vogël të popullsisë, emigracioni shqiptar, siç e quan dhe Russel King, është "një lloj laboratori që mundëson studimin e proceseve dhe fenomeneve të reja të migrimit" për shkak të valëve dinamike, kaotike dhe ilegale që e kanë karakterizuar atë gjatë të gjitha fazave të tranzicionit, ndonëse në shkallë të ndryshme intensiteti. Duke iu referuar të dhënave zyrtare më të fundit, është vlerësuar se rreth 1.2 milionë shqiptarë jetonin në emigracion në 2008, duke përbërë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë shqiptare (rreth 25%). Prej tyre, 85% jetojnë dhe punojnë në Greqi dhe Itali, ndërsa pjesa tjetër në vendet e Evropës Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

[20] *Për më tepër informacion, referojuni: "Përcaktuesit Makroekonomikë të Remitancave: rasti i Shqipërisë", prezantuar në Workshopin e katërt: "Kërkimet Ekonomike në Evropën Juglindore".*

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës së Shqipërisë, dërgesat e emigrantëve në Shqipëri janë rritur me një normë mesatare vjetore prej 5.6% gjatë 15 viteve të fundit. Kjo normë ishte shumë më e lartë deri në vitin 2007 (rreth 10.37%) por ra ndjeshëm në tre vitet e fundit, duke regjistruar një rënie prej 15.21%, 6.56% dhe 13.06% përkatësisht në vitet 2008, 2009 dhe 2010. (Grafik 2). Gëdeshi (2010) përmend dy faktorë kryesorë si përgjegjës për rënien progresive të remitancave. Së pari, kriza ekonomike globale e kohëve të fundit preku ndjeshëm vendet si Italia dhe Greqia. Kriza në këto vende ndikoi negativisht në mundësitë e punësimit dhe në nivelin e të ardhurave të emigrantëve shqiptarë, të cilat çuan në aftësi të kufizuara për të kursyer dhe për të dërguar remitanca në vendin e origjinës. Së dyti, ashtu siç është pranuar në shumë studime, remitancat kanë një trend afatgjatë në rënie (Docquier, Rapoport 2005; IOM, 2005). Me kalimin e kohës, emigrantët rregullojnë statusin e tyre, krijojnë familje në vendin mikpritës ose bashkohen me pjesën tjetër të familjes, çka dobësون lidhjet familjare me vendin e origjinës.

Megjithatë ka shumë polemika dhe debate mbi arsyet përse ndodhi reduktimi progresiv i remitancave në tre vitet e fundit. Nga njëra anë mbështetet ideja se ky reduktim ndodhi për shkak të krizës globale ekonomike që preku vendet ku jetojnë dhe punojnë emigrantët dhe nga ana tjetër se ai ndodhi për shkak të lidhjeve familjare që dobësohen me kohën, ndërmjet emigrantëve në vendin mikpritës dhe familjeve të tyre në vendin e origjinës.

Rezultatet e vrojtimit pranë familjeve për të ardhurat nga emigrantët, realizuar në vitin 2008 nga Banka e Shqipërisë, tregojnë se 94% e dërguesve janë fëmijët e familjeve (djali ose vajza), të cilët përbëjnë rreth 80% dhe 15% të emigrantëve total. Këta dërgues mendohet të dërgojnë rreth 81% dhe 5% të remitancave totale, duke mbështetur kështu qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e lidhjeve familjare në afatin e mesëm dhe rrjedhimisht të flukseve të remitancave.

Sipas statistikave zyrtare, remitancat janë flukse të rëndësishme, duke patur parasysh madhësinë e ekonomisë shqiptare (Grafikë 3). Ndërmjet 8 vendeve të rajonit, Shqipëria renditet e treta përsa i përket raportit të remitancave ndaj PBB-së, duke qëndruar pas Bosnje-Hercegovinës (14.90%) dhe Republikës së Kosovës (13.41%). Megjithatë, magnituda e flukseve të remitancave është ende e diskutueshme për shkak të metodologjisë që zbatohet në matjen e tyre.

Prej vitit 1996, transfertat e emigrantëve në Shqipëri përbëjnë një burim të rëndësishëm të financimit të huaj, vlerësuar rreth 12.51% e PBB-së, krahasuar me 21.08% të PBB-së në eksporte dhe 4.35% të PBB-së në investimet e huaja direkte (IHD). Megjithatë në dy vitet e fundit, IHD-të duket sikur konvergjojnë drejt raportit të remitancave ndaj PBB-së, duke kompensuar kështu reduktimin në remitanca, në terma makroekonomikë (Grafikë 3).

Grafik 2. Remitancat në Shqipëri në terma nominalë 1993 - 2010 (milionë EUR)



Burimi: Bilanci i Pagesave, Banka e Shqipërisë

Një fakt tjetër i stilizuar, mjaft i rëndësishëm në diskutimin e flukseve të jashtme, është luhatshmëria e këtyre flukseve, matur si raporti i devijimit standard ndaj mesatares. Duke gjykuar mbi këtë matje, remitancat janë më pak të luhatshme se eksportet e mallrave dhe të shërbimeve, dhe IHD-të, duke i bërë kështu remitancat një burim tërheqës të financimit të huaj. Devijimi standard i flukseve të remitancave është rreth 33.69% e mesatares, krahasuar me 68.16% të eksporteve dhe 91.23% të IHD-ve (Grafikë 3).

Ciklikaliteti i remitancave me aktivitetin ekonomik të vendit të origjinës është një temë e prekur gjerësisht në literaturë, e cila ofron gjetje të përziera dhe kontradiktore. Chami et al.(2003), duke përdorur metoda panel të vlerësimit për 114 vende në një periudhë 30 vjeçare, arriti në përfundimin se remitancat janë kundërciklike, duke mbështetur hipotezën që dërgimi i tyre motivohet nga altruizmi. Ndërsa një studim i kryer nga FMN në vitin 2005 gjeti një lidhje statistikisht jo të rëndësishme ndërmjet remitancave dhe rritjes reale ekonomike për frymë të vendit të origjinës, pavarësisht nga zhvillimi financiar.

Për të studiuar karakteristikat ciklike të flukseve të remitancave, në këtë studim është ndjekur teknika e filtrit Hodrick-Prescott që e shpërbën serinë kohore të prodhimit dhe të remitancave në komponentët e tyre ciklikë, dhe në trendin stokastik (Giuliano and Ruiz Arranz, 2005). Nëse remitancat dërgohen për arsye altruiste, korrelacioni ndërmjet komponentit ciklik të remitancave dhe prodhimit është statistikisht i rëndësishëm, dhe me shenjë negative. Në rast se dërgimi i remitancave motivohet nga fitimi, pra ato janë dërguar për qëllime investimi, koeficenti i korrelacionit duhet të jetë statistikisht i rëndësishëm dhe me shenjë pozitive. Së fundmi, remitancat konsiderohen a-ciklike nëse koeficienti i korrelacionit nuk është i rëndësishëm statistikisht, pavarësisht shenjës (Giuliano and Ruiz-Arranz, 2005). Grafiku 2 tregon korrelacionet e komponentëve ciklikë të remitancave, eksporteve të mallrave dhe të shërbimeve, dhe të IHD-ve, me komponentët ciklikë të PBB-së së Shqipërisë. Remitancat tregojnë një korrelacion pozitiv prej 0.49 me PBB-në e Shqipërisë, që është mjaft më i vogël se ai i eksporteve. Shenja pozitive e korrelacionit duket sikur është në kundërshtim me gjetjet e vrojtimit të Bankës

Grafik 3. Fakte të stilizuara rreth remitancave në Shqipëri

a) Burimet e financimit të huaj në Shqipëri 1996 - 2010 (% of GDP)



Burimi: Banka e Shqipërisë, FMN dhe Instituti i Statistikës në Shqipëri

Grafik 3. Fakte të stilizuara rreth remitancave në Shqipëri

b) Pamje krahasimore: Remitancat në vendet e rajonit



Burimi: Banka e Shqipërisë, FMN dhe Instituti i Statistikës në Shqipëri.

Grafik 3. Fakte të stilizuara rreth remitancave në Shqipëri

c) Ciklikaliteti i flukseve 1996-2010



Burimi: Banka e Shqipërisë, FMN dhe Instituti i Statistikës në Shqipëri.

Grafik 3. Fakte të stilizuara rreth remitancave në Shqipëri

d) Luhatshmëria e flukseve të financimit të huaj (1996 - 2010).



Burimi: Banka e Shqipërisë, FMN dhe Instituti i Statistikës në Shqipëri

së Shqipërisë, realizuar pranë familjeve për të ardhurat nga emigrantët, studimet e Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar, institucioneve të tjera, të cilat konvergjonë në rezultatet që: "emigrantët shqiptarë dërgojnë remitanca për të përmbushur nevojat ditore të konsumit dhe për këtë arsye përfaqësojnë një burim të kufizuar të kapitalit për investim dhe për financimin e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm në vendin e origjinës" (Buletini Ekonomik, Banka e Shqipërisë, Nr.3). Sipas këtyre studimeve, priet që remitancat të tregojnë një korrelacion negativ me prodhimin (Grafikë 3). Megjithatë, vlen të përmendet se koefiçentët e korrelacionit paraqitur në grafik duhet të interpretohen me kujdes, pasi nuk janë kontrolluar për rëndësinë e tyre statistikore.

3. TË DHËNAT DHE METODOLOGJIA

Duke ndjekur literaturën mbi përcaktuesit makroekonomikë të remitancave, në këtë studim i kemi klasifikuar variablat që potencialisht mund të ndikojnë sjelljen e remitancave në tre grupe kryesore: variabla që përfaqësojnë situatën makroekonomike të vendit mikpritës; variablat që përfaqësojnë situatën makroekonomike të vendit të origjinës; dhe variablat që kapin lidhjet mes vendit mikpritës dhe vendit të origjinës. Kërkrsa parësore kërkimore që shtrohet është: përcaktimi i kushteve makroekonomike (të vendit mikpritës/ të vendit të origjinës/ të të dyve/apo të asnjërit prej vendeve) që merren parasysh nga emigranti shqiptar kur vendos se sa remitanca do të dërgojë. Në përpjekjet për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, studimi gjen disa shpjegime dhe interpretime mbi dy çështje të tjera. Njëra lidhet me pyetjen: "Pse emigrantët shqiptarë dërgojnë remitanca?". Çështja tjetër lidhet me pyetjet: "A mundet Shqipëria të tërheqë më shumë remitanca? Si?"

Për të përfaqësuar kushtet makroekonomike të vendit origjinë përdorim Prodhimin e Brendshëm Bruto të Shqipërisë, marrë nga Instituti i Statistikave në Shqipëri. Aktiviteti ekonomik i vendit të origjinës përdoret në shumë studime, si përafrues për pasqyrimin e mundësive të punësimit dhe të gjenerimit të të ardhurave të familjeve të emigrantëve (Sayan and Tekin-Koru, 2007; El-Sakka, 2005; and Eric Lueth and Marta-Ruiz Arranz, 2007). Megjithatë, efekti i PBB-

së në remitanca varet nga shtysa e dërgimit të remitancave që mbizotëron tek emigrantët shqiptarë. Në qoftë se altruizmi është shtysa kryesore, goditjet negative në prodhimin e vendit të origjinës do t'i nxisin emigrantët të dërgonin më shumë remitanca. Por, nëse remitancat dërgohen për qëllime investimi, atëhere goditjet negative në prodhimin e vendit origjinë do të pasqyrojnë mundësi investimi të përkeqësuara dhe rrjedhimisht do të çojnë në reduktimin e remitancave.

Për të përfaqësuar vendin mikpritës përdorim normën e peshuar të papunësisë së Greqisë dhe Italisë, duke patur parasysh se 85% e emigrantëve shqiptarë janë të vendosur në këto dy vende. Për të ndërtuar këtë indeks, peshat që i japin normës së papunësisë të këtyre dy vendeve bazohen në pjesën e remitancave që vijnë nga secili vend. Studime të mëparshme tregojnë se prodhimi i vendit mikpritës është një përcaktues i rëndësishëm i dërgesave të emigrantëve sepse përkthehet në kërkesë pune më të madhe, paga më të larta, të ardhura më të larta dhe rrjedhimisht në dërgesa më të larta. Në këtë studim, zgjedhim të përfaqësojmë kushtet makroekonomike të vendit mikpritës me normën e papunësisë dhe jo me Prodhimin e Brendshëm Bruto, sepse e para konsiderohet si një përafrues më i mirë i mundësive të gjenerimit të të ardhurave për emigrantët, për shkak të marxhinalizimit të tyre social (Higgins et al., 2004). Të dhënat mbi normat e papunësisë të Italisë dhe Greqisë janë marrë nga statistikat e Bankës Qendrore Evropiane.

Për të përfaqësuar lidhjen mes vendit mikpritës dhe vendit të origjinës, përdorim kursin nominal të këmbimit LEK/EUR, marrë nga Banka e Shqipërisë. Studime të mëparshme tregojnë se efekti i kursit të këmbimit mbi prodhimin është i dyshimtë.

Të dhënat e përdorura në vlerësimin ekonometrik përfshijnë periudhën nga viti 1996 deri në 2010, me frekuencë tremujore. Pra, numri i observimeve është 60.

Të dhënat mbi remitancat janë marrë nga Bilanci i Pagesave të Bankës së Shqipërisë dhe përfshijnë transfertat monetare të emigrantëve që janë punësuar në vendin mikpritës, dhe që konsiderohen rezidentë në ekonominë e këtij vendi[21]. Të dhënat zyrtare mbi remitancat përfshijnë transfertat e dërguara nëpërmjet kanaleve formale (bankat tregtare ose agjensitë e transferimit të parasë) dhe kanaleve informale (para në dorë në pikat kufitare). Të parat maten automatikisht, ndërsa të dytat janë të vlerësuara si diferencë e flukseve hyrëse të valutës (eksportet e mallrave në cash, shërbimet e udhëtimit, blerja e lekut nga publiku) dhe flukseve dalëse të valutës (importet në cash, shërbimet e udhëtimit, blerja e valutës nga publiku). Prandaj, në këtë studim është marrë parasysh se metodologjia e matjes së remitancave bashkë me ecurinë e tyre dinamike dhe gjendjen kaotike të emigracionit shqiptar mund të paraqesin kufizime që duhen patur parasysh, pasi mund të ndikojnë në gjetjet e tij empirike.

Ky studim përdor Mekanizmin e Vektorit të Korrigjimit të Gabimit, për të studiuar dinamikën afatgjatë dhe afatshkurtër të remitancave. Përdorimi i këtij

[21] *Sipas përkufizimit të dhënë nga manuali i Bilancit të Pagesave, individët që punojnë dhe qërndrojnë në një ekonomi të re për më pak se një vit konsiderohen jo-rezidentë, dhe çdo transaksion/transfertë e tyre përfshihet në kategorinë: Të ardhurat nga puna e punëtorëve sezonalë.*

modeli zgjidh problemin e endogjenitetit midis remitancave dhe variablave të tjerë makroekonomikë. Disa studime kanë gjetur se remitancat ndikojnë variablat e tjerë makroekonomikë, si investimet apo konsumin në vendin e origjinës (Acosta et al. 2007). Në rastin e Shqipërisë, nuk ka asnjë studim empirik që tregon se si remitancat ndikojnë varibalat makroekonomikë në vend, përveç fakteve të stilizuara dhe vrojtimeve të ndryshme. Kështu, vrojtimi i Bankës së Shqipërisë pranë familjeve të emigrantëve shqiptarë në vitin 2008 tregon se rreth 30% e të ardhurave mujore të familjeve që përfitojnë nga këto transferta, mbulohet nga remitancat. Gjithashtu, vrojtimi tregon se kur remitancat i bashkohen shportës së konsumit familjar, mund të përdoren për nevoja familjare produktive ose joproduktive; mund të rrisin varësinë e familjarëve në këto të ardhura, duke rritur kështu normën e papunësisë; ose mund të përdoren për të rritur investimin në aktivitete të ndryshme të biznesit apo në pasuri të paluajtshme.

4. GJETJET KRYESORE

Ky studim gjen se remitancat, ashtu si në afatin e gjatë dhe të shkurtër, varen vetëm nga kushtet makroekonomike të vendit mikpritës, që përfaqësohet nga norma e peshuar e papunësisë së Greqisë dhe Italisë. Një rritje në normën e papunësisë me 1 pikë përqindje i redukton transfertat e emigrantëve me 0.13% në afatin e gjatë. Dy variablat e tjerë shpjegues të përdorur në këtë studim, rezultojnë të parëndësishëm statistikisht, si në afatin e gjatë ashtu dhe në atë të shkurtër, duke hedhur poshtë hipotezën tradicionale se remitancat dërgohen kryesisht për të plotësuar nevojat e konsumit të familjeve të emigrantëve në vendin e origjinës.

E vetmja gjetje që mbështet hipotezën e altruizmit është axhustimi i shpejtë i remitancave në ekuilibrin e tyre afatgjatë, siç tregohet nga rëndësia statistikore dhe magnituda e lartë e termit të korrigjimit të gabimit.

Gjithashtu studimi nuk gjen asnjë evidencë që të mbështesë hipotezën se arsyeja e investimit në vendin e origjinës ndikon në vendimin e emigrantit shqiptar për sasinë e remitancave që dërgon në vendin e origjinës.

Bazuar mbi këto gjetje lindin dy çështje të rëndësishme për tu analizuar nga pikëpamja e vendimmarrjes në Shqipëri, ku remitancat përbëjnë një burim shumë të rëndësishëm të financimit të huaj. Së pari, remitancat janë një kanal tjetër i rëndësishëm nëpërmjet të cilit zhvillimet ekonomike dhe goditjet në Eurozonë transmetohen në Shqipëri. Së dyti, nëse Shqipëria kërkon të rrisë flukset e remitancave në afatin e gjatë, duhet të përqëndrohet në karakteristikat demografike dhe individuale të emigrantëve shqiptarë, pasi këto flukse nuk janë shumë të ndjeshme ndaj zhvillimeve makroekonomike në vendin e origjinës.

LITERATURA:

- Chami, R., Connel, F. and Samir, J. 2003. Are Immigrant Remittance Flows a Source of Capital for Development? IMF Working Paper. No. 03/189. Washington: IMF.

- Sayan, S. and Tekin-Koru, A. 2007. Remittances, Business Cycles and Poverty. The Recent Turkish Experience. MPRA Paper. No. 6029

- El-Sakka, M. 2005. Migrants workers' remittances and Macroeconomic Policy in Jordan. Department of Economics: Kuwait University

- Lueth, E., amd Ruiz-Arranz, M. 2007. Are workers' remittances a hedge against macroeconomic shocks? The Case of Sri Lanka. IMF Working Paper. Vol 7(22).

- International Monetary Fund. 2006. Albania: Selected Issues. IMF country report. No. 06/285

- The Economic Bulletin of the Bank of Albania. 2009. No.3, retrieved at January 2011, at http://www.bankofalbania.org/web/Buletini_Ekonomik_Vellimi_12_nr_3_5674_1.php

- The Economic Bulletin of the Bank of Albania. 2009. No. 4, retrieved at February 2011, at http://www.bankofalbania.org/web/Buletini_Ekonomik_vellimi_12_nr_4_5814_1.php

- Higgins, M., Hysenbegasi, A., and Pozo, S. 2004. Exchange-rate uncertainty and workers' remittances. Applied Financial Economics. No. 14. Pages: 403 – 411

- Acosta, P. A, Lartey, E.K.K and Mandelman F.S. 2007. Remittances and the Dutch Disease. Working Paper, 8, Federal Reserve Bank of Atlanta

- Giuliano, P. and Ruiz-Arranz, M. 2006. Remittances, Financial Development and Growth. IZA Discussion Paper. No. 2160

MIKROKREDIA NË SHQIPËRI

ALMA NAKO, JONIDA PRIFTI, DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES

Roli dhe kontributi i mikrofinancës në zhvillimin ekonomik të një vendi vlerësohet si mjaft i rëndësishëm. Përveç rolit social në mbështetjen e shtresave të varfëra dhe fuqizimin e segmenteve të caktuara të popullatës në jetën sociale dhe ekonomike, mikrofinanca shihet edhe si nxitës i zhvillimit ekonomik. Ajo kompenson mungesat e bankave tregtare në zonat urbane dhe rurale, duke iu përgjigjur kërkesave të individëve dhe bizneseve të vogla të pambuluara nga sektori bankar. Referuar të dhënave të INSTAT, bizneset e vogla dhe shumë të vogla në vendin tonë zënë 90 për qind të sipërmarrjeve totale22 duke u konsideruar si motori kryesor i ekonomisë. Pjesa më e madhe e tyre është e përqendruar në shërbime dhe tregti, duke dëshmuar edhe natyrën mikro të tyre. Zhvillimi i këtyre bizneseve lidhet ngushtë me mundësinë për mbështetjen e tyre me financim. Në këtë drejtim, institucionet e mikrokredisë zhvillojnë ekonominë, kontribuojnë në punësim dhe në përmirësimin e nivelit të jetesës.

STRUKTURA E SEKTORIT TË MIKROKREDISË

Paketa e shërbimit të mikrofinancës në Shqipëri përbëhet kryesisht nga ofrimi i mikrokredive. Historia e mikrokreditimit në Shqipëri ka nisur në fillimet e viteve '90 me asistencën e organizatave të ndryshme ndërkombëtare si dhe me angazhimin e qeverisë për ta zhvilluar dhe konsoliduar këtë segment në tregun financiar. Produkt i programit të parë të mikrofinancës në Shqipëri janë dy Unionet e Kursim Kreditit me metodologji kreditimi mbështetur në parimet e kooperativës financiare. Ndryshe nga institucionet e tjera të mikrokredisë, ato operojnë edhe me grumbullimin e depozitave. Ndërkohë, ofruesit e shërbimit të mikrofinancës të licensuar dhe kontrolluar nga Banka e Shqipërisë e kanë fillesën e tyre në vitin 2002. Vitet e fundit, mikrokredia ka tërhequr edhe interesin e bankave nisur nga avantazhi i diversifikimit të portofolit.

Vendin kryesor në grupin e institucioneve të përqendruara në mikrokredi, të organizuara si institucione financiare jo banka dhe shoqëri të kursim kreditit, e zënë NOA, Fondi Besa dhe Unioni Shqiptar i Kursim Kreditit (83% të portofolit total të mikrokredisë).

Vitet e fundit vërehet një prirje pozitive në drejtim të rritjes së pranisë të subjekteve të licencuara për këtë aktivitet, duke e zhvilluar tregun e mikrofinancës si në madhësi ashtu edhe në produkte. Vetëm në gjysëm e dytë të vitit 2010 janë licensuar 2 shoqëri: Vision Fund Albania dhe Capital Invest.

[20] Bazuar në klasifikimin e sipërmarrjeve sipas numrit të të punësuarve nga INSTAT (1-4 të punësuar). Të dhënat janë për fundin e vitit 2009.

Megjithatë, ky treg mbetet ende në fazat e zhvillimit dhe reformimit të tij. Pesha e tij në portofolin e sistemit bankar në fund të vitit 2010, duke mos përfshirë bankat që ofrojnë këtë shërbim, arrin vetëm në 3.28 për qind dhe 4.9% duke konsideruar edhe pjesën e tregut të mikrokredisë të mbuluar nga bankat.

Tabela 3. Segmentimi i tregut të mikrokredisë në fund të vitit 2010 sipas organizimit insitucional.

Subjekti	Totali port. (mil. lekë)	Kredi me prob./ total port.	Nr. kredimarrësve aktiv	Total depozita (mil. lekë)	Urbane	Rurale
Institucionet financiare jo banka (1)	11,492.88	9.45%	42,789			
NOA sh.a.	4,736.13	11.08%	17,904	-	√	
Fondi Besa sh.a.	4,558.67	7.58%	17,954	-	√	
Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit sh.a	1,970.22	10.18%	4,452	-	√	√
VisionFund Albania sh.p.k	215.62	6.93%	2,459	-	√	
Capital Invest sh.a.	12.24	0.00%	29	-	√	
Shoqëritë e kursim kreditit (2)	4,475.33	4.13%	41,663[1]	1,776.32		
Rrjeti i shkk-ve të Unionit Shqiptar i Kursim Krediti (100 sh.k.k.)	4,003.81	3.81%	31,029	1,380.57	√	√
Rrjeti i shkk-ve të Unionit Jehona (26 sh.k.k.)	471.52	6.87%	10,634	395.75	√	√
Totali (1+2)	15,968.21	7.96%	84,452	1,776.32		
Segmenti Bankar (3)	7,857.21	12.79%	13,705			
Banka ProCredit	6,003.04	13.95%	10,678		√	
Banka Credins	1,322.95	7.25 %	2,917		√	
Dega e Bankës Kombëtare Greke	531.22	13.40%	110		√	
Totali (1+2+3)	23,825.42	12.24%	98,157			

[1] *Për shoqëritë e kursim kreditit, si kredimarrës aktiv, i jemi referuar numrit të anëtarëve në këto shoqëri.*

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Banka e parë në treg që ka ofruar shërbimin e mikrokredisë është Banka ProCredit, e cila që kur u krijua, është evidentuar si institucion me aktivitet të zgjeruar në mikrokredi. Banka të tjera janë: Banka Credins dhe Dega e Bankës Kombëtare Greke. Pesha e tyre në totalin e portofolit të mikrokredisë është e rëndësishme, ndërkohë që numri i klientëve është më i kufizuar. Aktualisht, konkurrenca në treg gjykohet jo e lartë për shkak se nuk ekzistojnë mbivendosje të mëdha të shërbimeve të mikrokredisë në të njëjtat zona gjeografike. Për rrjedhojë, ofrimi i këtij shërbimi edhe nga bankat shihet si një moment pozitiv, duke mundësuar mbulimin e nevojave të klientëve për kredi.

Grafik 5. Krahasimi i raportit "Kredia mesatare / AKB[1] per capita" me vendet e rajoni[2].



[1]E Ardhura Kombëtare Bruto: PBB + dividentë e fitime të ardhura në vend - dividentë e fitime të dërguara jashtë vendit.
[2]Të dhënat janë për fundin e vitit 2009.
Burimi: Mixmarket (Microfinance Information Exchange).

Krahasuar me vendet e rajonit, vërehet se në vendin tonë ekzistojnë hapësira për më shumë rol aktiv të ndërmjetësve financiarë për sa i takon zhvillimit të mikrokredisë. Niveli relativisht më i lartë i treguesit të analizuar në grafikun 1, krahasuar me vendet e tjera (duke përjashtuar Kosovën), tregon se në popullatën me të ardhura të ulta depërtimi i mikrokredisë është i pamjaftueshëm. Kjo është

ndikuar edhe nga mungesa që ka patur legjislacioni ynë në përkufizimin e mikrokredisë si aktivitet. Ndryshimi i kuadrit rregullator në këtë drejtim ka mundësuar që operatorët e rinj të licencuar sipas kërkesave të reja, të orientohen tek ky segment kredimarrësish, të cilët përfaqësojnë edhe objektivin kryesor të mikrokredisë.

Aktualisht, oferta e mikrokredisë është e orientuar kryesisht drejt zonave urbane të vendit, duke lënë të pambuluar me shërbime financiare zonat rurale. Në varësi të llojit të institucionit dhe të nivelit të zhvillimit të tij, vërehen nivele të ndryshme të grupeve të synuara të klientelës si dhe nivele të ndryshme të kreditimit, të cilat materializohen në nivelin e zhvillimit të kredisë mesatare. Kështu NOA dhe Fondi Besa, përveç kreditimit të individëve, financojnë edhe biznese të vogla dhe shumë të vogla. Ndërkohë, edhe bankat janë të përqendruara në kreditimin e bizneseve të vogla dhe të një pjese të bizneseve të mesme. Por ndryshe nga institucionet jobanka, bankat duke pasur burime më të shumta financiare, zbatojnë shuma maksimale kreditimi më të larta. Ndërkohë, operatorët e tjerë janë të përqendruar kryesisht në kreditim individësh për vetëpunësim dhe sipërmarrje të vogla familjare. Rrjeti i shoqërive të kursim kredititit u shërben klientëve të cilët kanë si karakteristikë dalluese ekzistencën e një lidhjeje të përbashkët si: komunitare, profesionale, etj..(me mire te gjendet nje përkufizim i ndryshem nga ai i Fondit Jehona) Vlera mesatare e kredive të tyre është relativisht e vogël[23].

Përqasja rregullative dhe roli i Bankës së Shqipërisë në zhvillimin dhe rregullimin e mikrokredisë.

Legjislacioni aktual për sektorin e mikrokredisë në Shqipëri është përshtatur në një mënyrë të tillë, e cila i lejon këto institucione (përjashtuar unionet e kursim kredititit) të marrin licenca për dhënien e kredie vetëm nëse kanë licencën për Institucionet Financiare Jobanka (IFJB). Kuadri ligjor që drejton aktivitetin e tyre është Ligji "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ndërkohë që Ligji "Për shoqëritë e kursim-kredititit" rregullon veprimtarinë e shoqërive të kursim-kredititit dhe unioneve të tyre.

Vëmendja e Bankës së Shqipërisë ka qenë e orientuar në drejtim të përshtatjes dhe zhvillimit të një kuadri rregullativ, për të lejuar jo vetëm monitorimin e mjaftueshëm të aktivitetit të mikrofinancës/mikrokredisë por edhe për ti dhënë një impuls shtesë zhvillimit të tij. Në muajin shkurt të vitit 2009, rregullorja e re e licencimit për subjektet financiare jobanka ka përkufizuar këtë aktivitet, duke e veçuar nga aktivitetet e tjera dhe duke bërë të mundur edhe trajtimin më të zbutur/ lehtësuar të kërkesave për kapital fillestar. Kjo risi e parashikuar në këtë rregullore ka mundësuar rritjen e kërkesave për licencim të subjekteve financiare jobanka, që ofrojnë shërbimin e mikrokredisë.

Edhe procesi i mbikëqyrjes ka pësuar një zhvillim pozitiv në drejtim të forcimit të strukturave mbikëqyrëse dhe analizuese. Mbikëqyrja e këtyre institucioneve edhe në rastet kur ato nuk pranojnë depozitave, është e rëndësishme, pasi

[21] Kredia mesatare për rrjetin e shkk-ve paraqitet në vlerën 107 mijë lekë, ndërkohë që për subjektet financiare jobanka paraqitet në 575 mijë lekë.

përmirëson menaxhimin operacional të tyre, duke rritur standardet e raportimit dhe praktikat e shëndetshme të kreditimit. Kjo mundëson sigurimin e më shumë fondeve, duke krijuar hapësira për zgjerimin e aktivitetit, bazës së klientelës, gamës së produkteve të ofruara si dhe krijimit të pavarësisë financiare. Mbikëqyrja e këtyre subjekteve, duke përfshirë edhe shoqëritë e kursim kreditit bazohet në kriteret e licencimit dhe në disa norma mbikëqyrëse që duhet të respektohen. Aspektet kryesore të kuadrit rregullativ mbikëqyrës kanë të bëjnë me mjaftueshmërinë e kapitalit, rrezikun e kredisë, likuiditetin dhe pozicionin valutor. Ndër rreziqet kryesore vlerësohet ai i kredisë. Përfshirja në regjistrin e kredisë të këtyre subjekteve, si raportues dhe përdorues të autorizuar të të dhënave, në muajin nëntor të vitit 2010, është një nga sipërmarrjet më të fundit të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për të përmirësuar menaxhimin e rreziqeve në këto institucione.

Zhvillimet kryesore në aktivitetin e mikrokredisë

Në fund të vitit 2010 tregu i mikrofinancës në Shqipëri, jashtë sistemit bankar[24], rezulton me një tepricë kredie bruto 15.967 milionë lekë, e shpërndarë në rreth 84.000 klientë aktivë. Ecuria e këtij portofoli paraqitet në rritje, por me ritme të reduktuara gjatë viteve 2009 - 2010. Për rrjedhojë, edhe kredia mesatare ka ardhur në rënie. Në kushtet kur numri i kredimarrësve aktiv është rritur nga njëri vit në tjetrin, rënia e kredisë mesatare vjen si pasojë e reduktimit të tepricës së disbursuar të kredisë për kredimarrësit e rinj, kryesisht gjatë vitit 2010. Kjo përfaqëson një nga masat e marra në përgjigje të zhvillimeve financiare në vend.

Grafiku 6. Ecuria e portofolit të kredisë bruto dhe kredisë mesatare (në mln lekë, majtas) dhe numri i kredimarrësve aktiv (djathtas) për periudhën 2005-2010.



Burimi: Mixmarket (Microfinance Information Exchange).

Niveli i kredive me probleme paraqitet me rritje të lehtë në kohë, përjashtuar këtu vitin 2010, ku vërehet një përkeqësim i ndjeshëm i tij. Kjo tendencë

[22] Zhvillimet në tregun e mikrokredisë analizojnë subjektet financiare jobanka dhe rrjetin e shkk-ve. Treguesit përkatës të sistemit bankar nuk janë përfshirë, nisur nga karakteristika të ndryshme të aktivitetit të bankave përsa i përket natyrës së klientelës, shumës maksimale të kreditimit si dhe specifikave të kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës.

identifikohet për çdo subjekt pjesëmarrës në tregun e mikrokredisë. Ndryshe nga sistemi bankar në tërësi, subjektet jobanka dhe unionet e kursim-kreditit të cilat operojnë në tregun e mikrokredisë, po e përcjellin më me vonesë fenomenin e përkeqësimit të cilësisë së portofolit.

Nëse përqendrohemi vetëm në zhvillimet e vitit 2010, vërejmë se kjo ecuri e nivelit të kredive me probleme kombinuar edhe me ritmet në rënie të rritjes së totalit të portofolit, rezulton në përkeqësim të cilësisë së portofolit matur nga treguesi "kredi me probleme/ totali i portofolit". Analizuar sipas grupeve të institucioneve, treguesin më të dobët të cilësisë së portofolit e kanë institucionet financiare jobanka. Metodologjia e kreditimit në shoqëritë e kursim kreditit, e cila bazohet në marrëdhëniet e besimit midis anëtarëve dhe presionin social, është faktori kryesor që ndikon në nivelin e ulët të kredisë me probleme të tyre.

Grafiku 7.

a) Ecuria e kredisë me probleme sipas subjekteve (në mln lekë).



b) Ecuria e "Kredisë me probleme / Totali i portofolit" sipas grupeve të institucioneve (në %).



c) Ecuria e rezultatit financiar (në mln lekë).



d) Niveli kapitalizimit për vitin 2010 (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pritshmëria e treguesit të cilësisë së portofolit është në kahun rritës. Kjo, ndikuar kryesisht nga ana e ofertës në drejtim të uljes së ritmit rritës të portofolit të kredisë, parë në dy aspekte:

- Finalizimi i projektit për përfshirjen e këtyre institucioneve në regjistrin e kredisë në muajin nëntor të vitit 2010, parashikohet të shoqërohet me kufizim të kreditimit të klientëve që janë të ekspozuar edhe në subjekte të tjera.
- Në përgjigje të zhvillimeve ekonomike, këto institucione kanë forcuar kriteret analizuese të kredidhënies si dhe kanë reduktuar shumën maksimale të kreditimit për një individ.

Ndërkohë, rritja e vetë nivelit të kredive me probleme pritet të ngadalësohet krahasuar me vitin 2010. Kjo, ndikuar si nga përmirësimi i treguesve makroekonomikë, krahasuar me vitin e kaluar, ashtu edhe nga forcimi i standardeve krediduese nga vetë institucionet.

Referuar strukturës së portofolit të mikrokredisë sipas sektorëve të ekonomisë në fund të vitit 2010, vërehet përqendrim i tij kryesisht në bujqësi dhe silvikulturë, tregti dhe hoteleri, peshat e të cilave janë përkatësisht 22.9, 23.6 dhe 10.7 për qind. Ky orientim i kredidhënies gjykohet pozitiv në rastet kur sektorët e mësipërm përfaqësojnë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e PBB-së. Sipas grupeve të institucioneve, ndikimin më të madh në kreditimin e bujqësisë dhe silvikulturës e ka rrjeti i shkk-ve (54 % e portofolit të rrjetit). Bujqësia vlerësohet si një nga sektorët me potenciale zhvillimi afatgjata për ekonominë dhe kreditimi i saj nga subjektet e tjera të mikrokredisë inkurajohet. Në të njëjtën kohë, ekzistojnë hapësira për një orientim të portofolit të mikrokredisë edhe drejt sektorëve të tjerë të rëndësishëm, si: industria përpunuese apo shërbime kolektive, pesha aktuale e të cilëve është përkatësisht 7.84 dhe 8.80 për qind. Njëkohësisht, kreditimi i individëve, aktualisht me një peshë prej 3.3 për qind, ndikon në zhvillimin e mikrokredisë dhe përmbushjen e rolit social të saj.

Performanca financiare e institucioneve të mikrokredisë paraqitet pozitive. Sikurse shihet edhe nga grafiku i mësipërm, aktiviteti i tyre rezulton pozitiv ndër vite. Ndërkohë që rritja e nivelit të kredive me probleme gjatë periudhës 2009 - 2010 ka ushtruar presion në rezultatit financiar, i cili është reduktuar për shkak të rritjes së shpenzimeve për provigjione. Edhe pse me rezultat financiar pozitiv, fitimet akoma nuk përbëjnë një burim të qëndrueshëm për mbështetjen e rritjes së tyre. Niveli i raportit të rezultatit neto ndaj aktiveve mesatare mbetet ende i ulët[25]. Ndërkohë, nivelet e kapitalizimit për vitin 2010 janë mbi ato minimale rregullatore për të gjitha subjektet, duke paraqitur një nivel të mjaftueshëm të kapitalizimit për sigurimin e një veprimtarie të qëndrueshme[26].

Megjithë rritjen e problematikës në aktivitetin e mikrokredisë këto dy vitet e fundit në drejtim të rritjes së kredive të pakthyera në afat dhe uljes së fitimeve, treguesit e mësipërm financiarë tregojnë për nivele të moderuara rreziqesh me të cilat përballet sektori i mikrofinacës si dhe një situatë të qëndrueshme financiare të tyre. Në të njëjtën kohë, roli i subjekteve në përballjen e kësaj situate ka qenë aktiv. Këto institucione kanë marrë masa në drejtim të forcimit të standardeve të kreditimit nëpërmjet kritereve më shtrënguese analizuese, rritjes së maturitetit maksimal, përqendrimit më të madh të miratimeve në qendër, duke ulur rolin e degëve në procesin vendimarrës, ristrukturime të portofolit, etj. Njëkohësisht, vërehet krijimi i departamenteve të manaxhimit të rrezikut në disa prej këtyre institucioneve, duke rritur manaxhimin efektiv të rreziqeve që shoqërojnë aktivitetin e tyre.

Krahasuar me disa nga vendet e rajonit[27], mikrokredia në Shqipëri ka potenciale për tu zgjeruar. Rritja mesatare vjetore e portofolit të kredisë në Shqipëri për periudhën 2005 - 2009 paraqitet më e ulta (19.04 për qind), ndikuar kjo kryesisht edhe nga rritja e shpejtë e këtij tregu në rajon, gjatë

[23] Niveli i treguesit ROA për fundin e vitit 2010 paraqitet në nivelin 1.58 për qind për institucionet financiare jobanka dhe 0.36 për qind për rrjetin e shoqërive të kursim kreditit.

[24] Analiza e nivelit të kapitalizimit bazohet në nivelin e raportit "kapital/ totali i aktivit" për subjektet jobanka dhe "kapital/portofoli i kredisë" për rrjetin e shoqërive të kursim kreditit. Niveli minimal rregullativ i tyre është respektivisht 10 për qind dhe 8 për qind.

[25] Viti 2010 nuk është përfshirë në analizë për shkak të mungesës së të dhënave.

Grafiku 8. Krahasimi i rritjes së mikrokredisë dhe performancës së portofolit për periudhën 2005-2009 me disa vende të rajonit.



Burimi: Mixmarket (Microfinance Information Exchange).

viteve 2005 - 2008. Por, në ndryshim nga këto vende, ngadalësimi i rritjes së mikrokredisë gjatë viteve 2008 - 2009, si dhe rritja e portofolit në rrezik (mbi 30 ditë), në Shqipëri paraqitet më e ulët dhe e mirëkontrolluar.

Problematikat dhe sfidat në të ardhmen

Mikrokredia në Shqipëri është akoma në fazat e zhvillimit dhe reformimit të saj. Promovimi i mëtejshëm i saj është në vëmendjen e vazhdueshme të Bankës së Shqipërisë, në kushtet kur rritja ekonomike është e një rëndësie të veçantë për të.

Sfida kryesore e subjekteve të mikrofinancës, përtej subjekteve bankare, mbetet sigurimi i fondeve për vazhdimësinë e aktivitetit. Shpesh herë fondet sigurohen nga institucione ndërkombëtare dhe për rrjedhojë akordohen në valutë.

Fondet në valutë i hapin rrugën një tjetër sfide, asaj të ekspozimit ndaj pozicioneve të hapura valutore. Duke qenë se mikrokredia akordohet kryesisht në lekë, atëherë subjektet e mikrofinancës ndërrmarin kosto të tjera duke përdorur metoda hedging për t'i konvertuar këto fonde në lekë. Për rrjedhojë edhe kosto e transmetuar tek klientët është më e lartë.

Si rezultat i kostove shtesë që subjektet mikrofinancë ndërrmarrin, rritet edhe norma e interesit për klientët. Në krahasim me tregje të tjera mikrofinance, vihet re se klientët shqiptarë paguajnë norma më të larta interesi. Rritja e çmimit për këtë shtresë në nevojë mbart rrezikun e një largimi të mundshëm të mikrofinancës nga qëllimi fillestar për të cilin është krijuar.

Nga ky këndvështrim, një alternativë e mundshme do të ishte subvencionimi apo krijimi i lehtësirave të tjera për subjektet e mikrofinancës.

BANKA E SHQIPËRISË NË HARKUN KOHOR

JANAR-QERSHOR 2011

Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani, me zj. Ngozi Okonjo-Iweala, Drejtoreshë e Lartë e Bankës Botërore

Në datën 10 janar 2011 Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, zhvilloi një takim me Drejtoreshën e Lartë të Bankës Botërore zj. Ngozi Okonjo-Iweala, në ambientet e Bankës së Shqipërisë.

Gjatë takimit, u vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira midis dy institucioneve si dhe u inkurajua forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dypalësh. Banka Botërore vazhdimisht ka shprehur gatishmërinë për të mbështetur Bankën e Shqipërisë në zbatimin e projekteve që kanë si qëllim konsolidimin, modernizimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar shqiptar.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë njohu zj. Iweala, me zhvillimet më të fundit makroekonomike në Shqipëri, duke u përqendruar veçanërisht në ecurinë e inflacionit dhe punën e Bankës së Shqipërisë për kontrollin e tij. Ai u ndal gjithashtu dhe në zhvillimet më të fundit të sistemit bankar dhe punën e realizuar nga Banka e Shqipërisë për ruajtjen dhe stabilitetin e tij.

Zj. Iweala vlerësoi kontributin dhe rolin e Bankës së Shqipërisë në sigurimin e stabilitetit makroekonomik dhe financiar të vendit.

Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, me drejtues të Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Greqisë

Në datat 17-18 janar 2011, një delegacion i nivelit të lartë të Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Greqisë zhvilloi një vizitë dyditore pranë Bankës së Shqipërisë. Kjo vizitë u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit dypalësh midis dy bankave qendrore.

Gjatë qëndrimit në Shqipëri, delegacioni i Bankës së Greqisë u prit nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani. Në takimin ku merrnin pjesë edhe përfaqësues të tjerë të lartë të Bankës së Shqipërisë, u diskutua mbi zhvillimet ekonomiko-financiare, duke u përqendruar veçanërisht në ecurinë e grupeve bankare që operojnë në të dy vendet.

Delegacioni grek i shoqëruar nga homologët shqiptarë zhvilloi takime të përbashkëta me drejtuesit ekzekutivë të bankave greke që operojnë në Shqipëri. Në këto takime, ata patën mundësinë të diskutonin mbi situatën dhe zhvillimet e këtyre bankave dhe tregut në përgjithësi, si dhe të adresonin çështje që lidhen me strategjitë e tyre për të ardhmen.

Në mbyllje të vizitës, Guvernatori Fullani zhvilloi një takim të përbashkët me delegacionin grek si edhe me drejtuesit ekzekutivë të bankave greke që operojnë në Shqipëri. Gjatë takimit, Guvernatori i njohu të pranishmit me konkluzionet e Bankës së Shqipërisë mbi ecurinë e ekonomisë shqiptare, sistemit bankar dhe bankave greke gjatë vitit 2010. Më konkretisht, ai u shpreh se bankat greke që operojnë në Shqipëri kanë qenë dhe janë pjesë e rëndësishme e sistemit bankar shqiptar këto vitet e fundit.

Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, me përfaqësuesit e pushtetit vendor, të sektorit bankar, të komunitetit të biznesit të Qarkut të Shkodrës dhe me akademikë të Universitetit 'Luigj Gurakuqi'

Në datë 20 janar 2011, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani zhvilloi një takim në qytetin e Shkodrës, me përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe me drejtues të sektorit bankar të qytetit. Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues nga pushteti vendor si dhe akademikë nga Universiteti 'Luigj Gurakuqi'.

Pas përfundimit të fjalës, Guvernatori Fullani iu përgjigj pyetjeve të të pranishmëve.

Në përfundim të takimit, drejtues të bankave që operojnë në qarkun e Shkodrës, shprehën gatishmërinë e tyre për krijimin e mundësive, të cilat nevojiten për të mbështetur biznesin. .

Zhvillimi i ceremonisë së promovimit të librit "Epoka e trazirave: Aventura në një botë të re" të Alan Greenspan, ish-Kryetar i Bordit të Guvernatorëve të Rezervës Federale

Në datën 3 shkurt 2011, Banka e Shqipërisë organizoi ceremoninë e promovimit të librit "Epoka e trazirave: "Aventura në një botë të re" të Alan Greenspan, ish- kryetar i Bordit të Guvernatorëve të Rezervës Federale. Parathënia e librit është shkruar nga të Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani. Në fjalën e tij, Guvernatori Fullani u shpreh se drejtimi që z. Greenspen i bëri politikës monetare të Rezervës Federale, si besimtar i zjarrtë i tregut dhe ithtar i inovacionit, i karakterizuar nga zhdërvjelltësia për zgjidhjen e situatave të pamundura, e justifikon plotësisht shprehjen se politika monetare nuk është shkencë, por art.

Duke marrë shkas nga përfundimet e autorit, z. Fullani vuri theksin në disa prej këtyre çështjeve siç janë: pavarësia e Bankës Qendrore, vazhdimi i reformave strukturore, bashkëpunimi rajonal dhe domosdoshmëria për të thithur sa më shumë investime të huaja.

Në lidhje me pavarësinë është e rëndësishme që banka qendrore të jetë e pavarur, transparente, e përgjegjshme, por jo e izoluar. Bashkërendimi me institucionet e tjera vendimmarrëse është i rëndësishëm.

Ceremonia e promovimit të librit u zhvillua në prani të Ministrit të Financave, z. Ridvan Bode, deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, drejtuesve të sistemit bankar, përfaqësuesve nga komuniteti i biznesit, ekonomistëve si dhe opinionistëve dhe gazetarëve.

Projekti i binjakëzimit i Bankës së Shqipërisë dhe Bankave kombëtare të Italisë dhe Francës

Në datën 23 mars 2011, Banka e Shqipërisë prezantoi projektin e binjakëzimit mes Bankës së Shqipërisë, dhe bankave kombëtare të Italisë dhe Francës, i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) me 1 milion euro. Projekti synon të përmirësojë praktikat e punës së Bankës së Shqipërisë, duke i përafruar me ato të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Ai do të sjellë ekspertizën e BE-së dhe përvojën e dy prej vendeve themeluese të saj në dobi të sistemit bankar shqiptar dhe do të trajnojë ekspertët e Bankës së Shqipërisë, duke ndihmuar kështu rrugën e integrimit ekonomik të vendit tonë në BE.

Pjesëmarrës në ceremoni ishin edhe Shefi i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ambasadori Ettore Sequi, Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së Italisë, z. Fabrizio Saccomanni, si dhe përfaqësues nga sistemi bankar.

Projekti prej 1 milion eurosh do të vazhdojë deri në maj 2012 dhe do të zbatohet nga bankat qendrore të Italisë dhe Francës.

Nënshkrimi i Memorandumit së Bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes bankare, midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës së Italisë

Në kuadër të bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave qendrore evropiane, në datë 23 mars 2011, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes bankare midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës së Italisë. Memorandumi u nënshkrua nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Ardian Fullani dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së Italisë, z. Fabrizio Saccomanni.

Memorandumi i Bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes bankare formalizon bashkëpunimin ndërmjet dy bankave qendrore, në drejtim të shkëmbimit të informacionit, si dhe të koordinimit të punës për mbikëqyrjen e grupeve bankare që operojnë në të dy vendet.

Firmosja e ketij memorandumi do të ndihmojë Bankën e Shqipërisë në ushtrimin e rolit të saj për garantimin e stabilitetit të sistemit bankar në vend.

Zhvillimi i ceremonisë së përurimit të punimeve të rikonstruksioni të Godinës së Bankës së Shqipërisë

Në datën 28 mars 2011, Banka e Shqipërisë organizoi ceremoninë e përurimit të punimeve të rikonstruksionit të Godinës së Bankës së Shqipërisë.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm ministri i Financave z.Ridvan Bode, përfaqësues nga studio fituese e projektit, përfaqësues të trupit dipllomatik në Shqipëri, si dhe nga sistemi bankar. Fjala e hapjes u mbajt nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Ardian Fullani. Guvernatori Fullani dhe Ministri i Financave Bode kanë vënë tullën e parë, duke i hapur rrugën punimeve që do të modernizojnë ambientet e brendshme të Bankës së Shqipërisë.

Godina qendrore e Bankës ndodhet në qendër të sheshit "Skënderbej", duke përfaqësuar në mënyre dinjitoze një nga institucionet administrative më të rëndësishme të vendit tonë, bankën qendrore, në cilësinë e autoritetit të vetëm monetar si dhe mbikëqyrës. E ndërtuar rreth 70 vjet më parë, kjo godinë qëndron si një vepër arti dhe mbrohet nga shteti si pjesë e qendrës së kryeqytetit, e shpallur Ansambël Monument Kulture.

Godina e Bankës së Shqipërisë përfundoi së ndërtuari në vitin 1938 dhe plotësonte kërkesat e kohës. Ndërsa në vitet dyzetë, arkitekti Morpurgo hartoi një tjetër projekt, i cili parashikonte ndërtimin e godinave të tjera që i përshtateshin linjës arkitektonike të ndërtesës aktuale. Ndërtimi i tyre do të plotësonte kompleksin e Bankës së Shqipërisë. Por, ky projekt mbeti në letër pa mundur të realizohet.

Në projektin e ri, parashikohet që në përputhje me filozofinë e Bankës së Shqipërisë, përveç plotësimit të kërkesave administrative, të plotësohet edhe kërkesa për marrëdhënie më të plota dhe transparente me publikun. Në këtë kuadër, është parashikuar që në ndërtesën qendrore, Banka e Shqipërisë do të ketë muzeun e numizmatikës dhe të historisë së aktivitetit financiar dhe bankar të Shqipërisë. Në këtë mënyrë, koleksioni i pasur i monedhave dhe kartëmonedhave të emetuara që nga antikiteti e deri më tani do të jetë i hapur për publikun.

Zhvillimet e vrullshme sasiore dhe cilësore që kanë shoqëruar aktivitetin e Bankës së Shqipërisë, kanë bërë që kërkesat për hapsira ndërtimore për të ushtruar aktivitetin e saj ditor të rriten në vazhdimësi. Ushtrimi i shumë prej funksioneve unike të përfaqësimit, kërkesat funksionale gjithnjë e në rritje, angazhimet e shumta të Bankës së Shqipërisë në aktivitetet ndërkombëtare, kërkesat e domosdoshme në teknologjinë e informacionit dhe një sërë arsyesh të tjera, diktonin nevojën për ambiente të tjera shtesë. Në këto kushte, blerja e godinës së ish - Hotel Dajtit, përbën një nga lëvizjet strategjike të Bankës së Shqipërisë, për një zgjidhje afat gjatë dhe dinjitoze, në sigurimin e ambienteve të reja, të cilat do plotësojnë më tej infrastrukturën që ofron godina qendrore. Kjo është një lëvizje që do të ndikojë në përafrimin e Bankës së Shqipërisë me Bankën Qendrore.

Me përfundimin e investimeve në këto dy objekte, Banka e Shqipërisë shpreh bindjen se modeli i saj institucional do të përafrohet akoma më shumë më atë të sistemit të bankave qendrore të Evropës. Nga ana tjetër, do të jetë një kontribut i jashtëzakonshëm për ruajtjen dhe evidentimin e trashëgimisë kulturore të qytetit të Tiranës si dhe për nxitjen për zhvillimin e aktivitetit cilësor, edukativo-shkencor të vendit në fushën e bankingut qendror e atë të financave.

Mbi 85 vjetorin e monedhës kombëtare

Banka e Shqipërisë kremtoi këtë vit një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë ekonomike të vendit tonë në përgjithësi e të institucionit të bankës qendrore në Shqipëri në veçanti: 85-vjetorin e hedhjes në qarkullim të monedhave e kartëmonedhave të para kombëtare.

Me këtë rast, Banka e Shqipërisë në datë 31 mars 2011, organizoi ekspozitën: " 85 vjet - monedhë kombëtare" në ambientet e hollit të Muzeut Historik Kombëtar.

Monedha kombëtare u paraqit në këtë ekspozitë me të gjithë spektrin e vlerave që ajo mbart. Me qëllim shpalosjen e këtyre vlerave, ekspozita qe e përbërë nga koleksione të monedhave dhe kartëmonedhave nga antikiteti deri në ditët e sotme.

Ekspozita u çel nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, në praninë e Kryeministrit të Shqipërisë, z. Sali Berisha, si dhe përfaqësues të tjerë të vendit, guvernatorë dhe përfaqësuesve të bankave qendrore të rajonit, studiuesve të fushës, përfaqësuesve të ndryshëm të botës së financave, medias dhe publikut të gjerë.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë organizoi edhe Simpoziumin "Monedha Kombëtare: disa aspekte historike", ku specialistë të fushës trajtuan pikëpamje të ndryshme të zhvillimit të historisë së parasë shqiptare.

Mbi zhvillimin e seminarit rajonal "Aspektet ligjore të bankingut qendror"

Në datën 5 prill 2011, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën e Francës organizoi seminarin rajonal me temë "Aspektet ligjore të bankingut qendror".

Në këtë seminar merrnin pjesë juristë nga Banka Qendrore e Francës, nga bankat qendrore të rajonit, nga Banka e Shqipërisë si dhe nga institucionet shqiptare. Gjatë punimeve të këtij seminari u diskutuan çështje ligjore të bankës qendrore pas ngjarjeve të krizës globale të vitit 2008.

Të pranishmit në këtë seminar i përshëndeti dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani.

Mbi zhvillimin e konferencës së 24-ët të grupit të mbikëqyrësve bankarë të vendeve të Evropës Qendrore dhe asaj Lindore

Në datat 12- 13 prill 2011 u zhvillua në Tiranë konferenca e 24-ët ndërkombëtare e grupit të mbikëqyrësve bankarë, të vendeve të Evropës Qendrore dhe asaj Lindore (BSCEE). Grupi i Mbikëqyrësve Bankarë të Evropës Qendrore dhe Lindore është krijuar në vitin 1991 dhe sot ai njeh si anëtarë autoritetet mbikëqyrëse bankare të 21 vendeve të këtij rajoni.

Përveç pjesëmarrësve nga vendet anëtare, të ftuar të veçantë në këtë konferencë ishin gjithashtu personalitete si: Zëvendëssekretari i Përgjithshëm i Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare, Drejtori i Institucioneve Financiare për Ballkanin Perëndimor – BERZH, si edhe Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes të Grupeve Bankare në Bankën e Italisë.

Konferenca, në rolin e një forumi të nivelit të lartë teknik, trajtoi dy tema:

Rolin e sistemit bankar dhe të mbikëqyrësit në ruajtjen e stabilitetit financiar, dhe Bazel III: standardet ndërkombëtare rregullatore mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të institucioneve financiare dhe likuiditetin, të përcaktuara nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare.

Fjala e hapjes u mbajt nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, i cili bëri një analizë të përmbledhur të zhvillimeve ekonomike dhe financiare në Shqipëri gjatë dy viteve të fundit, duke u ndalur në çështje që kërkojnë vëmendje më të madhe nga ana e industrisë bankare dhe e autoritetit mbikëqyrës në të ardhmen.

Mbi seminarin e organizuar nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Universitetin e Oksfordit

Në datë 21 qershor 2011, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Universitetin e Oksfordit organizoi seminarin e nivelit të lartë me temë "Sfidat aktuale ekonomike dhe bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore". Fjala e hapjes u mbajt nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani.

Në këtë seminar morën pjesë përfaqësues nga rrethet akademike në Shqipëri, në rajon, e më gjerë, përfaqësues nga sistemi bankar, institucione shtetërore, organizma ndërkombëtarë në Shqipëri dhe përfaqësues nga Banka e Shqipërisë. Organizuar si pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bankës së Shqipërisë dhe Universitetit të Oksfordit, nënshkruar në shtator 2010, seminari i sotëm bën pjesë në axhendën e Bankës së Shqipërisë për të qenë aktor aktiv në iniciativat e bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore.

Temat kryesore që u diskutuan gjatë seminarit ishin: identifikimi dhe analizimi i sfidave kryesore ekonomike në nxitjen e rritjes së qëndrueshme

në rajon; identifikimi i hapësirave dhe niveleve të bashkëpunimit intensiv rajonal; eksplorimi i rolit të institucioneve dhe ankorave të jashtme në rritjen e bashkëpunimit rajonal.

Në shtator të vitit 2010, Banka e Shqipërisë nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Universitetin e Oksfordit. Qëllimi i bashkëpunimit është kryerja e kërkimeve shkencore për nxitjen dhe thellimin e njohurive mbi politikat ekonomike dhe sfidat me të cilat përballet Shqipëria dhe rajoni; vlerësimi i mundësive politike për nxitjen e rritjes së qëndrueshme ekonomike në rajon si dhe integrimi në Bashkimin Evropian.

Seminari i të premtes

Departamenti i Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë organizon dy herë në muaj "Seminarin e të premtes". Kjo iniciativë fton nëpunësit e Bankës së Shqipërisë, kërkuesit e sferës akademike dhe të institucioneve të tjera financiare, kërkimore dhe shkencore, të prezantojnë dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin materialet e tyre kërkimore teorike dhe empirike, me fokus mbi rastin e Shqipërisë dhe mbi zbatimin e metodave më të reja kërkimore.

Edhe gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2011 në Seminarin e së Premtes janë prezantuar një sërë punimesh, si nga përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, ashtu edhe nga institucionet e tjera. Çështjet e trajtuara kanë qenë të ndryshme, ku përmendim ato të përqëndruara në politikën monetare dhe stabilitetin financiar, në aspekte të politikës fiskale dhe të politikave zhvillimore, si dhe në çështje të konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare në nivel turizmi dhe bujqësie. Më poshtë do të gjeni një përshkrim më të detajuar të materialeve të prezantuara.

Tema e parë e prezantuar gjatë gjashtëmujorit të parë 2011 është : "Mafia dhe shpenzimet publike: evidenca e multiplikatorit fiskal nga një gjysëm-eksperiment", nga Saverio Simonelli (Universiteti Federiku i II i Napolit, Itali). Ky material analizon multiplikatorin e shpenzimeve publike në prodhim, bazuar në shpenzimet për infrastrukturën në rajone të ndryshme të Italisë, si dhe bazuar në ligjin 1991 që mandatonte ndërprerjen e punëve publike, si rezultat i infiltrimit të mafias në administratën lokale. Për identifikimin e këtij multiplikatori, autorët kanë përdorur metodën e panelit për provinca të ndryshme. Rezultatet empirike tregojnë se ky multiplikator luhatet nga 1.4 në 2, duke patur në konsideratë edhe efektin bashkëkohor, dhe me vonesë kohore të impaktit të masave antimafia të qeverisë në prodhim

"Integrimi rajonal dhe efektet në rritjen ekonomike: pasojat në IHD dhe tregti", nga Jonel Kristo, Departamenti i Kërkimeve. Qëllimi kryesor i këtij materiali është matja e efektit të integrimit rajonal në terma të rritjes ekonomike, kanalet kryesore të transmetimit si dhe matja e intensitetit të këtyre lidhjeve. Matja e këtij efekti është realizuar me metodën me panel me efekte fikse, që përfshin 9 vende nga Evropa Juglindore për periudhën 1996-2009. Rezultatet e studimit tregojnë se një rajon i integruar përfiton më shumë në terma të tregtisë, kryesisht me anë të eksporteve, dhe në terma të investimeve të huaja direkte. Një tjetër konkluzion i këtij materiali është që një

rajon i integruar rritet më shumë në vëllim nëse stimulon integrimin tregtar dhe konvergjencën ndërindustriale në nivel ndërkombëtar, krahasuar me një rajon me mungesë të këtyre nismave. Një rajon i tillë tërheq gjithashtu më shumë investime të huaja, por analiza tregon se kusht paraprak për këtë është krahu i punës kompetent dhe i disponueshëm. Rezultatet janë të vlefshme në kontekstin e një rajoni ku mbizotëron industria e kostos dhe jo industria e teknologjisë së lartë.

"Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm: një përqasje empirike për Shqipërinë" nga Lorena Skufi, fituese e çmimit të parë të Guvernatorit për Diplomën më të Mirë, viti 2010. Disa nga çështjet e trajtuara kishin të bënin me kuptimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, si dhe sfidat e ardhshme për zhvillimin e tij në Shqipëri. Qëllimi kryesor i këtij materiali është analizimi i turizmit të qëndrueshëm në tre dimensionet e tij, matja e impaktit ekonomik, mjedisor dhe social në të ardhurat që gjenerohen nga turizmi. Për analizën sasiore të zhvillimit të turizmit është përdorur modeli i korrigjimit të gabimit (vector error correction model). Kërkimi shtrihet në periudhën 1995-2008 dhe rezultatet tregojnë se të ardhurat nga turizmi janë të lidhura pozitivisht me produktin e brendshëm bruto, me zhvillimin social, si dhe lidhen negativisht me degradimin e mjedisit.

"Konsumi "për t'u dukur": efektet e ndikimeve sociale mbi kërkesën, çmimin dhe fitimet e Firmës. Konsumi për t'u dukur në Shqipëri" nga Armando Memushi, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës. Ky punim synon të kuptojë rolin e sjelljes konsumatore "sociale" në përcaktimin e çmimeve të të mirave "për t'u dukur" dhe të fitimeve e të pjesëve të tregut të firmave që prodhojnë dhe shesin produkte të tilla. Për këtë qëllim është përdorur një model analitik që përfshin influencat sociale në sjelljen e konsumatorit dhe pastaj shqyrtohen ndikimet e tij mbi çmimet, fitimet dhe pjesët e tregut të firmave. Rezultatet për konsumatorin shqiptar tregojnë që: konsumi i të mirave për t'u dukur përbën një pjesë shumë të vogël të konsumit total. Gjithashtu se gjinia dhe arsimimi i kryefamiljarit janë faktorët me ndikimin më të madh në nivelin e konsumit "për t'u dukur" dhe se individët që banojnë në Tiranë konsumojnë mesatarisht më shumë produkte "për t'u dukur", krahasuar me qytetet e tjera.

Një tjetër material i prezantuar në serinë e 'Seminareve të së Premtes' është ai me temë: "Deficiti i llogarisë korrente në Shqipëri dhe pasojat politike", nga Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve. Ky material ka për qëllim të vlerësojë normën ekuilibër të llogarisë korrente në Shqipëri. Vlerësimi është bazuar në dy përqasje, atë të kontabilitetit të propozuar nga Lane dhe Milesi-Ferretti (2006), si dhe në përqasjen empirike mbi vlerësimet në panel të këtyre të dhënave. Niveli ekuilibër i llogarisë korrente që sugjerojnë metodat e përdorura është i ndryshëm, kështu që madhësia e rregullimit të llogarisë korrente duhet të interpretohet me kujdes. Ky material synon gjithashtu të hedhë dritë edhe mbi pasojat e mundshme që mund të ketë në të ardhmen për politikën monetare dhe fiskale, përkeqësimi i mëtejshëm i llogarisë korrente, tendencë e vënë re kryesisht gjatë viteve të fundit.

Material tjetër i prezantuar është ai me temë: "Vlerësimi i efektit afatgjatë të turizmit në rritjen ekonomike të Shqipërisë", nga Jonel Kristo, Departamenti i Kërkimeve. Ky studim synon të masë efektin e sektorit të turizmit në rritjen e përgjithshme ekonomike të vendit tonë, gjatë periudhës 1995-2008. Nëpërmjet analizës së fluksit të vizitorëve të huaj dhe të ardhurave totale reale në ekonomi, është studiuar lidhja afatgjatë e turizmit me rritjen ekonomike. Vlerësimi përfundimtar sugjeron se për çdo 5 % rritje të qëndrueshme në të ardhurat nga turizmi, ekonomia rritet me 1%. Nga ana tjetër, çdo prishje e këtij ekuilibri kërkon 3.4 tremujorë që të korrigjohet.

"Përcaktuesit makroekonomikë të remitancave në Shqipëri", nga Esida Abazaj, Departamenti i Kërkimeve. Ky studim synon të masë empirikisht përcaktuesit makroekonomikë të dërgesave të emigrantëve në Shqipëri gjatë periudhës 1996-2010. Ai është studimi i parë i llojit të vet për rastin e Shqipërisë. Metodologjia e zbatuar është Mekanizmi i Korrigjimit të Vektorit të Gabimeve, që mundëson studimin e dinamikës afatshkurtër dhe afatgjatë të remitancave. Gjetjet tregojnë se remitancat në afatin e gjatë varen vetëm nga kushtet makroekonomike të vendeve mikpritëse, që përfaqësohen nga norma e papunësisë në këto vende, e peshuar me pjesën e remitancave që vjen nga secili vend mikpritës. Një rritje e normës së papunësisë me 1 pp, i redukton flukset e remitancave me 0.13% në afatin e gjatë. Ndërsa ndryshoret e tjera shpjeguese (kursi i këmbimit dhe PBB-ja e Shqipërisë) rezultuan statistikisht të parëndësishme, si në afatin e shkurtër ashtu dhe në afatin e gjatë, duke hedhur poshtë hipotezën që remitancat dërgohen kryesisht për të plotësuar nevojat e konsumit të familjeve të emigrantëve shqiptarë në vendin e origjinës. E vetmja gjetje që mbështet motivin altruist të remitancave është koeficienti i lartë dhe statistikisht i rëndësishëm i termit të korrigjimit të gabimit. Nga ana tjetër, studimi nuk gjeti evidencë në mbështetje të motivit të investimit të remitancave.

"Qeverisja e bankave në Shqipëri" nga Kliti Ceca, Irini Kalluci, Oriela Kodra, (Departamenti i Kërkimeve) Vasilika Kota, (Departamenti i Stabilitetit Financiar) dhe Arzana Haxhiaj, (Departamenti i Burimeve Njerëzore). Qëllimi kryesor i këtij materiali ishte evidentimi i rolit dhe rëndësisë që ka mirëqeverisja e bankave në Shqipëri, matja e të cilës u realizua me anë të llogaritjes së indeksit të qeverisjes së bankave për sistemin bankar shqiptar.

"Ciklet politike në të ardhurat nga privatizimi: rasti i Shqipërisë", nga Drini Imami, Endrit Lame (Universiteti Bujqësor i Tiranës) dhe Holger Kächelein (Fakulteti Ekonomik, Tiranë). Ky material ka për qëllim evidentimin e cikleve politike në Shqipëri, kryesisht gjatë proceseve zgjedhore, duke përdorur instrumente të ndryshme ekonomike, si për shembull instrumente të politikës fiskale dhe monetare. Në studimin e mëparshëm për ekzistencën e cikleve politike në Shqipëri është gjetur një evidencë e qartë e ekspansionit fiskal përpara zgjedhjeve. Në këtë material si element i financimit të qeverisë dhe i rritjes së ekspansionit fiskal në vendet në tranzicion janë marrë të ardhurat nga privatizimi, për të testuar nëse kemi një rritje të tyre, para zgjedhjeve elektorale. Rezultatet empirike tregojnë një rritje të konsiderueshme dhe statistikisht të rëndësishme të të ardhurave nga privatizimi para zgjedhjeve, duke kontribuar si element bazë i financimit të rritjes së shpenzimeve të qeverisë në këto periudha.

"Niveli optimal i rezervës valutore: një vlerësim empirik për rastin e Shqipërisë", nga Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve. Ky material studimi analizon lidhjen ndërmjet ndryshueshmërisë në transaksionet ndërkombëtare, kostos financiare dhe nivelit të rezervës në rastin e Shqipërisë. Qëllimi i parë është të shqyrtohet ndikimi i ndryshimeve në transaksionet ndërkombëtare në rezervën e mbajtur dhe së dyti të vlerësohet rezerva optimale nga pikëpamja e kostos oportune të mbajtjes së saj. Materiali mbështetet mbi modelin Buffer-Stock, i cili supozon se rezerva optimale ndikohet nga luhatshmëritë në shpenzimet dhe të ardhurat në bilancin e pagesave. Rezerva shërben si amortizues për të zbutur luhatjet në transaksionet e jashtme, ndërsa stoku fillestar është niveli optimal i rezervës. Fokusi i modelit është vlerësimi i rezervës optimale me qëllim sigurimin e mundshëm kundrejt goditjeve nga faktorë ekzogjenë ose "kriza", veçanërisht nga ndërprerjet e flukseve të kapitaleve të huaja dhe kryesisht të remitancave. Volatiliteti i ndryshimit të rezervës është kapur nëpërmjet përqasjes Autoregressive Conditional Heteroskedasticity (ARCH), ndërsa modeli Buffer-Stock është vlerësuar me metodën ARDL. Rezultatet paraqesin një lidhje negative të rezervës me volatilitetin e ndryshimeve në transaksionet ndërkombëtare, negative me kostot oportune, dhe pozitive ndaj vëllimit të importeve. Rezultatet sugjerojnë se rezerva optimale është më tepër e ndjeshme ndaj ndryshimeve në bilancin e llogarisë korrente se sa ndaj kostos oportune të mbajtjes së saj.

Një tjetër material i prezantuar është: "Mbas krizës, strategjitë e reja për politikën monetare evropiane dhe menaxhimi i saj", nga Profesor Franco Bruni, Universiteti Bocconi, Milano. Çështjet kryesore që u trajtuan nga Profesor Bruni lidheshin me strategjitë e reja dhe sfidat me të cilat duhet të përballet BE (Bashkimi Evropian) në të ardhmen, në kuadër të paktit të rritjes, stabilitetit dhe qeverisjes së anëtarëve të saj. Kriza financiare që preku globin në vitin 2007, solli një këndvështim të ri për politikën monetare kudo në botë. Fokusi i saj në të ardhmen nuk do të jetë vetëm qëndrueshmëria e çmimeve, por edhe stabiliteti financiar, si një objektiv eksplicit i politikës monetare në të ardhmen.

Material tjetër i prezantuar është ai me temë: "A mund të konkurrojë ekonomia bujqësore e vogël shqiptare në kushtet e konkurrencës së tregut agroushqimor rajonal e evropian", nga Ismail Beka, zëvendësdrejtor i GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit). Ky prezantim kishte për qëllim analizimin e sektorit të bujqësisë në Shqipëri, problemet që ka aktualisht ky sektor, si dhe evidentimin e sfidave të ardhshme. Të dhënat zyrtare të INSTAT-it tregojnë se gjysma e popullsisë shqiptare jeton në zonat rurale dhe se bujqësia është një ndër veprimtaritë jetike të tyre. Gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, reformat në këtë sektor kanë qenë të pakta, duke bërë që ekonomia shqiptare të vazhdojë të jetë një vend importues neto, pavarësisht burimeve potenciale natyrore që ka. Kështu, ndër sfidat e ardhshme për rigjallërimin e mëtejshëm të sektorit bujqësor përmendim: urbanizimin e zonave të caktuara, planifikimin rural dhe hapësinor, edukimin dhe kualifikimin e individëve, përcaktimin e strategjive të reja me vizione afatgjata, etj..

NGJARJET JURIDIKE, JANAR -QERSHOR 2011

MBIKËQYRJA BANKARE

Në datën 19.01.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratime vendimin nr. 03 rregulloren "Për administrimin e rrezikut operacional". Përmes kësaj rregulloreje përcaktohen kërkesat dhe rregullat për administrimin e rrezikut operacional në veprimtarinë bankare dhe financiare. Subjektet e kësaj rregulloreje, pra bankat, subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim kreditit dhe unionet e tyre, duhet të krijojnë një sistem të brendshëm ku përfshihen politika, procedura, rregulla dhe teknika, për të administrimin sa më efikas të rrezikut operacional.

Na datën 09.03.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 13 "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët"". Përmes këtij vendimi përcaktohet që informacioni parakontraktor dhe ai kontraktor të përfshijnë edhe vlerën e këstit, numrin e kësteve dhe periodicitetin e shlyerjeve të kësteve, si dhe të paraqitet një plan i shlyerjes së kredisë duke përfshirë totalin e detyrimit (kryegjë dhe interes) për të gjithë kredinë. Vendimi sjell ndryshime edhe në nenin që rregullon të drejtat dhe detyrimet në rastin e shlyerjes së kësteve para afatit të maturimit.

Në datën 09.03.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 14 "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare"". Ndryshimet e aprovuara me këtë vendim prekin nenet që rregullojnë kërkesat e përgjithshme për produkte dhe shërbimet bankare, metodën e llogaritjes dhe të publikimit të normës efektive të interesit për kreditë, elemente e marrëveshjes së kredisë dhe informacione të veçanta lidhur me këtë marrëveshje.

Në datën 11.05.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 33 "Për një shtesë në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të huaja në Republikën e Shqipërisë"". Pas këtij ndryshimi, përveç veprimtarive të parashikuara në ligjin nr. 9662 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", bankat dhe degët e bankave të huaja lejohen të kryejnë veprimtarinë e shërbimeve të kasave të sigurimit, gjithmonë pas licencimit ose dhënies së miratimit paraprak nga Banka e Shqipërisë.

Në datën 11.05.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 34 "Për dhënien e miratimit paraprak për rritjen e përqindjes së pjesëmarrjes influencuese të z. Renis Tërshana në kapitalin aksioner të bankës

Credins sh.a.". Sipas këtij vendimi pjesëmarrja e influencës së aksionerit z. Renis Tërshana , nga 19.48% (nëntëmbëdhjetë pikë dyzetetetë për qind) rritet në 20.78% (njëzetë pikë shtatëdhjetetetë për qind) nëpërmjet blerjes së 1.3% (një pikë tre për qind) të aksioneve të z. Sejdin Zere në kapitalin aksioner të Bankës Credins sh.a. .

Në datën 15.06.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 42 rregulloren "Për ekspertin kontabël të autorizuar të bankave dhe degëve të bankave të huaja". Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e kritereve, kushteve dhe procedurave për miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar të bankave nga Banka e Shqipërisë, përcaktimin e auditimit për qëllime të Bankës së Shqipërisë nga eksperti kontabël i autorizuar i bankave dhe degëve të bankave të huaja, si dhe përcaktimin e marrëdhënieve midis ekspertit kontabël dhe Bankës së Shqipërisë

Në datën 15.06.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 43 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka". Përmes këtij vendimi përcaktohet që subjektet financiare jobanka ose institucionet financiare të mikrokredisë, duhet të njoftojnë Bankën e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve për listën e agjentëve të tij apo ndryshime të saj. Gjithashtu, agjenti për ushtrimin e veprimtarisë financiare të transferimit të parave merr miratimin e Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur si agjent është një bankë ose degë e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë.

Në datën 15.06.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 44 "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka e Tiranës sh.a.". Me këtë vendim, Banka e Tiranës sh.a. i jepet miratimi paraprak për kryerjen e veprimtarive financiare shtesë të tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) të letra me vlerë të transferueshme, instrumente të tjera të negociueshme dhe aktive financiare, pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë. Kjo bankë mund të kryejë edhe shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara më sipër.

SIGURIMI DHE MBROJTJA

Në datën 19.01.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 04 rregulloren "Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtari bankare dhe financiare". Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave minimale të sigurisë për ambientet në të cilat ushtrohen veprimtaritë bankare dhe financiare, me qëllim zhvillimin normal dhe në mënyrë sa më të sigurt të tyre. Kështu, përmes saj rregullohen procedurat për kushtet teknike të sigurisë, kushtet për zonën e arkëtarëve, kushtet për zonën e ruajtjes së vlerave monetare, kushtet për mbrojtjen me anë të pajisjeve elektronike, kërkesat për transportin e vlerave monetare etj.

SISTEMI I PAGESAVE

Në datën 23.02.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr 12 "Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloret "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe- AIPS" dhe "Për funksionimin e sistemit të blerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)". Këto ndryshime, ndër të tjera, përcaktojnë se çmimi i komisioneve për të gjitha urdhërpagesat në nisje në AIPS, nuk duhet të jetë më i madh se 1,500 lekë, ndërsa çmimi i komisioneve për të gjitha urdhërpagesat në nisje në AECH nuk duhet të jetë më i madh se 500 lekë.

POLITIKA MONETARE

Në datën 23.03.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 21 "Për rritjen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes". Sipas këtij vendimi, duke u rritur me 0.25 pikë përqindje, norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, nga 5%, bëhet 5.25%.

Në datën 23.03.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 22 "Raportin vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2010". Sipas këtij raporti, aktiviteti ekonomik në vend u rrit në mënyrë progresive gjatë këtij viti, i ndihmuar edhe nga ecuria pozitive e ekonomisë botërore dhe nga dinamizmi i sektorit privat. Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 3.6%, duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimi i kuadrit operacional të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, i ndërmarrë në muajin qershor, i shërbeu rritjes së efektivitetit të politikës monetare, si dhe nxitjes së funksionimit të tregut ndërbankar.

Në datën 27.04.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 26 "Raportin e politikës monetare për tremujorin e parë të vitit 2011. Sipas këtij raporti, ekonomia shqiptare gjatë kësaj periudhe, vlerësohet të patur një ecuri pozitive. Zgjerimi i shpejtë i eksporteve dhe rritja e moderuar e importeve kanë sjellë një përmirësim të deficitit tregtar, ndërkohë që inflacioni rezultoi 4.0%, kryesisht si pasojë e efektit të rritjes së çmimeve të mallrave ushqimore dhe çmimit të naftës në tregjet botërore. Në përgjigje të këtij fenomeni, Banka e Shqipërisë rriti normën e saj bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje në fund të muajit mars. Në të ardhmen, presionet inflacioniste parashikohen të mbeten të larta, por intensiteti i tyre do të vijë në rënie gjatë vitit.

Në datën 27.04.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 29 "Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi minimumin e rezervës së detyruara të mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat". Sipas këtyre ndryshimeve, Banka e Shqipërisë mund të remunerojë bankat për mbajtjen e rezervës së detyruar në lekë dhe në valutë, për periudhën e mbajtjes së saj, ndërsa norma e remunerimit përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe njoftohet të paktën 30 ditë pune përpara fillimit të periudhës së mbajtjes.

TEKNOLOGJIA DHE INFORMACIONI

Në datën 09.03.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 17 rregulloren "Për sigurinë e informacionin". Kjo rregullore ka për qëllim hartimin e një strategjie për zbatimin e Politikës së Sigurisë së Informacionit në Bankën e Shqipërisë. Përmes saj përcaktohen rregulla të përgjithshme mbi sigurinë e informacionit dhe prek të gjitha burimet dhe sistemet e informacionit në pronësi ose përdorim të Bankës së Shqipërisë.

STABILITETI FINANCIAR

Në datën 23.03.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 24 "Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2010". Sipas këtij raporti, në fund të gjashtëmujorit, gjendja e sistemit financiar dhe e sektorit bankar vlerësohet e qëndrueshme. Veprimtaria e sistemit tonë financiar është zgjeruar duke e rritur peshën ndaj PBB-së në nivelin 85%. Gjendja e kapitalizimit dhe e likuiditetit të veprimtarisë paraqitet e mirë. Nevoja për të përmirësuar cilësinë e kredisë, vijon të përfaqësojë sfidën kryesore me të cilën ndeshet sektori bankar. Bankat tregtare duhet të vlerësojnë qëndrueshmërinë e tyre dhe duhet të veprojnë paraprakisht në drejtim të forcimit të gjendjes së tyre të kapitalit dhe të kontrollit të rreziqeve të veprimtarisë, ndërsa Banka e Shqipërisë do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme operacionale dhe do të vlerësojë nevojën për plotësime e përmirësime në kuadrin rregullativ dhe mbikëqyrës.

EMISIONI

Në datën 25.05.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 39 rregulloren "Për eksport-importet e kartëmonedhave e të monedhave metalike shqiptare". Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i sasisë dhe procedurave për eksport–importin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare, me ose pa kurs ligjor. Përmes saj, ndër të tjera, përcaktohet se importi cash i monedhave shqiptare me kurs ligjor, është e drejtë ekskluzive e Bankës së Shqipërisë dhe se individët kanë të drejtë të eksportojnë apo të importojnë monedha shqiptare cash me kurs ligjor, pa kaluar shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Në datën 25.05.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 40 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 27, datë 30.03.2005 "Për shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, për vitin 2006"". Me miratimin e këtij vendimi, përcaktohen specifikat e të dhënat teknike të monedhës metalike prerja 50 (pesëdhjetë lekë, me tematikë "Kodiku i purpurt i Beratit 043 Φ - Beratinus – 1", pa kurs ligjor.

Në datën 29.06.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 48 "Për rishtypjen e kartëmonedhës shqiptare me kurs ligjor, me prerje 1000 lekë". Përmes këtij vendimi parashikohet rishtypja, në vitin 2011, e kartëmonedhës me prerje 100 lekë, imazhi "Pjetër Bogdani", emetim i vitit 2007

POLITIKA EKONOMIKE

Në datën 07.01.2011, Ministri i Financave miratoi udhëzimin nr. 3 "Për disa shtesa në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar". Ky udhëzim parashikon, mes të tjerash, që në të ardhurat e tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, të përfshihen të ardhurat monetare që shkojnë për shtimin e kapitalit të shoqërisë, nga individët me burim të ardhurash nga jashtë shoqërisë, nëse këta individë nuk janë tatuar më parë për këto të ardhura. Tatimi do të paguhet në të njëjtën datë që individi do të paguajë të ardhurën monetare për shtimin e kapitalit të shoqërisë pranë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Në datën 10.01.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Regullator të Energjisë miratoi vendimin nr. 1 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të shitjes së energjisë elektrike". Përmes miratimit të këtij vendimi synohet të sigurohen rregulla dhe procedura të thjeshta për operime të shpejta, bazuar në një proces konkurrues dhe transparent, për realizimin e shitjes së energjisë elektrike, pa cënuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike të klientëve.

Në datën 12.01.2011, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 18 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1058, datë 21.10.2009 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH)". Pas këtij ndryshimi për tatimpaguesit që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, përmes profesioneve të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, farmacist, arkitekt, projektues, ekonomist, ekspert kontabël, etj., pavarësisht nga qarkullimi vjetor, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në hiqet dhe të gjithë janë subjekte të TVSH-së.

Në datën 19.01.2011, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 33 "Për miratimin e rregullores "Për procedurën e shqyrtimit, nga Komisioni i Prokurimit Publik, të ankesave ndaj procedurave të ankandit apo vendimeve për përjashtim nga këto procedura" dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të ankandit publik". Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit nga Komisioni i Prokurimit Publik, të ankesave ndaj procedurave të ankandit, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, barazisë, paanësisë në vendimmarrje, transparencës dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.

Në datën 02.02.2011, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 84 "Protokollin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Çekisë, për ndryshime në marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Çekisë "Për nxjerrjen dhe mbrojtjen e ndërsjellët të investimeve". Ndryshimet që sjell ky vendim në protokollin e nënshkruar më parë mes palëve, kanë të bëjnë kryesisht me njohjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në një bashkim doganor, ekonomik apo monetar, në një treg të përbashkët ose në një zonë të tregtisë së lirë. Gjithashtu, dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk do të interpretohen në mënyrë që të detyrojnë një palë kontraktuese të shtrihet deri tek investitorët e palës tjetër kontraktuese, ose të ardhurat e investitorëve

të tjerë, përfitime nga çdo trajtim, privilegj apo preferencë, të cilat mund të zbatohen nga pala kontraktuese, duke u mbështetur në cilindo marrëveshje ndërkombëtare ose angazhim që lidhen tërësisht ose kryesisht me taksat.

Në datën 10.02.2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10369 "Marrëveshjen e ndihmës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për qeverisjen me drejtësi dhe në mënyrë demokratike, investimin në njerëz dhe rritjen ekonomike". Në mënyrë që të plotësohen objektivat e ndihmës së huaj për qeverisjen me drejtësi dhe në mënyrë demokratike, investimin në njerëz dhe rritjen ekonomike, palët nënshkruese bien dakord të punojnë së bashku duke i përqendruar aktivitetet në fushat të ndryshme si ajo e shëndetësisë, shtetit ligjor, qeverisjes së mirë dhe rritjes së sektorit privat. Objektivat e kësaj marrëveshjeje përqendrohen në mbështetjen e transformimin e Shqipërisë në një demokraci të qëndrueshme sociale dhe ekonomike. Për arritjen e këtyre objektivave, kontributi total i USAID-it do të jetë 75,000,000 $ (shtatëdhjetë e pesë milionë dollarë amerikanë).

Në datën 11.02.2011, Enti Rregullator i Energjisë miratoi me vendimin nr. 9 "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm apo të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror". Nëpërmjet kësaj rregulloreje përcaktohen procedurat e licencimit për kryerjen e aktivitetit brenda sektorit të gazit natyror, duke specifikuar termat dhe kushtet për dhënien, ndryshimin, rinovimin apo heqjen e një licence, si dhe ngarkohet ERE për përcaktimin e pagesave që duhet të kryhen për të gjitha llojet e aplikimeve. Rregullorja vepron rregullon licencimin për aktivitete si, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin apo tregtimin e gazit natyror.

Në datën 17.02.2011, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Financave miratuan udhëzimin nr. 6 "Për disa shtesa në udhëzimin nr. 6257, datë 2.9.2008 "Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti", të ndryshuar". Këto shtesa, ndër të tjera, vendosin kushtin që asnjë anëtar i familjes që përfiton kredi të lehtësuar, të mos jetë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar. Me ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit, ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave, i cili bën verifikimet e nevojshme në të gjitha institucionet publike e private, qendrore e vendore, të ngarkuara për lëshimin e dokumenteve.

Në datën 24.02.2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10382 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës për bashkëpunimin për zhvillim". Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të forcojë lidhjet e miqësisë midis dy vendeve nënshkruese, duke synuar që të kontribuojnë për rritjen e zhvillimin e qëndrueshëm e të barabartë shoqëror, si dhe drejt reformave politike, ekonomike e shoqërore të nevojshme për përshtatjen sa më të mirë të Shqipërisë me strukturat e BE-së. Për përmbushjen e këtyre objektivave, Danimarka angazhohet të vendosë në dispozicion të Shqipërisë asistencë financiare, burime materiale, asistencë teknike dhe mundësi kualifikimi, ndërsa Shqipëria do të sigurojë efikasitetin e tyre.

Në datën 02.03.2011, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta miratoi udhëzimin nr. 4 "Për kriteret e përdorimit të fondit të pashpërndarë të mbrojtjes sociale për vitin 2011". Sipas këtij udhëzimi, fondi i pashpërndarë i mbrojtjes sociale do të përdoret për mbështetjen me fonde të rasteve të paparashikuara, si nga fondet e njësive të qeverisjes vendore, ashtu edhe nga fondet e buxhetit të shtetit. Kategoritë që do të përfitojnë nga ky fond janë familjet apo individët në nevojë në raste fatkeqësish, njësitë e qeverisjes vendore për plotësimin e nevojave të paparashikuara, si dhe shërbimet sociale komunitare të cilat ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve, të moshuarve apo individëve në nevojë.

Në datën 10.03.2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10392 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, përfaqësuar nga Ministri Federal i Financave, për bashkëpunim financiar". Përmes nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, qeveritë e dy vendeve synojnë të nxitin dhe zgjerojnë bashkëpunimin financiar brenda kuadrit të ligjeve, rregulloreve dhe politikave të tyre ekzistuese përkatëse. Kështu, pala austriake angazhohet të mbështetë dhënien e kredive për ndihmën e kushtëzuar me terma koncesionarë, të rifinancuar nga Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft (OeKB), deri në shumën 40 000 000 (dyzet milion) euro.

Në datën 17.03.2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10396 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për transportin detar". Përmes nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje palët synojnë të përmbushin interesat e përbashkëta për krijimin e një baze ligjore të vazhdueshme për mbarëvajtjen e marrëdhënieve reciproke tregtare nëpërmjet transportit detar, për të siguruar zhvillimin e tregtisë së lirë dhe rritjen e nivelit të mundësive të marrëdhënieve ndërkombëtare në këtë fushë.

Në datën 17.03.2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10399 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar". Përmes këtyre ndryshimeve, ndër të tjera, përcaktohet që përfituesit e ndihmës ekonomike do të jenë fëmijët në nevojë; jetimët që nuk janë përfshirë në institutet dedikuar atyre; prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë; viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror e deri në çastin e punësimit; si dhe viktimat e dhunës në familje.

Në datën 24.03.2001, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10402 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Singaporit për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat". Sipas kësaj marrëveshjeje, nëse një rezident i Shqipërisë përfton të ardhura që, në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, mund të tatohen në Singapor, Shqipëria lejon si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e

atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Singapor. Gjithashtu, nëse një rezident i tij përfton të ardhura nga Shqipëria, që mund të tatohen edhe atje, Singapori lejon tatimin shqiptar të paguar, drejtpërdrejt ose me zbritje, si rezultat i kredisë ndaj tatimit të Singaporit të pagueshëm mbi të ardhurat e atij rezidenti.

Në datën 24.03.2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10404 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". Nëpërmjet këtyre ndryshimeve, në ligjin " Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" specifikohen kërkesat e përgjithshme për mallrat e akcizës që kërkojnë pulla fiskale, si dhe çmimi e mënyra se si paguhet çdo pullë fiskale e prodhuar dhe e shpërndarë nga një koncesionar i autorizuar për lëshimin, shpërndarjen dhe monitorimin e tyre.

Në datën 31.03.2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10407 "Marrëveshjen e huasë dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar për Zhvillim, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit "Fondi i investimeve sociale IV". Fondi i huasë prej jo më shumë se 20 milion (20000000) eurosh do të përdoret për të përmirësuar përdorimin e infrastrukturës së rehabilituar dhe të rindërtuar të rrugëve rurale, si dhe përdorimi i skemave të ujësjellësve ruralë të rehabilituar dhe të rindërtuar me rrjedhje të lirë në tarifa që mbulojnë koston të pranueshme nga pikëpamja sociale. Norma e interesit fikse e caktuar mbi huanë është 2% dhe shlyera e plotë e saj parashikohet të përfundojë në vitin 2025.

Në datën 07.04.2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10415 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 " Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". Ndryshimet e parashikuara në këtë ligj prekin nenet që rregullojnë identifikimin e personave që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar, procedurat që duhen ndjekur për çregjistrimin e subjekteve pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore të papaguara, si dhe procesin e sekuestrimit, konfiskimit e të likuidimit në rast të mos shlyerjes së plotë të këtyre detyrimeve.

Në datën 13.04.2011, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës miratoi urdhrin nr. 305 "Për procedurat dhe formën e hartimit të programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare". Sipas këtij urdhri, programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare është dokumenti afatmesëm i planifikimit minerar, që hartohet në bazë të strategjisë minerare dhe është i vlefshëm për një periudhë tre vjeçare. Ai duhet të përmbajë drejtimet për zhvillimin e sektorit minerar; promovimin e zonave minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare, përmes procesit të konkurrimit; programimin e veprimtarive të kërkimeve themelore gjeologjike; parashikimin e përgjithshëm të produktit vjetor në sektorin minerar; zonat e rrezikshme, ku veprimtaria minerare është e ndaluar dhe ku ndalohet dhënia e të drejtave minerare; zonat minerare perspektive, etj.

Në datën 21.04.2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10418 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor". Përmes këtij ligji përcaktohen parimet dhe garancitë e subjekteve që përfitojnë nga legalizimi i kapitalit, kompetencat e organeve administrative publike e të bankave, që marrin pjesë në procesin e legalizimit të kapitalit, si dhe veprimtaritë e lidhura me këtë proces. Gjithashtu, në ligj parashikohet falja e një pjese të borxhit tatimor e doganor, të kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, dhe kompetencat e organeve të administratave tatimore dhe doganore, të cilat evidentojnë debitorët që do të përfitojnë nga ky ligj.

Në datën 26.04.2011, Ministri i Financave miratoi udhëzimin nr. 9 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, lidhur me deklaratën individuale vjetore të të ardhurave". Përmes këtyre shtesave rregullohen procedurat që duhen ndjekur për të përmbushur detyrimin për dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave. Në udhëzim përcaktohen gjithashtu edhe rastet kur individë të caktuar përjashtohen nga ky detyrim.

Në datën 26.05.2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10419 "Marrëveshjen Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për financiamin e projektit të rrugës Tiranë- Elbasan". Sipas kësaj marrëveshjeje, Banka Islamike për Zhvillim do të marrë pjesë në financimin e projektit sipas mënyrës së Istisna's, me një shumë prej 222,700,000 (dyqind e njëzet e dy milionë e shtatëqind mijë dollarë amerikanë) USD. Financimi i IDB-së do të mbulojë koston e shpenzimeve të ndërtimit dhe shërbimeve të konsulencës nga km 10+400 deri në km 18+400 (tuneli është përfshirë plotësisht në këtë seksion). Rruga e re e parashikuar, Tiranë –Elbasan, do të jetë një rrugë e ndarë në 4 korsi. Objektivat kryesorë të projektit janë sigurimi i një lëvizjeje të pandërprerë të trafikut, reduktimi i kostove operative të automjeteve, reduktimit të aksidenteve automobilistike, kursimi i kohës së udhëtimit dhe rritja e përgjithshme ekonomike në zonën e projektit.

Në datën 26.05.2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10421 "Për ratifikimin protokollit shtesë të marrëveshjes për ndryshimin dhe anëtarësimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore". Sipas këtij protokolli, Republika e Shqipërisë, Republika e Kroacisë, Republika e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Mali i Zi dhe Republika e Serbisë do të eliminojnë të gjitha tarifat doganore në import, të gjitha detyrimet me efekt të njëjtë dhe të gjitha tarifat e importit me natyrë fiskale në tregtinë ndërmjet tyre në datën e hyrjes në fuqi të këtij protokolli shtesë, për të gjitha produktet e ndryshme nga ato që janë subjekt i koncesioneve dypalëshe.

Në datën 01.06.2011, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 391 "Për miratimin e statutit të Shoqërisë "Nxitja e biznesit social" sh.a. ". Sipas këtij vendimi, Shoqëria është një shoqëri aksionare me ofertë private, ndërsa objekti i saj është zhvillimi ekonomik dhe social i qëndrueshëm, përmes nxitjes për zhvillim në nivel kombëtar të një biznesi social të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv. Për arritjen e qëllimit të sipërpërmendur, shoqëria

ndjek qëllimet e saj sociale dhe mjedisore, përmes mbështetjes dhe nxitjes së bizneseve sociale dhe të mikrofinancës, si dhe krijon mundësi për të ardhura të qëndrueshme për shtresat e varfra të shoqërisë në Republikën e Shqipërisë. Në çastin e themelimit, shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, zotëron 10 000 (dhjetë mijë) aksione të barabarta me 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë.

Në datën 02.06.2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10427 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse për përmbushjen e detyrimeve financiare të Republikës së Shqipërisë kundrejt Federatës Ruse për balancat e llogarive të korporatës shtetërore "Banka e Zhvillimit dhe Veprimtarisë Ekonomike me Jashtë (Vneshenkonombank)" te Banka e Shtetit Shqiptar". Kjo marrëveshje do të zbatohet për detyrimet financiare të Republikës së Shqipërisë ndaj Federatës Ruse që përfaqësojnë balancën e përgjithshme të pashlyer në llogaritë e korporatës shtetërore "Banka e Zhvillimit dhe Veprimtarisë Ekonomike me Jashtë (Vneshekonombank)", të hapur në Bankën e Shtetit të Shqipërisë, për t'i shërbyer xhiros tregtare dhe operacioneve jotregtare ndërmjet BRSS-së dhe Republikës Popullore të Shqipërisë. Borxhi, i konvertuar në dollarë amerikanë, arrin shumën 1.036.723,48 (një milion e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet e tre presje dyzet e tetës) USD dhe do të shlyhet tërësisht nga pala shqiptare, jo më vonë se data 30 qershor 2011.

DREJTIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË, 30 QERSHOR 2011

KËSHILLI MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI	Kryetar
FATOS IBRAHIMI	Zëvendëskryetar
TEFTA ÇUÇI	Anëtare
LIMOS MALAJ	Anëtar
KSENOFON KRISAFI	Anëtar
ADRIAN CIVICI	Anëtar
ARJAN KADAREJA	Anëtar
HALIT XHAFA	Anëtar
BENET BECI	Anëtar

GUVERNATORI

ARDIAN FULLANI

ZËVENDËSGUVERNATORËT

FATOS IBRAHIMI — Zëvendësguvernator i Parë

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

ELIVAR GOLEMI

KABINETI I GUVERNATORIT

GENC MAMANI

DREJTUES PËR KOORDINIMIN PRANË KABINETIT TË GUVERNATORIT

GRAMOZ KOLASI

DEPARTAMENTET DHE NJËSITË E TJERA

DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE	*Roden Pajaj*
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE	*Erald Themeli*
DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE	*Altin Tanku*
DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE MONETARE	*Marjan Gjermeni*
DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES	*Indrit Banka*
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR	*Klodion Shehu*
DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	*Xhilda Kanini*
DEPARTAMENTI I STATISTIKËS	*Diana Shtylla*
DEPARTAMENTI I EMISIONIT	*Dorian Collaku*
DEPARTAMENTI I KONTABILITETIT DHE FINANCËS	*Elsa Bizhga*
DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE	*Dashmir Halilaj*
DEPARTAMENTI JURIDIK	*Toni Gogu*
DEPARTAMENTI I KONTROLLIT	*Elivar Golemi*
DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË, INTEGRIMIT EVROPIAN DHE I KOMUNIKIMIT	*Oneda Andoni*
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT	*Agron Skënderaga*
DEPARTAMENTI I SIGURIMIT DHE MBROJTJES	*Eduard Sinani*

DEGËT

Shkodër	*Ermira Istrefi*
Elbasan	*Valentina Dedja*
Gjirokastër	*Anila Thomaj*
Korçë	*Liljana Zjarri*
Lushnje	*Shpresa Meço*

BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË, DERI NË 30 QERSHOR 2011

1. BANKA RAIFFEISEN SH.A.
Licenca nr. 2/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 163, datë 11.12.1998.
Certifikata nr. 2 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Christian CANACARIS
Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Qendra Tregtare Evropiane, Tiranë.
Telefon: +355 4 2274 910
Faks: +355 4 2275 599
E – mail: info@raiffeisen.al
Website: www.raiffeisen.al

2. BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A.
Licenca nr. 3/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 165, datë 11.12.1998.
Certifikata nr. 3 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Hikmet GÜLER
Adresa: Rruga "Durrësit", sheshi "Rilindja" (Zogu i Zi), Godina Teknoprojekt. P.O. BOX 128, Tiranë.
Telefon: +355 4 2228 460 / 2223 873 / 2227 408
Faks: +355 4 2228 460 / 2228 387
E-mail: info@ubaal.com
Website: -

3. BANKA VENETO SH.A.
Licenca nr. 5/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 164, datë 11.12.1998.
Certifikata nr.4 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Libero CATALANO (deri më 31.12.2010)
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Ndërtesa Kullat Binjake, Tiranë.
Telefon: +355 4 2280 555
Faks: +355 4 2280 356
E – mail: info@bisbanca.com
Website: www.bisbanca.com

4. BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A.
Licenca nr. 6/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 162, datë 11.01.1999.
Certifikata nr. 5 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Seyhan PENCAPLIGIL
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë.
Telefon: +355 4 2250 955
Faks: +355 4 2250 956
E – mail: info@ bkt.com.al

Website: *www. bkt.com.al*

5. BANKA TIRANA SH.A.
Licenca nr. 07, datë 12.09.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 12.09.1996.
Certifikata nr. 6 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Dimitrios SANTIXIS*
Adresa: *Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", PO BOX 2400/1, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2269 616 / 7 / 8, +355 4 2233 441 / 42 / 43 / 44 / 45 / 46 / 47*
Faks: *+355 4 2233 417 / 2369 707*
E – mail: *info@tiranabank. al*
Website: *www. tiranabank. al*

6. DEGA E BANKËS KOMBËTARE TË GREQISË, TIRANË
Licenca nr. 08, datë 25.11.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4, datë 14.03.1996.
Certifikata nr. 7 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Ioannis KOUGIONAS*
Adresa: *Rruga "Durrësit", Godina Comfort, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2274 802 / 2274 822*
Faks: *+355 4 2233 613*
E – mail: *nbgalbania@ icc-al.org*
Website: *-*

7. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SH.A.
Licenca nr. 09, datë 20.02.1997.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 30.04.1996.
Certifikata nr. 8 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Mahendra Singh RAWAT*
Adresa: *Qendra e Biznesit, Rruga "Murat Toptani", Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2254 372 / 2256 254*
Faks: *+355 4 2254 368*
E – mail: *info@icbank-albania.com*
Website: *-*

8. DEGA E BANKËS ALPHA – ALBANIA
Licenca nr. 10, datë 07.01.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 01/03/96, datë 27.12.1997.
Certifikata nr. 9 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Andreas GALATOULAS*
Adresa: *Rruga "Kavajës", G – KAM Business Center, kati II, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2278 500*
Faks: *+355 4 2232 102*
E – mail: *tiranabranch@alpha.gr*
Website: *-*

9. BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SH.A.
Licenca nr. 11, datë 10.08.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 105, datë 10.08.1998.
Certifikata nr. 10 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Stefano FARABBI*

Adresa: *Rruga "Ismail Qemali", Nr. 27, P.O. BOX 8319, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2248 753 / 4 / 5 / 6, +355 4 2276 000*
Faks: *+355 4 2248 762*
E – mail: *helpdesk@intesasanpaolobank.al*
Website: *www.intesasanpaolobank.al*

10. BANKA PROCREDIT SH.A.
Licenca nr. 12, datë 15.03.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 03.03.1999.
Certifikata nr. 11 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Flutura VEIPI*
Adresa: *Rruga "Durrësit", Laprakë, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2389 300*
Faks: *+355 4 2233 918*
E mail: *info@ procreditbank.com.al*
Website: *www.procreditbank.com.al*

11. BANKA EMPORIKI – SHQIPËRI SH.A.
Licenca nr. 14, datë 28.10.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999.
Certifikata nr.13 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *George CARACOSTAS*
Adresa: *Rruga "Kavajës", nr. 59, "Tirana Tower", Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2258 755 / 56 / 57 / 58 / 59 / 60*
Faks: *+355 4 2258 752*
E – mail: *headoffice@ emporiki.com.al*
Website: *www.emporiki.com.al*

12. BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
Licenca nr. 15, datë 28.08.2002.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 66, datë 28.08.2002.
Certifikata nr. 14 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Sherine KAMEL*
Adresa: *Rruga Perlat Rexhepi, Al-Kharafi Group Admistration Building, Kati 1&2, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2272 168, +355 4 2272 162*
Faks: *+355 4 2272 162*
E-mail: *creditbkalb@icc-al.org*
Website: *-*

13. BANKA CREDINS SH.A.
Licenca nr. 16, datë 31.03.2003.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 26.03.2003.
Certifikata nr. 15 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Artan SANTO*
Adresa: *Rruga "Ismail Qemali", nr. 21, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2234 096*
Faks: *+355 4 2222 916*
E –mail: *info@ bankacredins.com*
Website: *www.bankacredins.com*

14. BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A. (ISH BANKA POPULLORE SH.A.)
Licenca nr. 17, datë 16.02.2004.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 06, datë 11.02.2004.
Certifikata nr. 16 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori:	*Hubert de SAINT JEAN*
Adresa:	*Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", kullat Binjake, kulla 1, kati i 9-të, Tiranë.*
Telefon:	*+355 4 2280 442 / 3*
Faks:	*+355 4 2280 441*
Mobile:	*068 (69) 20 60 974*
E-mail:	*bp.info@socgen.com*
Website:	*www.bpopullore.com*

15. BANKA UNION SH.A.
Licenca nr. 18, datë 09.01.2006.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 101, datë 28.12.2005.
Certifikata nr. 17 " Për sigurimin e depozitave".

Drejtori:	*Gazmend KADRIU*
Adresa:	*Bulevardi "Zogu I", pallati 13-katësh, përballë Stacionit të Trenit, Tiranë.*
Telefon:	*+355 4 2250 653 / 2258 081*
Faks:	*+355 4 2272 880*
E – mail:	*info@ unionbank.com.al*
Website:	*www.unionbank.com.al*

16. BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A.
Licenca nr. 19, datë 06.07.2007.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 35, datë 27.06.2007.
Certifikata nr. 12 " Për sigurimin e depozitave".

Drejtori:	*Bozhidar TODOROV*
Adresa:	*Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", kullat Binjake, kulla 2, kati 14, Tiranë.*
Telefon:	*+355 4 2276 702 / 3*
Faks:	*+355 4 2280 210*
E – mail:	*-*
Website:	*www.fibank.al*

Përveç bankave dhe degëve të bankave të huaja, Banka e Shqipërisë ka licencuar deri më 30 Qershor 2011 edhe subjektet e mëposhtme:

Nr.	Subjekte
19	SUBJEKTE JOBANKA
292	ZYRA TË KËMBIMIT VALUTOR
2	UNIONE TË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT
126	SHOQËRI TË KURSIM-KREDITIT
1	ZYRË E PËRFAQËSIMIT TË BANKAVE TË HUAJA

PUBLIKIME TË BOTUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2011

Kjo listë u përpilua për të informuar lexuesit mbi botimet e Bankës së Shqipërisë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2011. Duke vizituar faqen tonë zyrtare të internetit (www.bankofalbania.org) mund të plotësoni e dërgoni formularin në public@bankofalbania.org ose në faks + 355 4 2419408 dhe të regjistroheni për t'u bërë pjesë e listës së shpërndarjes të botimeve të Bankës së Shqipërisë.

Gjithashtu, ju mund të përfitoni nga shërbimi i njoftimeve automatike të Bankës së Shqipërisë. Nëpërmjet këtij shërbimi, çdo mesnatë, sistemet e Bankës do t'ju njoftojnë në postën tuaj elektronike rreth ndryshimeve apo të rejave në argumentet që keni përzgjedhur. Më poshtë mund të gjeni titujt e publikimeve të Bankës së Shqipërisë të botuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2011. Kjo listë nuk përfshin vrojtimet e kryera nga Banka e Shqipërisë, të cilat publikohen vetëm në formë elektronike (http://www.bankofalbania.org/web/vrojtime_3405_1.php).

RAPORTI VJETOR:

Raporti Vjetor 2010

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR:

Raporti i Stabilitetit Financiar, Gjashtëmujori i dytë 2010

RAPORTI VJETOR I MBIKËQYRJES:

Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes 2010

RAPORTET PERIODIKE TË POLITIKËS MONETARE:

Raporti i politikës monetare për tremujorin e katërt 2010
Raporti i politikës monetare për tremujorin e parë 2011

BOTIME PËR STATISTIKAT:

Raporti Mujor Statistikor (Botohet çdo muaj të vitit).

BULETINI ZYRTAR :

Buletini Zyrtar – Vëllimi 13, nr. 1
Buletini Zyrtar – Vëllimi 13, nr. 2

Buletini Zyrtar – Vëllimi 13, nr. 3
Buletini Zyrtar – Vëllimi 13, nr. 4
Buletini Zyrtar – Vëllimi 13, nr. 5

BULETINI I BANKËS SË SHQIPËRISË:

Buletini i Bankës së Shqipërisë - Gjashtëmujori i parë 2010
Buletini i Bankës së Shqipërisë - Gjashtëmujori i dytë 2010

MATERIALE DISKUTIMI:

Pozicioni konkurrues i ekonomisë shqiptare në terma të produktivitetit e të kostos së punës - Evelina Çeliku, Iris Metani
Vlerësimi i peshave për indeksin e kushteve monetare në Shqipëri – Oriela Kodra
Persistenca e inflacionit në Shqipëri – Vasilika Kota
Analizë e sistemit bankar Shqiptar nën këndvështrimin rrezik - performancë – Irini Kalluci

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË:

Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë, Nr.5
Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë, Nr.6

PUBLIKIME EDUKATIVE-INFORMATIVE:

Broshura "Simbolika e kartëmonedhave shqiptare"
Broshura "7 mësime të shkurtra për paranë"
Fletëpalosja "Rrugëtimi i parasë"
Broshura "Banka Qendrore Evropiane; Eurosistemi; Sistemi Evropian i Bankave Qendrore"
Broshura "Regjistri i kredive" (ribotim)
Broshura "Çfarë është Raporti mbi Kredimarrësin?" (ribotim)
Broshura "Qendra e kërkimit dhe trajnimit të Bankës së Shqipërisë në Berat" (vetëm në anglisht)

TË TJERA:

"Politika të stabilitetit monetar dhe financiar – leksione nga kriza" – Punimet e Konferencës së 8-të Ndërkombëtare të Bankës së Shqipërisë
"Politikat ekonomike në EJL: Hartimi, ecuria dhe sfidat" - Ideoi dhe përgatiti, Ardian Fullani (vetëm në anglisht)